



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 11, 12 DHE 15 DHJETOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
11. 12. i 15. DECEMBRA 2008. GODINE

DHJETOR – DECEMBAR
2008

Më 11.12.2008, ora 10:00

Seancën e kryesoi Jakup Krasniqi, Kryetari i Kuvendit

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë me seancën, në emër tuaj edhe në emër të qytetarëve, përshëndesim dhe i urojmë marrjen e Çmimit Nobel, Presidentit Ahtisari, duke i dëshiruar fat dhe shëndet në familje, duke ia uruar dhe festat e fund vitit dhe njëkohësisht veprës së tij i dëshirojmë shëndet të mirë dhe kemi besim se shëndeti i kësaj vepre do të jetë i mirë. Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Hap punimet e seancës së sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Është kjo seanca e 50 me radhë në legjislaturën e tretë.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 78 deputetë, që do të thotë janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

I kemi para se të fillojmë 2 diskutues, po shpresoj se tjerë nuk shtohen. Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Duke pasur parasysh se ne si deputet kur po bëjmë pyetjet parlamentare po na shkojnë 6 muaj për t'u lexuar një pyetje, unë e kam parë të udhës që ta ngre një çështje të rëndësishme, e cila ka të bëjë me shërbimet korrektuese në Kosovë, shërbime këto të cilat kanë defekte të mëdha pas luftës.

Ne e dimë se deri në vitin 2006, deri në mars të vitit 2006, UNMIK-u ka menaxhuar shërbimet korrektuese, por pas vitit 2006 shërbimet korrektuese menaxhohen nga ne. Andaj unë dua t'ju përkujtoj se në vitin 2001 nga Burgu i Mitrovicës kanë ikur 21 kriminelë serbë të akuzuar për krime lufte dhe askush nuk është marrë në përgjegjësi dhe askush nuk e ka thënë asnjë fjalë as në Kuvendin e atëhershëm as më vonë.

Në vitin 2007 kanë ikur 7 burgosur nga Burgu i Dubravës, 2 prej tyre nuk jetojnë më, janë vrarë në Maqedoni dhe ata kanë pasur të drejtë të jetojnë edhe pse kanë qenë të dënuar edhe pse kanë ikur, por nuk jetojnë më, sepse dikush i ka menaxhuar keq burgjet.

Dhe, në vitin 2008 nga dera kryesore e Burgut më të ruajtur në Kosovë, me duar në xhepa iku i burgosuri dhe në burg shkojnë disa gardianë, por nuk shkon hierarkia kryesore e

udhëheqjes të legjislacionit të Kosovës apo e Ministrisë së Drejtësisë apo e drejtorëve të cilët duhet ta menaxhonin më mirë burgun.

Them këtë, sepse po krijohen probleme mandej, kështu që të gjithë të burgosurit që ikin, nuk vijnë me dëshirë më në burg. Prandaj, ne kemi bërë Ligjin për falje dhe kërkojmë procedura që ata njerëz që dëshirojmë t'i falim, t'i falim me procedura dhe jo pa procedura, me duar në xhepa, duke e kënduar këngën e Isuf Hajdarit të dalin prej burgu. Le të harrojnë ata që mendojnë se këtu është

KRYETARI: Ja Gani, Faleminderit!
Fjalën e ka kërkuar deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedniče!

Ja imam u vezi treçe tačke, koja će doći verovatno kasnije na dnevni red i želim pre nego što ta tačka u kojoj ćemo uzeti učešća, u ime Koalicije Vakat zahtevamo da Vlada zaustavi realizaciju projekata u Ministarstvu za zajednice i povrata, gde su na delu zloupotreba sredstava iz budžeta Kosova. Juče smo imali konferenciju, izneli smo puno podataka, jer se radi o interesnoj grupi oko SLS, koja na jedan veoma nekorektan način želi da menadžira sredstvima iz budžeta Kosova. Mi smo dokumentaciju predali i Agenciji protiv korupsije, ali želimo da Vlada na vreme zaustavi ovo da se bi kasnije suočavala sa drugim problemima. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!
Vazhdojmë me rendin e ditës.

Pika e parë e rendit të ditës.

- Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 20 dhe 25 nëntor 2008

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se procesverbalet dhe transkriptet të seancave plenare të mbajtura më 20 dhe 25 nëntor 2008 u janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët a kanë vërejtje në procesverbale? Nuk ka. Atëherë, konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 20 dhe 25 nëntor 2008.

Pika e dytë e rendit të ditës:

- Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të Rregullës 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.11 të Rregullores pyetjet e parashtruara gjatë muajve shtator, tetor 2008 të cilat nuk kanë marrë përgjigje brenda 2 seancave, do të publikohen në Buletinin e Kuvendit.

Fillojmë me procedimin e pyetjeve të parashtruara. Deputetja Shpresa Murati, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçin. Nuk e di nëse zëvendëskryeministri është i gatshëm të përgjigjet. Deputete Shpresa, a doni ta bëni pyetjen? Urdhëro, deputete!

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsedniče!

S obzirom da je tu zamenik premijera, možda bi on mogao da mi da odgovor na postavljano pitanje.

Uredbom br. 2006/14 o proglašenju Zakona o Radioteleviziji Kosova, članom 20.11 predviđa se da 5% sredstava od prikupljene javne pretplate za emitovanje programa upućuje u Fond osnovan pri Kabinetu premijera za podršku manjinskim multietničkim i ugroženim medijima. Međutim, nijedan manjinski medij u 2007. godini, a kraja 2008. godine, nije dobio ništa od tih sredstava. I ako su mediji na Bosanskom, Turskom i Romskom jeziku u jako teškom položaju, kada ne postoji nijedan pisani medij na ovim jezicima, u poslednje vreme nedobijamo ni ono što je zakonom predviđeno.

Moja pitanje glasi: Zašto se ne sprovodi Zakon, i šta ćete preduzeti u budućnosti da bi se zakon sprovodio na pravi način, a manjinski mediji budu.....

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, deputetja thotë që Kryeministri duhet të përgjigjet. Kalojmë në pyetjen e dytë.

Deputetja Njomza Emini, pyetje për ministrin e Kulturës, zotin Valton Beqiri. Deputete e keni fjalën.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti ministër,

Në Programin e Qeverisë të vitit 2008 deri në vitin 2011, më saktësisht në pjesën për kulturë, rini dhe sport është premtuar finalizimi i planit të veprimit për rini. Tash ka kaluar gati një vit, kur mendoni, më saksish, që Qeveria juaj apo ju t'i tregoni rinisë kosovare se do të bëhet finalizimi i planit të veprimit për rini?

KRYETRI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI VALTON BEQIRI: Faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

E nderuara Njomza,

Para së gjithash, kam obligim t'ju tregoj se plani i veprimit për rini është i kufizuar nga viti 2008 deri 2011, megjithatë ne jemi në proces të punës së vazhdueshme dhe ky plan ka për qëllim ta ndryshojë pozitivisht rolin e rinisë, situatën e rinisë, qoftë në institucionet qeveritare, qoftë në ato joqeveritare. Pra, deri më tani kemi arritur që t'i mbajmë rreth 25 takime me ministrinë e ndryshme të cilat janë të involvuara në këto projekte. Po ashtu në kuadër të punës sonë kemi përkrahje të madhe nga UNICEF-i, UNDP..., Organizata Botërore e Shëndetësisë, organizatat qeveritare gjermane **GTZ** dhe organizatat rinore.

Pra, dua t'ju tregoj se deri tani janë realizuar 25 takime në 6 grupe pune me pjesëmarrje të gjitha institucioneve nga niveli qendror dhe ai lokal, ndërsa procesi është lehtësuar nga agjencitë që i përmenda.

Punëtorja përmbyllëse për rishqyrtimin e këtij dokumenti u zhvillua më 21, 22 dhe 23 nëntor në Ohër dhe pa marrë parasysh që në vitin 2011 e kem si pikë të fundit të kryerjes

së obligimeve tona, unë ju siguroj që deri në dhjetorin e vitit 2009 do ta kemi draftin final të këtij ligji. Pra, tani deri në fund të vitit do ta kemi një propozim, një draft i cili do të shqyrtohet gjatë vitit 2009 dhe deri 2010, gjegjësisht në janar të vitit 2010 do ta keni draftin final edhe unë jam shumë i sigurt, sepse puna është duke ecur shumë mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, a ke pyetje shtesë? Jo. Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetjen e radhës.

Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete a doni ta bëni pyetjen? Regjia, fjalën deputetes Luljeta Shehu.

LULJETA SHEHU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në qoftë se mund të përgjigjet zëvendëskryeministri, atëherë do ta kisha lexuar pyetjen se është një pyetje mjaft me rëndësi.

KRYETARI: Lexoje pyetjen, deputete!

LULJETA SHEHU: Familjet e të pagjeturve janë në ankth të pritjes që të kenë informata për të pagjeturit e tyre. Pyetja është: Çka është duke punuar Qeveria në këtë drejtim kur dihet se numri i të pagjeturve është 1976 persona?

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministër, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuari Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Zonja deputete, faleminderit, për pyetjen!

Që në fillim më lejoni t'i prezantoj se sipas të dhënave të muajit dhjetor të vitit 2008 janë gjithsej 1919 të pagjetur, nga ky numër janë mbi 420 mbetje mortore ende të paidentifikuara, respektivisht pa rezultat të saktë të ADN-së dhe këto janë mbetje mortore në Morgun e Prishtinës.

Unë do të përpiqem së paku në 3 pika të jap një përgjigje që e shpresoj se e kompletton këtë.

Qeveria e Kosovës që nga ditët e para e ka vënë në prioritet përkushtimin e saj për këtë çështje të rëndësishme për qytetarët e Kosovës, në veçanti për ato familje që tash e 10 vjet ballafaqohen me këtë fat tragjik të tyre.

Fillimisht është bërë funksionalizimi i Komisionit qeveritar, pra është bërë emërimi i kryetarit dhe nënkryetarit. Nënkryetari i Komisionit qeveritar vjen nga komuniteti serb për të pagjeturit, është bërë kompletimi i stafit dhe zyrës. Jemi në fund të krimit të databazës, pra një baze e të dhënave që ka munguar në gjithë këtë periudhë për numrin e të pagjeturve, për identifikimin e tyre dhe për rastet që mbesin në hulumtim.

Së voni po bëhet edhe ngritja e kapaciteteve të këtij komisioni dhe është marrë vendimi që edhe më 3 punë kryes edhe me 3 punëtorë të ngritët kapaciteti i komisionit, 2 hulumtues të rasteve dhe një person zyrtar që do të merret me interpretimet ligjore dhe me aspektin ligjor të problematikës.

Dhe, në fund të kësaj pike, më lejoni të them se jemi në përfundim të draftimit të Ligjit për të pagjeturit, projektligj i cili është futur në agjendën legislative të vitit në vijim që nga fillimi i punës së Qeverisë.

Pikë tjetër e përpjekjeve dhe punës së Qeverisë është vazhdimi i dialogut me palën serbe. Qeveria e Kosovës ka bërë kompletimin dhe fuqizimin e Grupit kosovar për dialog, i cili grup deri më tani ka pasur gjithsej 3 takime, 2 prej tyre kanë qenë në Beograd dhe njëri ka qenë në Prishtinë edhe takimi i radhës që duhet të bëhet në fillim të vitit që vjen- do të jetë në Prishtinë.

Rreth dialogut dhe rreth problematikës unë mund të citoj edhe projektin e Propozimit, domethënë Propozimin Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari, i cili me pikën 5.1 dhe 5.2 të dispozitave të përgjithshme ose hyrëse i obligon Kosovën dhe Serbinë që të vazhdojnë ...

KRYETARI: Regjia, t'i vazhdohet edhe një minutë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: Po përpiqem shkurt të them, pra është kompletuar edhe ky grup punues dhe duhet të vazhdohet bashkëpunimi me shoqatat ndërkombëtare dhe vendore t'i kontribuojnë zvogëlimit të numrit të atyre personave që kanë mbetur të pagjetur. Më lejoni të them se ky bashkëpunim vazhdon me komunitetin ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, me ISMP-në, pastaj me OMPF-in edhe me shoqatat e familjarëve. Shumë shkurtazi, në dy takimet e fundit që kanë qenë javën e kaluar, që i kam pasur unë me zonjën Ketrin Bomberger, është drejtore e ISMP-së për Ballkan, thuhet se 400 mbetje mortore që nuk janë identifikuar ende, do të futen në një rianalizë me teknologjinë e fundit të ADN-së, sepse deri tani rezultatet nuk identifikojnë kush janë këta persona dhe, e them me keqardhje, po duket se një numër i të varrosurve ose të rivarrosurve janë bërë gabim kështu që mund

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputeti Emrush Xhemajli, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi.
Fjala e deputetit Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuara zonja ministre,

Gjendja në sistemin e drejtësisë, sidomos në prokurori dhe gjykata na shqetëson të gjithëve dhe pyetja ime ka të bëjë lidhur me këto. Deri ku kemi mbërri me reforma në sistemin e drejtësisë dhe çka jeni duke ndërmarrë që të mos vijë deri te grevat, siç ishte ajo greva pak më herët e punonjësve të administratës së drejtësisë? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ministre e ke fjalën.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari Kryetar i Parlamentit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari koleg Xhemajli,

Pyetja që më shtrohet mua në fakt nuk ka të bëjë me Ministrinë e Drejtësisë, sepse Ministria e Drejtësisë nuk i menaxhon as prokuroritë as gjykatat, këto i menaxhon Këshilli Gjyqësor Prokurorial deri në një zgjidhje tjetër, deri në nxjerrjen e ligjeve për reformën gjyqësore. Jam e vetëdijshme që situata nuk është e mirë, mirëpo ne jemi në përfundim e sipër të hartimit të pakos të ligjeve të cilat do t'i paraprijnë reformës gjyqësore dhe besoj se me një organizim të ri do të funksionalizohet edhe më shumë sistemi gjyqësor i Kosovës dhe i prokurorive.

Nga ana tjetër dua të shpresoj se edhe me mbështetje të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it do të merren të shqyrtohen edhe ato lëndë të cilat deri më tani kanë qenë nën velon apo kanë pasur embargo nga UNMIK-u, siç janë rastet për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Sa i përket stafit administrativ të prokurorive ne gjithmonë kemi kërkuar që ata të mos trajtohen si staf civil, iu kam drejtuar Qeverisë, por pritet që të nxjerrët Ligji për pagat dhe me të do të rregullohet edhe statusi i tyre, nëse do të mbeten si staf civil apo si staf mbështetës i prokurorive. Nëse keni pyetje shtesë, urdhëroni?

KRYETARI: Faleminderit, ministre!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputetja Rita Hajzeraj, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, e keni fjalën.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Nuk është hera e parë që Kryeministri mungon dhe ministrat gjegjësisht në seancat plenare sidomos në pikën e pyetjeve parlamentare, me qenë se është hera e dytë që unë dua ta lexoj pyetjen, gjithsesi do ta lexoj edhe pse mungojnë ata.

Më 31 janar të vitit 1992, në fshatin Uçë të Istogut janë vrarë 3 veta, do të thotë 3 qytetarë: Muharrem Hysenaj, Hysen Hysenaj dhe Hysen Hoxha, nga policia serbe në mbrojtje të nxënësve të cilët shkonin në shkollë – shtëpi. Për kohën kur po plasim, zoti Kryeministër nëse ai dëgjon, qytetarët janë shpallur dëshmorë të parë të shkollës shqipe po kështu shkolla e fshatit Uçë e mban këtë emër, por zoti Kryeministër këta nuk gjenden ende në listën e dëshmorëve të Kosovës. A e meritojnë këta 3 dëshmorë të jenë në listat e dëshmorëve të Republikës së Kosovës? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk di sa ishte pyetje për Kryeministrin, por ka edhe dëshmorë tjerë që nuk janë në listën e dëshmorëve. Ju e dini se Ligji i miratuar në Kuvend është vetëm për dëshmorët e luftës së fundit, Luftës Çlirimtare të UÇK-së. Faleminderit!

Deputeti, Riza Smaka, pyetje për ministrin e Bujqësisë, zotin Idriz Vehapi. Deputet Smakaj, e keni fjalën.

RIZA SMAKA: Faleminderit!

Pyetja kuvendore referuar mosaplikimit të neni 17 të Ligjit 02L/111 për bletët. Kjo është pyetja. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër,

MINISTRI IDRIZ VEHAJI: Faleminderit, zoti Kryetar,

Zëvendëskryeministër, ministra

Deputetë,

I nderuari deputet Smaka, faleminderit për pyetjen,

Sipas Ligjit për bletarinë nr. 02L/111 neni 17 ku bëhet fjalë për riprodhimin e bletëve ju informojmë se në Kosovë riprodhohet vetëm bleta e llojit Apis, Mellifera dhe nënlojet e saj. Shumëzimi i bletëve bëhet në bletore me shumimin e familjeve ekzistuese dhe në Kosovë ekziston vetëm një bletërritës i cili prodhon ama për treg. Kjo është ndërmarrja tregtare private “Apis” në Pejë.

Kjo ndërmarrje disponon të gjitha pajisjet për prodhimin e amave sipas standardeve të parapara me ligj dhe në këtë kontekst ju informojmë se është planifikuar hartimi i udhëzimit administrativ për certifikimin e bletoreve për prodhimin e amave, i cili do të fillojë së zbatuari që nga viti i ardhshëm, viti 2009. Kjo është përgjigja, zoti deputet.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Përsëri deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Bujqësisë, zotin Idriz Vehapi.

RIZA SMAKA: Faleminderit!

Pyetja kuvendore referuar tregtimit të produkteve bletore. Konform me Ligjin për bletët, produktet bletore: mjalti, dylli, luzma, helmi bletor mund të tregtohen vetëm pas plotësimit të kërkesave higjienike sanitare. Me konsideratë, zoti ministër, si dhe sa aplikohet imperativi ligjor përkitazi me tregtimin e produkteve bletore në vendin tonë aktualisht? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti, ministër e ke fjalën,

MINISTRI IZDRIZ VEHAJI: Sa i përket përgjigjes për pyetjen e dytë, unë dua t’ju informoj se me rastin e importit të produkteve, të prodhimeve të bletëve dedikuar tregut të brendshëm, mostrat merren nga autoritetet e AVUK-ut për analiza kimike dhe bakteriologjike dhe këto analiza kryhen në Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës. Edhe për këtë qëllim, Ministria e Bujqësisë planifikon që të hartojë një udhëzim administrativ për përcaktimin e cilësisë së mjaltit dhe të prodhimeve të mjaltit të cilat vihen në qarkullim. Mirëpo, përkundër kësaj, është edhe imperativ i kohës që të kemi parasysh ndërtimin e një mini- laborator, i cili do të merrej ekskluzivisht me kontrollin e cilësisë të produkteve të mjaltit. Në këtë e kemi në agjendë dhe do të shohim momentin kur do t’i sigurojmë mjetet duhet ta bëjmë këtë punë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Udhëzimi mund të bëhet menjëherë dhe ajo infrastrukturë, sa më parë që është e mundur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetja e radhës, deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e Tregtisë, zotin Lutfi Zharku. Deputet, ministri nuk është, a dëshironi ta bëni pyetjen? Faleminderit!

Dy pyetje i lashë për më vonë për ministrin e Arsimit, por ministri, edhe pse tha se do të vijë, nuk ka ardhur. A donë deputetët t'i lexojnë pyetjet? Deputeti Enis Kervan, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj. Atëherë, urdhëroni lexoni pyetjen deputet!

Ju faleminderit:

ENIS KERVAN: I nderuari ministër!

Kur kemi të bëjmë me çështjen e nxënësve me nevoja të veçanta, të cilët vijojnë klasat e bashkëngjitura, qëllimi të cilave është parapërgatitja themelore e fëmijëve në fjalë, për integrimin sa më të shpejtë nëpër klasa të rregullta, në pajtim me aftësinë e tyre, pra aty ku nxënësit kanë treguar prirje.

Problemi qëndron në atë se kemi një mospërputhje të qëllimit dhe të rezultateve të klasave të lartpërmendura, plan ky i cili është një kusht themelor për mësimdhënie dhe mësimnxënie të fëmijëve me nevoja të veçanta. Një prej rasteve konkrete është shkolla fillore “Motrat Qiriazit” në Prizren, ku janë dy klasë të bashkëngjitura. Në klasën në gjuhën turke vijojnë 11 nxënës, ndërsa në klasën e gjuhës shqipe janë 9 nxënës me nevoja të veçanta të grupmoshave të ndryshme, te të cilët nuk kanë staf të mjaftueshëm që mësimdhënia të ketë qasje kualitative të nxënies.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Zotëri ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Arsimi special për ne është një çështje shumë e rëndësishme meqë dinjiteti i një shoqëri matet edhe me atë se si trajtohet një pjesë e të rinjve tanë, të cilët për arsye të caktuara kanë thjesht pengesa që ta ndjekin procesin mësimor, prandaj, gjatë kësaj kohe, ne deri me tash kemi trajnuar 130 arsimtarë dhe kemi në tërë territorin e Kosovës rreth 80 edukatorë të cilët punojnë në shkollat speciale.

Në Kosovë ekzistojnë 1200 nxënës të cilët ballafaqohen me nevojën e domosdoshme për arsim special. Sa i përket shkollës konkrete në Prizren “Motrat Qiriazit”, ne do të bëjmë përpjekje maksimale që vitin e ardhshëm të punësojmë edukatorë, përderisa bartja e nxënësve, shpenzimet e ushqimit, mirëmbajtjes dhe të gjitha këto çka ndërlihdhen, aktualisht financohen nga Ministria e Arsimit, ndërsa çështja e edukatorëve do të jetë një çështje e cila do të duhej të zgjidhet.

Po ashtu, planifikojmë që vitin e ardhshëm në qytetin e Prishtinës ta ndërtojmë një qendër burimore, meqë sot problemi kryesor është që shumica e këtyre nxënësve nuk duhet të trajtohen në shkolla speciale, por duhet të jenë pjesë e klasave të bashkëngjitura në shkollat e rregullta, qoftë si klasë e veçantë, qoftë brenda përbrenda klasës me nxënës të tjerë. Një gjë e tillë është duke ndodhur në Prizren, një gjë e tillë është duke ndodhur edhe në pjesët tjera të Republikës së Kosovës. Po, dua t'ju siguroj që për rastin konkret do të ndërmarrim masa që ky problem të zgjidhet sa më shpejtë.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shitesë? Jo, ju faleminderit!

Deputetja Nurishahe Hulaaj, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj.

Deputete, e keni fjalën!

NURISHAHE HULAJ: Ju faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Sa i përket çështjes, nostrifikimit të diplomave universitare, meqenëse shumë të rinj studentë mbarojnë studimet në universitetet tjera jashtë Republikës së Kosovës dhe po presin shumë gjatë për të bërë nostrifikimin e diplomave universitare 6 deri në 12 muaj, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është e obliguar që të bëjë nostrifikimin e diplomave të studentëve që i kanë kryer studimet universitare jashtë vendit në afatin kohor sa më të shkurtër të mundshëm. Pyetja është- Sa zgjasin procedurat e nostrifikimit të diplomave universitare në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe a ekziston ndonjë udhëzim administrativ që e rregullon këtë çështje? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit. Ekziston një udhëzim administrativ, i cili është nënshkruar para dy javësh. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është që jo vetëm ta rregullojmë çështjen e nostrifikimit, pra të barasvlerës së diplomave, meqë një sistem modern arsimor dhe nënkupton programet e tilla arsimore, të cilat programe thjesht edhe përfundojnë me grada universitare, por edhe programet të cilat nuk përfundojnë me një gradë të caktuar universitare.

Prandaj, të gjitha përpjekjet tona gjatë muajve të fundit kanë qenë që ta kemi një strukturë të tillë në Ministrinë e Arsimit, e cila adreson këtë problem shumë shpejt.

Kemi themeluar një qendër e cila thirret Eniknarik, që është pjesë e rrjetit të qendrave të tjera që ekzistojnë edhe në Bashkimin Evropian edhe në pjesët e tjera të botës, të cilat në një mënyrë shumë të shpejtë e bëjnë baras vlerësimin dhe nostrifikimin e diplomave.

Unë, e di që kërkesat e studentëve kanë qenë dhe janë shumë të mëdha. Stafin që e kemi në Ministri është shumë i vogël, mirëpo deri me tash nuk kemi pasur edhe infrastrukturë të nevojshme ligjore. Pas këtij udhëzimi administrativ, i cili është nënshkruar para dy javësh besojmë që këto pritje të gjata që kanë qenë në Ministrinë e Arsimit, sa i përket nostrifikimit të diplomave janë po ashtu shumë të mëdha.

Po ashtu, duhet të them që kemi edhe disa raste kur bëhen përpjekje që me diplomat e falsifikuara të marrin vërtetim në Ministri të Arsimit. Unë dua vetëm t'i informojë deputetët e Kuvendit të Kosovës, që çdokush që bën përpjekje përmes një grade të falsifikuar të marrë diku jashtë ose ndonjë diplome të falsifikuar, ne thjesht diplomat e tilla dhe kërkesat e tilla do t'i procedojmë në gjyq, më që shpeshherë janë profesione të ndjeshme, si profesioni i mjekut, bëhet përpjekje që të ushtrohet përmes gradave të tilla, mirëpo, pothuajse ky problem është zgjidhur.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputete, a ke pyetje shitesë? Ju faleminderit edhe prej teje.

Për shkak të agjendës, e kalojmë pikën e tretë, shpresojmë që pas pikës 4, ajo do të jetë pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e katërt:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Në bazë të rregullës 35, pika 1...

Ardian, mund ta marrësh fjalën, por realisht ne po presim që pas kësaj pike të vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës. Nëse e do fjalën, urdhëro!

ARDIAN GJINI: Të paktën një shpjegim, se nuk kalohet kështu prej pike në pikë. Vetëm kaq kërkoja, jo më tepër.

KRYETARI: Unë, më duket e thashë, për shkak të agjendës së Kryeministrit. Shpresojmë që pas kësaj pike të rendit të ditës, do të vijë pika e radhës, do të thotë, pika e tretë, veç e ndërrojnë vendin pika e tretë dhe e katërt. Ne kemi mundur ta caktojmë edhe një pauzë, por realisht unë mendoj se është herët të bëjmë pauzën, ta kalojmë edhe këtë pikë.

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, zotin Ahmet Shala që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari zoti Kryetar,
I nderuar zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë

Kam kënaqësinë e veçantë që sot para jush në fakt paraqes, do të paraqesim katër projektligje dhe, me lejen e Kryetarit mund të shkojmë edhe në paketë, por është zgjedhja juaj.

Këto ligje në fakt janë ndryshim i rregulloreve jo në substancë, por vetëm në formë dhe në norma. Unë po flas tani, meqenëse Kryetari më thirri për Ligjin për ndryshimin e vlerës së shtuar, përkatësisht të TVSH-së, është komplet Rregullorja në fuqi vetëm ndryshimet janë, nëse mund të them sipërfaqësore. Është ndryshimi i titullit, në vend të rregullores është ligj dhe në vend të normës 15% rritet për 1%, përkatësisht bëhet 16% për hir të kompensimit të uljes së normës për korporatat dhe uljes së normës për pagat individuale ose të hyrat individuale, ne i kemi ngritë TVSH-në për 1% dhe ndryshimet tjera të vogla janë faktikisht termi i Rregullores zëvendësohet me ligj, termi i Autoritet Bankar dhe i pagesave zëvendësohet me Bankë Qendrore, dhe termi PSSP zëvendësohet me Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ne e kemi përgatitur pothuajse edhe ligjin e ri i cili do të vijë në janar këtu për shqyrtim dhe ai ligj pastaj do t'i trajtojë në mënyrë shumë të thukët, shumë më fundamentale të gjitha elementet një nga një ashtu siç parashihen edhe me Konventën e Unionit Evropian.

Me qëllim që politikat e Qeverisë së Kosovës për zvogëlimin e normave, përkatësisht rritjen ose ndryshimin e politikave fiskale, të jenë të mundshme të fillojnë me 1 janar,

ne jemi marrë vesh edhe me Komisionin për Buxhet dhe Financa, që këto ndryshime kozmetike ka plotë ndryshime të cilat do të duhej të bëheshin, por jemi fokusuar vetëm në ndryshimet të cilat e ndërrojnë normën dhe i ndërrojnë këto thirrjet elementare dhe ju ftoj që ta përkrahni këtë projektligj, i cili është tepër i rëndësishëm për të zhvilluar politikën e Qeverisë së Kosovës dhe premtoj, në fakt e kemi të gatshëm, por ishte dilema a mundet të realizohet ajo para Vitit të Ri apo jo, që në janar neve ta sjellim këtë Ligjin komplet i cili do t'i reflektojë edhe disa nga vërejtjet mbase të cilat janë edhe të miat edhe tuajat për ta përmirësuar komplet filozofinë e TVSH-së për Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti ministër!

Hapi debatin për diskutim në parim, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, nëse e ka kërkuar dikush fjalën.

Deputete Safete, në emër të grupit apo të Komisionit? Ju faleminderit!

Në emër të komisioneve të përhershme, nuk e kanë kërkuar fjalën, pra shkojmë në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj. E keni fjalën, deputete!

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ne edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, meqenëse nuk ishte kryesuesi i Komisionit, në mungesë të Kryetarit, i kemi përkrahur në parim këto ligje. Meqenëse ka qenë çështja vetëm te ndryshimi që janë bërë në politikën fiskale, ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike e kemi përkrahur rishikimin e politikave fiskale dhe e kemi rishikuar edhe kemi shikuar me vëmendje Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar. Ne e përkrahim në parim këtë ndryshim i cili është bërë në Ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe kontributin tonë në eliminimin e disa paqartësive të cilat ekzistojnë në disa nene, do ta japim përmes anëtarëve tonë në Komisionin për Buxhet dhe Financa, gjatë amendimit të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Unë nuk shoh që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së është paraqitur dikush.

Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën. Ju faleminderit!

SABRI HAMITI: Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim këtë ligj, siç i përkrah edhe ato tri të tjerat që vijnë pas. Por, njeriun që është caktuar për të raportuar, Haki Shatrin, momentalisht nuk po e shoh, por e përkrahim.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, e ka fjalën deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryesues!

Përsëritje për Kabinetin qeveritar,

Përsëritje për deputetët,

Grupi parlamentar Aleanca Kosova e Re ka menduar se me këtë reformë tatimore të Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave do të bëjë një ndryshim, por jo në këtë metodë çfarë e ka preferuar zoti ministër, dhe ne si parti jemi të vetëdijshëm që kjo formë e tatimit është një burim i rëndësishëm për buxhetin e Kosovës, por njëkohësisht mendojmë se kjo çështje është dashur të jetë në përputhshmëri me zhvillimet aktuale si

dhe me politikat, rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, në të kundërtën ne e rrezikojmë në mënyrë serioze avancimin e politikave investive në Kosovë.

Kështu që, do të thotë se Grupi Parlamentar i AKR-së nuk e përkrah këtë Projektligj.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar ministra, kolegë deputetë,

Grupi Kuvendor i AAK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe kemi konstatuar se ky projektligj është një kopje, të them, e Rregullores së UNMIK-ut, përveç se në ndryshimin e normës tatimore prej 15 në 16%.

Duke e pasur për bazë se Qeveria i ka politikat e veta fiskale, mirëpo edhe ne si të thirrur të qytetarëve, të popullit, duhet të sqarojmë se me këtë Projektligji ngarkohet konsumatori i fundit, çka do të thotë qytetari i Kosovës për vitin 2009, do të blejë gjërat ushqimore me një përqindje më të lartë dhe kështu që ngritja e të ardhurave në 10% do të jetë shumë më e vogël ndoshta me ngritjen e shportës ushqimore që do të ndodhë me një vlerë të shtuar 16%.

Gjithashtu, mund të themi se ka paqartësi në disa nene, sidomos neni 20 si duket nuk është i përkthyer mirë nga gjuha angleze dhe të them të drejtën edhe si ekonomist po e lexoj dy- tri herë dhe po ka paqartësi, gjithashtu edhe neni 1, kështu të gjitha këto të meta do të eliminohen në Komisionin Funkcional, mirëpo si grup dhe në emër të Grupit nuk e përkrahim për të vetmin arsye, për arsye se e godet atë klasë që duhet për ta mbrojtur, e mbrojnë atë klasë se nuk ka nevojë mbrojtje, do të thotë e godet konsumatorin dhe e godet popullin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, nuk shohë të lajmëruar për fjalë.

Në emër të Grupit Parlamentar” 7+”, deputetja Mufera Shinik e ka fjalën.

MUFERA SHINIK: Teşekkür ederim,

Katma Değer Vergi Yasa Tasarısı, 7+ Parlamenter Grubu tarafından prensipte kabul edilmektedir. Gerekli uyarı ve önerilerimizi amandmanların hazırlanmasında, Bütçe ve Finansi Komisyonuna sunacağız.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Bojan Stojanović e ka fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala Vam gospodine predsjedavajući:

Uvažene gospodo poslanici i Vladin kabinetu,

Samostalna liberalna stranka, to jest Poslanički grup Samostalne liberalne stranke je uzeo na razmatranje Zakon o porezu na dodatnu vrednost. Ono što smo primetili jeste da ima nekih jezičkih neusaglašenosti, međutim verujemo da se radi o prevodu na srpskom jeziku. Mi ćemo svakako podržati ulazak ovog Zakona u skupštinsku proceduru. Sve što budemo imali, saradjivaćemo kroz skupštinske komisije. Jednostavno, možda ovo jeste priča da će neki porezi biti povećani i da možda prividno građani će biti opterećeni,

međutim tu se radi o pravama i obavezama šta građani imaju prava, a koje obaveze imaju, porezi, jačanje, jednostavno će dovesti do pevećanja i samog budžeta, pa ćemo moći očekivati verovatno neki boljitak u budućnosti, to je ono što moramo da prodjemo kroz taj period.

Naravno, taj zakon je usaglašen sa evropskim standardima, u to ne sumnjam da Vlada ima kapacitet. Sve što budemo imali kroz Komisiju ćemo dati predlog i ostale parlamentarne grupe i poslanaici, tako da se nadamo da ćemo u drugom čitanju imati jedan odličan zakon. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Kalojmë në fjalën e deputetëve, sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputeti Ardian Gjini.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë, fillimisht deklarohe se në parim nuk e përkrah ndryshimin e normës nga 15 në 16%, por para se të hyj aty, t'i them edhe disa fjalë për vetë emërimin e këtij tatimi ose të këtij obligimi. Sa herë që ta dëgjoj, më bie kështu, më rikujtohet ai kompleksi i inferioritet që ka Tirana ndaj Romës dhe Prishtina ndaj Tiranës, ngase çdo gjë tentohet që alla italiane të merren gjërat këtu në mungesë të njohurisë, sipas të gjitha gjasave, duke e injoruar plotësisht natyrën e gjuhës shqipe. Kjo është marrë tekstualisht nga IVA italiane, domethënë nga Imposta sul Valore Aggiunto, që italisht i bie mirë, por në gjuhën shqipe nuk tingëllon mirë tatimi mbi vlerën e shtuar, ngase kemi të bëjmë me një vlerë të shtuar tatimore, domethënë një 15% që i shtohet çmimit final dhe nga definicioni atë 15% deri më tani konsumatori ia ka paguar shtetit për ta fituar të drejtën që ta konsumojë produktin dhe nga ky definicion, domethënë, tregohet arsyeja se pse unë nuk e përkrah ngritjen e normës, ngase në mënyrë të drejtpërdrejtë penalizohet fukaraja.

Në kriza ekonomike, i nderuari zoti kryesues, është tendencë që vlera e shtuar tatimore apo TVSH-ja, këtu siç po i thuhet gabimisht, të ulet norma. Në Britani, shembull konkret, tash do të ulet nga 17.5% në 15% për shkak se tentohet që me uljen e vlerës së shtuar tatimore të rritet fuqia blerëse, fuqia konsumuese e cila pastaj në mënyrë direkte do t'iu ndihmojë edhe korporatave.

Siç e dini, zoti kryesues, ne në Kosovë nuk kemi krizë, por ne kemi depresion ekonomik që sa vite, domethënë kemi 50% të popullatës që jetojnë në varfëri. Thuhet, janë disa statistika të vjetruara tash, 15% varfëria ekstreme, që për mendimin tim ajo varfëria ekstreme është rritur në 20%, ngase veç sivjet deri në korrik patëm inflacion rreth 14%. Domethënë, me 90 centë nuk kanë mund të blihen ato 2500 kaloritë e domosdoshme për të ekzistuar, siç thuhet, dhe tash këtyre fukarenjve ti t'ua rritësh një obligim edhe për 1%, unë e kam parasysh se pasanikëve, milionerëve aty, që janë rreshtuar, nuk ua prish xhepin, po e kam zorin e fukarenjve. Këtu tentohet prej qorrit që marrësh sy. Unë mendoj se në këtë krizë ekonomike, norma nuk duhet të ngritet, përkundrazi të mendohen mënyra të tjera. Ka mënyra të tjera se si stimulohet biznesi, se si rritet buxheti. Kjo është mënyra më agresive, më e thjeshtë dhe më e papranueshme dhe më jokorrekte për kohën në të cilën jetojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Do të flas shkurt vetëm pak për politikën e këtij ligji. Pse bëhet ligji? Çka është politika e ligjit, se në fund të fundit, secili ligj është politikë? A ju kujtohet e kemi kaluar buxhetin e Kosovës para disa kohe, Kuvendi i Kosovës e ka kaluar atë buxhet dhe ai buxhet tani duhet t'i ketë këto ligje të cilat sot i kemi në rend dite, në mënyrë që të funksionojë?

Nëse këto ligje nuk kalojnë, atëherë ai buxhet ka qenë i hartuar pa asnjë nevojë, që do të thotë se kur është hartuar buxheti Qeveria ka besuar se në të ardhmen do t'i ndryshojë ligjet, në mënyrë që ta mbështesë buxhetin e vet. Kjo është arsyeja e vetme, do të thotë buxheti kur është hartuar dhe kur ka kaluar, nuk ka qenë i mbështetur në ligjet ekzistuese. Realisht ka qenë dashur të jetë ashtu, se nuk mund të kalohet një ligj, i cili duhet të hyjë në fuqi me ndryshimin e ligjeve të cilat vijnë më vonë, kjo është çka është duke ndodhur.

E falënderoj zotin Tali për një shpjegim i cili është shumë i saktë edhe për gjuhën e cila përdoret, mirëpo edhe për temën për çka po flasim. Ne duhet ta kuptojmë dhe njerëzit duhet ta kuptojnë çka po ndodhë? Po rritet kjo farë TVSH-ja që i themi ne, TVSH-në e paguajnë blerësit, blerësi i fundit e pagan. Ka qenë 15% në vlerën e çdo malli, tani bëhet 16% në vlerën e çdo malli dhe në të njëjtën kohë ulët taksë e korporatave. Tani ne, si parti politike nuk kemi asgjë kundër uljes së taksës së korporatave, mirëpo kemi shumë kundër rritjes së TVSH-së.

Taksat e korporatave zakonisht ulët kur besohet se teprica e cila do t'u teprojë korporatave do të shpenzohet për rritje të biznesit, për punësim të mëtutjeshëm dhe vetvetiu do të gjenerohen taksë të reja.

Mirëpo, çka ndodh tani, me këto ndryshime askush nuk beson se do të rritet punësimi, askush nuk beson se do të rritet gjenerimi i tatimeve prej rritjes së biznesit të korporatave, mirëpo duhet mbuluar këtë ulje të tatimit të korporatave, duhet mbuluar me rritje të tatimit të cilin e paguajnë njerëzit të cilët kanë për të blerë realisht bukë.

Kjo është realisht krejt politika e këtij ligji. Kjo është arsyeja pse ne nuk do ta votojmë këtë ligj, kjo është arsyeja pse të gjithë njerëzit duhet ta marrin vesh se këto ligje që kanë ardhur sot, janë ligje të varfërimit të qytetarëve të Kosovës. Edhe sivjet kemi suficit, do të thotë çka po ndodh? Qeveria po i tërheq të hollat prej njerëzve, prej korporatave, po ua merr të hollat, po i futë në arkë të shtetit dhe nuk po mbërrin t'i shpenzojë, do të thotë nuk po mbërrin t'i kthejë edhe po akumulohen në arkë të shtetit. Ky është realisht me fjalët më të thjeshta shpjegimi i varfërisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.

RIZA SMAKA: I nderuari kryesues,

Të nderuar qeveritarë, deputetë,

Mjerisht, sot në Kosovë ekzistojnë dy klasa, ekstremisht në diferenca, një klasë tepër e pasur dhe pjesa dërmuese, mjerisht, tepër e varfër. Do të kisha pasur dëshirë, jam i bindur secili prej nesh që të ishte raporti i kundërt, shumica të pasur, mundësisht të gjithë, mirëpo ajo nuk është dhe nuk mund të bëhet.

E tash, në këtë kontekst, konsumatori që e përbën masën më të madhe të popullit të Kosovës, edhe në këtë mënyrë atakohet, në shumë mënyra tjera atakohet. Tregu, po e zëmë, konkurrenca është ilojale në tregun kosovar, monopoli në treg, çmimet janë marramendëse në bazë të monopolit në treg e tjera, e tjera dhe në këtë mënyrë, do të thotë, mirëkuptim për politikën ekonomike qeveritare, se synimi është fisnik që buxheti e tjera, e tjera, por gjithsesi do të isha angazhuar që të bëhet një rishikim, ani pse ky dokument është trajtuar analitikisht në Komisionin për Buxhet edhe është vlerësuar si një dokument që do të duhej të kalonte, po flas me tonin e Komisionit.

Më pastaj, ju lutem, do të isha ndalur te vlera e shtuar. Në teori ekzistojnë vetëm dy vlera: vlera e prodhimit dhe vlera e qarkullimit. Këtu nuk është fjala për vlerën. Është fjala për taksë të shtuar, prandaj do të duhej të meditohej përfundimisht të përshtatet një term i përshtatshëm adekuat se nuk rritet vlera, përkundrazi është fjala për taksë të shtuar në produktin final. Edhe Komisioni për Buxhet i ka dhënë, jam i bindur që në etapën vijuese do të inkorporohen disa amendamente, por vetëm parimisht. Te neni 30 që kjo dispozitë do të duhej të hiqej, sepse jo ministri për Ekonomi dhe Financa, por secili ministër ka autorizim me Ligjin për Qeverinë, në bazë të Ligjit për të miratuar edhe rregullore, edhe rregulla, edhe instruksione, ajo është një nga ingerencat elementare të ministrit, prandaj mos të përsëritet kjo, hiqet, do të duhej të hiqej edhe gjithsesi do të duhej të riformulohej neni 32, ku thuhet: Ky ligj hyn në fuqi me 1 janar 2009. Ne do ta koordinojmë asisoj që të hyjë në fuqi, po e zëmë, mirëpo duhet të miratohet, të shpallet, të bëhet promullgacioni, të hyjë në fuqi dhe, kësisoj. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet deputeti Armend Zemaj.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti drejtues i seancës parlamentare!

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Mendoj që interesimi për këto tema që u vunë në rend dite, duhet të jetë më i gjallë i të gjithë deputetëve, por edhe i Qeverisë, sepse kjo drejtpërdrejt prek jetën dhe gjitha fushat e veprimtarive tjera të ekonomisë në Kosovë, prandaj unë kujtoj që në vazhdim të atij debati që kemi filluar lidhur me politikën buxhetore dhe Projektbuxhetin e vitit 2009, t'i kemi parasysh vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet që dolën nga Kuvendi lidhur me politikën që i kemi programuar për vitin 2009, që duhet të jenë të harmonizuara dhe mundësisht të analizuar sa më thellë, në mënyrë që vërtet ato të jenë sa më të mira, sepse po e prekin jetën drejtpërdrejt të çdo qytetari.

Me këtë rast, ne po e shqyrtojmë një paket projektligjesh të cilat u cituan këtu edhe nga Ministri i Ekonomisë dhe i Financave. Unë kujtoj që duhet të jemi të kujdesshëm në ndryshimet dhe plotësimet e propozuara për disa arsye. Përderisa është, sipas pikëpamjes sime e logjikshme që të provohet, të kemi ndryshim në Projektligjin për të ardhurat personale, zvogëlimin tyre, sepse edhe ashtu të ardhurat personale nuk janë të mëdha dhe të kënaqshme krahasuar me nevojën dhe krahasuar me standardin dhe ecuritë ekonomike. Tek pjesa e Projektligjit që parasheh ndryshimet e taksave të korporatave, mendoj që ato duhet të rishikohen dhe duhet të mbeten të atilla për shumë arsye, në mënyrë që kur të vijmë te projektligji që veç e kemi në rend dite çështjen e TVSH-së, mendoj se nuk janë kushtet dhe nuk janë rrethanat ekonomike që e favorizojnë ndryshimin e TVSH-ës nga 15 në 16%. Mendoj që ngritja e këtillë duhet të analizohet mirë, sepse e prek drejtpërdrejt, ashtu siç u tha, konsumatorin – qytetarin, prandaj duhet të jemi të kujdesshëm nëse veç edhe më herët i kemi proklamuar politikën fiskale si

partnerë në koalicion, e unë kujtoj që duhet të merren edhe modelet apo, të them, duhet të merren edhe praktikat e vendeve tjera si kanë vepruar **tash** në kuadër të kësaj që është shfaq si krizë globale edhe në vende të tjera.

Dëgjova një emision, para pak ditësh ku masat e shteteve tjera janë krejt ndryshe nga kjo që është propozuar këtu sot. Ishin edhe Qeveria franceze edhe Qeveria Gjermane ato të cilat nuk u pajtuan që të rritet TVSH-ja e tyre, por morën masa të tjera për industri të caktuara, siç është ajo automobilistike dhe industria e përpunimit të drurit, në mënyrë që ato të stimulohen në forma të tjera, por pa e prekur TVSH-n, sepse drejtpërdrejt ndikonte në sferat dhe fushat tjera për qytetarët e saj, ndërsa, disa vende veç e ulën TVSH-ën.

Prandaj, shikuar nga këto rrethana, mendoj se është mirë që edhe Qeveria, edhe kjo që është propozuar, deri në leximin e dytë, të rishikohet. Pra, të mos kemi ndryshime në taksat e propozuara të korporatave dhe të gjenden modalitete tjera, siç edhe të mos kemi rritjen e TVSH-së sepse, kujtoj, kriza ekonomike dhe ecuritë ekonomike në Kosovë nuk janë të favorshme. Prandaj, po të jemi pak më të përkushtuar dhe më serioz, kujtoj se ka modalitete tjera dhe mundësi tjera që duhet të provojë t'i shfrytëzojë Qeveria, në mënyrë që të mos e rrisë TVSH-n.

Unë, personalisht, si deputet, jam i rezervuar, sepse kujtoj që kjo do të reflektojë jo mirë dhe nuk janë aspak kushtet e favorshme që të ndryshojë TVSH-ja.

Nuk di Qeveria a ka pasur debat apo opinione publike me Odën Ekonomike, me Aleancën e Biznesit, me grupet e interesit e të tjera. Po them nuk e di dhe s'prish punë kjo nëse unë nuk e di, por kujtoj se drejtpërdrejt kjo do të ndikojë, domethënë edhe në afarizmin e tyre. Mund të them se ndërmarrjet nuk e kanë vështirë të rrisin TVSH-n, por dihet kënd e tangon drejtpërsëdrejti.

Prandaj, kërkoj që deri në leximin e dytë të provojë Qeveria ta gjejë një modalitet apo variant tjetër, sepse kujtoj, ngritja e TVSH-së në këtë moment, nuk është e përshtatshme dhe nuk është për mendimin tim në pajtim me politikën të cilat veç i kemi proklamuar. Faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj, le të përgatitet deputeti Adem Hajdaraj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar qeveritarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të ndaj një mendim, sepse para se të vijë buxheti për vitin 2009 ka qenë një propozim në Kryesinë e Kuvendit që të shqyrtohet kjo paketë e projektligjeve dhe kjo nuk ka hyrë në rend dite dhe nuk e di arsye pse, por mendoj se Kryesia e Kuvendit me të vërtetë ka bërë një gabim paraprak, sepse së pari është dashur të vijë kjo paketë e projektligjeve, atëherë edhe ne ta shqyrtojmë Projektligjin për buxhetin për vitin 2009.

Të nderuar deputetë,

E tha edhe ministri për Ekonomi dhe Financa se duhet të shqyrtohen këto tri projektligje tjera dhe pastaj të shqyrtohet Projektligji për TVSH-n, sepse edhe ndryshimi i normës së TVSH-së, domethënë, rrjedh nga ndryshimet që janë në Projektligjin për të ardhurat në

korporata dhe në të ardhurat individuale dhe nga ajo nga akciza e cila është 17 kilogram në 21 kilogram.

Unë mendoj se duhet të sqarohemi këtu nga ministri për Ekonomi e Financa se a janë bërë analiza apo cilat janë parametrat në ruajtjen e stabilitetit rreth të hyrave buxhetore dhe mbulimin e humbjeve që do të krijohen me zvogëlimin e normave tatimore.

Shtrohet pyetja, zoti ministër- cila është rritja nga të hyrat në buxhet – a është e bazuar në fakte apo kemi e kemi të bazuar vetëm në vlerësim?

Pse e them këtë? E them nga frika, sepse mendoj që me rritjen e normës së TVSH-së e kam një brengë ku bizneset do të orientohen më shumë në informalitet. Këtë informalitet ne e kemi gjithnjë dhe përballemi me të, që mendoj se nuk po mund të vijmë deri te zvogëlimi i tij, sidomos te qarkullimi i mallrave dhe paraqitja e tyre në mënyrë reale. E them këtë, sepse do të ketë ngritje të çmimeve dhe të produkteve të shërbimeve.

Këtu e kam një mendim edhe për rritjen e akcizës së duhanit. Të nderuar deputetë, në Kosovën e pasluftës kontrabanda më e madhe ka qenë e orientuar në duhan dhe atë besa e mbështetur edhe nga politikanë të njohur dhe nga politika në përgjithësi. Mirëpo, e vetmja ajo që është pozitive dhe stimuluese, që mendoj është edhe për shoqërinë edhe për biznese, është ndryshimi në të ardhurat në korporata dhe në ndryshimin në të ardhurat individuale. Prandaj, mendoj se ministri për Ekonomi e Financa dhe Ministria për Ekonomi e Financa është dashur që këtyre projektligjeve t'u bashkëngjis një sqarim më shumë nga politikat fiskale ekonomike dhe nga Departamenti për Makroekonomi apo ndoshta para se t'i miratojmë të kemi një sqarim shtesë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Adem Hajdaraj, le të përgatitet deputeti Ibrahim Gashi.

ADEM HAJDARAJ: Zoti kryesues!

Zoti zëvendëskryeministër, zotërinj ministra dhe deputetë të nderuar,

Unë desha të ndalem pakëz rreth terminologjisë së këtij ligji për arsye se shoh një varg termash jo të përshtatshëm dhe kjo nuk është karakteristikë vetëm për këtë ligj, por edhe për ligje tjera ku gjuhës nuk i kushtohet fare vëmendje.

Pajtohem plotësisht me vërejtjet që i dhanë deputeti Tali dhe profesor Riza Smaka rreth termit “vlëra e shtuar”, po nuk do ta shtjelloja atë më tej, por vetëm të shihet “mbi”, “o – o” të krahasohet, për shembull, me serbishten “zakon o porezu”. “Mbi” nuk qëndron kjo parafjalë kurrësi “mbi”, që po përdoret për të gjitha rastet “mbi”, por “për” dhe pastaj atë që e thanë edhe zotërinjtë.

Po ashtu, do të ndalem te termi “borxh i keq”. Unë nuk e di që ka borxh të keq as të mirë, nëse i krahasojmë tash togfjalëshat borxhi i keq, antonimi është borxh i mirë. Po borxhi është borxh, nuk është i mirë as i keq, është borxh. Prandaj, ma merr mendja se – borxhi, këta dy togfjalësha nuk qëndrojnë kurrësi. Ai që ka borxh, ai është i keq, ashtu-ashtu edhe pa e paguar, derisa të mos e paguajë edhe shumë e shumë raste të tjera, por në leximin e dytë do të shohim nëse nuk përmirësohen, përndryshe gabimet gjuhësore, sa i përket lidhore, sa i përket trajtave: “ai do të shkon”, “ai do të punon” këtu hasen gabimisht- duhet “do të shkojë”, “do të “punojë” e shumë trajta tjera. Dhe, mirë ka bërë të dalë Shoqata e Gjuhës Shqipe që ka propozuar të formohet Ligji për gjuhën ku edhe

deputetët do të japin përgjegjësi nëse nuk e përdorin gjuhën drejt, edhe qytetarët. Kështu e kanë të gjithë, edhe gjermanët edhe të tjerët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi le të bëhet gati deputeti Berim Ramosaj.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje të nderuar ministra, zëvendëskryeministër dhe kolegë deputetë, Mendoj se sot po diskutojmë një projektligj tepër të rëndësishëm që në fakt është pak befasi propozimi për rritjen e tatimit në vlerën e shtuar që vjen nga Qeveria e cila, në periudhën parazgjedhore, me shumë pompozitet ka folur se politikat e qeverisë do të jenë të fokusuara në uljen e varfërisë, në krijimin e vendeve të punës, në krijimin e masave stimuluese për investitorët e brendshëm dhe të jashtëm, në inkurajimin e biznesit të mesëm e të vogël, sidomos dhe, kjo tash, që vjen sot për diskutim, mendoj që është e kundërta e asaj dhe vjen në një kohë kur me disa paraqitje të mëhershme të përfaqësuesve të Qeverisë që janë kompetentë, pra nga ministratë përkatëse kemi pasur paralajmërime se Qeveria po ecën mirë me zgjerimin e bazës fiskale, me rritjen e efijencës së mbledhjes së taksave dhe me luftimin e ekonomisë informale. Këto ndoshta janë masa që do të mund evitonin ngritjen e vlerës së tatimit, domethënë tatimit në vlerën e shtuar – mekanizma që i kanë pritur dhe i presin qytetarët. Domethënë luftimi i ekonomisë informale është mekanizëm që më së shumti e mbush arkën e shtetit, mendoj unë dhe më shumë madje se rritja 1%. Dhe, natyrisht për rritjen e efijencës në mbledhjen e taksave, kemi pasur paralajmërime se të gjitha komunat qëndrojnë shumë më mirë këtë vit në mbledhjen e taksës dhe kjo , domethënë, ka qenë për ne një shpresë se do të luftohet edhe në atë mënyrë varfëria dhe do të stimulohet, thashë, ngritja ekonomike dhe mund të them se subjekti politik që përfaqësoj këtu është kundër kësaj për faktin se ne, në programin tonë zgjedhor kemi pasur dhe kemi strategjinë e uljes së taksës – të tatimit në vlerën e shtuar dhe assesi rritje së tij e aq më tepër kur kjo vjen në një kohë të një krize globale financiare e cila pa shmangshëm do të godasë edhe vende të vogla sikur që është Kosova.

Prandaj, i bashkohem mendimit të gjithë atyre që kishin vërejtje dhe që në mënyrë profesionale i thanë ato vërejtje dhe mendoj se Qeveria është mirë që gjatë diskutimit, përkatësisht ta amendamentojë dhe rikthejë së paku në vlerën çfarë e ka pasur. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj dhe le të përgatitet, i fundit për këtë pikë të rendit të ditës, Gani Buçinca.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke marrë parasysh kërkesën e Qeverisë për reformën e sistemit respektivisht politikës fiskale, pa dyshim se ky ligj për TVSH-n, respektivisht tatimin mbi vlerën e shtuar ka efekte, respektivisht konsekuenca buxhetore në rritjen e buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Mirëpo, duke i marrë parasysh premiset që janë dhënë qysh më herët edhe nga Qeveria dhenta programi qeveritar që do të rrisë bazën tatimore, ndërsa do të ulë shkallën e tatimeve – kjo bie në kundërshtim me vetë programin e Qeverisë që e ka prezantuar para këtij Parlamenti.

Andaj, nëse mendon kjo qeveri, respektivisht Ministria që të jetë në harmoni me atë program që ka plasuar dhe i kanë besuar qytetarët e Kosovës, me këtë ligj del një shmangie aq e madhe sa që në njëfarë forme, mos të them – i gënjen dhe i mashtron

qytetarët të cilët vërtet kanë menduar se do të ketë ulje të taksave. Duke marrë parasysh se TVSH-ja në Kosovë, për ndryshim nga të gjitha vendet e tjera të Evropës dhe rajonit që faktikisht mbledhet në momentin e fundit, sepse TVSH-ën e paguan qytetari, konsumatori e jo biznesi, mirëpo, në Kosovë TVSH-ja mbledhet në kufi, shumica e saj. Duke marrë parasysh tash këtë efekt, efekte buxhetore do të ketë shumë, por mundësia e evazionit fiskal është se rritet probabiliteti 100%, në kuptimin e asaj se shumica e bizneseve do të mundohen t'i ikin TVSH-ës, të cilën gjë, me shkallën 15% në njëfarë forme. Edhe atëherë ka pasur evazion fiskal, mirëpo jo në atë shkallë jo aq frapante. Ndërsa, me rritjen eventuale nga 15%-shi në 16% vërtet buxheti i Kosovës do të thithë mjete, që u pa edhe nga pasqyra që flitet se do të rritet për milionë euro dhe ka mundësi të financimit edhe të fushave të tjera. Mirëpo, duke marrë parasysh shkallën e varfërisë, duke marrë parasysh normën e madhe të papunësisë në Kosovë, duke marrë parasysh mbledhjen e kësaj takse në kufi dhe shumë elemente tjera - na bëjnë të kuptojmë se nuk mund t'i afrohem standardeve evropiane.

Unë e kuptoj kërkesën e Qeverisë së Kosovës apo të gjithë qytetarëve të Kosovës se dëshirojmë të harmonizojmë norma qoftë të taksave apo qoftë të normave në përgjithësi me Unionin Evropian, por nuk mund të shkojmë në këtë element duke marrë parasysh se nuk i kemi plotësuar kërkesat tjera. Qytetarët e Kosovës kanë shumë ndryshim të madh, edhe në aspektin e korpës së shpenzimeve, edhe në aspektin e punësimit, edhe në aspektin e mirëqenies kanë ndryshim shumë të madh në krahasim me qytetarët e Evropës. Andaj, me këtë ligj i jepet mundësi edhe më e madhe dallimit të diferencave, respektivisht mundësive për tejkalime negative që sot janë edhe sugjerime të Bankës Botërore dhe sugjerime të Fondit Monetar Ndërkombëtar që të bëjmë diçka në luftë kundër varfërisë.

Mua ma merr mendja se ky ligj ka ra në kundërshtim me interesat vitale të qytetarëve të Kosovës duke mos aluduar në mundësinë e harmonizimit me normat apo TVSH-ën në vendet tjera. TVSH-ja në vendet tjera vërtet është më e madhe. Mirëpo, duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit të Kosovës në krahasim me vendet tjera, del se, në këtë periudhë tranzitore apo në këtë periudhë ku pretendojmë vërtet t'i fusim kategoritë ekonomike edhe në jetën e përgjithshme, edhe ekonomiko-sociale në Kosovë, po më duket që e kemi përshpejtuar me këtë normë.

Në qoftë se e krahasojmë tash këtë normë të shtimit prej 1% dhe uljen e tatimit të korporatave me 50%, duhet ta ketë Qeveria parasysh se nuk ka fare konsekuenca buxhetore ajo ulje e taksës, ndërsa kjo ka shumë konsekuenca buxhetore. Në qoftë se nxjerrim një konkluzë nga kjo, del se ende buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe politika zhvillimore e Kosovës po shkon në drejtim të një buxheti emergjent që në fakt tenton apo synon të mbledhë sa më shumë mjete e jo të stimulojë zhvillimin, ta ngritë nivelin ekonomik të qytetarit dhe t'i japë shans bizneseve të vogla dhe të mesme të ecin më tutje.

Ne, edhe si Grup Parlamentar, shprehemi shumë të rezervuar për këtë, por edhe personalisht, si deputet, shpreh brengat e mia në kuptim të asaj që vërtet mirëqenia e qytetarëve për çdo ditë e më tepër po varfërohet. Faleminderit!

Kryesuesi: E ka fjalën Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: I nderuari, zoti kryesues! Ju falënderoj për fjalën e dhënë. Përsëritës të gjithë Kabinetin qeveritar dhe juve kolegë deputetë!

Me vëmendje dëgjova debatin që u zhvillua rreth këtij projektligji dhe, t'ju them të drejtën, falënderoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave që ua dha mundësinë disa kolegëve të mi deputetë që të bëjnë propagandë politike dhe t'i shprehin brengosjet e veta për qytetarët.

Nuk kishte asnjë vërejtje profesionale në aspektin profesional ekonomik, mirëpo në përgjithësi u shfrytëzua ky projektligj për të vazhduar propagandën për fushatën zgjedhore e cila më duket se do të jetë pak e largët për këta kolegët e mi.

Është e vërtetë çdo ngritje e TVSH-së prek buxhetin e qytetarit. Unë jam shumë serioz në trajtimin e kësaj çështjeje, mirëpo, varfëria nuk zbutet nëpërmes ngritjes as uljes së TVSH-ës. Varfëria, si problem i shoqërisë sonë dhe më gjerë, zbutet vetëm duke krijuar vende të reja të punës, duke u dhënë njerëzve mundësi që të jetojnë nga puna e jo nga beneficione tjera, nga lëmosha ose nga asistenca sociale.

Ligjin duhet shikuar në këtë kontekst. Sa e ulë ky varfërinë ose sa e ngrit varfërinë dhe duhet t'i shpjegohet kjo qytetarit se për shpenzime mujore në vlerë prej 500 euro qytetari do të paguajë 5 euro më shumë, kurse korporatat që kanë marrë beneficione dhe recesioni ekonomik që është në Evropë do t'i detyrojë prodhuesit e të mirave materiale që padyshim me çdo kusht t'i ulin çmimet dhe kjo do të jetë një përfitim shumë i madh i qytetarëve të Kosovës, sepse çmimet në tregun global do të vijnë duke u ulur që korporatat të mund t'i ruajnë vendet e punës dhe këtu do të përfitojë qytetari i Kosovës, me siguri, shumë më shumë se që do të humbë duke u ngritur 1% TVSH-ja. Vetëm këtë sqarim desha t'ua jap dhe megjithëkëtë unë shpreh keqardhjen se kjo do të ngritë koston e qytetarit. Mendoj se në këtë fazë të ndërtimit të shtetit të Kosovës, forcimit të institucioneve demokratike të Kosovës, ne duhet të pranojmë dhe duhet ta votojmë në parim Ligjin dhe padyshim unë i falënderoj të gjithë ata të cilët do ta përkrahin ligjin në parim. Nuk është ndonjë sakrificë e madhe për qytetarin duke marrë parasysh të mirat që do të rrjedhin nga disa zhvillime tjera, qofshin globale qofshin brenda në Kosovë.

Edhe diçka tjetër, harrova të them. Evazioni fiskal nuk varet nga vullneti i korporatave. Evazioni fiskal nëse e lëmë në vullnetin e korporatave do të jetë marramendës. Evazionin fiskal duhet penguar duke rritur efikasitetin e punës së doganave, kur flasim për evazionin e jashtëm fiskal. Kur flasim për evazionin e brendshëm fiskal duhet rritur edhe efikasitetin e administratës lokale për mbledhjen e taksave. Mendoj se diskutimet ishin në përgjithësi të nivelit politik propagandistik. Ju ftoj që ta votojmë këtë projektligj në parim.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur deputeti Bajram Kosumi, me kartelën e deputetit Ethem Çeku.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Diskutimi për këtë ligj është shumë serioz për arsye se prek interesin e secilit qytetar të Kosovës apo, thënë më drejt, prek xhepin e secilit qytetar të Kosovës. Kuleta e secilit njeri të Kosovës do të jetë e prekur me këtë projektligj.

Çështja e parë që dua ta theksoj është se çështjet e tilla që prekin interesin e të gjithë qytetarëve është njëfarë rregulli i pashkruar dhe duhet të paraprihen me debate publike.

Nuk mund të propozojë Qeveria ndryshimin e TVSH-së pa pasur debate të gjëra publike për këtë çështje.

Unë kam diskutuar për këtë temë në seancën kur është diskutuar Projektligji për buxhetin e vitit 2009. Atëherë e kam pasur njëherë prej pikave themelore të debatit këtë çështje dhe i pata apeluar Qeverisë që ta rishqyrtojë edhe një herë propozimin e vet për rritjen e TVSH-së, përkatësisht për uljen e taksave të korporatave dhe për uljen e tatimeve të taksave në pagat e njerëzve që janë të punësuar.

Këto janë dy veprime që Qeveria i ka propozuar t'i ndërmarrë për vitin 2009 lidhur me buxhetin e Kosovës. Nga njëra anë, t'i zbrësë për 50% taksat e korporatave dhe tatimin e pagave – të njerëzve të punësuar në Kosovë dhe zbrazësinë që e krijon kjo zbritje për 50% ta plotësojë me ngritjen e TVSH-së 1%. Ky është propozimi i Qeverisë.

Po të përkthehet me gjuhën praktike, Qeveria po mundohet t'i ndihmojë bizneset, po mundohet t'i ndihmojë njerëzit që kanë paga në Kosovë dhe zbrazësia që krijohet me këtë tendencë të Qeverisë po mbushet me ngarkesën e secilit njeri që konsumon në Kosovë, dhe të gjithë qytetarët e Kosovës konsumojnë, e kjo do të thotë po e gjuajnë barrën në shpinën e qytetarëve të Kosovës.

Mendoj se është një politikë, për këtë moment, e gabuar, për dy arsye themelore.

E para, në Kosovë rrezikohet paqja sociale. Në Kosovë ka krizë sociale. Ne të gjithë e dimë se ka krizë sociale, por është një krizë, pak a shumë e menaxhueshme. Është një krizë me të cilën jemi mësuar që disa vite dhe mund të përballemi deri diku me të. Edhe pse po them kështu, gjithnjë e më shumë janë ma kërcënuese kërkesat e strukturave të ndryshme të shoqërisë sonë, siç është ajo e shëndetësisë për të mos qenë të kontrolluara, për të mos qenë të dëgjueshëm.

Prekja e TVSH-së, ngarkimi i qytetarit të Kosovës, është një hap më afër krizës sociale, e shpejton procesin e krijimit të krizës sociale dhe të shpërthimit të krizës sociale në Kosovë. Kjo është arsye e parë pse nuk duhet të ndërrohet TVSH-ja dhe nuk duhet të bëhet ngritje e TVSH-së që do të prekë interesin e çdo qytetari.

Çështja e dytë, nuk ka të bëjë me qytetarin po ka të bëjë me vetë Qeverinë. Siç e përmendën disa kolegë këtu edhe më herët, Qeveria ka qenë e përcaktuar për disa politika tjera ekonomike dhe unë mendoj se ka qenë me të drejtë, nuk ka qenë ai përcaktim vetëm i kësaj Qeverie, por edhe më herët qeveritë kanë pasur një përcaktim për rritjen e bazës së tatimpaguesve, për luftimin e ekonomisë informale – që do të ishin faktorët themelore më të rëndësishëm për rritjen e buxhetit të Kosovës dhe krijimin e rendit dhe ligjit në ekonominë e Kosovës.

Çka po ndodhë tash? A po heq Qeveria dorë nga këto politika, apo nuk po heq dorë, por thotë më lehtë është për ta ngritur TVSH-në sesa për ta luftuar ekonominë informale dhe për ta zgjeruar bazën e tatimpaguesve. Sa për qind paguhet tatimi në pronë në Kosovë? Sa për qind komnat mbledhin tatimin në pronë në Kosovë? Është një përqindje për të ardhur keq.

Në vend se Qeveria të orientohej e të bëjë punën e vet në zgjerimin e bazës së tatimpaguesve dhe në luftimin e ekonomisë informale e ka gjetur një formulë shumë më të lehtë ta ngarkojë qytetarin prej 15% në 16% me TVSH.

Ky është njëfarë kekoizimi i Qeverisë. KEK-u, duke mos mund që të zgjerojë bazën e atyre që paguajnë energji elektrike, i ngarkon ata që paguajnë dhe i dënon njësoj si ata që s'paguajnë, thuaja se, me ata që paguajnë. Qeveria nuk po mund të zgjerojë bazën e tatimpaguesve dhe po e gjen një zgjidhje më të lehtë, po e ngrit 15% në 16%.

Unë, edhe një herë i apeloj Qeverisë se më mirë është - shumë hapur të përballët me ekonominë informale dhe e ka ndihmën edhe të Kuvendit edhe të pjesës më të madhe të shoqërisë së Kosovës – pra, duhet të tentojë ta zgjerojë bazën e tatimpaguesve në Kosovë dhe të mos prek aty ku është interes social i qytetarëve të Kosovës, sepse po e rrezikon paqen sociale në Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Janë lajmëruar njëkohësisht edhe dy deputetë për fjalë. Fjalën e ka deputeti Naser Osmani, le të përgatitet deputeti, besoj i fundit për këtë pikë të rendit të ditës, Sllavisha Petkoviq.

NASER OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Do t'i them vetëm disa fjalë shkurt lidhur me këtë pakon e projektligjeve të cilat janë paraqitur para neve e që kanë të bëjnë me një bazë të ligjshmërisë, të politikës fiskale të këtyre ligjeve dhe ligjeve të cilat janë aprovuar më herët.

Konsideroj se ka qenë diçka e domosdoshme të paraqitet kështu pasi që projekcioni buxhetor ka qenë i bazuar në këto katër ligje dhe atëherë duhet të jemi të vëmendshëm që të bëhet një shqyrtim, ashtu siç tha ministri, kozmetik për të mund me ardhur deri te realizimi i këtij projekcioni buxhetor.

Ne jemi të vetëdijshëm se gjendja sociale në Kosovë është jashtëzakonisht e keqe, është e vështirë. Edhe kjo rritje e do të ndikojë. Nuk kemi këtu të bëjmë me shpenzime të 500 eurove për 5 euro, por kemi të bëjmë me 75 euro. Domethënë, kjo është ajo shumë që do të ndikojë, sepse e dëgjova këtë kalkulim më herët dhe kjo do të ndikojë drejtpërsëdrejti edhe në standardin. Mirëpo, meqenëse Ligji për TVSH-n nga Grupi punues është hartuar, është i gatshëm dhe do të vijë në këtë Kuvend diku më së voni kah mesi apo fundi i janarit, ne në mënyrën më profesionale duhet ta diskutojmë dhe t'i marrim të gjithë parametrat të regjionit dhe duke pasur parasysh standardet dhe nivelet në këtë regjion do të marrim edhe mesataren, e cila do të jetë e balancuar me nevojat buxhetore dhe e përballueshme për popullatën e Kosovës. Mirëpo, në këtë moment dhe në këtë kohë, ballafaqohemi me gjendjen e rëndë sociale dhe me nevojën e përmbushjes së arkës së shtetit për të mund të funksionojë institucionet e Kosovës. Dhe këtu, domethënë, kemi një moment i cili duhet përmbushur që të mund të realizohet krejt ajo politikë e cila është paraparë që institucionet e Kosovës të mund të funksionojnë.

E konsideroj edhe si anëtar i Komisionit për Buxhet, në të cilin nuk e kam dhënë pajtimin lidhur me këtë ndryshim, por pas shumë diskutimeve e debateve me kolegë jam bindur se kjo duhet të kalojë kështu si është, por kërkojmë nga Qeveria që Ligjin për TVSH-ën ta bie sa më parë në Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për replikë është lajmëruar deputeti Gani Buçinca. Urdhëroni, e keni fjalën!

GANI BUÇINCA: Jo, megjithatë, dua të jap një sqarim. Ngritja për 1% e TVSH-ës nuk është 75 euro, i nderuar kolegë Osmani, por është TVSH-ja në tërësi 75 euro, siç thatë ju.

Vetëm këtë desha ta sqaroj, sepse ngritja për 1% e TVSH-së nuk e ngrit më shumë se 5 euro në muaj nëse një konsumator shpenzon 500 euro (harxhon para) për të blerë gjëra konsumuese. Këtu është problemi, asgjë tjetër dhe vetëm këtë desha ta sqaroj.

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Sllavisha Petković. Ju lus deputet të mos nxitoni, keni pasur kohë për t'u lajmëruar. Le të përgatitet deputetja Vezira Emrush. Shumë vonë jeni paraqitur dhe ju lus të keni mirëkuptim.

SLAVIŠA PETKOVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Ovde sam čuo neke stvari koje ja stvarno ne znam, jer ljudi o finansijama kada pričaju da li u opšte znaju o čemu pričaju. Prvo sam čuo malo pre, kažu da povećanje PDV i poreza ne utiče na siromaštvo. Vrlo čudna konstatacija! Vrlo čudna konstatacija!

Druga stvar. Po čemu i kako je to Vlada kvalifikovala da podiže poreze ili PDV, čime je to Vlada pospešila privredu, čime je to Vlada i kojim programom je pomogla privredi pa da traži za uzvrat povećanje poreza.

Drugo, Ministar finansije je ovde. On dobro zna šta znači kada nemate izvoz a imate velik samo uvoz. Porezi i poreska politika se vodi na osnovu izvoza gospodo, a ne na osnovu uvoza. Vi možete da dižete carinske stope za uvoz, ali nemate izvoza. Čim nemate izvoza, nemate šta da naplatite. Vi možete samo ovim zakonom dodatno da osiromašite i ovako siromašno stanovništvo. Ili je sada ovaj zakon odraz nerealnog budžeta koji ste kvalifikovali za sledeću godinu od 1 milijardu i 400 i nešto miliona, bez da odgovorite gde ćete naći te pare. Pa valjda ste to sad shvatili pa sada hoćete dodatnim zakonima, ovakvim zakonima šta – da popunjavate rupe u budžetu. Totalno, nerealno. Totalno, nerealno!

Možete, neću da dužim, kada budete napravili izvoz, kada Kosovo bude imalo veći, tri puta veći izvoz od uvoza, onda možete da namećete dodatne namete i dodatne poreze i da opterećujete stanovništvo. A sa samo uvozom, sa 50 i nešto, 60% ljudi nezaposlenih, sa ljudima koji nemaju za osnovne dnevne potrebe, vi kažete da to neće uticati na siromaštvo. Boga mi će uticati i to znate kako će uticati, katastrofalno mnogo jer 1% posto za nekog ko nema ništa i 1% je mnogo. I pola procenta je mnogo. Tako da, ovaj predlog zakona mi u opšte ne liči da ga je pravio neko ko se u opšte razume u finansije i u poresku politiku. Ja kažem opet, meni se ovo čini da samo sa ovim zakonom hoćete da popunite nerealni budžet koji ste projektovali za sledeću godinu. Hvala predsedavajući!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Shpresoj se do të jetë deputetja e fundit Vezira Emrush, që mund ta marrë fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Ja se zahvaljujem predsedavajućem na datu reč. Nisam imala nameru da se javljam, ali posle svih diskusija moram da kažem, kao gradjanka, da 1% dodatne TVŠ stope smatram kao jednu neodgovornu meru od strane vlade. Jednostavno, mi moramo da kažemo, i čuli smo, da ne utiče na gradjane, a to u stvari utiče generalno na gradjane i ovo je linija manjeg otpora kada ne možemo da analiziramo i da definišemo poreznike i da naplatimo potraživanja, mi onda kažnjavamo gradjane. Najniži sloj, šta je to? Hoću da odgovorim kolegi koji se javlio da nije to na 75%. Ovde je analizirana koliko u regiji je prosečna stopa poreza. U regiji, prosečni lični dohotci su od 250 – 350 svih zemalja koje su bile zajedno sa nama, a naš je prosečni dohodak 120 po zaposljenom, a kada su u pitanju penzioneri imaju 70, penzije 40. Ovo pogadja penzionera od cene struje koja će mu biti povećana, do paradajza koji će kupiti na pijaci. Samo toliko. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka, për në fund, ministri Ahmet Shala. Urdhëroni, e keni fjalën, ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, kryesues!

Natyrisht do të përpiqem të flas shumë shkurt dhe falënderoj për të gjitha vërejtjet e sugjerimet. Sigurisht se pat shqetësime reale, pat edhe dallime në filozofi të mendimit, në koncepte ideologjike, por nuk dua të hy në ato. Pat edhe debate për linguistikën, a duhet të quhet TVSH, a duhet të quhet ndryshe? Sigurisht se, prapë në ato nuk do të hyj. Unë thashë, janë katër ndërrime në këtë ligj ose rregullore që ka ekzistuar qysh nga viti 2003.

Të gjitha ato probleme që kanë qenë, qofshin linguistike, qofshin terminologjike, kanë ekzistuar qysh nga data e vitit 2001 – 2002 – 2003 kur kanë filluar rregulloret. Ne, për të mos i hyrë ndryshimeve tani në këtë rregullore, jemi marrë vesh, bashkë me Komisionin, në fakt, kemi ligjin e gatshëm, i cili do të vijë diku kah mesi i janarit dhe na është sugjeruar që, me qëllim të përsheptimit të procedurave ne mund t'i sjellim vetëm këto ndryshime siç thashë, po thuaj se kozmetike, përveç normës.

Le të lëshohemi tash pak te norma. Para se të them mbase për normën, do të duhej të sqaroj se konsultimet me bizneset – asociacionet tjera janë bërë qysh nga shkurti. Posa që kemi marrë, faktikisht mandatin, diku në shkurt kemi bërë konsultimet me asociacionet e biznesit, në maj, po ashtu, me institucionet ndërkombëtare dhe ka sugjerime e propozime të ndryshme. Por, thamë, duhet kjo të shikohet si paketë. Ne i kemi edhe tri ligje, që tani do të pasojnë, të cilët kanë implikime buxhetore. Implikimi buxhetor që do të sjellë ky 1% është faktikisht është që nëse një produkt ka qenë 1 euro mund të bëhet 1 euro e 1 cent. Pra, nuk duhet ta dramatizojmë aq shumë atë ngritje ose atë ndikim. Humbjet teorike buxhetore ose fitimet teorike buxhetore nga ndryshimet unë i kam këtu dhe me shifra mund t'ua jap dhe janë të kalkuluar. Prandaj, në qoftë se e zbresim taksën në profit, në qoftë se e zbresim taksën në të hyrat individuale ne do të kemi humbje buxhetore dhe ato janë mbi 40 milionë euro në vjet. Përmes TVSH-së dhe akcizës ne natyrisht se do të përpiqemi t'i kompensojmë. Mirëpo, nuk është një ndryshim signifikant i madh 1%, pra është në 1 euro 1 cent, eventualisht. Dhe, sipas të gjitha gjasave dhe në konsultim me biznesin shumica e çmimeve do të rrumbullakohen dhe pothuaj nuk do të vërehet ai ndryshim aq i madh.

Nuk dua tash të hy në paragjykime si do të ndodhë, por ne konsiderojmë, sipas disa deputetëve që thanë a ka politikë investuese në Kosovë, apo politikë të ngarkesës së vetëm të një shtrese? Politikat që janë ndryshuar në ndryshimin e taksës mbi profitin dhe në ndryshimet individuale do të sjellin te rritja e mundësisë së punësimit dhe rritja e mundësisë së investimeve. Natyrisht se ngritja 1% do të ndikojë, por ndikimi është jo signifikant karshi ndikimeve tjera pozitive që do të bëhen.

Unë lus të gjithë deputetët që ta përkrahin këtë ligj dhe, siç e thashë, ne kemi Ligjin dhe i kemi sjell në Kuvend 3 versione. Si rregullore na është thënë që ta bëjmë si amendament rregulloren. Pastaj, na është sugjeruar se nuk mund të bëhet amendimi i rregulloreve, por mund të bëhet amendimi i ligjit. Pra, këtë po e transferojmë në ligj dhe po e amendojmë faktikisht vetëm normën dhe disa nga termat të cilat konsideroj duhet të ndryshohen, ndërsa për termat tjerë, profesor – me shumë të drejt neve i kemi paraqitur në Ligjin për TVSH-ën. Ju falënderoj gjithsesi për secilën vërejtje të arsyeshme dhe për ato tjerat që janë konceptuale mund të debatojmë në ndonjë seancë akademike për ndryshimet filozofike ose të shkollave të ndryshme të mendimit se çfarë do të ndikojë

kjo, por këtë sinqerisht ju lus që ta përkrahim me qëllim që të ecim përpara me buxhetin. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë ju ftoj që të deklarohe mi anë të votimit për miratim në parim të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Faleminderit! Në sallë janë të pranishëm 97 deputetë.

Konstatoh se me 56 vota “për”, 30 “kundër” dhe 6 “abstenime” miratohet në parim Projektligji për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional;
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi;
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që, në afatin sa më të shpejtë, para se të vijë Ligji për Projektbuxhetin në lexim të dytë, të shqyrtojnë projektligjin dhe t’i sjellin rekomandimet e tyre në Kuvend.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: A do të vazhdojmë punën, apo të bëjmë një pauzë, sa për të pirë kafe?

(Ndërhyrje: pauzë...)

Atëherë, do të bëjmë një pauzë prej 15 minutash.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, vazhdojmë punën.

Në pajtim me Rregullën 25 pika 1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Grupi Parlamentar i AAK-së i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesë për të ftuar në interpelancë Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 25 pika 2 të Rregullores së Punës të Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë maksimalisht 2 orë.

Në pajtim me Rregullën 25 pika 7 të Rregullores së Punës, përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit deri 5 minuta.

Ftoj përfaqësuesin e parashtruesit të interpelancës të Grupit Parlamentar të AAK-së, që ta marrë fjalën. Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Edhe njëherë, dy fjalitë e para të cilat mund të nxirren prej raportit, do t'i them që në fillim. E para është që Unioni Evropian nuk kërkon nga Kosova që menjëherë t'i përmbushë të gjitha kushtet e anëtarësimit, por kërkon vendosmëri, punë, përkushtim, seriozitet e sinjeritet dhe thotë se këto që i kërkon nuk janë përmbushur. Dhe, e dyta, thotë se Kosova mund ta gënjejë veten sa të dojë, por askënd tjetër përveç vetes.

Mund të them më tutje, në fillim të interpelancës, se ky është raport i progresit, do të thotë është raport që i shpjegon ndryshimin në gjendje prej vitit të kaluar deri në këtë vit, ose për periudhën që e përshkruan dhe nuk është raport i gjendjes, për shkak se në disa dokumente të cilat kanë qarkulluar të Qeverisë, thuhet se është arritur CEFT-a, është arritur Traktati i Regjisë dhe këto janë të gjitha arritje të qeverive të kaluara, të mandateve të kaluara, do të thotë, po flasin për progresin në 12 muajt e kaluar e jo për gjendjen në të cilën është Kosova.

Do t'ju jap disa arsye pse e kemi thirrur interpelancën, fillimisht. E para, është se procesi i integritetit evropian është i rëndësishëm jetike për Kosovën, në cilindo aspekt që të flasim për të, përderisa nuk kemi parë seriozitetin e cili mund t'i rrijë karshi seriozitetit të procesit nga ana e Qeverisë deri më tani. Dhe, vetë fakti që deri më tani nuk kemi asnjë përgjigje në më se 100 pika, të cilat përmenden në raport, tregon se as vetë raportin Qeveria nuk e ka marrë seriozisht.

Çështja tjetër, është mosserioziteti gjatë negocimit të raportit. Shikoni, sa herë që të prodhohet raporti i progresit, një zyrtar i lartë i Qeverisë shkon në Bruksel. Më ka ndodhur mua, i ka ndodhur edhe një kolegut tim prej ish- Qeverisë, i ka ndodhur edhe një personi shumë senior të kësaj Qeverie që të shkojë në Bruksel dhe ta negociojë raportin, t'i thotë Komisionit këto që i keni shkruar janë në rregull ose nuk janë në rregull. Tani çka ka ndodhur? Qeveria ka shkuar në Bruksel dhe e ka negociuar gjuhën, ku ka qenë e shkruar – nuk ka progres fare, është kërkuar që të thuhet ka pak progres. Edhe ashtu ka ndodhur. Lexojeni raportin, kështu ka ndodhur. Përderisa në raport ka pasur çështje shumë serioze, të cilat nuk janë të vërteta dhe askush prej Qeverisë nuk i ka thënë Komisionit Evropian se këto nuk janë të vërteta.

Shembull ta marrim, është kisha në Gjakovë, e cila, në raport thuhet se është shkatërruar në mars 2004 dhe këtë raport e shfrytëzon edhe ministri i Jashtëm i Serbisë në Këshillin e Sigurimit, ndërsa askujt prej Qeverisë nuk i ka rënë ndërmend të thotë në Bruksel se nuk është e vërtetë. Bile – bile, nuk e kanë pyetur as kryetarin e komunës se iu kishte treguar ai që nuk është e vërtetë se kjo kishë, për të cilën po flisni, që në fakt nuk është as kishë, nuk është kallur në vitin 2004.

Çështja e fundit, pse e kemi thirrur interpelancën, është se keni humbur shansin për t'i treguar botës se Kosova mundet vetë. Realisht, ju e dini, na kanë akuzuar shumë gjatë shumëkush se kosovarët nuk dinë të qeverisin me vetveten, se kanë defekte, se kanë tjera e tjera, s'po i përmend dhe realisht gati se i keni vërtetuar ato që i kanë thënë.

Te brendia e materialit, në fillim i kam grupuar disa çështje për të mos shkuar te secila se, ju thashë edhe njëherë, janë më se 100. E para, si grupim është mosafërsia qeverisëse, thotë moskoordinimi qeveritar dhe do të thotë ka çështje të cilat do t'i përmend pikë për pikë tani, disa prej tyre, jo të gjitha, dhe mospuna, mosdedikimi. Për shembull, thotë “strategjia legjislative nuk ka data, nuk është e harmonizuar me asgjë” dhe ka ardhur pas një viti punë. Thotë “rishikimi i buxhetit ka qenë shkelje e Kushtetutës”. Shikoni faqen 11, paragrafi 7, në versionin origjinal. Komisioni Evropian thotë, e dikush duhet të na tregojë neve, a kanë të drejtë ata a s'kanë të drejtë? Bën pyetje, e këto janë pyetje

diplomatiqe dhe e di që në Qeveri ka njerëz që i kuptojnë çka do të thotë kur bën pyetje Komisioni Evropian dhe thotë nuk e dimë si do të koordinohen zyrat në Zyrën e Kryeministrit me ministritë? Do të thotë se ka ministri, po ka edhe zyra. Tash edhe ministritë janë të Kryeministrit. Nuk e dinë ata pse ka edhe zyrë për disa çështje.

Tjetra, thotë, është shkatërrimi i shërbimit civil. Tetë sekretarë permanentë për tre muaj janë shkarkuar prej pune, pa arsye, pa dhënë arsyen, bile-bile ka zyrtarë shumë të lartë të Qeverisë që dalin në televizor dhe thonë se jemi të lumtur që asnjë njeri nuk është dalë prej punës. Po, ata e dinë, Komisioni Evropian e di që të paktën tetë sekretarë permanentë janë shkarkuar shpejt e shpejt.

E përmend mosemërimin e njerëzve nëpër organe vitale, për shembull, bordet mbikëqyrëse janë thatë. Nuk ka borde mbikëqyrëse. Thotë FSK-ja, AIK-ja, i përmend të gjitha me radhë, thotë nuk janë emëruar dhe tregon se është dhënë afat. Kur ka hyrë Kushtetuta në fuqi, janë dhënë disa muaj afat për t'u emëruar këta njerëz. A e dini pse janë dhënë disa muaj? Ekzakt, për t'u koordinuar dhe për të arritur që kur të vijë koha e emërimit, të jenë të gjitha punët e kryera, por nuk janë kryer ndërkohë, e tash duhet të koordinohen.

Tjetër, lexoni për ekonominë. Domethënë, e keni faqen 28, paragrafin 1 dhe, ju lutem, krahasoni me raportin e vitit të kaluar. Po ju lutem, kërkoj edhe prej mediave, e do të dalë te mediat pak më vonë, që ta bëjmë këtë krahasim se është shumë interesant ta bëjmë. Këto tregojnë se ka degradim në Kosovë, jo përparim. Domethënë, krahasimi me vitin e kaluar është shumë serioz për t'u bërë.

Thotë, vetë Komisioni, se ka prej 05 deri 5 milionë keqpërdorim në secilën ministri më pak se një vit të kaluar. E keni këtë edhe në raport, me siguri e keni lexuar. Thotë, grupi ndërmintor për antikorrupsion nuk është themeluar dhe thotë se në këto bordet mbikëqyrëse për antikorrupsion ka përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit dhe të Zyrës së Presidentit dhe Komisioni thotë se ne nuk e dimë si e garanton paanësinë politike ky veprim. Dhe, prapë, ata që e kuptojnë gjuhën diplomatike, thonë se e ka prishur paanësinë politike, sepse i kanë dërguar dy njerëz aty ku s' duhet për t'i dërguar dhe kontrollojnë.

Komisioni, po ashtu, e ka përcjellë tenderin e "Rilindjes". I ka përcjellë sekretarët permanentë dhe urdhëresat për moszbatim të ligjit. E keni urdhëresën për moszbatim të Ligjit për duhanin, të datës 15 tetor, për shembull, që do të dalë te sundimi i ligjit. Dhe, po dal menjëherë, se po e ndërliði dhe po më sjell te sundimi i ligjit.

Te sundimi i ligjit, kemi dëgjuar shpesh, thuhet: gjyqet. Nuk janë gjyqet. Gjyqet janë efikasiteti i gjyqësorit. Sundimi i ligjit është, për shembull, sekretarët permanentë. Sundimi i ligjit është "Rilindja". Kuvendi ka thënë jo, Qeveria e bën. Sundimi i ligjit janë doganat. Domethënë, moszbatimi i Ligjit për duhanin, për shembull, iu jepet urdhër doganave mos ta zbatojnë ligjin. Nuk e dimë pse! Thirret shefi i Agjencisë Antikorrupsion te zëvendëskryeministri. E mbani mend atë ngjarje, menjëherë sa ta publikojë raportin, edhe nëse çokollata i ka dhënë ky, është intimidim i një njeriu i cili nxjerr raport. Pse e ka thirrur? Sundimi i ligjit domethënë sa ndihen njerëzit të barabartë në Kosovë. A njihen të barabartë studentët kur shkojnë në fakultet të konkurrojnë apo duan ta kenë dikë të njohshëm për t'u regjistruar? A njihen të barabartë njerëzit që donë të hyjnë në punë, por duhet ta kenë dikë në Qeveri për të hyrë në punë? A ndihen të barabartë bizneset kur konkurrojnë në tender apo duhet për të dhënë para për të fituar

tenderin? Ky është sundimi i ligjit. Njerëzit duhet të ndihen të barabartë në Kosovë dhe, më tregoni ju mua, se a ndihen të barabartë apo nuk ndihen të barabartë?

Në fund, po i jap disa reflektime. Për shembull, po kthehem pak te doganat. Ju e dini që është shkarkuar drejtori i përgjithshëm i doganave njëherë. Nuk e dimë si është kthyer, por në raport të Komisionit doganat lavdërohen. Puna e doganave, thotë, është punë shumë e mirë. Tani ne nuk e dimë se kush e ka gabim. Nuk mund edhe të jetë edhe mos të jetë, nuk mund të thotë dikush bardh e dikush zi dhe të dytë ta kenë mirë. Nuk bën dhe nuk është e besueshme kështu për ne.

Shikoni faqet 8 dhe 9 të raportit të këtij viti, në fakt të vitit të kaluar dhe krahasoni me faqet 10 dhe 11 të raportit të këtij viti për qeverisjen dhe për korrupsionin. Ekzistojnë disa shkallë të klasifikimit të problemeve. Një shkallë thuhet se korrupsioni është evident, një shkallë tjetër thotë se korrupsioni është serioz, një shkallë tjetër thotë korrupsioni është brengosësh dhe një shkallë tjetër thotë korrupsioni është shumë brengosësh. Në raportin e këtij viti thotë korrupsioni është shumë brengosësh, do të thotë është shkalla më e lartë e klasifikimit të brengës të cilën e shpreh Unioni Evropian për një problem për të cilin edhe ne po flasim. Përmendet prapë puna e duplikuar, në shumë vende.

Dhe, në fund, po ju them edhe diçka shumë interesant që ende nuk ka ndodhur dikush të diskutojë për të. Thuhet në raport “mediat intimidohen”, që do të thotë në përkthim realisht frikësohen ta kryejnë punën e vet, dikush mund ta përkthejë – edhe kërcënohen.

Tani i kam lexuar raportet e shumicës së vendeve të cilat aspirojnë anëtarësim në Unionin Evropian, shembull të marrim të Armenisë, të Shqipërisë, të Kroacisë, të Malit të Zi, të Maqedonisë dhe të shumë vendeve. Askund nuk thuhet se mediat intimidohen. Thuhet për Kosovën. Tani nuk po supozoj për një moment, po them, nuk e di a është e vërtetë apo nuk është e vërtetë që mediat intimidohen në Kosovë. Mirëpo, nëse Komisioni Evropian e shënon në raport se në Kosovë mediat intimidohen, ky ka qenë dashur të jetë alarm për Qeverinë, për Parlamentin, për partitë në pushtet dhe për të gjithë të tjerët për të biseduar për këtë çështje, sepse është çështje tepër serioze. Ju e dini që në këtë sallë të Kuvend, në këtë mikrofon kemi dëgjuar 1001 herë se Kosova është vend demokratik. 1001 herë minimum. Edhe të na shkruhet në raport se mediat intimidohen dhe një muaj e gjysmë pas publikimit të raportit të mos e thotë askush një fjalë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Koha të shkon në grup. Regjia, ia vazhdoni kohën.

ARDIAN GJINI: Edhe veç tri fjali dhe e kreva. Në fund, po ju them, të gjitha këto që i thashë, kishin për të qenë jo relevante nëse për një muaj e gjysmë deri më tani Qeveria të kishte dalë e t'i kishte adresuar këto akuza serioze, por nuk ka dalë. Ka dalë tash, pasi është thirrur interpelanca dhe e bën një listë prej 1001 dëshirave për punë që janë kryer shumë më përpara dhe i qet si gjendje, jo si raport të progresit.

Unë i lus mediat, si fjali e fundit, le të shkruajnë për këto çështje sepse janë tepër serioze, se përdërisa nuk shkruajnë – vazhdojnë të intimidohen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ftoj Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi, të paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjet e shtruarra në interpelancë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë sot të prezantoj sqarime rreth Raportit të Komisionit Evropian në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës që përfshinë vitin 2007-2008.

Mendoj se këto debate i shërbejnë, në veçanti, kur është puna për integritet evropian, i shërbejnë forcimit të institucioneve të Republikës sonë, i shërbejnë një debati të gjallë për të ardhmen evropiane të vendit tonë, i shërbejnë një debati më të avancuar demokratik dhe thjesht një jete më të gjallë demokratike.

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kam kënaqësinë sot që, si Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës të prezantoj para jush – të nderuar deputetë dhe para qytetarëve të Kosovës suksesin e Kosovës në rrugën e saj të sigurt drejt integritetit në Bashkimin Evropian dhe në strukturat tjera Euro-atlantike.

Raporti i progresit të Komisionit Evropian është një mënyrë apo formë e rregullt e komunikimit të Republikës së Kosovës tani e tutje me Komisionin Evropian për progresin e arritur brenda periudhës njëvjeçare.

Këto raporte zhvillohen që nga viti 2002 dhe përmbajnë këto aspekte:

- marrëdhëniet e Kosovës me Bashkimin Evropian,
- analizat dhe vlerësimin e situatës politike në Kosovë,
- funksionimin e demokracisë,
- sundimin e ligjit,
- të drejtat e njeriut,
- mbrojtjen e minoritarëve dhe çështje tjera regjionale,
- analizën dhe vlerësimin e situatës ekonomike,
- analizën dhe vlerësimin e kapacitetit për të zbatuar standardet evropiane.

Raporti i progresit përfshinë periudhën 1 tetor 2007 – tetor 2008. Raporti i ri vlerëson progresin e arritur në Kosovë në drejtim të përmbushjes së kriterëve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe në të njëjtën kohë paraqet sfidat për të ardhmen e vendit tonë.

Në vlerësimin e progresit, Komisioni Evropian ka pasur parasysh periudhën mjaft sfiduese të pas shpalljes së pavarësisë, ku Republika e Kosovës është përballur me çështjen e ngritjes dhe zhvillimit të institucioneve shtetërore. Në fakt, raporti i fundit i progresit, në mënyrë specifike paraqet punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës në ndërtimin dhe zhvillimin e suksesshëm të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Pavarësisht kësaj, bazuar në eksperiencën nga shtetet tjera, të cilat sot janë anëtare të Bashkimit Evropian, lehtë mund të konkludojmë se procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian është mjaft kompleks dhe sfidues. I njëjti proces është valid edhe sot si për Kosovën ashtu edhe për vendet tjera të Ballkanit Perëndimor që aspirojnë të anëtarësohen në Bashkim Evropian. Kosova tashmë është pjesë e rëndësishme e këtij procesi, i cili, padyshim do të rezultojë me anëtarësimin e plotë të Kosovës në strukturat Euro-atlantike. Ky është një përkushtim normal dhe ne jemi të vetëdijshëm se Republika e Kosovës do të ketë sfida tjera që të hyjë në rrugën e sigurt të integriteteve evropiane. Jemi të vetëdijshëm

se një angazhim i tillë është sfidues dhe ballafaques. Për këtë arsye edhe kemi marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar sa më shumë rrugën tonë.

Do të ishte krejt naive, të nderuar deputetë, që dikush të mendojë se raporti i progresit të mos jetë edhe më kërkues dhe paksa kritik në sektorë të caktuar, sepse një gjë e tillë do të nënkuptonte se Kosova është e gatshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian qysh sot, në fakt Kosovës i nevojiten edhe shumë punë tjera për t'i bërë.

Ne të gjithë e dimë se të gjitha raportet që janë bërë deri më sot për Kosovën nga Komisioni Evropian kanë qenë reale apo kritike për sektorë të caktuar dhe kjo është krejt normale për gjendjen të cilën e kemi kaluar si vend dhe popull, sepse reformat nuk ndodhin brenda natës, e Kosova është shtet i pavarur tash e nëntë muaj. Prandaj, vlerësimet e raportit të progresit për nevojën e ndërmarrjes së masave tjera shitesë në sektorë të ndryshëm dhe vlerësimet për thellimin e reformës në sistemin e drejtësisë, edukimit, energjetikës, shëndetësisë, bujqësisë e të tjera, nuk duhet të marrim si një ndëshkim, mirëpo duhet t'i kuptojmë si një domosdoshmëri dhe si një ngritje shqetësimi edhe të institucioneve të Republikës së Kosovës që sa më shpejt t'i adresojmë këto çështje si institucione, si qytetarë të Kosovës për të arritur objektivin tonë.

Raporti i progresit vlerëson vendimet e institucioneve të Kosovës, vendimet e Qeverisë edhe për privatizimin. Sa i përket privatizimit të Postë telekomit, KEK-ut, aspektet e distribuimit, procesin e konsensionit për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, fillimin e ndërtimit të termocentralit "Kosova e re" dhe vendimin për fillimin e ndërtimit të hidrocentralit në Zhur me 300 megavatë.

Dua të theksoj se vendimi i Qeverisë së Kosovës për privatizimin e PTK-ës i shërben zhvillimit ekonomik dhe teknologjik të Kosovës. Ky vendim përfshin privatizimin e shërbimeve të telefonisë fikse dhe mobile të ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, edhe procesi i privatizimit të distribuimit të KEK-ut i shërben një pune më të mirë, më efikase, më cilësore, për çka jemi konsultuar me ekspertë vendorë e ndërkombëtarë dhe është mbështetur nga të gjithë.

Gjithashtu, duhet të kemi një proces krejt modern normal dhe në përputhshmëri me kohën, kushtet, rrethanat dhe përgjegjësitë institucionale shtetërore tona sa i përket procesit të koncesionit të Aeroportit, por edhe përgjegjësinë e lartë shtetërore për fillimin e ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re" dhe fillimin e ndërtimit të hidrocentralit në Zhur dhe marrjen e vendimeve tjera për ndërtimin e hidrocentraleve tjera më të vogla.

Mirëpo, të nderuar deputetë, e di që ka pasur edhe vërejtje aty-këtu sa i përket privatizimit por dua të sqaroj edhe një herë në Parlament, para jush, para të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe para miqve ndërkombëtarë se kjo është filozofia politike dhe qeverisëse e jona që në fakt përputhet me prioritetet e së djathtës, por unë respektoj edhe mendimet e të tjerëve por nuk mund t'i përkrah kur ndërlidhen drejtpërdrejt me një mendim të së kaluarës, të monopolit dhe centralizimit.

Të nderuar deputetë,

Raporti i progresit të këtij viti është shumë më i avancuar sesa ai i vitit të kaluar.

Të nderuar deputetë, lehtë është për të thënë - jam i djathtë, por duhet të jesh edhe në prioritet, jo veç me dëshirë.

Raporti i progresit, pra, i këtij viti është shumë më i avancuar se sa i vitit të kaluar. Kërkohej nga të gjithë forcim i luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Të nderuar deputetë,

Ju e dini se vitin e kaluar Kosova ishte në mesin e vendeve prej më të korruptuarave në rajon, ndërsa tash bota vlerëson Kosovën si prej vendeve më pak të korruptuara dhe këtu kemi edhe vlerësimin e mekanizmave ndërkombëtar ku Kosova përfshihet në vendin e fundit për korrupsion. Ju mund të thoni – janë vetëm shigjeta, por është Gallup Iterneshenel.

Të nderuar deputetë,

Raporti i progresit të vitit të kaluar ka qenë edhe më tepër vlerësim për punën e UNMIK-ut se sa të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes së asaj kohe. Nuk duhet të harrojmë se më parë Kosova ka qenë e administruar nga UNMIK-u, i cili ka qenë autoriteti ekzekutiv në shumicën e fushave të rëndësishme. Institucionet vendore kanë shërbyer më tepër si dekor i asaj administrate dhe janë marrë me çështje të sektorëve anësorë. Është çështje personale nëse dikush sot ka nostalgji për atë lloj qeverisje të tejkaluar, por unë e di që qytetarët e Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës nuk kanë një nostalgji të tillë, sepse ne tash punojmë në shtetin tonë të pavarur dhe sovran, ne tashmë zhvillojmë dhe implementojmë projekte nacionale të cilat për çdo ditë e më shumë po përmirësojnë jetën e fëmijëve tanë. Mos të harrojmë se tashmë raportet e progresit të Komisionit Evropian bëhen për Kosovën si shtet i pavarur e sovran dhe vlerësohet puna e institucioneve shtetërore e cila është duke u vlerësuar lart nga të gjithë partnerët tanë ndërkombëtar.

Më duhet të ritheksoj se vendimtar në këtë proces është vullneti i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe i të gjitha institucioneve që t'i marrë këto rekomandime dhe t'i inkorporojë në agjendën e saj duke paraparë aktivitete konkrete për adresimin e tyre.

Është e vërtetë se Fondi Monetar Ndërkombëtar ka ngritur pyetjen shumë legjitime sa i përket rritjes së pagave të punëtorëve të arsimit në Kosovë, vendim të cilin e kemi marrë me vetëdije të plotë unë si Kryeministër dhe Qeveria që e udhëheq. Por, për aq sa ka qenë legale dhe legjitime pyetja e FMN po aq ka qenë domosdoshmëri vendimi i Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagave për të gjithë punëtorët e arsimit kosovar në rreth 30% që ndodhi për herë të parë pas luftës. Tash, së shpejti, do të ndodhë edhe autonomia financiare e Universitetit dhe edhe për punëtorët e Universitetit do të ketë dyfishim të pagave.

Prandaj, është aftësi e Qeverisë diskutimi dhe mirëkuptimi me faktorët ndërkombëtar që kjo, që nuk ka ndodhur në nëntë vitet e kaluara, të ndodhë tani. Ka pasur mundësi, të nderuar deputetë, të punohet shumë më tepër në tetë vjetët e kaluara. Nuk po them se ne kemi bërë punë të përkryer, por jemi munduar dhe jemi përpjekur të bëjmë punën më të mirë të mundshme. Dhe, ky është vetëm fillimi.

Një vullnet të tillë, çfarë e kemi pasur, ne do ta vazhdojmë edhe në të ardhmen për të realizuar menjëherë pas publikimit të raportit, me ç'rast Qeveria e ka marrë dhe analizuar raportit në mënyrë të detajuar dhe ka dalë me veprime konkrete ndaj Komisionit për adresimin e atyre sfidave në mbledhjen plenare të 15-të të takimit të mekanizmit përcjellës të stabilizim asocimit.

Në takimin e mekanizmit përcjellës të stabilizim asocimit unë dhe ministrat kemi marrë obligime dhe jemi zotuar se do të marrim veprime konkrete për adresimin e sfidave. Si rezultat i kësaj, Qeveria do t'i inkorporojë të gjitha zotimet e marra gjatë takimit të mekanizmit përcjellës në planin e veprimit të partneritetit evropian, rezultate konkrete dhe të matshme ku secili veprim do të përmbushet.

Qeveria parasheh rreth 1.500 veprime konkrete si adresim ndaj partneritetit evropian dhe se këto do t'i përmbushim me vullnet, me përpikëri të plotë dhe vizion të qartë.

Kjo tregon se integrimet evropiane mbesin prioritet kryesor për Qeverinë e Kosovës. Për ta bërë këtë jemi kujdesur që t'i sinkronizojmë në mënyrë më të mirë dokumentet më të rëndësishme të Qeverisë, si Planin e veprimit të partneritetit evropian, Kornizën afatmesme të shpenzimeve, Planin vjetor të punës, Planin për investime publike dhe Buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Vetëm në këtë mënyrë do të mund të kemi një politikë unike dhe të qëndrueshme për integrim sa më të shpejtë të shtetit të Kosovës në strukturat e Bashkimit Evropian.

Vlerësimet e Raportit të progresit janë plotësisht në pajtim me pozicionin dhe qëllimet për zhvillimet politike dhe institucionale të Qeverisë në fushat – si sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, rritja e dialogut dhe pajtimi ndërmjet komuniteteve.

Të nderuar deputetë,

Me rëndësi të veçantë, që duhet theksuar, është studimi i fizibilitetit, i cili tanimë ka filluar dhe pritet të përfundojë deri në vjeshtën e vitit 2009. Kjo tregon përkushtimin e Bashkimit Evropian ndaj vullnetit, gatishmërisë, seriozitetit, sinqeritetit të institucionit të Kosovës për integrim në strukturat e Bashkimit Evropian. Studimi i fizibilitetit bëhet vetëm për vendet të cilat janë të pavarura, serioze, të përgjegjshme dhe kanë ardhmëri të qartë për strukturat e Bashkimit Evropian. Ky studim do të tregojë se Republika e Kosovës është e gatshme për të nënshkruar marrëveshjen për stabilizim asocim, për të cilën duhet të vendosë Këshilli i Bashkimit Evropian. Kjo do të jetë një punë sa teknike po aq edhe politike, gjatë së cilës do të llojmë për njohje të reja nga vendet tjera anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat së bashku do të japin miratimin e tyre për nënshkrimin e marrëveshjes.

Për ta adresuar të gjithë agjendën evropiane, Qeveria e Republikës së Kosovës, në prill të këtij viti, ka miratuar Planin për integrimin evropian 2008 – 2010. Ky është plan i përgjithshëm strategjik me të cilin parashikohet krijimi i strukturave dhe mekanizmave specifik për udhëheqjen e agjendës evropiane.

Si rezultat i partneritetit evropian, Qeveria e Republikës së Kosovës ka përpiluar Planin e veprimit të partneritetit evropian, i cili në çdo kohë do të japë përgjigje ndaj problemeve të shtruara nëse ka nevojë për vendime politike, krijim apo ndryshim institucional, mbështetje legislative, zhvillim të kapacitetit administrativ, zhvillim të burimeve njerëzore.

Duke parë gjithë këtë proces të integritetit evropian, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendime adekuate për përforcimin e strukturave dhe mekanizmave të cilat do të lehtësojnë dhe përshpejtojnë këtë proces. Ky mekanizëm, duhet të veprojë në nivelin politik dhe operacional. Bashkëpunimi me botën akademike, shoqërinë civile, mediat e

lira, është qëllimi ynë drejt një procesi sa më gjithëpërfshirës. Filozofia e Qeverisë së Republikës së Kosovës është thellimi i partneritetit me botën akademike, marrja dhe implementimi i ideve të tyre, thellimi i bashkëpunimit dhe partneritetit me shoqërinë civile, me mediat e lira dhe natyrisht me të gjithë komunitetin e biznesit, me gjithë komunitetin e shoqërisë kosovare. Me krijimin e mekanizmave dhe strukturave për integrim në Bashkimin Evropian janë marrë parasysh këto parime të rëndësishme:

- Zotimi politik, i qartë dhe i fuqishëm si sinjal për kapacitetet demokratike dhe përkushtim për interesat madhore strategjike;
- vazhdimësi e procesit me pranimin e përgjegjësisë së plotë për pasojat në rast të ndërprerjes së procesit ose ndryshimit të rendit të prioritetëve;
- qëndrueshmëri të mekanizmit me të kuptuarit se mënyra më e mirë dhe më e shpejtë për të zhvilluar kapacitetet administrative është ndërtimi i mëtejme i tyre mbi rezultatet e arritura, në vend se të zëvendësohet struktura ekzistuese, duke humbur investimet në kapitalin njerëzor;
- llogaridhënia e paraqitur si parim i menaxhmentit të mekanizmit që bart përgjegjësinë për funksionimin e tij ose lëshimet eventuale;
- qartësia me qëllim që të kuptohen dhe monitorohen lehtë ndarja e përgjegjësiave me objektiva të qarta, rezultate dhe indikatorë të matshëm;
- transparenca të jetë bazë për marrëdhëniet në nivel të strukturave politike, administrative, bizneseve dhe publikut më të gjerë, gjithmonë duke pasur parasysh se çdo qytetar ka të drejtë të plotë të jetë i informuar dhe të dijë se si po lëviz shteti drejt qëllimit - anëtarësisë së plotë në Bashkimin Evropian.

Për të përforcuar këtë mekanizëm të transparencës, unë kam marrë disa vendime të rëndësishme që rezultojnë drejtpërdrejt edhe me transparencën e funksionimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, por edhe institucioneve tjera në nivel vendi.

Unë do të ndalem vetëm te funksionimi transparent i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për herë të parë kemi instaluar qeverisje të mirëfilltë transparente ku mbledhjet e Qeverisë mbahen në prani të gjitha mediave, gjatë gjithë kohës. Disa mbledhje kanë qenë të transmetuara edhe drejtpërdrejt në televizion që njerëzit të kuptojnë se çka punon dhe si shërben Qeveria e zgjedhur nga ata për të mirat e tyre. Kemi mbajtur edhe mbledhje në rajone të ndryshme të Kosovës që të jemi sa më afër qytetarëve, sa më afër zotimit dhe fillimit të implementimeve të projekteve edhe në nivel lokal, si në Mitrovicë, në Istog, në Pejë. Gjithashtu, për herë të parë institucionet e Kosovës kanë hapur derën, e mund të them edhe zemrën, për çdo qytetar që është i interesuar të takohet me Kryeministrin e Kosovës në zyrën e tij për të dëgjuar dhe filluar zgjidhjen e problemeve të tyre, qofshin individuale, familjare apo edhe shoqërore. Një diçka e tillë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Por, në të njëjtën kohë, dëshiroj të theksoj se ende ka çka për t'u bërë, në veçanti në qasjen në dokumentet zyrtare, për çka duhet të punohet edhe më tepër.

Sa i përket këtyre çështjeve, kam përcaktuar njërin, prej dy zëvendëskryeministrave, si bartës të procesit politik në integriteteve evropiane – zotin Kuçi. Kam themeluar Këshillin Ministror për Integrim Evropian, që përbëhet në mënyrë të përhershme nga unë, si Kryeministër, dy zëvendëskryeministrat, ministri i Ekonomisë dhe Financave, ministri i

Shërbimeve Publike dhe ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal. Në këtë organ do të marrin pjesë edhe të gjithë ministrat tjerë, varësisht nga agjenda. Detyrë e këtij organi do të jetë diskutimi dhe vendosja e strategjisë së qeverisë, prezantimi ose ndryshimi i politikave për anëtarësim, përcaktimi i prioritetëve, pozita e Qeverisë në procesin e integritetit, pozitat negociuese e tjera.

Dëshiroj të prezantoj këtu edhe një vërejtje. Këshilli pritet të fillojë punën në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm, kjo varet nga puna e Komisionit edhe për Integritet Evropian.

Kam themeluar Komisionin Punues për Integritet Evropian, i cili do të udhëhiqet nga zëvendëskryeministri, ndërsa të gjithë sekretarët e përhershëm do të jenë ex officio të Komisionit. Të ftuar do të jenë edhe udhëheqësit e doganave, të Administratës tatimore, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Entit Statistikor të Kosovës. Ky organ do t'i shqyrtojë të gjitha çështjet relevante në procesin e integritetit, në veçanti marrëdhëniet me Komisionin Evropian, realizimin e të gjitha prioritetëve afatshkurtra dhe afatmesme, përfshirë çështjet ligjore, institucionale dhe investuese, programimi dhe realizimi i asistencës së Bashkimit Evropian dhe shfrytëzimin e instrumenteve të Bashkimit Evropian "Taex", binjakëzimin e tjera.

Kam themeluar 6 grupe punuese, të cilat në mënyrë specifike do të merren me çështjet e orientuara kah kaptinat dhe në harmoni me mekanizmin përcjellës të stabilizim-asocimit.

Këto grupe punuese janë të ndara në qeverisje, ekonomi, tregu i brendshëm, kohezioni social, infrastruktura, bujqësia dhe peshkataria. Puna e këtyre grupeve ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve ligjore dhe konkrete të problemeve të lidhura me koordinimin dhe implementimin e agjendës për integritet evropian. Tashmë të gjitha grupet kanë zhvilluar takimet e tyre të para.

Kam marrë vendim për shkrirjen e Agjencisë për Integritet Evropian në Qendrën për Koordinim të Donatorëve në Agjencinë për Koordinim të Zhvillimit dhe Integritetit Evropian. Kjo për arsye të koordinimit më të madh dhe më efikas të donatorëve nga Bashkimi Evropian dhe jashtë saj dhe ju e dini se donacionet e Bashkimit Evropian veç kanë filluar të vijnë në Kosovë.

Në këtë aspekt ne do të mund t'i koordinojmë politikat tona drejt Bashkimit Evropian me asistencën e vendeve jo anëtare në një sistem ku Republika e Kosovës do të fitojë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian dhe zhvillimit në përgjithësi.

Gjithashtu, edhe sa i përket shërbyesve civilë, dua të theksoj se raporti vlerëson punën profesionale të Qeverisë së Kosovës sa i përket shërbyesve civilë që asnjë njeri me motive politike nuk është larguar nga puna, ndërsa çështja e jo profesionalizmit është çështje e diskutueshme.

Më tutje, ne do të vazhdojmë me funksionet kryesore të Agjencisë që e përmenda, të cilat do të jenë: përgatitja e strategjive, analizave dhe koordinimit të politikave; koordinimi i asistencës së donatorëve; harmonizimi, integriteti dhe përafrimi i legjislacionit dhe përkthimi i legjislacionit të Bashkimit Evropian; ngritja e kapaciteteve; informimi dhe komunikimi.

Të nderuar deputetë,

Duke dashur që ta përmbyll fjalën time hyrëse prezantuese, dëshiroj të theksoj se ky është viti në të cilin kemi punuar të gjithë bashkërisht dhe njerëzit kanë pritur që Kosova do të

bëhet shtet dhe sot është Kosova shtet i pavarur, sovran dhe demokratik i njohur nga 53 shtete. Qytetarët kanë pritur që Kosova të ketë kushtetutë, sot Kosova ka Kushtetutë moderne. Qytetarët kanë pritur që të fillojë zhvillimi ekonomik, ka filluar zhvillimi ekonomik. Qytetarët kanë pritur vendosjen e qeverisjes së mirë, kemi vendosur qeverisjen e mirë, transparente dhe efikase. Qytetarët kanë pritur betejë të pa kompromis kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe sot Kosova është në vendin e fundit prej vendeve të rajonit në raport me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Prandaj, Raportin e Komisionit evropian, ne si Qeveri e Kosovës, si institucione të Republikës së Kosovës e vlerësojmë si raport real, pozitiv dhe i sfidave për të ardhmen. Me qeverisje të mirë Kosova ka të ardhme të sigurt evropiane, por i gjithë ky sukses është sukses i të gjithë neve që jemi këtu dhe të tjerëve që na kanë ndihmuar në rrugën tonë evropiane. Mirëpo, dua të theksoj se, asnjë parti e vetme dhe asnjë qeveri e vetme nuk do të mund ta shpijë Kosovën në strukturat e NATO-s dhe Bashkimit Evropian në veçanti, prandaj edhe pse mund të kemi dallime konceptuale sa i përket relacioneve pozitive – opozitë duhet të punojmë kur të vijë puna për Bashkim Evropian, për strukturat e NATO-s, për qeverisje të mirë të gjithë së bashku dhe një ofertë e tillë është e drejtuar nga ana ime, nga Qeveria e Kosovës për të gjithë juve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e kanë grupet parlamentare, sipas kohës, e në dashi po ua lexoj edhe kohën se sa ka secili grup. PDK, ka 30 minuta, LDK 25, AKR 11, AAK 11, LDD 11, Grupi SLS 8, Grupi “7+” 7 minuta dhe deputetët e pavarur kanë 10 minuta.

Vazhdojmë sipas radhës. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, nëse e do fjalën. Nuk e do fjalën. Atëherë, shkojmë me radhën e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike. Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër, anëtarë të Kabinetit,

Sot është rast i mirë që Qeveria të paraqet, ashtu siç ndodhi me Kryeministrin, gjendjen reale dhe angazhimet konkrete pas Raportit final që Komisioni Evropian e ka dërguar në Kosovë. Sepse, për gjendjen në të cilën është Kosova, Qeveria e ka pasur të drejtën që ta negociojë me Komisionin Evropian dhe me vetë faktin se kjo metodë e punës është e njohur për të gjitha shtetet që kanë aspirata integruese është e qartë se duhet angazhim konkret. Kryeministri i paraqiti angazhimet, planet, projektet që kërkohen jo vetëm nga institucionet, por edhe nga spektri i gjerë i shoqërisë së Kosovës dhe që përfshin rolin e secilit veç e veç për të punuar, në mënyrë që rruga jonë pas përfundimit të statusit aspirata jonë për pavarësi është realizuar dhe aspirata e integriteteve evropiane mbetet aspiratë jonë e madhe e cila kërkon mund, kërkon sakrificë dhe kërkon angazhim serioz të gjithë neve.

Me vetë faktin se ne si vend me aspirata për integritete evropiane dhe me probleme serioze të funksionimit të shtetit sikur në të gjithë Ballkanin Perëndimor ka detyruar Komisionin Evropian ta ndërtojë dhe ta emërojë një komisar të veçantë, i cili merret me zgjerim dhe ndërton mekanizma të veçantë që merret me trajtimin e këtyre aspiratave - tregon se ne do të punojmë shumë.

Ajo që është thënë vazhdimisht që Brukseli si aspiratë, si vizion, nuk është spital për shtetet e sëmura, por kërkon që ato shtete të shërohen dhe mandej të integrohen në këtë familje evropiane është shembulli më i mirë që kërkon nga ne që në shtyllat ku duhet të funksionojë shteti dhe raporti pasqyron se ne duhet të marrim masa serioze, në mënyrë që të arrijmë standardin i cili Kosovën e dërgon në këtë rrugë.

Ne jemi në fillim. Kryeministri e paraqiti për herë të parë se Kosova ka hyrë në fazën e studimit të fizibilitetit, është hap i parë. Është hap i parë që Kosova hyn në rrugën e gjatë të integriteteve evropiane dhe ky studim do të detektojë qartë krejt atë që Kosova ka nevojë të kalojë në procesin e politikave të integritetit. Secili prej nesh e ka të qartë se ky proces nuk është i lehtë, ky proces nuk është që duhet të vendoset jashtë prioriteteve, përkundrazi rekomandimet duhet të përkthehen, pra, në prioritete të larta dhe Grupi Parlamentar i LDK-së dhe LDK si forcë politike e ka mbështetur vazhdimisht perspektivën evropiane. Dhe, sinqerisht e ka mbështetur! Besoni se e ka mbështetur!

Dhe, ky sinqeritet dhe besim në mbështetje është përkthyer në politika në të gjitha qeverisjet që ne i kemi pasur. Në të gjitha qeverisjet e LDK-së e LDK-ja ka marrë pjesë në të gjitha qeverisjet, kështu që kjo politikë për ne është shumë e njohur, kjo politikë për ne është prioritet dhe kjo politikë kërkon nga ne përkushtimin dhe mbështetjen e plotë që i jepet Qeverisë, sepse edhe Parlamenti ka detyra. Këtu ka rekomandime edhe për Parlamentin, ka rekomandimin edhe për gjyqësorin si pushtet i ndarë, ka rekomandime edhe për të tjerët, nuk është vetëm qeveria këtu, Qeveria është lidere dhe sigurisht ajo duhet të udhëheqë por të gjitha rekomandimet duhet t'i përkthejmë në detyra dhe angazhimet tona në këtë drejtim do të jenë serioze, do të jenë të sinqerta dhe unë nuk do të hyj në detaje të rekomandimeve sepse si i tillë është në duart tuaja dhe e kemi diskutuar edhe në komisione parlamentare dhe dëshiroj të japim mbështetjen që Raporti i progresit me punën tonë, me angazhimin tonë, në vitin 2009 të vjen si rezultat apo si e arritur më e madhe që ka të bëjë në krahasimin me këtë vit. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e ka Grupi i AKR-së, deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Raporti i progresit për Kosovën, të cilin po e debatojmë sot, kap të gjitha fushat e mosfunksionimit apo të funksionimit institucional dhe shoqëror në vendin tonë. Sigurisht se sikur çdo raport tjetër, edhe ky hartohet varësisht nga këndvështrimi i hartuesve dhe në këtë rrafsh dua të besoj në profesionalizmin dhe paanshmërinë e këtij raporti.

Raporti në fjalë ndalet edhe te punësimi dhe politikat sociale, që është një nga pikat më të dobëta të funksionimit të institucioneve të Kosovës dhe kjo për një fakt kryesor – mungesën e infrastrukturës ligjore gjegjëse dhe mungesën e kapaciteteve humane. Në raportin e progresit përmendet raporti vjetor për punë dhe punësim për vitin 2008, por që nuk është aprovuar asnjëherë dhe kjo ka ardhur si rezultat i joprofesionalizmit dhe joseriozitetit.

Me këtë rast, si duket, për ta mbuluar këtë dështim, opinionit publik i kujtohen akrobacionet politike të ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, kur deklaronte për do farë marrëveshjes për punësim sezonal të qytetarëve të Kosovës në Shtetet Evropiane.

Dhe, shkojmë më tutje. Raporti piketon diskriminimin e disa grupeve më të pafavorshme, siç janë gratë, romët, hashkalinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara. Dua të them menjëherë se është politika institucionale, e ndikuar edhe nga faktorët ndërkombëtarë, që kanë bërë që një numër i madh i këtyre grupeve që u përmendën, të trajtohen si u tha më sipër.

Në këtë mes, diskriminimi pozitiv ka bërë që një pakicë kombëtare të kthehet në një shumicë politike në Kosovë, ndërsa të gjitha të tjerat sikur janë lënë në harresë edhe pse gjithmonë ishin në mbështetje të pavarësisë së vendit tonë. Ka mundësi që kështu ne do të humbasim edhe përkrahjen e këtyre pakicave, prandaj në këtë drejtim Qeveria duhet të jetë shumë më e kujdesshme.

Çështje tjetër, është rinia. Unë e di që ekziston plani i veprimit për punësimin e të rinjve në Kosovë, por ky plan është e zeza mbi të bardhën dhe asnjëherë nuk ka gjetur zbatueshmëri. Në fakt, si mund të zbutet papunësia e të rinjve në Kosovë ose edhe plani për fuqizimin e rinisë, për të cilën gjë qeveria në buxhetin për vitin 2009 ka ndarë vetëm 440.000 euro.

Papunësia që, sipas raportit, shkon deri në 43% të popullatës ekonomikisht aktive, pastaj 45% jetojnë në varfëri dhe 18% në varfëri të skajshme, mbeten pikat më të dobëta dhe më dëshpruese të Qeverisë aktuale.

Vlen të përkujtohet në këtë rast oferta që iu është bërë qytetarëve të Kosovës gjatë fushatës elektorale, por që realisht është treguar ofertë mashtruese.

Gjendje e keqe dhe pa vizion përshkruhet edhe në fushën e funksionimit të sindikatave të punëtorëve dhe të grevave që vijnë si rezultat i mungesës së ligjeve. Në Kosovë mund të gjenden raste për sigurimin e kafshëve, por Qeveria akoma nuk ka ligj për sigurimin shëndetësor të njerëzve.

Është edhe një çështje tjetër e rëndësishme që prek edhe anën humane të njeriut, e që do të duhej ta prekte edhe anën humane të Qeverisë. Është fjala për vdekshmërinë e foshnjave dhe të nënave, që mbetet më e larta në rajon. Kujtoj se Qeveria do të jetë më e përgjegjshme duke krijuar kushte që nënat t'i gëzohen kohës së lindjes së foshnjave të tyre dhe jo t'i kapë frika e vdekjes. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Ju njoftoj se Lidhja Demokratike ka edhe 21 minuta, AKR edhe 7. Fjalën e ka grupi i AAK, kush dëshiron ta marrë fjalën. Zylfije Hundozi është e paraqitur këtu më herët.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zotëri Kryetar,
Zotëri Kryeministër, ministra të pranishëm,
Deputetë të nderuar,

Unioni Evropian është deklaruar qartë për perspektivën evropiane të Kosovës. Këtë e kanë bërë edhe institucionet e Kosovës duke u shprehur se synimi kryesor i tyre pas shpalljes së pavarësisë është integrimi evropian. Pas analizës së raportit të progresit të Komisionit Evropian, shtrohet pyetja a duam me të vërtetë ne të anëtarësohemi në Unionin Evropian, apo do të mbesim shtet i izoluar dhe i varfër në Ballkanin Perëndimor. Pas 17 shkurtit, Qeveria i ka pasur duart e lira. Nuk ka pasur më pretekst se statusi i pazgjidhur po e pengon zhvillimin ekonomik dhe sundimin e ligjit, kështu që dua ta pyes Qeverinë se kush po e pengon tani që të gjejë rrugë që të lëvizim nga kjo pozitë e tashme.

Pas analizave të bëra të raportit të Komisionit Evropian për vitin 2008, i cili nëse krahasohet me raportin e vitit të kaluar, kuptohet se nuk është arritur progres në asnjë prej kriterëve të Kopenhagës, të cilat duhet të plotësohen që Kosova të lëvizë prej pozitës në të cilën ndodhet tani, e ajo është shkalla më e ulët sa i përket procesit të integrimi evropiane në shumë fusha me rëndësi të jetës.

Raporti i dhënë nga ana e Komisionit, si i tillë e pasqyron realitetin, i cili është krijuar për arsye se kjo Qeveri, kur e ka filluar punën e vet, nuk ka pasur program dhe strategji, kështu që shumicën e punëve i ka bërë ad-hoc dhe është normale që nuk ka pasur rezultate pozitive.

Ta marrim vetëm një pjesë të këtij raporti, për shembull, gjegjësisht kriterin ekonomik për anëtarësim, ku decidivisht theksohet se për shkak të mungesës së bashkërendimit të punëve në mes të ministrive, qasja ad-hoc ndaj politikave fiskale, konsistenca e brishtë e politikave ekonomike, cilësia e dobët e implementimit dhe planifikimit buxhetor vazhdojnë ta dëmtojnë mjedisin e gjithëmbarshtëm ekonomik dhe, për shkak të kësaj, në Kosovë varfëria është edhe më tutje e madhe dhe Kosova është vendi më i varfër në Evropë.

Papunësia ka shënuar rritje në krahasim me vitin e kaluar dhe tash është 43,6%. Për shkak të korrupsionit ekzistues, pa marrë parasysh sa për qind është, kostoja e jetës është rritur për 20%, e vullneti politik për ta luftuar korrupsionin nuk ekziston dhe ai është për këtë arsye në rritje, e çmimin për këtë po e paguajnë qytetarët e Kosovës.

Dështimi i furnizimit të qëndrueshëm me rrymë elektrike e ka vështirësuar edhe më tepër zhvillimin ekonomik të Kosovës, rritja e importit në krahasim me eksportin dhe shumë dështime të tjera që detajisht janë dhënë në këtë raport.

Kriteret e Kopenhagës për integrim evropian përputhen me kërkesat e përditshme të qytetarëve të Kosovës për zhvillim dhe jetë më të mirë. Zhvillimi i Kosovës nuk është vetëm deri te Fushë-Kosova dhe QMI-a, por shkon shumë më larg, zotëri Kryeministër.

Në kriterin politik, po e marr shembull vetëm sundimin e ligjit. Sundimi i ligjit është jetik dhe shumë me rëndësi për funksionimin e jetës normale të qytetarëve të Kosovës. Qeveria as në këtë fushë nuk ka plan e as strategji si ta bëjë Kosovën shtet ku sundon ligji. Në Parlament është dërguar strategjia legjislative pa orar për dërgimin e draftligjeve, por edhe ligjet e miratuara në Kuvendin e Kosovës nuk po zbatohen. Nuk ekziston një sistem operacional për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Strategjia për reformën e sistemit gjyqësor nuk përfshin një plan gjithëpërfshirës për të efektivizuar të tri burimet e legjislacionit që të krijojë siguri legale.

Nga e gjithë kjo, mund të supozohet se Qeveria pret që EULEX-i t'ia kryej punët që i takojnë asaj. Nuk dua të hyjë më tepër në detaje. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i ka më shumë se 60 faqe dhe për punën e secilës ministri ka vërejtje. Mirëpo, mund të them se ky raport paraqet një udhërrëfyes të mirë me të gjitha sfidat e identifikuar për punën e institucioneve të Kosovës dhe nëse ai përfillet, besoj se Raporti i progresit i Komisionit Evropian për vitin e ardhshëm do të jetë më i mirë se ky. Faleminderit!

KRYETARI: Ju njoftoj ju të AAK-së se keni në dispozicion edhe 6 minuta. Fjalën e ka shefi i Grupit të LDD, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Zotëri Kryeministër,

Është fakt se tash po bisedojmë për një raport, një dokument i cili është hartuar jashtë Kosovës dhe nuk po flasim për punën e Qeverisë, së pari, por është edhe fakt se integrimi evropian jo vetëm që u theksua se është i rëndësishë jetike për Kosovën, por është edhe synim i të gjitha subjekteve politike dhe na përket edhe ne si deputetë në këtë Kuvend, por të gjithë ata që kanë pasur rastin ta shikojnë përmbajtjen e këtij raporti, do të binden në faktin se në këtë raport paraqesin stagnime të shumta në të gjitha sektorët e zhvillimit të jetës dhe lirisht mund ta quajmë se kemi të bëjmë me një raport regresi. Ky raport do të duhej të reflektonte një porosi të qartë për Qeverinë e Republikës së Kosovës se kursi aktual politik duhet të ndryshojë.

Në anën tjetër, Lidhja Demokratike e Dardanisë konsideron se është përgjegjësi e institucioneve të vendit ta kuptojnë drejt këtë raport, por do të ishte dobësi politike e institucioneve të vendit, në radhë të parë të Kryetarit të vendit dhe të Qeverisë, që çdo raport me qasje kritike që adresohet në nivel të Kosovës, ta përkthejnë në raport suksesi.

Gama e shqetësimeve tona të cilat përkojnë me këtë raport që, shkurtimisht do t'i përmend me këtë rast, do të ishin: Në këtë raport në mënyrë eksplicite theksohet për fuqizimin e strukturave paralele dhe implementimin e legjislacionit të Republikës së Serbisë në veri të Kosovës. Në këtë raport theksohet se sistemi gjyqësor mbetet i dobët në të gjitha nivelet. Çka do të ishte shqetësuese për ne, mbledhja e të dhënave nëpër gjykata është e dyshimtë. Korrupsioni mbetet brengë kryesore, i cili theksohet se është i përhapur dhe mbetet problem kryesor në Kosovë. Në këtë raport konstatohet humbje në buxhetin e ministrisë, në çdo ministri, si rezultat i korrupsionit nga 0.5 deri në 5 milionë euro për vit.

Monopolizimi apo shtrirja e monopoleve të qeverisë në të gjithë segmentet, është shqetësues në këtë raport. Po ashtu, është shqetësues presioni politik mbi mediat, ku theksohet se mediat iu ekspozohen kërcnimeve politike. Për ne do të ishte një shqetësim serioz për një vend i cili pretendon t'i arrijë, t'i implementojë standardet evropiane.

Në këtë raport theksohet shumë qartë për fenomenin e pastrimit të parave në Kosovë, trafikim, krim të organizuar, por çka do të ishte shqetësimi më i madh, konsideroj për Kuvendin e Kosovës dhe për ne si deputetë, se në këtë raport theksohet në mënyrë eksplicite dhe të vendosur se mungon, thotë, vendosmëria, përcaktimi dhe kapaciteti i nevojshëm i institucioneve të Kosovës për ta luftuar efektivisht krimin e organizuar. Këto janë disa porosi të qarta të cilat institucionet tona do t'i marrin seriozisht, ose do të duhej t'i marrin seriozisht, dhe do të ishte një shqetësim që duhet të konsiderohet për institucionet e vendit dhe për ne si deputetë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Ju njoftoj se grupi juaj i ka edhe 7 minuta. Radha është për Grupin Parlamentar të LSL, që i kanë 8 minuta. Kush e do fjalën nga ju? Urdhëroni! Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar “7+” është lajmëruar Myfera Shinik. Fjalën e ka deputetja Myfera Shinik.

MÜFERA ŞİNİK:

Sayın Başbakan, bakanlar ve milletvekilleri, hepinizi saygıyla selamlıyorum

Ben fırsattan faydalanarak sizlerin ve Kosova vatandaşlarının Mübarek Kurban Bayramını kutlar, sağlık, başarı ve huzur diliyorum. Mutlaka Kosova Cumhuriyeti'nin ilerleme ve gelişmesinde Avrupa Komisyonu açısından geçen bir yıllık Raporun Başbakan tarafından sunulması çok önemli. Aynı zamanda Avrupa Birliğine giderecek

olan ÷lkeler arasında entegre olma açısından da çok büyük önem taşımaktadır. Ancak Kosova Cumhuriyetinin bağımsızlığından bu yana 10 ay geçti, yani tamamen bir yıl bile değil. Bundandır Kosova hükümetinin tenit edildiğı, eleştirildiğı, yolsuzluk, kaçakçılık gibi konularda yardım sumak, desteklemek, ister başta başbakan ister bakanlar kurulu, ister milletvekilleri olarak ister de Kosova Cumhuriyeti'nin vatandaşları, yani bireyleri olarak hepimize düşen birer vatandaşlık borcu ve görevidir diye düşünüyorum. Sayın Başbakanımıza da sunmuş olduğı Rapordan dolayı teşekkür eder, başarılı çalışmalarının devamını diliyorum. Faliminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti dhe ministri Alush Gashi.

ALUSH GASHI: I nderuari, zoti Kryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ekselencia e tij Kryeministri me zëvendësit dhe të gjithë vëzhguesit,

Ky Raport i progresit është një prej lajmeve të mira për institucionet e vendit se jemi në një përkushtim të BASH në Komisionin Evropian që sa më parë sfidat e përbashkëta të identifikuar t'i zgjedhim sipas standardeve për të cilat kemi interes, vullnet dhe përkushtim që t'i arrijmë.

Jam shumë i nderuar me identifikimin e sfidave në shëndetësi nga ana e ekspertëve të Komisionit Evropian, me të cilët ne në kryeqytetin e Republikës së Kosovës kemi dialog të vazhdueshëm.

Më lejoni që t'i përmend vetëm disa nga sfidat, të cilat janë edhe preokupim i shumë deputetëve në Kuvendin e Kosovës, preokupime të cilat i kanë shprehur përmes shqetësimeve të tyre, qoftë nga votuesit, grupet parlamentare dhe përmes pyetjeve parlamentare, kemi provuar si Qeveri t'u japim përgjigje dhe, natyrisht, në ato përgjigje kemi ofruar disa nga rezultatet.

Në raportin e progresit, një nga sfidat që përmendet në shëndetësi, është çështja e Banjës së Pejës, që gjendet në komunën e Istogut, si edhe e Termalit të Killokotit.

Siç e dini, Ilixhja apo Banja e Pejës, që gjendet në një komunë evropiane, siç është Istogu (të qeshura në sallë). Kryetari është i LDK-së, nuk është i LDD-së, ju i keni humbur zgjedhjet atje! Nga ne është kërkuar, nga Qeveria e Kosovës, respektivisht nga Ministria e Shëndetësisë kërkohet që të jepet përgjigje se si do të veprohet në këto dy institucione të rëndësishme shëndetësore, të cilat sipas Ligjit për shëndetësi bëjnë pjesë në institucione shëndetësore sekondare. Siç e dini, vite më parë për këto dy institucione është lutur Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit që t'i trajtojë.

Në vitin 2006, Qeveria e Kosovës ka pasur një qasje tjetër dhe ka menduar se mund të jetë një formë e kombinuar. Siç jeni në dijeni, transformimi nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, në këtë të privatizimit, ka marrë kohë. Prandaj, shpresojmë se në vitin 2009, kjo çështje e këtyre dy institucioneve do të zgjidhet.

Nën dy, një prej sfidave shumë të rëndësishme është preokupimi i të gjithë deputetëve, i Qeverisë, por edhe i shoqërisë, është çështja e mungesës aktuale të nënshkrimit të Ligjit të sigurimeve shëndetësore. Mu për atë, ne menjëherë kemi formuar komision për sigurime shëndetësore, kemi ftuar ekspertë të Bankës Botërore, të Organizatës Botërore

të Shëndetësisë, Fondin Monetar por edhe konsulentë të tjerë dhe gjatë vitit 2009 Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta ketë Ligjin për sigurime shëndetësore.

Sfida e tretë, viti 2009, siç është premtuar, ne do ta realizojmë.

Komisioni Evropian shpreh brengosje të madhe se çfarë uji pimë ne qytetarët e Republikës Kosovës, sepse një numër i madh i sëmundjeve infektive, të ashtuquajtura sëmurje hidrike, që janë si pasojë i ujit të ndotur, na sjellin probleme shëndetësore në vendin tonë.

Çështje tjetër që Komisioni Evropian kërkon që ne ta adresojmë dhe ne atë adresim e mirëpresim, sepse si pjesë e investimeve të përbashkëta, jo vetëm në Ministri të Shëndetësisë, por edhe në ministrinë e tjera është rregullimi i infrastrukturës, që do të thotë që në vendin tonë mos të jenë vetëm 30% të banimeve të lidhura me kanalizim, por kjo çështje të rritet në nivel më të lartë.

Një prej sfidave të identifikuar nga Komisioni Evropian, është ajo të cilin ne e kemi diskutuar ditë më parë edhe këtu. Është çështja e infrastrukturës së sistemit shëndetësor në Republikën e Kosovës, i cili ndahet në atë primar, sekondar dhe terciar...(qeshje).

Banka Botërore iu ka përgjigjur kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë që këtë sfidë të identifikuar në Raportin e progresit, ta hulumtojë dhe ka dalë me propozimin e Master planit të rrjetit shëndetësor të Republikës së Kosovës, dhe me atë master plan, për të cilin ne me shumë përkushtim do ta zbatojmë së bashku me ju, edhe me ata që pajtohen, edhe me ata që nuk pajtohen, sepse shëndetësia, siç e dini, është shumë e rëndësishme dhe e kërkon përkushtimin e të gjithëve.

Një prej çështjeve më të dhimbshme në vendin tonë është vdekshmëria e lartë e fëmijëve në vendin tonë dhe ne do t'i zbatojmë të gjitha rekomandimet që kanë dalë nga Komisioni Evropian dhe në mbështetje të reformave që i kemi, në farmaci, Komisioni përmes të IPS ka pranuar binjakëzimin e Agjencionit Kosovar të Produkteve Medicinale, me Agjencion gjerman, slloven dhe të Polonisë.

Çështje tjetër e cila theksohet në raport, e është shumë e rëndësishme për ne, është mungesa e institucionit shëndetësor për trajtimin e problemit me drogë. Nuk po bëjë me dorë nga askush. Ne gjatë vitit 2009, në bashkëpunim me kryetarin e kryeqytetit të Kosovës, në Qendrën kryesore të Mjekësisë Familjare, në një pjesë të qytetit që quhet Emshir do ta zhvillojmë këtë qendër për tretman të atyre që përdorin drogën, për tretman të atyre që përdorin alkool, dhe mendoj se kjo do të jetë një lajm i mirë.

Zhvillimi i përgjithshëm i edukimit shëndetësor dhe i ligjeve në fuqi, mendoj se do të arrijë që kjo çështje të jetë më mirë dita - ditës dhe, në fund, ndihem i nderuar që janë vlerësime pozitive për punë në Ministrinë të cilën e udhëheq. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Do të thotë, Lidhja Demokratike i ka në dispozicion edhe 13 minuta. Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: I nderuari, zotëri Kryetar i Kuvendit, fillimisht falënderoj për mirëkuptim!

I nderuari Kryeministër,
Zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë,

Unë do të koncentrohem, do të fokusohem kryesisht në konstatimet e Raportit sa i përket administratës publike dhe kam nderin që kam mundësinë që seancën plenare, sepse komisionet parlamentare këto ditë i kam njoftuar, t'i njoftoj me planet e Qeverisë së Kosovës për reformën rrënjësore të administratës publike, sepse jo rastësisht raporti është fokusuar mjaft detajisht te administrata publike dhe ka bërë kërkesa që Kosova tani pas pavarësisë dhe pas shtetkrijimit të lëvizë drejt reformave të fuqishme në sektorin publik dhe në administratë publike.

Ne kemi kuptuar dhe kemi analizuar drejt gjetjet e raportit, i kemi vlerësuar si vlerësime reale dhe kritike dhe Qeveria e Kosovës është duke i finalizuar të gjitha projektet që viti 2009 të jetë një vit i reformave rrënjësore në tërë sektorin publik dhe në administratën publike në veçanti.

Realisht, kanë qenë dy situata objektive që ne kemi trashëguar si Qeveri, që kanë cilësuar administratën publike dhe që kanë ndikuar tek raporti.

E para, administrata publike në Kosovë është ndërtuar në kushtet e administrimit ndërkombëtar, në kushtet e Rezolutës 1244, kur ka pasur një dualizëm në qeverisje dhe ku administrata nuk ka qenë e përshtatur një shteti sovran dhe të pavarur dhe, e dyta, ne nuk kemi pasur në periudhën e pasluftës një planifikim të mirë të administratës publike. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës e ka vendosur reformën e administratës publike në epiqendër dhe në përparësi dhe vitin 2009 do të jetë një vit ku qytetarët do t'i shohin menjëherë ndryshimet rrënjësore sa i përket sektorit publik. Janë tri momente që do të ndikojnë që në vitin 2009, ne të shkojmë guximshëm drejt krijimit të një administrate moderne, një administrate evropiane, një administrate që do të jetë tërësisht në shërbim të qytetarëve.

Unë po i prezantoj këto momente dhe do të jem shumë konkret sepse do të jap edhe afate dhe Parlamenti do të mbajë të lidhur pak për fjalë se sa Qeveria do t'i realizojë këto afate.

Fillimisht, ne pajtohemi me konstatimin që kemi një administratë ndoshta të stërngarkuar, e kemi një administratë ndoshta që ka edhe elemente sociale dhe ky nuk është faji i kësaj Qeverie, është faji i faktit se kjo administratë është ndërtuar në një kontest politik të një vendi që nuk ka qenë shtet sovran dhe i pavarur dhe tani ne kur kemi, në fakt plotësisht shtetkrijimin e përfunduar, dëshirojmë që administrata t'i përgjigjet një shteti çfarë është Kosova, një shtet që po kalon në një tranzicion drejt Bashkimit Evropian.

Janë tri momente të cilat Qeveria po i diskuton dhe që janë kyçe. Fillimisht, momenti i parë dhe më i rëndësishëm do të jetë riorganizimi i Ministrisë së Shërbimeve Publike, një projekt që është finalizuar dhe pritet që Kosova së shpejti ta ketë një ministri të administratës publike sipas modelit të shteteve të Bashkimit Evropian, një moment shumë i rëndësishëm sepse po e kemi një ministri që do të jetë kompetente kryesisht për performancën e administratës publike.

Ne si ministri kemi organizuar vizita të shumë deputetëve, shumë delegacioneve pikërisht në vendet ku ka pasur progrese më të mëdha në administratën publike, këto ditë një vizitë e Kuvendit është kthyer nga Estonia, më herët kemi qar delegacione tjera dhe me qëllim kemi organizuar këto vizita që deputetët t'i shohin progreset që i kanë bërë shtetet e tranzicionit.

Themelimi i kësaj, riorganizimi i kësaj ministrie do të jetë një hap shumë i rëndësishëm drejt progresit dhe ne me siguri që do të kemi pastaj edhe të arritura konkrete.

Momenti i dytë, në dëshirojmë që në vitin 2009 të fillojë procesi i krijimit, i kalimit nga një administratë klasike e zyrës, në një administratë moderne dhe digjitale, në një administratë që menaxhohet me e-qeverisje, e-qeverisja po bëhet tani filozofi politike e kësaj Qeverie dhe, nëse ju kujtohet, Kryeministri në fjalën e rastit kur ka prezantuar vizionin e-qeverisjen e ka prezantuar si një model apo si një mjet i reformimit të administratës publike dhe si një mjet që shkon drejt një sistemi të qeverisjes së mirë.

Këto ditë, Qeveria e Kosovës po e miraton strategjinë nacionale për e-qeverisje që pretendon që deri në vitin 2015, Kosova plotësisht ta implementojë këtë sistem, i cili do të mundësojë që qytetarët e Kosovës për të gjitha shërbimet publike të aplikojnë dhe të marrin shërbime në mënyrë elektronike. Dëshirojmë që sportelet e gjata, burokracia që krijohet nëpër administrata lokale të jetë diçka e kaluar dhe dalëngadalë të shkojmë drejt një administrate evropiane dhe moderne.

Momenti i tretë që neve do të na mundësojë të bëjmë progrese, është procesi i rishikimit funksional, një proces që është filluar më herët dhe që Qeveria e Kosovës plotësisht e ka mbështetur. Ne dëshirojmë që ta krahasojmë administratën tonë publike me 7 vende të Bashkimit Evropian që kanë pasur një tranzicion dhe, në fakt, të ndërtojmë një qeveri që i përgjigjet Kosovës, një qeveri efektive racionale, por edhe një qeveri e cila përballohet sa i përket buxhetit. Nuk guxojmë t'i lejojmë vetit në administratë publike të stërngarkuar, një administratë publike e cila në fakt edhe e ngulfat veten. Dëshirojmë ta shohim veten ku jemi, jemi duke krahasuar pikërisht me modelet tipike për Kosovën, gjetjet e para janë shumë pozitive dhe Qeveria e Kosovës po i jep një mbështetje të plotë politike implementimit të rishikimit dhe të riorganizimit të plotë të Qeverisë, sepse tani jemi shtet sovran dhe i pavarur dhe tani duhet vetë ta dizajnojmë modelin e qeverisjes sonë.

Momenti i tretë i rëndësishëm është pikërisht kompletimi i ligjeve organike që kanë të bëjnë me shërbimin civil dhe me administratën publike dhe ne këto ditë po diskutojmë në Qeveri tri ligje organike, është Ligji për Qeverinë, dëshirojmë që gjatë këtij viti ta miratojmë këtë ligj, pastaj Parlamenti në tremujorin e parë do t'i ketë dy ligje organike, është Ligji për shërbimin civil, një ligj shumë i domosdoshëm dhe dëshirojmë të vendosim rend dhe rregull në shërbimin civil, të klasifikojmë shërbyesit civilë, t'i mbrojmë shërbyesit civilë dhe të krijojmë një shërbim civil plotësisht profesional, që më tepër është i dedikuar shtetit sesa interesave partiake. Pra, një shërbim që plotësisht mbrohet me mekanizmat ligjor, me mekanizmat e një shteti demokratik dhe në atë drejtim ligji është jashtëzakonisht demokratik dhe i përpunuar mirë.

Gjithashtu, po e finalizojmë Ligjin për pagat e nëpunësve në sektorin publik, diçka që është i është dashur Kosovës dhe diçka që do të vendos një disiplinë sa i përket sistemit të pagave, sepse në të kaluarën kemi pasur ndoshta edhe një sistem të pa koordinuar mirë të pagave dhe dëshirojmë tani këtë çështje ta rregullojmë në mënyrë shtetërore.

Këto ditë kemi finalizuar projektin e themelimit të Gjykatës Kushtetuese dhe Parlamenti shumë shpejt do ta ketë në diskutim atë projektligj dhe me këtë Qeveria e Kosovës po i përgjigjet edhe kërkesës së Raportit të progresit që sundimi i ligjit, nga deklarata politike të bëhet një përkushtim konkret. Do të bëhet përkushtim konkret kur të kemi një gjykatë kushtetuese, e cila në fakt do ta mbrojë Kushtetutën dhe do ta

interpretojë në pajtim me frymën e saj. Thjeshtë, Qeveria e Kosovës i ka kuptuar shumë seriozisht kërkesat sa i përket administratës publike dhe është e vendosur që në mënyrë shumë të guximshme, në vitin 2009, ne të kemi produktet e para.

Duhet ta pranojmë realisht që Qeveria në gjashtëmujorin e parë ka qenë e përkushtuar kryesisht në procesin e shtetkrijimit, në procesin e inaugurimit të Kushtetutës apo të hyrjes në fuqi dhe në gjashtëmujorin e dytë shumica e ministrave kanë përgatitur strategjitë për qasje reformuese dhe këto do të japin produktet dhe rezultatet e para qysh në vitin 2009, kur besoj se performanca jonë si shtet do të përmirësohet dhe Raporti i progresit këtë do ta vlerësojë. Ajo që është shumë me rëndësi, është me rëndësi të gjithë duhet ta kuptojmë që reforma e administratës publike është një proces ndoshta edhe i dhimbshëm, që do të ketë edhe hapa të dhimbshëm, po që duhet t'i ndërmarrim, sepse ne duhet të pranojmë se mënyra e menaxhimit të sektorit publik ende është një mënyrë pak e vjetruar, pikërisht projekti i e-qeverisjes i cili po merr edhe mbështetje ndërkombëtare nga shtetet që janë lidere sa i përket e-qeverisjes. Ne veç kemi krijuar raporte bashkëpunimi dhe kemi marrë zotime për mbështetje trevjeçare nga tri shtetet që janë lidere në reformimin e administratës publike, është Republika e Estonisë, Republika e Sllovenisë dhe shteti i Austrisë, tri vende që janë treguar më të suksesshme në krijimin e administratës moderne. Ne kemi marrë zotime dhe projekte konkrete, kemi dërguar grupet e para të ekspertëve të teknologjisë informative që ata t'i marrin këto përvoja, jemi duke e reformuar edhe Institutin për Administratë Publike, që ky mos të jetë vetëm një institut për zyrtarët shtetëror, por të jetë një institucion permanent, se do të jetë në nivel akademik që të ofrojë programe moderne të trajnimit, që zyrtarët tanë mos të jenë zyrtarë të zyrës, por të jenë zyrtarë të cilët do të jenë plotësisht në shërbim të qytetarëve. Thjesht, kalimi nga administrata manuale në një administratë elektronike është diçka që është e mundshme. Fillimisht, kjo duket diçka idealiste, por pikërisht në shtetet e reja kjo është diçka e mundshme, sepse më lehtë është ta ndërtosh një administratë nga fillimi në një shtet në fillim të funksionimit të shtetit, se sa të rinovosh një administratë më vonë duke përmirësuar gabimet.

Për këtë arsye, ne jemi të vendosur që qysh vitin e ardhshëm rreth 57 aplikacione të jenë elektronike, që qytetarët të fillojnë në mënyrë elektronike t'i marrin shërbimet e para. Mund të them se gjendja në Kosovë sa i përket teknologjisë informative është mbi nivelin e rajonit, mbi nivelin e shteteve rajonale. Kosova është një territor i vogël që është pothuaj se i mbuluar mirë me internet, është i mbuluar mirë me kompjuterë dhe resurset humane dhe teknologjike e premtojnë këtë.

Thjesht, ne premtojmë që gjatë këtij mandati qeveritar, me mbështetjen e Parlamentit, me mbështetjen e opinionit të gjerë do të arrijmë që administratën tonë plotësisht ta transformojmë dhe t'i plotësojmë të gjitha standardet e Bashkimit Evropian, sepse krahas një gjyqësori të pavarur, kërkesat kryesore të ...

KRYETARI: Ju faleminderit! Dhjetë minuta shkuan. Fjalën e ka deputeti Slobodan Petroviq. Sllobodan, dil në foltore pasi nuk e ke kartelën këtu.

SLOBODAN PETROVIĆ: Dame i gospodo, narodni poslanici,
Popštovani premijeru, zameniče premijera, ministri,
Poštovani predsedniče Skupštine,

Ja želim isto, u ime Samostalne liberalne stranke, pre svega, svima onima koji na ovaj neposredan način slave praznik Bajram, da ga proslave u zdravlju i veselju sa svojom porodicom uz puno, puno lepih želja.

Ono što sam hteo da kažem, jednostavno je stalo u knjizi, odnosno u jednom našem Biltenu, koji smo mi odradili upravo kako bi oni ljudi koji nisu imali mogućnosti da vide šta smo mi uradili. S obzirom da znam da vi imate razumevanja prema pripadnicima Srpske zajednice koji su u ovom Parlamentu, i oni koji ne znaju, treba da znaju da bi imao puno problema upravo zbog toga što želimo dobro svojoj zajednici, što želimo dobro svim građanima Kosova. Želim najpre da se zahvalim premijeru, vladi, ovoj Skupštini, kako poziciji, tako i opoziciji, EULEX-u, OESC-eu, diplomatskim predstavnicima koji su zdušno podržali sve ono što je u interesu, pre svega, građana Kosova.

Ja pripadam onoj grupi ljudi koji malo pričaju a više rade. U prošlom periodu je bilo isto predstavnika Srpske zajednice koji su bili u institucijama Kosova ali, na našu žalost, nisu puno radili za svoju zajednicu.

Ono što ćete vi dobiti od nas, jeste upravo sve ovde što je radjeno za ovih devet-deset meseci, i to nije uradjeno samo našom zaslugom, nego zaslugom ovih ljudi ovde i vašom zaslugom i želim da vam se najiskrenije zahvaljujem na tome. Ovo su stvari koje su vidljive, ovo je nešto što je rezultat svih nas, i ovo je nešto što trebamo svi mi zajedno da se ponosimo. Ima i onih koji nas hvale, ima i onih kojih nas kritikuju. Mi nismo zlonamerni, nismo najbolji i ne uzimamo to za zlo. Imate pravo da kritikujete, ali rezultat je najbolji mogući pokazatelj. Ovo ovde je rezultat koji nije bio do sada u prošlih deset godina, uradjeno za 10 meseci, i ja moram, ako ne iz drugih razloga, iz onih moralnih razloga da se zahvalim svim onima koji su dali doprinos ovome. Pored vlade, tu je Američka ambasada, tu je USAID, tu je EULEX, tu je ICO i tu su naši prijatelji iz drugih ambasada koji su dali podršku.

Ne bih želeo da dužim, želim isto da pozdam Galupovo istraživanje i da kažem da sam ja bio prijatno iznenadjen i da budem neskroman s obzirom da i mi imamo naše predstavnike u Vladi i da je to deo i našeg rezultata i želim da kažem da je to i vaš rezultat. Još jednom želim ka vam kažem da ovo neće da se zaustavi samo na ovome. Radite ono što mislite da je interes vaš, vaših građana, naših građana, a mi ćemo uvek biti partneri svih onih koji ne izdvajaju ljude, koji ne ruše mostove, koji grade mostove. Naša misija je misija pomirenja, misija napredka, zajedničkog napredka. Još jednom se zahvaljujem. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radhën e ka deputetja Donika Kada, le të përgatitet Sabri Hamiti.

DONIKA KADA: Ju faleminderit, Kryetar!

Duhet ta falënderojmë edhe Kryeministrin për një mori përsëritjesh të premtimeve, realisht që i kemi dëgjuar edhe në fushatën zgjedhore, në fjalimin e tij, por realisht realiteti është mjaft ndryshe, është i hidhur edhe pasqyrohet edhe në Raportin e Komisionit Evropian.

Në rrethana normale të funksionimit të Qeverisë dhe të shtetit, nëse pranohet një raport kaq shqetësues, ku pikat kyçe tregojnë që, jo që nuk kemi ndonjë progres në Kosovë, por realisht kemi një prapakthim të të arriturave, do të duhej që Qeveria kujt edhe i

adresohet ky Raport, të ulet dhe të debatojë urgjentë për pikat, si dhe të ketë një strategji për përmirësimin e këtyre pikave.

Çka ndodh te na? Raporti fillimisht injorohet, më pas nën presionin publik, fillohet të diskutohet për të, por gjithnjë duke neglizhuar të vërtetën që paraqitet në atë raport dhe duke tentuar që përmes deklaratave dhe retorikës së thatë të vihet në dyshim opinionin. Në vend që të merret me punë konkrete, Qeveria pikë për pikë të ngrisë performancën e vet, ndodhë e kundërta. Ajo vazhdon intimidimin e mediave që janë bazë për zhvillimin e demokracisë, sidomos në vendet e dala nga lufta, në vendet që janë në tranzicion, siç është Kosova.

Pikën që flet për fuqizimin e rendit dhe të ligjit, Qeveria e nënkupton shumë bukvalisht dhe fillon sulmet dhe kërcënimet edhe nga kjo foltore ndaj policisë dhe, me qëllim të mbylljes së gojës, bën edhe skandalin e fundit, duke ndërhyrë në marrëdhëniet me publikun, resor ky që është shërbim civil dhe ku politika më së paku e ka vendin.

Në lëmin e energjetikës, një pikë që është ngritur gjithashtu në raportin në fjalë, Qeveria nuk ka pasur, duke mos pasur një platformë për zhvillimin e një procesi transparent të privatizimit, ku punëtorët do të përfshihen me skemë të veçantë që do t'u garantojë realizimin e të drejtave të tyre, vendos ta shesë kompaninë, pa bërë ndonjë plan paraprak dhe duke rrezikuar kështu 7000 punëtorë, të cilëve paraprakisht në fushata zgjedhore ju ka premtuar rritje të pagave. E njëjta përsëritet edhe me PTK-në, që është burim, një ndër burimet kyçe të të hyrave në buxhetin e Kosovës, dhe kjo ndodhë pas nënshkrimit paraprak të një kontrate shumë të dyshimtë.

Në gjithë këtë proces të ngutshëm bëhen ndërrime dhe politizime, sidomos në sektorë të prokurimit, ku kriter kryesor për t'u pozicionuar është të jesh i afërt me pushtetin.

Këto të dhëna, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kohë më parë i ka ngritur shumë herë. Duke filluar nga muaji prill kemi kërkuar debat, kemi kërkuar që të ndërmerren masa, sepse Kosova nuk është duke ecur në drejtimin e duhur. Mirëpo, shumë herë duke e ngulfatur fjalën e lirë edhe në këtë Kuvend, por edhe në media, jo të gjitha mesazhet tona janë marrë dhe kanë arritur deri tek opinionin publik. Sido që të jetë, raporti i fundit ka argumente të mjaftueshme për shqetësimet e dhëna, sidomos në gjyqësi, polici, media dhe elemente të tjera, të cilat po e bëjnë këtë vend që të ngulfatet dhe që të jetë larg zhvillimeve të duhura.

Prandaj, të gjitha këto ju bëjnë përgjegjës juve, si Kryeministër i vendit, për stagnimet në zhvillimin ekonomik, mungesën e investimeve, ngecjen në përmbushjen e standardeve integruese për vendin dhe kthimin prapa të Kosovës.

Për fund, duam ta dimë, çka keni ndërmarrë që kjo situatë dhe këta resorë të ndjeshëm të kenë një performancë më të lartë? Ju lutem që të na përgjigjeni shkurt, konciz, qartë, sepse qytetarët e Kosovës janë lodhur duke dëgjuar retorika të thata, të cilat ju po i bëni dhe cilat po prodhojnë konfuzitet në vend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! AAK-ja i ka edhe 2 minuta në dispozicion. Fjalën e ka deputeti, Sabri Hamiti. Le të përgatitet deputeti dhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi

SABRI HAMITI: Zotëri Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Zotëri Kryeministër i Republikës së Kosovës,

Të gjithë ministrat që jeni këtu,
Deputetë të nderuar,

Është një ditë kur unë për vete kam menduar që do të diskutohet shumë më shumë me dokumente. Edhe unë mbaj në mend bajagi shumë, por kam qejf t'i kam letrat përpara dhe është mirë që të gjithë t'i kemi, sidomos kur diskutojmë për raportet që bëhen për ne në nivelin evropian, nga Qeveria Evropiane, dhe në raportet që krijojmë ne me ta.

Lidhur me këtë problem, unë kam në dorë të dy dokumentet. Njëri është Raporti i progresit për një vit të kaluar, dhe i dyti, më i fundit, është një konkluzion për Ballkanin Perëndimor, ku studiohet edhe problemi i Kosovës dhe ky është shumë i freskët, Raport i Këshillit të Evropës, i datës 8-9 dhjetor të këtij viti. Pra, nëse i krahasojmë, do të shohim që në pjesët përfundimtare pak a shumë situata është e ngjashme, ajo që është konkluzioni për vendet e Ballkanit Perëndimor, pra i datave 8 dhe 9 dhjetor, është trimërues në kuptimin që analizon gjendjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor një për një dhe në to është edhe Kosova dhe për Kosovën. Shkurt, thuhet që ka bërë përparim të madh në adaptimin e ligjeve që i përket bashkë, si meritë edhe sponzoruesit, që është Qeveria dhe Kuvendi, që jemi ne, që trimëron me qëndrimin konstruktiv të këtij vendi që të ketë raporte të mira rajonale dhe që angazhohet Komisioni Evropian që ta kryej studimin për gjendjen dhe zhvillimin ekonomik dhe politik dhe perspektivat evropiane të Kosovës. Unë e thashë me qëllim fjalën “studimi”, sepse ata që i kanë përcjellë këto kontraverza në Bashkimin Evropian, e dinë që është bërë një luftë e madhe atje mes pro Kosovës dhe jo pro Kosovës, që të hiqet ajo pjesa e fizibilitetit dhe atë pjesë cilësuese e kanë hequr 5 – 6 vende që se kanë njohur Kosovën. Çka dua të them me këtë? Dua të them me këtë që ne duhet ta lexojmë realitetin në jetë dhe në dokumente dhe ky dokument, që ne e kemi përpara, e reflekton këtë situatë edhe në Bashkimin Evropian, sepse ne na kanë njohur shumica e vendeve të mëdha të Bashkimit Evropian, por nuk na kanë njohur disa, të cilat e bëjnë problematik diskutimin e shkuarjes së Kosovës kah Bashkimi Evropian sepse, ju e dini, që neni numër 1 i Ligjit themelor të Bashkimit Evropian thotë: “këtu aplikojnë shtetet e pranura dhe të pavarura”. Ne jemi shtet i shpallur i pavarur, po fatkeqësisht, ne i kemi brenda Bashkimit Evropian disa shtete që nuk e kanë njohur ende Kosovën, bile që bëjnë edhe propagandë pa u lodhur kundër saj ose bëjnë pengesa. Pra, dokumenti mbi të cilin po diskutojmë ne sot dhe për të cilën është thirr në interpelancë Kryeministri i Kosovës, zoti Thaçi, ka të bëjë me këtë dokument që, nëse e lexoni mirë, e është mirë ta lexoni mirë, deputetë, te neni 1 – 2 thotë, konteksti: “Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244/99”, konteksti, keni kujdes, dhe pjesa e dytë ku problematizohet parimisht lidhja jonë me Bashkimin Evropian, marrëdhëniet mes BE-së dhe Kosovës (sipas Rezolutës 1244) dhe pak më poshtë paragrafi i dytë: “Në shkurt të vitit 2008, Këshilli për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme është pajtuar për aksionin e përbashkët për të vendosur një mision për studimin e ligjit në Kosovë, të njohur EULEX, e ne jemi tash këtu. Pra, ne jemi në një situatë politike, ku ne dëshirojmë që të marginalizohet 1244 dhe Kombet e Bashkuara në zhvillimet në Kosovë dhe të forcohet Bashkimi Evropian me instrumentin konkret politik monitorues dhe ndihmues që është EULEX. Ky është realiteti ynë, ne jemi këtu në këtë pikë sot dhe këtu jemi edhe më aktual se raporti që e kishim të bërë para 1 – 2 muaj dhe këtu, unë prita, u çudita pak që ky problem nuk u tha. EULEX-i, siç thuhet, i propozuar në këtë dokument të Këshillit Evropian me mandatin origjinar që të monitorojë dhe të këshillojë institucionet e Kosovës, është i mirëseardhur dhe është ky mision origjinar Evropian, që ne e kemi pranuar. Ky është misioni të cilin e ka mbrojtur Qeveria, Parlamenti, opozita, pozita, Presidenti i Kosovës dhe, unë për vete, i përgëzoj të gjithë me kundërshtimin e tyre që këtij misioni t'i jepet një detyrë plotësuese, të cilën ia

japin rrugës ata që s'ë kanë njohur Kosovën, ata që nuk kanë lejuar të njihet Kosova në Kombet e Bashkuara dhe ata që pengojnë Kosovën në zhvillimet e veta. Prandaj, mendoj që është sot momenti dhe këtu të thuhet që ne e pranojmë misionin e Bashkimit Evropian që të monitorojë dhe ndihmojë zhvillimin e Kosovës, por ne nuk mund të pranojmë detyra shtesë që i jepen udhës këtij misioni dhe mendojmë që ky mision e ka kryer fillimisht punën mirë nëse është vendosur në kufijtë e Kosovës, sepse ashtu demonstroi sot që nuk preket tërësia territoriale e Kosovës, që është elementi themelor për ne sot dhe këtu. Dhe, ky, me misionin origjinal nuk lejon që të bëhet një dekompozim i Kosovës së brendshme, ju e kuptoni çka do të thotë kjo.

Sa i përket punës konkrete të raportit që iu referohet pra zhvillimeve para kësaj që ka ndodhur, unë mendoj që kjo është ngjarja më e madhe që ka ndodhur në raportet tona me Bashkimin Evropian, kjo që ka ndodhur ditët e fundit, ardhja e EULEX-it, dhe të shohim si funksionalizohet EULEX-i dhe kjo do të mbahet në shikim të përditshëm nga Qeveria dhe nga Kuvendi i Kosovës.

Sa iu përket institucioneve tona, ju e dini çka shkruan këtu. Kuvendi lavdërohet për shumë ligje që i ka kaluar, por thuhet që s'ka kapacitete të mjaftueshme të diskutimit dhe, unë për vete, pajtohem me te, sepse një mori ligjesh ne i kemi kaluar në hunë e në buzë, duke pasur parasysh obligimet e Ahtisarit, se janë ligje sistimore. Në anën tjetër, theksohet një bashkëpunim jo shumë i mirë në mes Parlamentit dhe Qeverisë. Unë mendoj që kjo duhet të ndodhë vitin e ardhshëm, sidomos agjenda legjislativë dhe agjenda e korrektimit të punës së Qeverisë ose të monitorimit duhet të jetë shumë më e strukturuar dhe, e treta, që duhet të them, që kudo këtu kemi një vlerësim, thotë: “një farë progresi është arritur”, vlerësimi është si etiketë. Unë mendoj që ne duhet të punojmë që kjo formulë të zhduket herën tjetër, të thuhet se në filan lëmi është arritur rezultat i mirë, në tjetrën hiq, se kjo është shumë neutrale. Dhe, meqë gjithkund përmenden kapacitetet, unë thërras edhe Kuvendin, edhe Qeverinë, që në fushat që lidhen me Bashkimin Evropian të mblidhen kuadrat më të mira që i ka Kosova. Harroni interesat e vogla politike edhe të partive, edhe të familjeve. Në Kosovë, kapacitetet që janë të domosdoshme për këtë komunikim, për këtë konkurrim, duhet të hyjnë dhe të jenë në funksion. Faleminderit, se më duket edhe një, edhe Armendi është.

KRYETARI: Faleminderit! Armendit i kanë mbetur edhe 4 minuta.

Fjalën e ka zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, le të përgatitet deputetja Njomza Emini.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kryeministër, të nderuar deputetë, anëtarë të Qeverisë,

Të filloj pak me shaka, duket që kur po e marrim fjalën, jo vetëm që s'po mjaftojnë minutat për ata që kanë kërkuar interpelancën, por edhe për neve, që edhe tonët gati po na marrin nga pak inatin, lëre më edhe të tjerët, po bëj shaka pak. Po, mendoj që debati i sotëm është në funksion të asaj që është menduar edhe më herët apo në ditën kur është marrë Raporti i progresit. Më lejoni që unë dua t'i theksoj ndoshta tri gjëra sot.

E para, duhet të diskutojmë apo është mirë të njoftojmë Kuvendin e Republikës për trajtimin në kuptimin e procesit të këtij raporti dhe më pastaj edhe për përmbajtjen e këtij raporti, si e kemi trajtuar nga ana e Qeverisë dhe çka duhet të bëjmë më tej. Dhe, ndoshta, pak më lejoni që të ndërlidhem në fund me disa kategori që mund të quhen edhe morale dhe që u përmenden në Kuvend.

Sa i përket procesit, mendoj që në ditën e parë që e kemi marrë Raportin e progresit, ne jemi takuar në Qeveri, kemi dalë me konstatimet tona dhe brenda 24 orëve Qeveria, respektivisht Kryeministri ka dhënë qëndrimin e Qeverisë dhe me një fjali mund të themi se raporti është konsideruar real. Nuk ka qenë lehtë për një qeveri të konstatojë se raporti është real, por mendoj se ka qenë e dobishme, e domosdoshme dhe, ndoshta, ka qenë një shkallë ku ne vetëdijësohemi që gjendja, edhe aty ku nuk është konstatuar që është shumë mirë, ka mundësi që të përmirësohet.

Çështja e dytë ka qenë, është diskutuar në Qeveri dhe brenda për brenda Qeverisë secili ministër dhe secili dikaster ka marrë obligimin që të përmirësojë fushat e cekura në raportin e progresit. Një proces tjetër ka qenë në Komisionin për Integritet Evropian, se ka qenë një debat i mirë, ku unë kam prezantuar në emër të Qeverisë dhe mendoj që ka qenë, po ashtu, vërejtje dhe sugjerime dhe bashkërisht kemi dalë të gjithë mirë.

Në disa debate kemi marrë pjesë edhe me shoqërinë civile, jo vetëm ne, por edhe deputetët, edhe përfaqësuesit e opozitës dhe si rrumbullakësim i saj ka qenë takimi 15 i mekanizmit përcjellës të stabilizimit - asociimit ku ka qenë përgjegjës, apo prezantuesi, edhe Qeveria e Kosovës, me ministri veç e veç, dhe përfaqësuesit e Komisionit Evropian.

Sa i përket përmbajtjes, më lejoni ta them një konstatim. Hartues të këtij raporti jemi të gjithë ne, është Qeveria, është Kuvendi, është sistemi gjyqësor, shoqëria civile, është ish Qeveria dhe të gjithë të tjerët që kanë jetuar dhe vepruar në Kosovë, edhe në kuptimin pozitiv. Unë pajtohem me zotin Gjini kur thotë se gjërat e progresit kanë qenë edhe nga Qeveria e kaluar. Kjo është e vërtetë, nuk i kemi ndërtuar të gjitha ne, por besoj që edhe zoti Gjini pajtohet se edhe gjërat negative, korrupsioni dhe do gjëra të tjera kanë qenë edhe më herët, nuk kanë filluar veç me ne. Ne kemi dalluar me një logjikë, logjika jonë ka qenë të luftimi i këtyre dukurive dhe disa gjërave. E para, besoj të gjithë e dimë që Raporti i progresit ka të bëjë me fazën tetor 2007 - tetor 2008, me fazën kur ka pasur zgjedhje dhe transferim pushteti, me fazën kur është shpallur pavarësia dhe me fazën kur kemi pasur kompetencat e UNMIK-ut, sidomos në fushën e drejtësisë.

Unë do të ndalem pak më shumë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Këtu i shoh apo, besoj, bashkërisht të gjithë ne i shohim tre aktorë që mund ta luajnë rolin e vet. Aktori i parë, faktori i parë është qeveria dhe institucionet e tjera. Nuk ka asnjë dilemë, qeveria duhet dhe e ka treguar disa herë vullnetin e saj politik, besoj Kuvendi ka dhënë mundësinë për infrastrukturë legale dhe mundësi buxhetore për organizatat që merren apo organet që merren me strategjinë apo me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe tani po shkon në fazën e operacionalizimit edhe me mekanizma të tjerë.

Aktori i dytë, është sistemi i drejtësisë, i cili nuk është në dorën e Qeverisë dhe nuk ka pretendim Qeveria që ta ketë në dorën e vetë, por është pretendim i Qeverisë që të jetë më efikas, t'i krijojmë kushte më të mira, të rrisim profesionalizmin dhe, me siguri, edhe me këtë aktor do të rritet shkalla e luftimit të këtyre dukurive.

Aktori i tretë, që mendoj se është shumë me rëndësi, është qytetari i Republikës sonë. Qytetari ynë duhet të kuptojë edhe më mirë se bashkëpunimi me organet e drejtësisë, luftimi i dukurive negative, nëse njëri nga këta tre aktorë çalon, qoftë institucionet, qoftë gjyqësia, qoftë qytetari, nuk kemi luftë të suksesshme kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Unë mendoj se këtu janë bërë disa hapa konkret, edhe në strategji, edhe në mekanizmat e tjerë, por ka nevojë dhe ka domosdoshmëri që të bëhet edhe më shumë.

U përmend pak sa raporti mediat dhe politika. Është e vërtetë që thuhet se mediat janë nën presion të politikës, por nuk thuhet të Qeverisë dhe është mirë që secili ta shohë veten aty se ku e gjen. Në anën tjetër, ne mediat, si Qeveri, i shohim tri raporte: e para - partnerë. Idetë tona, mendojmë se te qytetarët mund t'i përçojmë përmes mediave. E dyta, janë në momentet e caktuara korrektues të punës sonë dhe po e them me përgjegjësi të plotë. Ka raste kur nga gazetaria hulumtuese ne kemi ndërmarrë masa disiplinore dhe politike në Qeveri dhe i ftoj që nga ky vend prapë ta bëjnë mediat një gjë të tillë, prapë ta zhvillojmë gazetarinë hulumtuese dhe në radhë të parë kundër vetë Qeverisë, dhe raporti i tretë, ne e shohim edhe konkurrent. Ka mendime dhe ide që i vejmë ne, mediave ua merr mendja se është diçka tjetër dhe shpeshherë i ballafaqojmë ato mendime, por të tria këto shkojnë në dobi të qytetarëve të Republikës sonë.

Një kategori tjetër që u përmend, morale, që besoj e tha edhe zoti Gjini, po e përmendi me emër që, nëse ka nevojë për replikë, çështja e sinqeritetit, dhe një fjali që po përmendet shpesh, çështja e gënjeshtërit apo rrenës.

Besoj zoti Gjini, të gjithë ne edhe unë jemi rritur në një ambient ku rrenës ia kemi thënë dikujt shumë lehtë, si kategori, qysh do që të jetë. Në anën tjetër, jemi rritur në një ambient ku, edhe kur njerëzit e kanë thënë të pavërtetën, i kemi thënë: “të lumtë goja në koftë qashtu”, e jo bash drejtpërdrejtë. E lus zotin Gjini dhe të tjerët, mos ta vejnë në fjalor politik këtë fjalë, ta gjejnë një fjalë tjetër që e thotë kuptimin e njëjtë, por jo ta tensionojë situatën brenda për brenda Kuvendit.

Unë e di, krejt në fund po e them, që Qeveria ka marrë masa, e fton, kam mbështetje edhe Kuvendin edhe opozitën dhe shoqërinë civile, sistemin e drejtësisë që bashkërisht t'i përgjigjemi këtij raporti, t'i përmirësojmë sfidat. Ne i kemi quajtur sfida, opozita mund t'i quajë dobësi, që në vitin 2009 të kemi një raport tjetër dhe ai raport tjetër do të jetë nëse bashkërisht të gjithë ne do t'i kryejmë obligimet tona, në veçanti po e them, Qeveria, Kuvendi, gjyqësori, por edhe shoqëria civile mund ta luaj rolin e vet dhe, mbi të gjitha, do të përfshihen në raportin e vitit 2009 përmirësimet. Ne jemi shumë të bindur që do të ketë dhe kemi një plan të partneritetit të veprimit evropian, i cili do të shqyrtohet në janar apo në fillim të vitit 2009 dhe do t'i përfshijë të gjitha përgjigjet.

Ne e kemi përgatitur në raport, Komisionit për Integritet ia kam dhënë. Ju premtoj, nëse i duhet edhe Kuvendit, mbi 50 faqe si mendojmë ne t'i përgjigjemi. Por, këtu besoj të gjithë bashkërisht, edhe unë besoj që ky diskutim i sotëm është më shumë jo lufta e asaj kush çka ka bërë në të kaluarën, nga se ato secili, nëse ka përgjegjësi politike do ta bëjë, nëse ka penale, me siguri edhe atë do ta bëjë, por më shumë është si t'iu përgjigjemi sfidave të cilat na presin në vitin 2009 dhe në fund të vitit 2009, në tetor të vitit 2009, raporti i progresit, respektivisht studimi i fizibilitetit të jetë shumë më pozitiv se sa ka qenë në këtë vit. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit! Për fjalë radhën e ka deputetja Njomza Emini, le të përgatitet Berim Ramosaj. Nëse Berimi nuk vjen, atëherë ministri Enver Hoxhaj e ka fjalën si deputet.

NJOMZA EMINI: Ju faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë, si dhe Kabineti qeveritar, përshëndetje!

Duke e ditur se ka rëndësi të veçantë sot dita që po e diskutojmë Raportin e progresit të Komisionit Evropian, u thanë shumë vërejtje dhe ka një sërë problemesh dhe sfida që neve na presin për Bashkimin Evropian, mirëpo ajo se çka unë kam përgatitur, këto janë katër pyetje për Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotëri Hashim Thaçi, por para se t'i bëjë pyetjet, unë dua të them që luftë për ndjekjen e politikës të Bashkimit Evropian na duhet zero tolerancë, zero korrupsion dhe zero krim të organizuar. Mirëpo, deri me tani Qeveria e Republikës së Kosovës është plotë gojë dhe thotë në çdo fjali se ne do të shkojmë në Bashkimin Evropian, ne do t'i plotësojmë standardet, mirëpo asgjë nuk shihet konkrete sa i përket kritereve apo edhe standardeve për Bashkimin Evropian që do të adresojmë.

Mirëpo, çka është ajo më thelbësore, edhe ne si Komision për Integritet Evropian, që jemi në kuadër të Parlamentit, nuk kemi edhe aq sa duhet mbështetje apo edhe raportime aq sa duhet. Për të mos marrë edhe shumë kohë, sepse 3 minuta i kam kohë dhe do t'ia lë edhe kolegut, do të filloj direkt me pyetjet: Kosova dëshiron t'i bashkohet Bashkimit Evropian, zotëri Kryeministër, edhe pse nuk është, po shihet se sa është me rëndësi Bashkimi Evropian dhe integritet evropian. Kosova dëshiron t'i bashkohet Bashkimit Evropian, mirëpo si e mbështet mekanizmi koordinues i donatorëve këtë proces dhe, gjithashtu, çka ka ndërmarrë Qeveria e Republikës së Kosovës për të përmirësuar këtë gjendje të Raportit të progresit që e kemi për Kosovën, dhe me cilat fakte apo edhe diçka më konkrete që të na përgjigjet sot Kryeministri.

Andaj, edhe një herë kërkoj dhe shpresoj që tani edhe Qeveria, mirëpo edhe Kabineti qeveritar nëpër ministri që t'i kenë kuadrot e mira, sa u përket integriteteve evropiane, duke ditur se ka shumë të rinj që kanë magjistruar jashtë dhe ata të kthehen dhe të punojnë nëpër dikastere që u përkasin integriteteve evropiane.

Edhe një herë, edhe diçka që harrova ta them dhe po e përsëris, është që Agjencioni për Integritet Evropian ndodhë shpesh që të ndërrohen koordinatorët, ndërrohen punonjësit dhe aty ka mandej edhe mosfunksionim të ekipit që është brendapërbrenda, për shkak të buxhetit apo për shkak të koordinimit dhe të menaxhimit të tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Atëherë, po e zëvendësojmë do të thotë deputetin Berim Ramosaj me Naser Rugovën. Partia Demokratike i ka edhe 13 minuta. AKR-ja i ka edhe 4 minuta, AAK-ja i ka edhe 2, LDD-ja tash i ka 7 minuta.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të çmuar kolegë deputetë,

Raporti i progresit të Komisionit Evropian për Republikën e Kosovës, vërtet është gjë e mirë që për herë të parë adresohet një raport tani në konditat tjera juridike dhe politike, si shtet i pavarur.

Unë e kam bërë një analizë në bazë të renditjes dhe në atë që ka nënvizuar raporti i Komisionit Evropian për Kosovën. Te kriteret politike, që janë kritere më të rëndësishme për aspiratat e një vendit për aderim në mekanizmat e BE-së, është demokracia dhe sundimi i ligjit, funksionimi demokratik i institucioneve, në radhë të parë Parlamenti, Qeveria dhe respektimi i Kushtetutës së vendit.

Në këtë kontest, ka vërejtje serioze, po citoj: “Ka pak ose aspak ndërveprim në mes të Qeverisë dhe Kuvendit përveç kur e para i dërgon të dytës legjislacion”. Ky Kuvend ka nevojë për debat, për debat serioz për gjëra serioze që po e preokupojnë jetën e qytetarit dhe vendin tonë çdo ditë.

Te Qeveria, Qeveria është ballafaquar me disa vështirësi në prezantimin dhe koordinimin e prioriteteve të saj strategjike. Qeveria e vendit ka për obligim që strategjitë e veta mos t'i bëjë ad-hoc sikurse që ka ndodhur deri më tani, por të fillojë të hartojë strategji afatgjate për daljen e vendit nga kjo amulli politike dhe ekonomike dhe mikste, nëse doni.

Deklarimet për ndërhyrje politike, po citoj, në përzgjedhjen dhe caktimin e një numri për pozitat e rëndësishme, bordet e ndërmarrjeve publike, kanë ndikuar thotë në kredibilitetin e Qeverisë. Kemi borde politike me militantë partiakë joprofesionale. Pasojë e kësaj është menaxhimi i dobët, ofrime të shërbimeve katastrofale për qytetarët e Kosovës dhe aferat, si KEK-u, emërimet si në shekullin e kaluar të drejtorëve në aeroport, apo edhe super margaritari dardafon, e të tjera. Çfarë klime për investime po krijojnë në Kosovë dhe kush do të vjen të investojë në këto kushte. Nuk ka aderim në Bashkimin Evropian me këtë qasje. Qasja duhet të ndërrohet.

Te Kushtetuta, çka mund të themi. Kreu i vendit që duhet të garantojë respektimin e aktit më të lartë juridik në vend, e shkel vetë atë dhe kjo nuk do koment dhe po merr përsëritje dhe urime nga partneri më i madh i koalicionit. Zoti Kryeministër, ju duhet ta thoni qartë, sepse jeni shefi i ekzekutivit të vendit, nuk qenka kryeministri këtu, dhe jo të shkëmbejnë fontanë dëshirash, shkele Kushtetutën se po na vyen për interesat ditore politike.

Te administrata publike, po citoj: “Shërbyesit civilë vazhdojnë të jenë të gatshëm për ndërhyrje politike, korrupsion dhe nepotizëm”. Ju lutem, 60% të sekretarëve permanentë i keni caktuar këshilltarët e juaj politik. Çfarë reforme në administratë publike? Zoti ministër i Shërbimeve Publike, larg jemi prej reformës, e cila do t'ia hapte dyert institucioneve të vendit në Bashkimin Evropian!

Nuk ka statistika, po citoj, të besueshme në Kosovë, nuk kemi regjistrim të popullsisë. Qe tri katër herë vjen propozimi i Qeverisë në Kryesinë e Kuvendit dhe dikush “nga larg” po e pengon këtë proces tejet të rëndësishëm që të kemi statistika të besueshme edhe për strategji zhvillimore, edhe për zhvillim ekonomik dhe për sektorët e tjerë.

Te politika antikorruptcion. Çka të thuhet tjetër, i vetmi mekanizëm institucional - Agjencioni Kundër Korrupsionit të Kosovës, në vend që të përkrahet, fuqizohet nga Qeveria, sepse është kërkesë e prerë e Raportit të Komisionit Evropian, ka shtrëngime buxhetore, i zvogëlohet buxheti, ndoshta sepse e paraqiti sistemin e gjyqësorit dhe ekzekutivin e vendit si top institucionet më të korruptuara.

Pastaj, te reformat në sistemin gjyqësor është një njollë zezë për Kosovën dhe margaritari i fundit kur në pikë të ditës arratiset një i burgosur nga burgu i Dubravës dhe Ministria e Drejtësisë nuk thotë asgjë. Vërtet, kjo Qeveri i ka disa emra dhe disa tituj, por ministra më anemik, më të pazotë, ma jo kreativ nuk besoj që ka pasur Qeveria prej të 45-ës e tutje, sepse po ndodhin skandale dhe askush nuk merr përgjegjësi apo nuk e thotë një prononcim zyrtar. Kjo për Evropën është skandal dhe Qeveria duhet të mendojë seriozisht.

Pastaj, kur jemi te të drejtat ekonomike dhe shoqërore, shkelen të drejtat e fëmijëve, kemi trafikim të fëmijëve, thjeshtë, fëmijët punojnë punë të rënda fizike. Çka ka ndodhur me kategorinë e personave me të meta dhe aftësi të kufizuara. Indikator i një qeverisje demokratike është përkujdesja ndaj këtij grupi të veçantë të shoqërisë. Nuk ka strategji, nuk ka legjislacion, dhe çka t'ju thuhet, çfarë mesazhi t'i dërgohet kësaj kategorie shoqërore.

Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve, edhe këtu është një barrierë serioze për ecjen e Republikës së Kosovës përpara. Këtu nuk po flas si deputet i opozitës. Të gjitha minoritetet e kanë vendin e vet, jo njëra të favorizohet, tjerat të lihen anash. Strategjia e traktorëve është e tejkaluar. Ju lutem, bëni strategji konkrete për integrimin e të gjitha minoriteteve në Kosovë, sepse Kosova nuk mund të ecën përpara dhe nuk mund ta mbajë barrën e një komuniteti në Kosovë.

Te standardet evropiane. Tregu i brendshëm, qarkullimi i lirë i mallrave dhe kapitali. Thotë që tregu i brendshëm është në fazën fillestare, e kuptoj, por duhet të krijohen politika të volitshme, ambient i volitshëm, sepse është kriter i rëndësishëm që përcaktohet me kriteret e Kopenhagës. Po citoj, “asnjë progres nuk mund të vërehet në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve” dhe kjo është shumë serioze. Nuk ka shkuarje në Evropë as negociim me Evropën pa i marrë këto masa.

Punësimi dhe politikat sociale. E cekën edhe disa kolegë të tjerë, thjeshtë, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, po citoj “ka kapacitet të vogël administrativ, mungesa e kornizës legjislative dhe strategjike dhe mungesa e kapacitetit ekzekutiv”. Besoj se kjo po flet boll se çka po punon kjo Qeveri. Për pensionistët, për shtresat e tjera të mos...

KRYETARI: Regjia, t'i vazhdohet edhe një minutë

NASER RUGOVA:... e dëgjuam ministrin e Shëndetësisë çka na sugjeroi. Qysh është gjendja në shëndetësi, veç po e citoj: “vdekshmëria e foshnjave dhe e nënave më e larta, shfaqja e sëmundjeve ngjithëse alarmante”. ë përgjithësi Sektori i shëndetësisë është shumë i varfër dhe kërkon shtim të vëmendjes së Qeverisë. Trafikimi i qenieve njerëzore, krimi i organizuar, zotëri Kryeministër, merrni masat, sepse nuk ka aderim në BE me këtë koncept të qeverisjes që po vazhdon sot. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka ministri dhe deputeti Enver Hoxhaj, le të përgatitet Xhezair Murati. Partia Demokratike i ka në dispozicion edhe 13 minuta.

ENVER HOXHAI: I nderuar zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministër,

të nderuar kolegë, shumë të respektuar deputetë,

E kam ndërmend realisht në pak minuta që i kanë mbetur Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, në tre katër minuta vetëm t'i përmend disa çështje kyçe. Përpara se t'i shkoqis 7-8 probleme kyçe që përmenden në Raportin e progresit vjetor të Komisionit Evropian, të Bashkimit Evropian, më lejoni që ta them një vërejtje parimore.

Për ne si Kosovë është shumë e rëndësishme, përveç asaj se çfarë shkruhet në raport, kriteret politike, kriteret ekonomike dhe standardet evropiane, ta kemi edhe një interpretim tonin se është i domosdoshëm matja e progresit në Kosovë, se është i domosdoshëm një raport i tillë.

Këto vitet e fundit ka një përpjekje të madhe të vendeve të ndryshme për modernizim të tyre, ndërsa zakonisht një vend është i modernizuar, momente kur ka qytetarë, kur ka institucione të cilët konkurrojnë me të tjerët në botë dhe si pjesë e konkurrencës janë në gjendje thjeshtë atë konkurrencë ta fitojnë. Andaj, agjenda evropiane për Kosovën është edhe agjendë e modernizimit të saj. Në një drejtim të tillë, edhe debatet e tilla vërtet janë të domosdoshme, mirëpo edhe matja e progresit do të duhet të ndodhë si kriter dhe me matjen e progresit në debat në Kuvend.

Është shumë interesant që në *acquis communautaire* arsimit nuk është parakusht për integrim evropian. Me po të njëjtën kohë, ka shumë standarde edhe në fushën e arsimit parauniversitar dhe në fushën e arsimit universitar, të cilat janë standarde evropiane, të cilat në një formë kërkojnë që të plotësohen edhe nga shtetet të cilat dëshirojnë të jenë pjesë e Bashkimit Evropian.

Unë e kam ndërmend t'ju përmend vetëm 7 probleme kyçe, shqetësime të cilat janë ngritur nga Raporti i Bashkimit Evropian, por të cilat thjeshtë do të tregoj se gjatë këtij viti pasqyra është më e diferencuar, më pozitive se sa prezantohet në Raport, gjë që e kam thënë edhe para përfaqësuesve të Bashkimit Evropian në takimin që e kemi pasur para dy javësh.

E para, është çështja e kufizimeve buxhetore dhe e hapësirës shkollore. Dua vetëm t'ju informoj, të nderuar deputetë, që ne në vitin e ardhshëm, më 1 shtator të vitit të ardhshëm, në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në Pejë, në Prizren, në Gjilan, në Ferizaj edhe në Prishtinë do ta zhvillojmë mësimin me dy ndërrime, diçka që ka qenë e menduar të përfundojë në vitin 2017. Kështu që një shqetësim i tillë, realisht do të jetë shqetësim i

adresuar gjatë kësaj kohe. Po ashtu, ka një formulim që jo të gjithë nxënësit kanë marrë tekste shkollore pa pagesë. Ju e dini që gjatë këtij viti nxënësit nga klasa I deri në klasën V janë furnizuar me tekste shkollore, të gjithë i kanë marrë dhe të njëjtën kohë vitin e ardhshëm do t'ju marrin tekstet shkollore nga klasa I deri në klasën IX.

Më lejoni vetëm t'ju bëj me dije që dhënia e teksteve shkollore synon të arrijë dy qëllime. Qëllimi i parë është që, thjeshtë, të arrihet gjithëpërfshirje në arsim, dhe qëllimi i dytë është të ulet braktisja e nxënësve nga shkolla dhe kjo ka qenë e menduar si bazë për këtë vit.

Po ashtu, shtrohet problemi i teksteve për shkollat e mesme, të përgjithshme dhe për shkollat e mesme profesionale për minoritetin turk dhe për minoritetin boshnjak. Disa nga këto tekste janë në hartim e sipër, disa janë hartuar, mirëpo ne do të bëjmë përpjekje maksimale që çështja e teksteve të shkollave profesionale vërtet të zgjidhet përmes bashkëpunimit me Ministrinë e Edukimit të Turqisë, përderisa një formulim i tillë që nuk ka tekste për komunitetin boshnjak dhe turk nuk është i saktë, është pjesërisht i saktë. Disa nga tekstet ekzistojnë edhe nuk kisha pasur dëshirë t'ua përmendi juve të gjitha tekstet që ekzistojnë.

Romët, minoriteti Romë dhe shkollimi, është shqetësim i raportit. Më 1,2,3,4 dhe 5 shtator unë intenzivisht jam marrë me një çështje se si ta rrisim gjithëpërfshirjen e komunitetit romë në shkollat e Kosovës. E kemi strategjinë për integrimin e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian në shkollat e Kosovës. Këtë vit jemi duke hartuar plan-

programet për shkollat në këtë gjuhë dhe jemi shumë të interesuar që gjatë vitit të ardhshëm një proces i tillë të përfundojë.

Po ashtu, kemi pasur mësim të përshpejtuar në disa komuna të Kosovës. Meqë koha është shumë e shkurtër, njëra prej vërejtjeve të fundit që përmendet ka të bëjë me bashkëpunimin mes ministrive, sektorit privat, partnerëve social në fushën e arsimit. Më lejoni vetëm t'ju them që për ne si Qeveri e Kosovës çështja e arsimit është çështje ndërministrore dhe ndërsektoriale, i kemi disa këshilla, i kemi disa grupe punuese, i kemi disa komisione në të cilat ministri të ndryshme me qasjen ndërsektoriale synojnë ta zgjidhin problemin e arsimit. Këto ishin ndër vërejtjet kryesore që pata ndërmend, të nderuar deputetë, juve t'ju prezantoj në vija të shkurta, ndërsa një raport shumë më i gjatë ka qenë edhe para përfaqësuesve të Komisionit Evropian në Prishtinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Džezair Murati, le të përgatitet deputeti Ahmet Isufi, i cili i ka 2 minuta në dispozicion.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine Predsedniče!

Poštovani premijeru,

Zameniće premijera, ministri,

Danas su klupe popunjene i veoma lepo izgleda ova bina naša, potpun Vladin kabinet.

Ja neću govoriti danas koliku podršku premijer i njegov kabinet imaju u mojoj zajednici, jer oni to najbolje znaju i videli su na licu mesta kad su posetili našu zajednicu. Mislím da je i odziv i nivo i razgovor bio vrlo konstruktivan i na nivou, dakle to je puna podrška jer smo deo i ove Vlade, i ovog Kabineta. Medjutim, od početka formiranja Vlade, uvijek smo imali sugestije kada je u pitanju jedno ministarstvo koje pripada i nama, a to je Ministarstvo za zajednice. Do dana današnjeg, ni u političkom stafu tog Ministarstva nemamo zaposleno lice. Mislím, sa time se ne možemo pomiriti i ja nisam kriv što ovo pomenujem ovde, ako mislite da prečutim to. Ukazivali smo na to u više navrata ali transparentnost i saradnja i pored naše dobre želje, izostajala je gospodo.

Prilikom prve podele sredstava namenjenih za integraciju zajednica, nije bilo trnsparetnosti. Bilo je propusta, ukazivali smo na to, dokazani su propusti. Bilo je šta je bilo, taj je ministar otišao i još neki ljudi oko njega.

Promenu ministra smo prihvatili kao mogućnost da neke stvari premenimo. Medutim, stvari nisu išle na obostranu dobit, korist. Načinom podele sredstava u ovoj drugoj... podele, nismo zadovoljni, nije bila dovoljno transparentna, urađeno je sve to na brzinu, nisu dobro izmereni kriterijumi i mi, naravno, nakon mnogobrojnih žalbi ukazujemo na to da je procedura povređena, nisu uzete u ozbir sugestije opštinskih radnih grupa, što je ranije bilo obavezujuće, a pravdaju se time da nikada Bošnjačka zajednica ranije iz tog ministarstva nije dobila sredstva. Pa, zar to neko iz džepova djeli, to je budžet ove države, to je budžet ove vlade. Dakle, odgovori odnosno žalbeni rok nezadovoljnima je smanjen na 6 dana. Dve su podele bile, ne znamo koju da računamo. U jednoj je bilo 52, a u drugoj 58 individualnih projekata. Mi smo se zalagali da budu projekti od interesa za zajednice, ne od interesa za pojedince. Mislím da je ovakvom podelom projekata stvorena distanca, podela među zajednicama, a ne njihovo zbližavanje. Ja sada ne želim ovde, ovo što iznosim, što smo primetili, da neko misli sad da sam ja kriv što ovo pitam, a nije kriv neko što je tako urađeno!

Gospodo, za nas ovakva podela je neodrživa, neodrživa! Znamo da su primedbe upućene i Vladi, da su primedbe upućene i NDP, da su primedbe upućene i Komisiji za antikorupciju i ja ovde predlažem da se naši navodi provere time što će se formirati ili anketni odbor ispred Skupštine ili jedna vladina komisija, kako je to bilo i ranije... Zbog toga kažem, tražim od Vlade da se zaustavi ovakva podela sredstava dok se ove provere ne izvrše. Ja čestitam onima koji su uradili onaj Bilten, poštujem koji je danas pokazan, ali ja kažem da može se uradi još jedan takav Bilten familjarizma u ovom ministarstvu. Mi imamo podatke, izvolite da ih poverimo. Ukoliko se suprotno dokaže, mi smo tu da se pred ovim najvažnijim forumom izvinimo. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Kohën e harxhuat. Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi, 2 minuta.

AHMET ISUFI: I nderuar zoti Kryetar,
Kabinet qeveritar, zoti Kryeministër,
Të nderuar deputetë,

Ne po flasim sot për Raportin e vlerësimit të progresit të Komisionit Evropian dhe nëse shikohet realisht, siç u tha edhe më herët edhe nga Kryeministri, është real dhe pozitiv. Real është po, po pozitiv nuk është. Është nga raportet më kritike deri më tani dhe duhet kuptuar kështu nëse do Qeveria, institucionet e vendit të përmirësohen dhe të jenë vërtet progresive.

E kemi një qasje joracionale, konsideroj, sepse kjo Qeveri e ka filluar agjendën e vet me luftën kundër korrupsionit dhe zëvendëskryeministri thotë në këtë sallë se ne s'e kemi filluar, do me thënë dikush tjetër e paska filluar, po i bien që ne po e vazhdojmë, që nuk është shumë serioze kjo, duhet të kihet parasysh për fjalën të cilën e përdor zëvendëskryeministri në Parlamentin e Kosovës.

Po ashtu, nëse nuk doni edhe të shkojmë te raportet, shkojmë te ato që janë reale dhe sot i di opinionin e Kosovës. Kemi bllokim të institucioneve të Kosovës dhe kemi bllokim për arsye se nuk është emëruar ende drejtori i Agjencisë së Intelgjencës, nuk është emëruar komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk është emëruar Këshilli i Sigurisë Kombëtare, nuk po bëhen veprime të cilat duhet të bëhen në raporte, në mënyrë që të kemi vërtet vlerësim pozitiv më tutje, jo vetëm nga ana jonë, por edhe nga institucionet ndërkombëtare.

Tash kemi një raport neutral. Nuk është në pyetje opozita, është pyetje vlerësimi për Kosovën, për institucionet e vendit dhe për gjendjen në Kosovë. Kemi forcim të strukturave paralele, këtë e thotë në raport dhe lexoni raportin, sepse sikur po duket që dikush e ka lexuar një raport tjetër, dikush një tjetër. Të njëjtin raport jemi kah e ...

KRYETARI: Faleminderit!
Për replikë, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Isufi!

Ndoshta nuk kam qenë i qartë, me siguri, në prononcimin tim, por ajo çka ka qenë mendim i idesë sime dhe prapë është, që mentaliteti për korrupsionin ka dalluar me atë qeveri dhe këtë qeveri. Nuk po them që ka filluar ose ka mbaruar, nuk do të thosha asnjëherë që ka mbaruar sot, por ka dalluar në mënyrë diametrale. Ne nuk e kemi

stimuluar, ne e kemi luftuar dhe në çdo rast korruptiv e kemi stimuluar luftimin kundër tij, qoftë me gjykata, qoftë brenda Qeverisë, ndërsa në të kaluarën besoj që nuk ka qenë një gjë e tillë. Por, mos harroni, një dukuri e tillë çfarë është korrupsioni, kur të rrënjohet, nuk mund të luftohet për një ditë.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Numan Baliq. Këta janë lajmëruar 4 veta, i kanë 10 minuta. Pra, nga 2 minuta e gjysmë i keni.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti Kryetar për zemërgjerësinë! Me të vërtetë 2 minuta janë shumë, do të tentoj që të them diçka.

U vezi sa ovim izvještajem koji je na djelu i o kome govorimo, kažem da je on u cjelini uopšten, da tretira na gomilu, da tako kažem, mnoga pitanja koje su od važnosti, da nažalost, u mnogim slučajevima ne adresira na pravi način probleme koji su spomenuti i, ono što je vrlo važno, ne nudi preporuke koje su bitne za rješavanje vrlo važnih stvari koje su spominjane.

Naravno, na drugoj strani ovaj izvještaj nije bez političke pozadine i on je u nizu mnogih izvještaja koje smo i ranije imali i za prethodne vlade a i verovatno i za buduće vlade i koje se tiču, da tako kažem, discipliniranja vlada, ne samo Kosova, nego i u regionu, i jedno od sredstva za kooperativnost, a po nekada i poslušnost.

Glavna pitanja koja su spomenuta odnose se na korupciju, kriminal, policijsko pravosudni sistem, trgovinu ljudskim bićima, naravno pitanja manjinskih zajednica. Pošto imam jako malo vremena, onda ću spomenuti ovo pitanje, da ovo pitanje se ne treba regulisati samo u Ministarstvu za povratak i zajednice, u protivnom onda će to biti Ministarstvo rezervat a ne Ministarstvo.

Vlada Kosova mora omogućiti zastupljenost u svim ministarstvima, u svim opštinskim i javnim službama na svim nivoima, a ne samo unutar ovog ministarsva.

Očigledno je da su neki naučili da samo govore o dobitima i podjelama, o dobitima i podjelama, i malo prije smo slušali neke koji su razočarani što nema više dobiti i podjela tako da, bogu hvala, da se neke stvari u tom smislu mijenjaju na bolje. Mislim da Vlada treba pokazati jasan znak, da ne treba govoriti samo ovdje. U ovom izveštaju sam video da se govori samo o iseljenim i prognanim Srbima sa Kosova, a da se ne spominju Bošnjaci, Romi, Egipćani, odnosno Romi i Egipćani da, ali Bošnjaci i Gorani vrlo malo, tako da Vlada mora imati ujednačen i pavedan pristup svim zajednicama i da se treba omogućiti ravnopravnost unutar samih ministarstva u cijeloj Vladi Kosova i u opštinskim i javnim službama. Naravno da je nedostatak u mnogim slučajevima, statistika, neinformisanost, nedostatak sistema. Sam ovaj izvještaj u celini govori o nedostatku...

KRYETARI: Faleminderit, Fjalën e ka deputeti Slavisha Petković, le të përgatitet deputeti Brajšori.

SLAVIŠA PETKOVIĆ: Gospodine premijeru, prvo da stavite slušalice pošto znam da ne razumete srpski dobro, a bilo bi dobro da razumete sve ono što ću da vam kažem sada, tako da mi ne klimate glavom, a znam da ne razumete.

Prvo, pošto danas svi mašu nekim papirima, ajde da počnemo sa dokumentima. Ja se slažem sa Sabri Hamitijem da trebamo da dokumentujemo. Ovde držim Izveštaj Vlade Kosova. Znači, nije to moja priča o izveštaju Vlade Kosova, koji je potpisao Lirak Qelaj, savetnik zamenika premijera. Na osnovu ovog izveštaja je prošli ministar za povratak je isteran iz Vlade, znači nije smenjen nego isteran. U ovom izveštaju stoji, znači opet naglašavam, Izveštaj Vlade Kosova, da je udruženje porodično, koje se zove Samostalna liberalna stranka, ustvari jedna kriminalna organizacija. Znači, ne tvrdim ja, tvrdi Vlada Kosova, ovo je izveštaj Vlade Kosova. Na kontu toga je bivši ministar isteran. Doveden je novi ministar koji pitanje, evo sada da ga pitate, ako zna šta radi, evo tu mi sečite glavu. Ako ne zna koliko radnika ima, ne zna koliko departmana ima, ne zna šta mu je posao. Opet ovo sada kažem, ne kažem to ja, to kaže Doris Pak, zadnjoj delegaciji ove Skupštine u Briselu je Doris Pak njima svima rekla, evo tu su članovi delegacije, da ona tvrdi da Ministarstvo za povratak ne zna šta radi, i njoj nije jasno šta ti ljudi uopšte rade tamo. Ja verujem da je danas premijera bilo sramota kada je predsednik Samostalne liberalne stranke izašao i maše sa nekim papirom. Ovo je, gospodo, papir i rezultat Ministarstva za povratak. Izveštaj Vlade Kosova, izveštaj Kabineta zamenika premijera potpisan od Lirak Qelaja. Isti ovakav izveštaj, još gori, mi čekamo ovih dana, koji se nadamo isto će izaći jer rezultat... Ja ču sada da se zahvalim kao predsednik Samostalne liberalne stranke premijeru, hvala mu što se ove godine nije vratio niko, hvala mu što je čutao kada je Srpska samostalna liberalna stranka u Ministarstvu probala da ukrade 2 miliona eura zbog kojih je smenjen, isteran ministar, hvala premijeru i na tome! Znači, sve isto mu se ja isto zahvaljujem. Pun sam hvale.

Drugo, kažu rezultati, sve sam čuo danas, nisam čuo da li premijer, dali ga sramota da kaže danas da se ove godine nije vratio nijedan jedini čovek...

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputeti Esat Brajshori, le të përgatitet deputeti dhe ministri Fatmir Limaj. Esat, i ke 4 minuta në dispozicion, Fatmiri 6 minuta.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti i progresit për Kosovën sipas Rezolutës 1244/2008 vlerëson ndërtimin apo mangësitë e funksionalitetit të institucioneve të vendit tonë, kryesisht nga aspekti i infrastrukturës ligjore, të kapaciteteve humane dhe të funksionimit të tyre praktik.

Unë e kuptoj që ky raport i referohet Rezolutës 1244, por dua të theksoj gjithashtu që kjo rezolutë njëherë e mirë duhet të harrohet dhe të arkivohet në kujtesën e një të kaluarë të vendit tonë.

Një nga shtyllat për funksionimin efikas të shtetit do të duhej të ishte pikërisht policia. Ndërtimi i strukturave të policisë së Kosovës është bërë me ndihmën dhe përvojën e ndërkombëtarëve, prandaj një pjesë meritore ose jomeritore për profesionalizimin e këtij shërbimi bie edhe mbi ta.

Unë do të shkëpusja nga ky raport vetëm dy çështje të cilat do t'ia faturoja Qeverisë së Republikës të Kosovës.

E para, Në raport thuhet, citoj: “Pas shpalljes së pavarësisë, shumë zyrtarë të policisë prej serbëve të Kosovës kanë braktisur punën. Në disa zona jo me shumicë, thotë raporti, funksionimi i forcës policore multietnike nuk është plotësisht efektiv”. Në rastin konkret, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka gjetur modelin më të përshtatshëm për të mos thënë ka gjetur modelin më të keq, pra jo të drejtë, që duke ua paguar rrogat nga xhepi i varfër i qytetarëve të Kosovës me një kosto prej rreth 1.000.000 eurosh, ka tentuar t’i josh ata që të kthehen në punë. Përkujtoj këtu se të njëjtit marrin edhe nga një pagë nga Qeveria e Serbisë. Kjo zgjidhje, që unë do ta quaja politike, është antiligjore sepse veprimi i tyre ka qenë në fakt bojkotimi, sabotimi dhe padëgjueshmëria qytetare, aq më tepër kur përpara ligjit nuk ka dallime në baza etnike, gjinore, racore, por përpara ligjit të gjithë do të duhej të ishin të barabartë.

Çështja e dytë që evidenton raporti është se, citati: “Rrogat për policët janë të ulëta”. Duke pasur parasysh faktin se polici është një lloj letërnjoftimi i një shteti, duke pasur parasysh faktin se policia është siguria dhe garancia e përditshmërisë sonë dhe e jetës së fëmijëve tanë, duke pasur parasysh rrezikshmërinë në punë, atëherë Qeveria e Republikës së Kosovës prioritet duhet të ketë pikërisht rritjen e rrogave të policisë dhe kjo në një kohë sa më të shpejtë. Ndryshe, trajtimi i tillë i tyre me paga, do të prodhojë anarkinë e funksionimit të linjës zinxhirore e deri te inkriminimi i mundshëm i tyre në afëra korruptive. Policia e Kosovës duhet të jetë polici e dinjitetshme, efikase dhe profesionale. Pos kushtit që, për të qenë i tillë, duhet ta duash vendin tënd, duhet edhe trajtim dinjitoz nga ana e shtetit. Rritja e rrogave të policisë është rritje e garancisë së funksionimit të shtetit dhe rritje e sigurisë në vendin tonë. faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fatmir Limaj e ka radhën.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: I nderuar zoti Kryetar,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Mendoj që është tepër e rëndësishme me vetë faktin që sot Parlamenti i Kosovës e diskuton Raportin e Komisionit njëvjeçar për zhvillimet në vendin tonë, është tepër me rëndësi që ne i kushtojmë një kujdes të veçantë, pavarësisht pozitë – opozitë, pavarësisht mënyrën se si e komentojmë. Fakti tregon se, megjithatë, ky raport që nga ardhja është marrë me shumë seriozitet nga Qeveria e Kosovës, siç u tha edhe më herët nga parafolësit e mi. Brenda 24 orëve ka pasur një përgjigje nga Kryeministri, një vlerësim real, një vlerësim rreth raportit që nuk ka ndodhur asnjëherë në të kaluarën. Raportet përpara që kanë ardhur në Qeveri të Kosovës, kanë shkuar, janë ardhur, është diskutuar ndonjëherë ose nuk është diskutuar, por nuk ka pasur një qasje serioze. Kjo tregon se në atë raport të gjitha problematikat, të gjitha çështjet kritike dhe kritikuese që janë, tregojnë për angazhimin serioz dhe marrjen me seriozitet nga Qeveria e Kosovës për t’u angazhuar që, në vitin që po futemi, të përmirësojë të gjitha ato vërejtje, të gjitha ato probleme me të cilat ballafaqohet vendi ynë.

Ne kemi pasur rastin si ministra veç e veç në takimin me Përfaqësuesit e Komisionit Evropian të japim përgjigje në të gjitha ato pika të cilat janë kërkuar ose kanë pasur vërejtje të caktuara. Dhe, mendoj që nga ai takim që ne kemi pasur është parë qasja serioze e secilës ministri veç e veç, por edhe e Qeverisë në tërësi. Këtu, shkarazi u përmend një gjë tepër e rëndësishme që i ka ndodhur vendit tonë dhe mendoj që kjo nuk ndahet në pozitë dhe opozitë, por kjo ka të bëjë përfundimisht me të ardhmen e këtij vendi.

Përfundimisht, për herë të parë, e është shumë me rëndësi, në Raportin e Komisionit Evropian thuhet se në Kosovë do të fillojë studimi i fizibilitetit. Këtu ka deputetë me përvojë, këtu ka njerëz që merren dhe që e njohin mirë çka do të thotë integrimet evropiane. Ky është një hapë i madh, fillimi i hapjes së dyerve të Kosovës për t'u integruar në institucionet evropiane. Tani e tutje, Kosova është partner i Unionit Evropian, hapet dera drejt krijimit të partneritetit Kosovë - Union Evropian dhe drejt shkuarjes në nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim dhe asocim. Efektet politike të kësaj janë tepër të rëndësishme dhe të pallogaritshme me vetë faktin që ne jemi në raportet si vend i pavarur me Unionin Evropian, gjë që nuk ka ndodhë në të kaluarën, jo pse s'u kanë edhe vetë pavarësia, por thjesht, ju i dini problemet të cilat kanë qenë në Bashkimin Evropian, problemi me njohjen e Kosovës, kjo tregon që është një hap tepër i rëndësishëm dhe Unioni Evropian çfarë qasje ka ndaj Kosovës.

Mendoj që kjo duhet të vlerësohet, mendoj që kjo pavarësisht kush është në Qeveri sot, ju e dini që rruga drejt Unionit Evropian është rrugë e gjatë dhe ne nuk jemi në gjendje të dimë se kush do ta udhëheqë Qeverinë në faza të caktuara drejt anëtarësimit, por është e rëndësishme që kjo ka filluar dhe do të vazhdojë.

Tjetra që dua ta them, të nderuar kolegë, është çështja e krimit të organizuar. Mendoj që kemi në vend dhe në rajon të cilët nganjëherë krimin e organizuar e përdorin për hesape të brendshme politike. Krimi i organizuar nuk është sfidë vetëm për Kosovën, është sfidë rajonale bile përtej rajonale, por ne po flasim për rajonin.

Vendi ynë nuk mund të jetë jashtë kësaj me pozitën që e ka. Prandaj, kapacitetet tona, ne mund të flasim sa të doni, kapacitetet tona janë të pamjaftueshme, s'ka asnjë dilemë, për të luftuar një krim të organizuar, i cili nuk është, as nuk është i lindur, as nuk e ka bazën në Kosovë, por është e efektuar Kosova, është e vërtetë, nga pozicioni i saj që e ka. Nuk kisha dashur që të dëgjoj nga deputetët e këtij Parlamenti që vendin e tyre ta bëjnë bërthamë të krimit të organizuar, sepse nuk është. Shikoni përsëri raportin e një institucioni shumë të fuqishëm, shumë autoritativ – GALLUP, i cili e rëndit Kosovën të fundit në bazë të krimit të organizuar, ose në anën tjetër e paraqet Qeverinë e Kosovës, së bashku me Qeverinë e Malit të Zi dhe të Maqedonisë, si tri qeveri të cilat më së shumti janë të angazhuara në luftimin e krimit të organizuar dhe kjo, mendoj, duhet të vlerësohet. Këtu duhet dërgojmë mesazhe te njerëzit tanë, te qytetarët. Po them, po flas për një institucion tepër të rëndësishëm, shumë të besueshëm - GALLUP.

Zhvillimi ekonomik. Dikush tha që gjendja ekonomike është shumë më keq se sa në të kaluarën. Mendoj që ata njerëz që kanë sy të shohin, është lehtë të shihet se çka është duke i ndodhur sot Kosovës, si ka qenë dje. Se ne nuk i kemi rregulluar të gjitha problemet, askush mos të pret, se ka për t'u bërë më shumë, absolutisht, se ka vend për kritika, nuk ka asnjë dilemë. Po të thuash se s'po bëhet, kemi shkuar mbrapa, kjo është nihiliste, kjo është të mos duash ta pranosh realitetin. Ky vend sot është ndryshe nga ajo që ka qenë dje, sikur që jam i bindur që nesër ka për të qenë shumë më ndryshe se sa që është sot. Deri dje asnjë lëvizje investime serioze në këtë vend nuk ka pasur, hiq asnjë, hiq. Deri dje, krejt buxheti i këtij vendi e dimë ne si ka shkuar. S'ka pasur koordinim, flitet sot për koordinimin, s'ka koordinim të Qeverisë. Ne e dimë se çfarë qeverisje kemi pasur në të kaluarën. Sot ja kemi kthyer seriozitetin institucioneve të këtij vendit, sot ka zhvillim ekonomik, sot ka investime serioze, sot ka ende probleme ekonomike, kemi papunësinë, i kemi problemet të cilat i përmendën shumë deputetë, që janë absolutisht të vërteta, po këto nuk rregullohen për 9 muaj, as nuk kanë për t'u rregulluar për një

mandat. Por se jemi në rrugë të drejtë, kjo nuk ka asnjë dilemë, ne jemi në rrugën e drejtë, ne po ia kthejmë dinjitetin vendit tonë

KRYETARI: Faleminderit, ministër, e harxhove kohën!
Fjalën e ka deputeti Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče na datoj reči! Poštovani premijeru, vladin kabinetu, Poštovani gospodo poslanici, Evo, možda sad na kraju ove iscrpne debate da i mi kažemo nekoliko reči. Naravno, što se tiče premijera i Vlade, opšte je poznata stvar, Samostalna liberalna stranka je partner u Vladi, Samostalna liberalna stranka je ponosna na rezultate ne samo svoje, nego i na vladene rezultate. Moglo je biti bolje, uvek bolje može biti, ali nije ni ovo tako loše.

Korupcije i kriminala ima ne samo ovde, ima ga u regionu, ima ga u širom sveta i to nije neka novina. Mi se uporno trudimo da pokažemo kako to izgleda, ispada naš brend kako smo mi to izmislili. Ne, to mi nismo izmislili, to traje i nećemo se lako izboriti stim. Postoje zakonska akta, propisi, uredbe, zakoni koji su dobri, koji su doneti. Medjutim, moramo malo više da radimo na praktičnim pitanjima vazano za implementaciju svega toga i to će sigurno u budućnosti dati određene rezultate.

Samostalna liberalna stranka je danas bila prozvana ovde i da nisam bio prisutan, jednostavno bi bio zbunjen ko je u poziciji a ko u opoziciji. Jedno pričamo, drugo radimo. Vidite, kada imaju kontakta i pozicija i opozicija, ko je paralelna institucija, ko nije, ko je kome rodjak i šta je, pa smatramo da treba da se ostvrimo i na to malo, jednostavno imamao pravo. Mi nikada nikome nismo spomenuli, ali pošto se već pričalo o tome, da se pogledamo u ogledalo. Ogledalo ne služi samo da vidimo dali smo lepi ili ružni, nego da se vidimo kakvi smo. Ima ljudi koji ne vide ogledalo, dajte da im pomognemo da im damo, pa će valjda da se sagledaju, da vidimo ko je kome rodjak, ko je kome brat od tetke, ko kome brat od ujaka. Jedan u Skupštini Kosova, drugi koordinator, načelnik okruga na izborima 11. maja. Interesantna priča. Pri tom još kaže, mi smo kaže Vlada, ponosni smo na Vladu.

Vreme je da pogledamo ko je to pustošio livade, kako kažu. Ne mislim na cvetne livade, nego na liveđe iz Izveštaja auditora. Ovo nisu nagadjanja i naklapanja. O onome što se pričalo o Samostalnoj libeberalnoj stranci, smatram da je potrebno da se izvrši analiza i mi ćemo biti ponosni na to kada bude auditor izvršio. Ali da vidimo ko je pustošio ove livade koje je auditor dao, ko je pokrao te silne milione? Videćete kako će izveštaj sledećeg puta biti bolji. I premijer i cela Vlada će opet imati napade i trpeti napade zato što nisu raščistili sa prethodnim periodom. Zamislite, još se drznemo da pričamo kako neko drugi radi neke stvari koje su loše. Da vidimo čiji su bre to specialiteti, evo imamo i specialitete ovde. Ajde da vidimo ko to smenjuje i profeseore redovne, doktore nauka i postavlja učitelje. Kada vidim neke podatke, kada dobijem, vidim da nam obrazovanje nije loše. Zamislite, učitelji pa po par stanova od po par stotina hiljada eura. A sad, nije na moje ime, nego mi je na sina ili na strinu, na tetku ovo, ono, znaš, pa se mi malo pravimo naivni. Nema naivnosti, gospodo, to je kosovska realnost. Moramo da radimo na tom pitanju, moramo da se pogledamo u oči, da kažemo mi ćemo sa time da sećemo polako, i zna se gde je mesto ljudima koji su se ogrešili o zakon. To važi i za mene kao člana Samostalne liberalane stranke i za ministre iz Samostalne liberalne stranke, ali bogami važi i za ljude iz prethodnog perioda. Očemo li onu poslovicu narodnu „povika na vuka; a lisica kokoške nosi“. Odneli su oni davno

kokoške i kao vukovi, i kao lisice, pa sada su došli ovde da zezeju kosovsku javnost. E, nije to priča. Što se tiče govornika koji je pričao na srpskom jeziku, ne znam kako mu je tačno ime, za govornicom, ja nisam hteo da izadjem zato što govornica služi da se kažu pametne stvari, stvari koji će da vode budućnosti i prosperitetu, ali neki ljudi upotrebljavaju i kao teatar, cirkus. Naravno, to ovo nije i zato ne želim o tome da pričam.

Ajde da vidimo i tu priču, o tim ljudima, šta je bilo ranije sa Ministrastavom za povratak? Zamislite, pola miliona eura gradjani Kosova plate kompjuterski program firmi „Kaktus“ i to niko ne sme da kaže, a!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputetja Vezira Emrush, por pasi ajo është lajmëruar edhe deputeti Ethem Arifi, i keni nga dy minuta në dispozicion për të mbetur një minutë këtij të fundit.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë, për shkak edhe të kohës, por edhe nuk do të doja juve t'ju irritoj, se mos po më përjashtoni prej seancës, edhe kryeministri nuk qenka këtu, do të jem i shkurtër. Do të jem i shkurtër edhe për faktin se këto gjëra të cilat u prekën këtu edhe në këtë farë Raportin e progresit të Komisionit Evropian, personalisht i kam prekur gjithmonë, qoftë përmes pyetjeve të mia, qoftë përmes diskutimeve të ndryshme, po flas për luftën kundër korrupsionit, instalimit të ekspertizës dhe profesionalizmit në aparatën shtetëror, kritikën ndaj përzgjedhjeve në institucionet e rëndësishme shtetërore, ku nuk u mbajtën premtimet e dhëna gjatë fushatës elektorale, me një fjalë, të gjitha këto kritika që i ka adresuar Komisioni Evropian në Raportin e progresit. Por, unë do të doja t'ia adresoja një mangësi këtij raporti. U mor vesh, sipas mendimit tim, unë e lexova këtë raport dhe e lexova në origjinal, pra në anglishte dhe aty nuk pashë të paktën asnjë fjalë për zhvillimin e demokracisë në subjektet politike. Kjo është shumë me rëndësi për secilin vend i cili synon të aderojë në Unionin Evropian, nga fakti se demokracia dhe transparenca e një vendi, si parakusht për t'u integruar në Unionin Evropian, varet goxha shumë nga ajo se sa demokratike dhe transparente janë vetë subjektet politike, sidomos ato subjekte të cilat edhe financohen nga buxheti, por edhe nga subjektet e tjera politike.

Unë, nuk pashë se ato janë monitoruar, evaluuar, apo krahasuar suksesi i tyre me vitet e mëparshme. Pashë se ishin prekur disa aspekte, në faqe 8, te kriteret politike, pika 2, pastaj në pikën 2.1 Demokracia dhe sundimi i ligjit, ku përmendet Kushtetuta, pastaj në faqen 8 dhe 9 flitet për Parlamentin dhe Qeverinë, si bie fjala, kush fitoi e kush humbi, por jo për zhvillimet demokratike përbrenda subjekteve politike.

Unë, shpresoj se herëve tjera përpiluesi i këtij raporti, bashkëpunëtorët e zotit Davidi do ta kenë parasysh këtë fakt, flas për Renco Davidin...

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush, 2 minuta, le të përgatitet Armend Zemaj, që i ka në dispozicion 4 minuta.

VEZIRA EMRUŠ: Pozdruavljam sve prisutne kolege i Predsedništvo!

Pošto danas razmatramo Izveštaj Evropske zajednice, a na bazi interpelacije koju je grupa AAK pokrenula pred Skupštinom Kosova, smatram da je potrebno da i ja nešto danas kažem.

Svi znamo da je izveštaj sačinjen 15.11.2008 godine, kada je isti upućen Evropskom parlamentu i Savetu, na razmatranje. Kada je u pitanju sam Izveštaj, moramo biti jako zabrinuti zato što se u istom izveštaju navodi da je Kosovo i dalje zemlja abez vladavine zakona, zemlja tranzita i odredište za organizovan kriminal, kao što smo bili videli slučaj iz medija koje smo sve vidove kriminala imali samo kada je bila svera medicine u pitanju.

Evropska Komisija je ocenila da je Kosovo usvojilo Ustav, što je tačno, koji je u skladu sa evropskim standardima i različite zakone, koje smo intenzivno ovde usvajali, ali ti isti zakoni, sada je na nama, moraju se istpoštovati. Na bazi Ustava, Vlada Kosova je dobila jako težak domaći zadatak, gde kosovske institucije, svi znamo, moraju da jačaju vladavinu zakona, borbu protiv kriminala i korupcije i jačanje medjuetničkog dijaloga, koji lično za mene, praktično ne postoji čak i u ovoj samoj Skupštini.

Neću da zamaram mnogo kolege posle tolikih diskusija koje smo ovde čuli, i neću da zadirem u sve ove oblasti koje su napomenute...

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj, le të përgatitet Etem Arifi, i cili e ka në dispozicion një minutë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Unë mendova që do të kontribuoj diçka, po nuk ma merr mendja që do të mund të shtoj apo të lë diçka mangu më shumë se zotëri profesor Hamiti, ndërsa e kam një çështje kështu, pak më të shkurtër.

Është mirë kur po i dëgjojmë disa njerëz që folën për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Mua më vjen mirë, po në anën tjetër Kosova është vendi i vogël dhe shumica e njohim njëri - tjetrin këtu. Disa njerëz që pas luftës apo, të them pas vitit 2000 – 2001, kur kanë ardhur në pozita, se të vetmin financim e kanë pasur nga buxheti i Kosovës, kanë fjetur në shtëpia kështu, në kashtë ose në dyshek me kashtë. Ndërsa, sot i kanë milionat. I vetmi burim financiar i tyre ka qenë buxheti i Kosovës. Ndërsa, të dëgjohet duke kritikuar korrupsionin, kur mobilet e Ministrisë të Kthimit janë gjendur në lokalet e natës në Çagllavicë, nuk e di cili është kuptimi i shqyrtimit apo i interpretimit të raportit. Por, le të mbetet në ndërgjegjen e çdo njeri edhe para qytetarëve, ndërsa ajo çka është dashur sot të jetë në vëmendje, është ministri i Punëve të Brendshme edhe ministria e Drejtësisë. Ata duhet t'iu kushtojnë më shumë vëmendje edhe diskutimeve, edhe këtyre raporteve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Etem Arifi.

ETEM ARIFI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritarë,

Zoti Kryeministër, duke falimenduar disa prej ministrave, që kemi kontaktuar me disa ministra dhe na kanë ndihmuar në disa çështje që kanë të bëjnë me pjesëtarët e komunitetit Hashkali. Mirëpo, shumica e ministrave vetëm na i kanë marrë numrat e

telefonave dhe asnjëherë nuk na kanë thirr që të na ndajnë një termin sado të vogël që të dëgjojnë për hallet tona.

Unë personalisht falënderoj ministrin për Komunitete dhe Kthim në transparencën e kësaj Ministrie, ku të gjithë pjesëtarët e komunitetit Hashkalinjë kanë qenë të informuar me kohë për projektet që tash janë dhënë. Mirëpo, njëhërrësh i falënderoj edhe ministrit për Arsime që në disa çështje na ka ndihmuar. Problemi është te ministrat tjerë që asnjëherë nuk na kanë ftuar dhe nuk kanë qenë të gatshëm ...

KRYETARI: Faleminderit! LDK-ja i ka edhe 2 minuta, nëse dikush e do fjalën. Jo, atëherë faleminderit! Mirë, atëherë fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Dy vetë ma kanë përmendur emrin. I falënderoj që ma kanë përmend emrin, të dytë. Edhe njëherë përsëris, ai dokument të cilin e kemi përpara, ka shumë të vërteta, po për hir të vërtetës duhet të thënë që ka edhe shumë të pavërteta, sidomos rreth shënimeve ku trajtohet problemi i të shpërngulurve nga Kosova. Aty është një klishe që, po më duket, po kopjohet prej organizatave që merren me shpërngulurit, se nuk janë shpërngulur prej Kosove mbi 200.000 vetë, as serbë, as të gjithë bashkë. Ajo është një klishe dhe ajo duhet të mos përsëritet më. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Ministre, mund të kesh një minutë.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Desha të përgjigjem vetëm në deklaratën e zotit deputet Naser Rugova, që tha asgjë s'është marrë për arratisje spektakulare nga burgu. Ju them se 9 vet janë në burg, 18 janë të suspenduar, është formuar komisioni, i cili po punon në rastin dhe posa të kemi rezultate, do ta keni raportin e plotë.

KRYETARI: Faleminderit!
Zoti Kryeministër, fjala është e juaja!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar Kabinet qeveritarë,
Të nderuar deputetë,

Dëshiroj që përsëri t'ju falënderoj për debatin shumë korrektë dhe konstruktiv që është ndihmues për Qeverinë e Kosovës, për të gjitha institucionet e Republikës sonë.

Mendoj se interpelanca të tilla i ndihmojnë procesit të integrimit të Kosovës në strukturat e Bashkimit Evropian dhe në NATO, sepse vetëm një debat i tillë i përbashkët i shkëmbimit të ideve dhe të konkurrencës së ideve do ta çojë vendin tonë përpara, sepse synim dhe qëllim, por edhe vizion i të gjithë neve si politikë kosovare, por edhe vullnet i popullit të Kosovës, është që Kosova të jetë sa më parë që është e mundur pjesë e NATO-s dhe e Bashkimit Evropian.

Por, do të ndërlidhem edhe me çështjet që u ngritën këtu kalimthi. Dëshiroj ta theksoj se në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësuesit e Kosovës kanë marrë pjesë në negociata për raportin që është prezantuar dhe dua të shpreh respektin për përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të institucioneve të Kosovës që kanë prezantuar Kosovën në mënyrë të dinjitetshme dhe profesionale, profesionalizëm që ky është vlerësuar edhe nga vetë ekspertët e Komisionit Evropian.

Tjetër, dua të sqaroj se ky është raport i progresit, do të thotë raport pozitiv, real dhe sfidat që dalin para nesh.

U tha këtu, gjithashtu, prej iniciuesve të interpelancës se Kosova mundet edhe vetë, në fakt, ne duhet t'i marrim përgjegjësitë tona, duhet t'i kryejmë detyrat tona, detyrat e shtëpisë që duhet patjetër t'i kryejmë, se e kemi edhe besimin e qytetarëve, por Kosova nuk do të mbetet e izoluar, Kosova do të integrohet dhe do ta kemi mbështetjen e plotë dhe partneritetin e plotë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO-n dhe Bashkimin Evropian.

Në këtë drejtim, Kosova është duke implementuar të gjitha kriteret e Kopenhagës, kriteret demokratike edhe në politikë, edhe në ekonomi, edhe në legjislacion.

U përmend puna për minoritarët. Unë nuk kam çka t'i shtoj më tepër asaj që tha zoti Petroviq, që e dëshmoi me shifra, me kohë dhe fakte, Sllobodani, që është një punë e mirë, një punë konkrete, një punë që e shohin dhe e prekin për të mirë të gjithë minoritarët, duke filluar prej serbëve, boshnjakëve, turqve, hashkalinjve, romëve dhe të gjitha komuniteteve, kudo që jetojnë në Kosovë. Në kuadër të kësaj, mendoj se ata të cilët i kanë etiketat e tyre jo të mira nga e kaluara, nuk mund t'i etiketojnë të tjerët në të ardhmen, as sot.

Në kuadër të kësaj, Ministria e Kthimit do të vazhdojë me projektet konkrete. Gjithashtu, në kuadër të rritjes së përgjegjësisë, edhe të mia, si Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, kam formuar Zyrën për Komunitete dhe, gjithashtu, kam ndarë mjete financiare, por edhe në kuadër të Presidencës, Presidenti udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete.

Gjithashtu, në vazhden e përshëndetjes së Raportit të progresit, që është edhe vlerësim i Raportit të progresit edhe për edukim, në këtë drejtim është bërë punë e mirë. Dua të theksoj se ju e dini se ku e kemi filluar qeverisjen në edukimin në Kosovë, me fëmijët e Kosovës. Në kontejnerë, në shumë komuna të Kosovës. Sot më nuk është asnjë. E kemi filluar me shumë shkolla të vjetra, të shkatërruara e të dërmuara. Kemi ndërtuar shumë shkolla të reja e fakultete të reja.

Gjithashtu, kemi prezantuar dhe filluar së implementuari fillimisht pilot projektin, tash edhe projektin madhor, projektin në nivel vendi, projektin modern, atë të kompjuterizimit të çdo shkolle, në mënyrë që të ketë internet në çdo shkollë të Kosovës. Është i kushtueshëm, por nuk do të kursejmë asgjë për edukimin e fëmijëve tanë.

Për infrastrukturë rrugore, gjithashtu, u përmend këtu se ka pasur sukses, por edhe vlerësohet në Raportin e progresit puna që është bërë në infrastrukturën rrugore. Është e vërtetë se sot në Kosovë ka më pak baltë, shumë më pak, dhe ka shumë rrugë të reja, shumë më shumë, anekënd Kosovës, edhe në nivel lokal, por edhe regional, si dhe ndërkombëtar.

U përmend se nuk nënkupton zhvillim ekonomik vetëm rruga Prishtinë – QMI, por dua të theksoj se pa kaluar përmes QMI-së nuk shkohet as në Ferizaj, as në Kaçanik, as në Han të Elezit, ku do të mbërrijmë me auto-rrugën, të cilën e kemi filluar si Qeveri.

Gjithashtu, do të vazhdojmë, këtë viti kemi arritur deri në Aeroport, do të vazhdojmë vitin e ardhshëm plus 20 kilometra në drejtimin për Pejë dhe pastaj deri në kufi me Malin e Zi. Gjithashtu, do të vazhdojmë me projektin vitin e ardhshëm, ku ka mbetur në rrugën Prishtinë – Vushtrri – Mitrovicë, deri në Vushtrri, pastaj Mitrovicë dhe Leposaviq, dhe projekti madhor që është në përfundim e sipër për fillimin Vermnicë - Merdare.

Te sundimi i ligjit, Raporti i progresit e përshëndet instalimin e qeverisjes së mirë, transparente dhe efektive. Duke marrë parasysh, ne si Qeveri, edhe lëshimet e dobësitë dhe sfidat që dalin para nesh, pra është instaluar qeverisja e mirë, sundimi i ligjit, zero tolerancë ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, është instaluar transparenca dhe tash me instalimin dhe shtrirjen edhe të EULEX-it do të ndalet edhe kontrabanda.

Gjithashtu, edhe sa i përket shpëlarjes së parave, ne kemi marrë qëndrimin tonë, kemi marrë vendimet tona, kemi nxjerrë ligjet. Ndërsa, sa iu përket privatizimeve, dua t'ju them mënyrën më të sigurtë të mundshme në kuadër të përgjithësive shtetërore. Nuk e di, ju iniciuesit e interpelancës, a jeni kundër privatizimit si koncept, apo jeni kundër privatizimit, që nuk jeni vetë në proces, apo është mentaliteti i juaj? Nëse është mentaliteti, jam shumë i shqetësuar se Kosova nuk mund të kthehet në vitet '80-ta.

Në këtë drejtim, po ju them edhe disa gjëra të cilat ndoshta nuk do të ishin shumë të pëlqyeshme, por kësaj radhe jeni të kursyer.

U përmend shoqëria civile, shërbyesit civilë, zhvillimi ekonomik dhe perspektiva evropiane, si dhe përkushtime të tjera. Në anën tjetër, dua të theksoj se së shpejti do të punojmë edhe për nxjerrjen e Ligjit për prejardhjen e pasurisë të të gjithë zyrtarëve të Republikës së Kosovës dhe do të kërkojmë verifikimin e pasurisë së secilit zyrtarë prej bartësve të institucioneve, në mënyrë që të verifikohet pasuria e tyre prej qershorit të vitit 1999 deri sot, kush ku ka qenë dhe ku ka mbërrirë, megjithëse populli i di.

Të nderuar deputetë,

Shoqëria civile është një segment, një komunitet shumë i rëndësishëm për Kosovën, në mënyrë që të forcohet zhvillimi i demokracisë. Ndihej mirë dhe i përgjegjshëm që kemi thelluar bashkëpunimin me komunitetin e shoqërisë civile edhe atëherë kur e mbështesin qeverinë, edhe atëherë kur japin ide, por edhe atëherë kur e kritikojnë Qeverinë. Qeveria do të vazhdojë, edhe unë personalisht, të jemi bashkëpunues dhe partner të mirë të shoqërisë civile dhe mbështetës të angazhimeve të tyre.

Tek mediat, e përmendi zëvendëskryeministri, Raporti precizon qartë se mediat janë të kërcënuara nga politika. Por, nga politika nëse keni vërejtje, politika e rrok gjerë dhe vlerësohet partneriteti i Qeverisë së Kosovës, ndërsa sa i përket, nëse keni vërejtje për minutazhin, mendoj se jeni duke na tejkaluar neve, varet tash a dini për të mbarë apo të mbrapshtë, ajo është rezultat i punës së juaj.

Tek partneriteti politik, ishte për iniciuesit e interpelancës. Tek partneriteti politik, unë dua të theksoj se definitivisht këtë vit...

KRYETARI: Regjia, ia vazhdoni kohën!

KRYEMINISTRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Këtë vit ka ndryshuar qasja edhe e komunikimit mes partive politike, do të thotë kemi krijuar një standard të ri, standardin e komunikimit, të bashkëpunimit dhe të ndarjes së

ideve, qoftë si Qeveri, qoftë si partner të koalicionit, qoftë si opozitë për çështje të rëndësishme madhore që ndërlidhen drejtpërdrejt me interesat e vendit tonë.

Ne kemi prezantuar, ju e dini, të gjitha partitë politike, të gjitha grupet parlamentare, edhe Projektbuxhetin e vitit 2009, kam marrë pjesë edhe vetë personalisht në shumicën e këtyre takimeve dhe një partneriteti i tillë, një debat i tillë do të vazhdojë edhe në të ardhmen nga ne.

Gjithashtu, duhet përshëndetur, dhe përshëndetur edhe në raportin e progresit, partneriteti me komunitetin e biznesit. Ju e dini, iniciuesit e interpelancës, se biznesi më herët ka qenë në presion, në shantazh dhe i kërcënuar. Tash ka bashkëpunim, ka partneritet, ka mbrojtje ligjore dhe ka lehtësim në punë dhe taksa.

Ndërsa, përsëri, tek shërbyesit civil dua të them se nuk ka pasur, e them me përgjegjësi të plotë, asnjë të larguar nga puna për motive politike. Kur përzihen në afëra, atëherë ka punë ligji, jo Qeveria.

Dhe, krejt në fund, dëshiroj t'ju falënderoj përsëri për kontributin tuaj, por dua të theksoj se viti 2008 ka qenë viti historik i vendimeve të mëdha për të ardhmen e Kosovës, por edhe viti i fillimit të reformave të mëdha edhe në zhvillimin ekonomik dhe kemi ngritje të zhvillimit ekonomikë 5.5% dhe rritje të buxhetit për vitin 2009 mbi 15%. Prandaj, jam i sigurit dhe me optimizëm të madh se Kosova ka perspektivë të sigurt evropiane. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjala është e propozuesit, fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se pamja e sotme në Kuvendin e Kosovës është më realja në vitin e fundit, është pamja më reale e mundshme, është pamja, që tash po e tregoj pse Kryeministër. Është pamja kur tentojnë njerëzit të paraqesin humbjen si fitore prej fillimit. Është pamja e kamuflimit të vazhdueshëm, është pamja e mbështjelljes së gjithçkaje që është serioze me diçka joserioze.

Po ju tregoj. A e dëgjuat ministrin e Shërbimeve Publike? Ne i themi pse janë shkarkuar 8 sekretarë permanentë për 3 muaj, ai thotë duam të bëjmë government. A e dëgjuat Kryeministrin? Thotë transparencë, 5 herë e përmendi. Ne i themi pse janë shkarkuar sekretarët, ky thotë transparencë, ne i themi si u dhënë tenderi i Rilindjes, ky thotë transparencë, ne i themi pse e ke shkelë Kushtetutën me rishikim të buxhetit, ky thotë transparencë. Asnjë element transparence në Kosovë nuk ka, asnjë të vetëm. Transparenca është kamufluar me disa kamera, të cilat vendosen në mbledhje të Qeverisë dhe nuk marrin vesh as çka po ndodhë. Edhe po ju them, për aq sa na kanë njohur 100 shtete deri më tash, për aq ka transparencë në Qeveri të Kosovës, mbani në mend, 100 shtete që na kanë njohur.

Kryeministri tha, Raporti është pak sa kritik. Çka mendoni ju, intimidimi i mediave, korrupsion, shkatërrim i administratës publike, mostransparencë, po a paksa po ju duken këto, pak sa janë, a? Unë nuk e di qysh shpjegohet paksa në këtë farë konteksti të shpjegimit të raportit, të cilin e kemi ne para vetes dhe është krejt lehtë, krejt lehtë është të shihet situata kur, Kryeministri i Kosovës, në vend se të vijë me dokument, i cili na tregon se me çka po merret sot Qeveria, duke u bazuar në këtë raport, e akuzon ish Qeverinë, flet për raportin e para 2 viteve dhe mbanë fjalim më shumë se një orë e

gjysmë në total duke treguar krejt çka ka premtuar në fushatën parazgjedhore, edhe njëherë duke përsëritur.

Ne nuk duam të kërkojmë dorëheqjen e Kryeministrit sot për shkak se ka për të rënë vetë, mos u befasoj, bien vetë, e shihni se bien vetë, vetë kini për ta hequr ju. Ama, ne sot po kërkojmë ta shihni ju pak, ta shihni veten, ta merrni dokumentin, të shihni çka është duke ndodhur me ju, çka është duke ndodhur me Kosovën. Kosovës nuk është duke iu premtuar mirë me këtë që po shohim sot, jeta në Kosovë është duke u degraduar për çdo ditë dhe Kosova si shtet është duke u fyer, është duke u fyer në planin ndërkombëtar për shkak të krejt kësaj çka ndodh edhe për shkak krejt kësaj që e pamë sot, ekzakt sot. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Me fjalën e deputetit Ardian Gjini, debati përfundoi. E, në përmbyllje të interpelancës në Kuvend të Kryeministrit të Kosovës, zotit Hashim Thaçi, lidhur me Raportin e progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008, propozoj që seanca plenare të nxjerrë këto përfundime:

1. Ngarkohet Komisioni për Integritet Evropian që ta analizojë Raportin e progresit dhe të përgatisë një propozim të Planit të veprimit të Kuvendit për sfidat e Raportit të progresit për vitin 2008, i cili do të shqyrtohet dhe miratohet në seancë plenare të Kuvendit.
2. Komisionet e tjera parlamentare, të përfshijnë në rendin e ditës të takimeve të tyre të rregullta, sfidat e integriteteve evropiane, si pikë të veçantë, në mënyrë që të sigurojnë që Plani i veprimit për sfidat e Raportit të progresit për vitin 2008 të realizohet plotësisht. Komisionet parlamentare ia dërgojnë informacionet e tyre rregullisht Komisionit për Integritet Evropian.
3. Komisioni për Integritet Evropian çdo tre muaj do t'i raportojë seancës plenare të Kuvendit për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit për sfidat e raportit të progresit për vitin 2008.
4. Obligohet Qeveria e Kosovës dhe ministritë e saj që t'i ofrojnë bashkëpunim dhe informacion të rregullt Kuvendit të Kosovës dhe komisioneve gjegjëse parlamentare në realizimin e pikave të sipërpërmendura.

Ju falënderoj për debatin dhe tani kemi pauzë deri në 16,30.

(Pas pauzës, në mungesë të kuorumit, seanca u shty për të nesërmen, më 12.12 2008, në orën 10:00)

Vazhdimi i seancës më 12. 12. 2008

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministra, ministra,

Mirëmëngjes! Po e vazhdojmë seancën e djeshme. Pika e radhës është pika e pestë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Ju e dini që këtu i kemi 4 ligje, që janë në pako, dhe këto ligje është mirë të miratohen edhe në leximin e dytë para seancës së miratimit të Buxhetit të vitit 2009.

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij Projektligji.

Ftoj ministrin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantoj Projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Mirëmëngjesi!

I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Kam nderin që prapë sot para jush të paraqes tri projektligje: Ligjin mbi tatimin në korporata, Ligjin mbi tatimin në të hyrat individuale dhe në akcizën. Natyrisht, ne do të shkojmë sipas Rregullores, një nga një. Por, më lejoni që të paraqes Ligjin mbi të ardhurat mbi korporatat, përkatësisht ndryshimin e Projektligjit mbi të ardhurat mbi korporatat, i cili prapë po thuaj se, siç e thashë edhe dje, në përmbajtje është Rregullorja që ka qenë në fuqi. Mirëpo, në substancë, nëse mund të them, është një ndryshim fundamental, sepse ndryshimi i taksave është 50% më i ulët. Pra, ne përgjysmojmë taksat. Kosova para 3 – 4 viteve ka qenë vendi me taksa më të ulëta në korporata në regjion. Regjioni ka ecën shumë përpara dhe ne atë që kemi premtuar edhe para fushatës, atë që kemi biseduar dhe premtuar biznesit, në bashkëbisedim me ta kemi marrë vendim më 28 korrik të këtij viti që tatimi mbi fitimin mbi korporatat të përgjysmohet, përkatësisht nga 20% të silltet në 10%, që është konsideroj një vendim që e sjell Kosovën në vend ku përfaqësisht regjioni është aty. Vendet në regjion kanë ecën në 3 vitet e kaluara mjaft shpejt dhe Kosova pati mbetur mbrapa.

Përveç këtij ligji, ne kemi marrë vendim edhe për uljen e taksave mbi të hyrat individuale dhe ato më vonë do t'i sqaroj. Por, ky ligj ka shndërruar në aspektin teknik Rregulloren 2004/51 në ligj. Ne do të përgatitim komplet ligjin gjatë pranverës, për hir të sjelljes më të shpejtë të vendimeve të Qeverisë, të sjelljes së Kosovës në hartën e vendeve me taksa më të ulëta. Dëgjoni, do të dëgjoni në regjion edhe nga liderët të ndryshëm se vendet e tyre janë vendet me taksa më të ulëta. Në fakt, Kosova me këto vendime që, ju, besoj do t'i miratoni, sjell Kosovën në vendim me taksa më të ulëta me ngarkesë ose barrë të taksave më të ulët në regjion.

Me taksën mbi profitin do të sjellim në kuadër të regjionit, por taksat mbi të hyrat individuale do të sillen më të ulëtat në regjion dhe mesatarja do të jetë diku mbi 5.2 përfaqësisht.

Ndryshimet e normës tatimore janë bërë në nenet 5, në nenin 27, në nenin 29 dhe në nenin 31 të kësaj Rregulloreje, përkatësisht të Rregullores 2004/51. Disa ndryshime terminologjike të cilat janë bërë, faktikisht është termi i “Rregullores” i zëvendësuar me termen “ligj”, termi “autoritet bankar i pagesave të Kosovës” është zëvendësuar me

termin “Banka Qendrore” dhe, natyrisht, termi “PSSP” është zëvendësuar me termin “Kuvendi i Kosovës”.

Me qenë se tatimi në të ardhura të korporatës nuk rregullohet me ndonjë rregullore të vetme, në dispozitat kalimtare kemi propozuar që të mbeten në fuqi dy rregullore: 2005/51 dhe 2007/22 deri në aprovimin e Ligjit të ri të të ardhurave në korporata, i cili do të bëhet në pranverë.

Kjo është, konsideroj, një nga vendimet e fuqishme të Qeverisë së Kosovës për të mundësuar dy gjëra, që korporatat përkatësisht kompanitë e Kosovës të jenë në vend të barabartë me regjionin. Përmes kësaj, jam i bindur dhe kanë thanë edhe ekspertë të tjerë, që do të luftohet informaliteti. Ju e dini që shumë kompani, në qoftë se i kanë pasqyrat e veta financiare sot, nuk e tregojnë fitimin real, përpiqen t’i ikin faktikisht për hir se barra është 20% dhe secili nga një inercion i brendshëm, mbase edhe nga inercioni i kaluar gjatë viteve ’90-ta, përpiqen që të tregojnë një fitim sa më të ulët dhe mbeten jo partner serioz ose mbeten partner joserioz edhe ndaj bankave dhe partnerëve të ndryshëm ndërkombëtarë, sepse në pasqyrat e tyre financiare paraqitet fitime shumë të ulëta. Kjo besoj që do të ndihmojë që fitimet reale të paraqiten realisht në pasqyrat financiare, besoj që do mundësojë që kompanitë kosovare të kenë mundësi që para bankave të jenë partner më serioz dhe të kenë një pasqyrë më reale financiare dhe në të njëjtën kohë fitimet reale do të sjellin, po ashtu, edhe taksa reale. Shumë biznese kanë filluar ose janë përpjekur që të bëjnë, nëse mund të them, edhe vazion fiskal mu për shkak të taksës shumë të lartë. Nga kjo ne humbim 23.000.000 euro, nga kjo taksë teoretikisht humbim 23.000.000 euro, atë që dje flisnim se cilat do të jenë humbjet. Mirëpo, unë besoj që do rritet baza tatimore dhe në fakt nuk do t’i humbim 23.000.000 euro, por do të fitojmë shumë më shumë jo vetëm në aspektin e inkasimeve tatimore, por edhe në aspektin e sjelljes së biznesit në kuadër të ligjit dhe në kuadër të një profili më të mirë të korporatave të Kosovës ndaj bankave, por edhe ndaj partnerëve ndërkombëtarë. Andaj, besoj që nëse ka nevojë shpjegime të hollësishme unë të jap, ne kemi pas paraparë fare në fillim të këtij viti 7 versione të ndryshme, pra duke ngritur ose ulur njërën, për të balancuar çështjet e ndikimeve buxhetore.

Qeveria e Kosovës, pas shumë analizave ka ardhur me këtë propozim dhe ju lus juve, deputetë të nderuar, që ta përkrahni në mënyrë që të jemi në gjendje ta sjellim Kosovën në pasqyrën e vendeve ku biznesi kosovar do të jetë në gjendje të konkurrojë ligjshëm dhe të pasqyrohet ligjshëm në një performancë më të mirë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Konstatohet se në sallë janë 73 deputetë. Radha është e raportuesit në emër të Komisionit. Urdhëro, zoti deputet Shatri!

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuar Qeveri,

Të nderuar kolegë, deputetë,

Komisioni për Buxhet i ka shqyrtuar këto 4 ligje që sot i kemi në rend dite. Të jem i sinqertë, janë ngritur shqetësimet edhe dje, që janë dëgjuar nga disa deputetë këtu, dhe përparësitë dhe Komisioni në fund ka marrë një vendim duke parë nevojën për t’u aprovuar këto ligje paralelisht me Ligjin për buxhetin 2009, sepse bëhen bazë e të hyrave buxhetore, të projektuara në buxhet. Kemi dhënë rekomandim për deputetë që këto ligje të mbështeten në lexim të parë dhe arsyeja është sepse këto janë, thjeshtë, adaptim i

rregulloreve të mëhershme në ligj, me përjashtim të ndryshimit të normave të caktuara, për të cilat po diskutojmë, në 2 ligje ka zbritje të normave, në 2 ligje ka ngritje të normave, në mënyrë që këto si pako të jenë neutrale ndaj të hyrave në buxhet.

Prandaj, rekomandojmë që këto ligje të mbështeten. Kemi pasur parasysh që disa rregullore kanë mbetur jashtë këtyre ligjeve, por me qenë se jemi në dijeni që janë duke u përgatitur ligjet e reja nga kjo fushë, jemi pajtuar që ne të punojmë më shpejt, në mënyrë që të arrijmë edhe leximin e dytë paralelisht me leximin e dytë të Ligjit për buxhetin.

Dua t'ju them që ky qëndrim i Komisionit për Buxhet njëherë është adaptuar dhe mbështetet nga Grupi Parlamentar i LDK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet Shatri!

Radha është e shefave të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë, deputetë,

Partia Demokratike e Kosovës ka shqyrtuar, në parim, Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe gjatë shqyrtimit ka konstatuar se Projektligji është i nevojshëm dhe i domosdoshëm të aprovohet në lexim të parë, duke konstatuar se është nevojë e domosdoshme para aprovimit të Ligjit për buxhetin.

Ne konsiderojmë që ndryshimi dhe plotësimi që ka ardhur nga Ministria për Ekonomi dhe Financa për zvogëlimin e tatimit në fitim të të ardhurave të korporatave, është i respektueshëm dhe në parim e mbështesim si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të LDK-së foli deputeti Haki Shatri. Tani është radha e Grupit Parlamentar të AKR-së. Për diskutim është paraqitur deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Njëkohësisht, edhe për deputetët brenda Kuvendit,

Ne mendojmë se propozimi i MEF-it për reformat, të cilat prekin legjislacioni fiskal, ku pos të tjerash edhe tatimin në të ardhurat të korporatave, tatimin në të ardhura individuale, tatimin në vlerën e shtuar si dhe Projektligjin për normën e akcizës do të shohim sa do t'i ndihmojnë buxhetit të Kosovës.

Çështje që janë ngritur në këtë Projektligj janë mjaft delikate dhe në një mënyrë prodhojnë efekte kontraproduktive në bazë të 4 ligjeve që janë sjellë në Kuvendin e Kosovës. Mirëpo, duke parë se në këtë Projektligj, në nenin 5, shkalla e tatimit, kapitulli II, thotë se do të ketë zbritje të tatimit 10% në mënyrë të përgjithësuar, kisha kërkuar prej ministrit të precizohet edhe ulja e sigurimeve. Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah këtë Projektligj dhe të gjitha vërejtjet të cilat mund t'i japim, do të japim në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Mendojmë se ky Projektligj duhet të plotësohet në mënyrë që këto të jenë kontabile me zhvillimet në kohën nëpër të cilën po kalon Kosova. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ethem Çeku e ka fjalën.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ne na vjen shumë mirë që Qeveria, konkretisht njerëzit në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, bashkë me ekspertët ndërkombëtarë kanë prurë një ndryshim të politikave fiskale. Mendojmë që këto politika ndoshta janë programore, jo fushata elektorale, siç e tha ministri që kemi premtuar në fushata, sepse neve na nevojitet një qëndrueshmëri në ndërtimet buxhetore dhe në konceptet e zhvillimit ekonomik të vendit. Ndryshimin e ligjit në të ardhurat e korporatave në tri vitet e kaluara, e di ministri, nuk është bërë sepse janë parë korporatat si mundësi të ngritjeve buxhetore. Tani ndoshta e shohim që korporatat mund të jenë një mundësi të mirë e zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Në parim, Grupi ynë Parlamentar e mbështet dhe do t'i japim të gjitha sugjerimet tona në komisione të caktuara. Faleminderit! Dhe, më vjen mirë që po kalojmë nga e djathta Kryetar, po i ikim të majtës.

KRYETARI: Unë kam thënë moti që janë përzier pak! (Qeshje).

Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Përshëndetje, Kryetar!

Përshëndetje për Qeverinë,

Të nderuar deputetë,

Edhe ne si Lidhje Demokratike e Dardanisë, në parim e përkrahim Ligjin, duke marrë parasysh konceptin tonë programor për uljen e taksave. Mirëpo, dua të theksoj një fenomen se ligji i djeshëm, i cili u aprovua për ngritjen e TVSH-së, dhe ky ligj, nuk janë koherentë në aspektin e reformave tatimore. Këtë le ta dijë ministri dhe në qoftë se del ministri ta arsyetojë ligjin, nuk ka nevojë të bëjmë propagandë politike, por vërtetë të merret me çështje ligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe prej jush!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” deputeti Enis Kervan e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti Kryetar!

Sayın Başbakan, yardımcıları,değerli bakanlar ve vekiller,

28 Temmuz 2008 tarihinde Kosova Hükümeti gerçekleştirdiği toplantısında Maliye ve Ekonomi Bakanlığının Fiskal Politik Reformlarıyla ilgili önerisini de benimsemiştir. Bu Reformlar diğerleri arasında ortak şirketlerin gelirlerine yönelik katma değer vergisini de etkilemektedir. Böylelikle Yasa değişikliği ile vergilerde yüzde 20'den yüzde 10'a bir düşüş mevcuttur. Kosova Hükümetinin almış olduğu karara uyum sağlamak maksadıyla 7+ Parlamenter Grubu, Yasa Tasarısının ilk okunuşunu kabul ederken, uyarılarımızı gerekli komiyonlara ileterek katkılarımızı sunacağız. Faliminderit.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Radha është e Grupit SLS, fjalën e ka deputeti Slobodan Petrović.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Pozdravljam vladin kabinet,

Zamenike premijera,

Uvažene poslanike,

Poslanički klub Samostalne liberalne strane u načelu podržava ovaj predlog zakona.

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e deputetëve. Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Unë fillimisht dua të cek se pajtohem që ky Projektligj të shkojë në lexim të parë, pra të miratohet. Por, megjithatë do të them disa vërejtje të mia.

Vërejtja ime e parë ka të bëjë me atë se paketa e projektligjeve për ndryshimet në politikat fiskale është dashur të shqyrtohet shumë më herët. Buxheti për vitin 2009 është projektuar në bazë të ndryshimeve të propozuara në këto projektligje, pa u miratuar ato. Prandaj, do të thotë, për mua paraqet një pengesë për projektimin e buxhetit.

Është e vërtetë se rritja e tatimit të vlerës së shtuar për 1% do të atakojë kryesisht shtresat me të ardhura më të ulëta, edhe pse në masë të gjerë do të thotë edhe të gjithë popullin.

Kjo rritje e TVSH-së parashihet për të mbuluar uljen 10% të tatimeve në të ardhurat e korporatave dhe uljen e tatimit në të ardhurat personale. Ulja e tatimit në të ardhurat e korporatave për 10% parashihet se do të ndikojë në uljen e të hyrave buxhetore. Fillimisht, mendoj se ekziston mundësia të ndodhë kjo, por nëse shikojmë në afat të gjatë, mendoj se ulja e tatimit në të ardhurat e korporatave do të ndikojë në uljen e evazionit fiskal. Për arsye se, do të thotë, korporatat në të ardhmen nëse do të paguajnë 10% tatim në të ardhurat e tyre, do të jenë më të gatshme që të kryejnë obligimet e tyre tatimore se sa më parë, kur kanë pasur të kryejnë obligimet me një normë më të lartë të tatimit, do të thotë me 20%. Prandaj, kjo masë do të ndikojë në afat të gjatë do të ndikojë që të rritet baza tatimore dhe të rritet inkasimi i të hyrave tatimore në buxhet. Por, ulja e tatimit 10% në të ardhurat e korporatave në anën tjetër paraqet edhe një masë që do të ndikojë në tërheqjen e investimeve të jashtme.

Ne duhet të dimë se po garojmë në një konkurrencë shumë të fortë në rajon dhe më gjerë për të tërhequr investitorë të jashtëm në vendin tonë dhe kjo mund të jetë një prej faktorëve që në të ardhmen mund të na ndihmojë në këtë drejtim, së bashku me uljet e normave të tatimeve në të ardhurat personale.

Sa për informim, do të përmend disa shtete të rajonit, çfarë normash të tatimit në të ardhurat e korporatave zbatojnë Shqipëria, Maqedonia, Serbia dhe Bullgaria i kanë nga 10%, Mali i Zi 9%, ndërsa Rumunia dhe Hungaria 16%. Sa i përket të ardhurave personale, do ta marrë fjalën më vonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit, zonja deputete. Fjalën e ka deputeti Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni që fillimisht të deklarojmë se e përkrah këtë ligj. Sa herë që Qeveria e ka pasur mirë, gjithmonë e kam përkrahur Qeverinë. Por, më lejoni që, edhe dje, se më mbeti borxh ministri me disa fjalë. Ishte fjala e tij e fundit dhe atëherë nuk pata mundësi t'ia kthej. Nuk është gabim, nuk është tragjedi të mos dihen gjërat më 2001, duke pasur parasysh si keni kaluar deri më 2001, i nderuar. Por, tash, pas 7 – 8 vjetësh, pas të gjithë atyre workshops që ua kanë mbajtur ekspertët e famshëm botërorë, të mos dihen këto, problem është. Ky koktej që e keni bërë, tregon se makroekonominë nuk e keni mësuar mirë. Privatizimin u munduat, por këtu jeni të padijshëm. Shikoni, veç po ua marrë në

TVSH një fjali që e keni qitur. “Tatimet indirekte më të larta mundësojnë zvogëlimin e normës së tatimeve direkte”. Po të garantoj, te asnjë profesor serioz, që jep makroekonomi apo ekonomi politike, nuk kishe për të kaluar ti me këtë fjali.

Pastaj, mënyra se si je munduar ta shesësh këtë TVSH-në tënde, VSHT-në time, është se nuk çon peshë se është 1% ngritje dhe shtrohet pyetja atëherë, nëse nuk çon peshë ngritja 1%, pse po e ngritni? T’i qitni hi syve dikujt?! Unë dua ta them, jam i hapur për debat, se janë edhe do ligje të tjera që mund të të kthehen. Këto gjëra është dashur të mësohen mirë, se atje ku kam punuar, është dashur të dihen mirë. Une i kam mesuar, sepse nuk më kanë paguar për t’ua bartur çantën njerëzve atje ku kam punuar. Më është dashur ti munda ata në vend të tyre që kanë ardhur këtu ty për të shitur mend. Do të thotë, për këtë e di ekonominë mirë, se çare s’kam pasur pa e mësuar mirë.

Sidoqoftë, t’i kthehem tash tatimit në korporatë. Unë e pranoj, siç thashë, e përkrah për shumë arsye, edhe për faktin se Qeveria nuk po di ta shpenzojë buxhetin. Kemi sivjet 250 milionë suficit. Atëherë, nëse Qeveria nuk di t’i shpenzojë paratë e biznesit, t’i lëmë ndërmarrësit që vetë ato paratë e tyre t’i shpenzojnë sipas nevojës. U tha këtu se këto ndryshime fiskale do të jenë bazë për buxhetin e vitit 2009, buxhet të cilin, ju thashë atëherë kur e miratuan këtu, se nuk do ta arrini. Unë jam i bindur se në korrik përsëri do të na sillni Projektligjin për ndryshimin e buxhetit. Kjo është dezhavy për ne, vjet për vjet ndodhë kështu. Po, sidoqoftë, po them, keni mundur në këtë ligj apo edhe me iniciativa të tjera, që investimet e huaja direkt në sektorët, në industritë e caktuara, t’i lironi totalisht, ashtu siç po bën rajoni, për të qenë në hap në konkurrencë me politikën fiskale me rajonin, ashtu siç të paktën tentuat të bëni këtu fushatë politike. Posaçërisht, për ato të ashtuquajtura greenfield investments, por edhe ato brownfield investments nëpër zona të caktuara, për industri të caktuara. Por, edhe tash do të kthehem aty. Nëse synoni që Kosova të jetë më atraktive për investuesit e huaj, direkt edhe investuesit e huaj, por edhe ekuipazhi e të tjerë të lirohen nga tatimet në të hyra, se edhe ashtu ato si kemi. Do të thotë, ka mundësi të ndryshme për ta bërë Kosovën atraktive për investuesit e huaj, por jo duke rritur VSHT-në, të rëndohet fukaraja, qoftë ajo edhe kozmetike, ngritje kozmetike, siç me të madhe propagandoi dje në lajmet qendrore Televizioni shtetëror. Madje, madje ata thanë se edhe këtë ligj e kemi aprovuar ne opozita, fare pa e aprovuar ne. Faleminderit! Jam i hapur për debat. Urdhëro!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e ka deputeti Smaka.

RIZA SMAKA: Respekte kryesues, qeveritarë, deputetë, Konsiderohet se bërja e ligjit është puna kulminante profesionaliste e juristit edhe për shkak se është punë jo relativisht, po goxha e vështirë dhe tepër serioze, kërkon edhe eksperiencë të mira, edhe njohuri. Këtë e them në kontekst me këtë dokument, por jo veç me këtë, por me një numër të madh të dokumenteve, të cilat nga një imperativ i ngutisë i kemi miratuar, ani pse kemi vërejtur shumë defekte. Unë, tash për tash jam i koncentruar në aspektin e terminologjisë juridike dhe të standardeve juridike. Ndryshe, ky dokument edhe nga Komisioni për Buxhet, që është një komision serioz, është shoshitur dhe është konsideruar i pranueshëm dhe në këtë drejtim ne urojmë që të përmirësohet dhe të sendërtohet.

Nuk them tash unë, po e zëmë, se ata që e kanë hartuar, nuk kanë ditur, se nuk e praktikojnë këtë për të thënë. E përfilli thënien e Sokratit, i cili e ka pasur, si të them kështu,

postulat: Dija niset nga mosdija dhe kush pretendon se di, nuk di, e kush pretendon se nuk di, mund të dijë, sepse e di sa nuk di.

Konkretisht, preambula duhet të rishikohet edhe të riformulohet në konform me standard juridik, është e mangët. Edhe neni 32, po asi sojit edhe neni 34, në konformitet me institutin juridik të pormullgacionit. Nuk mund të thuhet se ky ligj hyn në fuqi me datën kaq, sepse janë disa kërkesa të mëparshme.

32-shi, po asi soji, nuk ka nevojë, duhet të fshihej krejtësisht, sepse çdo ministër i cilës do qeveri, sidomos i Qeverisë sonë, që e kemi të rregulluar këtë temë, nuk ka nevojë që të thuhet “miraton” apo, bile këtu thotë “mund të miratojë”, e qet në atë kuptimin fakultativ. Ai është më tepër imperativ, se ligji nuk mund të aplikohet, nuk mund të sendërtohet pa një numër të konsiderueshëm të akteve nënligjore, që nuk janë gjithmonë rregulloret, ka edhe rregulla, ka edhe instruksione obligative administrative.

Titulli. Ne e kemi ligjin e miratuar dhe është në rregull ai ligj. Jo, jo, i quan organizata biznesore, e janë 4 tipa të organizatave biznesore. Korporatat janë një nga ata tipa, prandaj do t’i kishim përjashtuar nëpërmjet një titulli kompanitë, po e zë, që mund të jenë komanditore, me përgjegjësi të kufizuar, partnershipet që mund të jenë të përgjithshme, mund të jenë të limituara. Prandaj, në parim them, që duhet të riformulohet, edhe pasi ka hyrë në procedurë, do të riformulohet, do të duhej të quhej “për organizatat biznesore”, jo për korporatat, sepse do të absorboheshin tre tipat e tjerë të organizatave biznesore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri deputet! Fjalën e ka, pasi nuk ka tjerë deputetë të paraqitur, fjalën e ka ministri Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Sigurisht që do t’i falënderoj të gjithë mbështetësit, sado që dikush përpiket të sjellë ndonjë debat të nivelit narcisoid ose vetëvlerësues narcisoid, nuk do të vijë. Vetëvlerësimet, profesori Smakaj i tha shumë mirë. Unë do të jem i gatshëm gjithmonë të dëgjoj mendime konstruktive dhe ato që shkojnë në drejtimit e zhvillimit ekonomik. Ai që pretendon që është i vetëdijshëm ose i gjithëdijshëm, e ka gabim.

Sigurisht që makroekonomia është një oqean dijesh dhe unë jam shumë i gatshëm të dëgjoj mendimet që bashkërisht t’i mbledhim forcat dhe të hecim përpara, duke mos u lëshuar prapë, thashë, në debate të cilat nuk kishin konstruktivitet.

Unë jam i sigurt që aprovimi i këtij ligji e sjell Kosovën në një nivel më të konkurrueshëm, përkatësisht në një aftësi konkurruese më të mirë të të gjithë bizneseve në Kosovë. Ju falënderoj për mbështetjen paraprakisht, megjithatë natyrisht i falënderoj të gjithë ata që kanë dhënë kontribut për të mundësuar ligjet në atë nivel që janë sot. Neve, në fakt, në këtë ligj po e mbrojmë vetëm normën. Ligji i ri do të vijë në janar e ulemi dhe debatojmë.

Unë, sot kisha bisedë me një profesor të mirënjohur tonin për të futur, në fakt, një fjalor standard të termave, të cilat do të mundësojnë që ligjet në të ardhmen të kenë vërtet një terminologji standarde. Kjo është ajo që e kemi trashëguar. Në këtë ligj nuk është prekur asgjë, përveç atyre që i thamë: norma pra prej 20 në 10% dhe termat të cilat i përmenda, nga “Banka dhe Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës”, në “Bankën Qendrore”, nga “PSSP-ja” në “Kuvend” dhe normat tatimore. Ato që janë bërë, janë bërë

para nesh. Sigurisht që ka pasur debate në atë drejtim, por ajo është gjendja. Ne tani do të fillojmë t'i përmirësojmë dhe sigurisht nuk do të arrijmë t'i përkryejmë ato. Është një fjalë shumë e mirë, më falni që po dua si ligjëratar të konsiderohet kjo: "perfektja është armiku i të mirës". Nuk është perfekte kjo, por ne konsiderojmë që kemi bërë diçka mirë për të pretenduar prefekten. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri ministër!

Tani, sipas procedurës do të përgatitemi për t'u deklaruar me votim për miratim në parim të Projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Kisha kërkuar ta di se a jeni të gjithë të furnizuar me kartela apo ka ndonjë që nuk ka kartelë dhe do të votoj;?

Në sallë janë 68 deputetë. Regjia gati. Votojmë tash:

Pa kartelë jeni "për" apo "kundër"?

Me 64 vota "për", 3 "kundër", 2 abstenime, konstatoj se Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon komisionet, siç janë:

- Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional,
- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisioni për Komunitete, dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që në afatin më të shpejtë të mundshëm, Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatim në të ardhurat individuale

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të paraqet para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI AHMET SHALA. I nderuari kryesues,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Shumë të nderuar deputetë,

Kam nderin, po ashtu, që sot para jush ta paraqes Projektligjin për tatimin në të ardhura individuale. Është në kuadër të pjesës së paketës fillestare, mund të them, të reformës fiskale. Sigurisht, ne do të flasim shumë gjatë vitit të ardhshëm për reformën në administratën tatimore. Dy faza janë që ne do të jemi të fokusuar gjatë trevjeçarit: reforma fiskale dhe reforma e administratës tatimore.

Deri më tani gjendja e normave në të hyrat individuale, dua t'ju shpjegoj këtu për opinionin, natyrisht, jo më shumë për juve, e hyrje individuale konsiderohet çdo e hyrë, pra paga që e merr punëtori dhe e hyra e bizneseve që janë të regjistrua si biznese

individuale. Mund të them se në Kosovë diku rreth 90% të bizneseve janë të regjistruara si biznese individuale, pra edhe ato biznese afektohen nga ky ndryshim.

Tani për tani, taksat në të hyrat individuale janë si vijon: prej 0 deri në 80 euro, çdo hyrje individuale taksohet me 0% ose nuk taksohet fare, prej 80 deri në 250, taksohet me 5%, prej 250 deri në 450, taksohet me 10% dhe mbi 450, taksohet me 20%.

Ne kemi marrë vendim, Qeveria, që të bëjë zvogëlimin e të hyrave individuale, përkatësisht taksimin, zvogëlimin e taksimit të të hyrave individuale për 50%, përkatësisht nga 20 në 10% të çdo të hyre individuale që arrin mbi 450 euro.

Çdo individ, qoftë ai punëtor civil, shërbyes civil ose kushdo tjetër, që ka të hyra mbi 4.50 euro, tani nuk do të taksohet me 20%, por vetëm 10% nga 1 janari, në qoftë se natyrisht ne e marrim përkrahjen e juaj.

Prej 250 deri në 450, shkojmë radhazi, do taksohen pra për diferencën, për 200 euro do të taksohen në vend të 10%, 8% dhe prej 250, po shkojmë poshtë, deri në 80, në vend të 5% do të taksohen 4%, ndërsa pjesa prej 0 deri në 80 prapë mbetet 0%.

Jemi përpjekur të jemi të balancuar, edhe pse këtu sigurisht do të ketë debate dhe jam i gatshëm të debatojmë edhe në ndonjë seancë tjetër, se keni zvogëluar për 50% pjesën mbi 450, e di se Dritoni këtë ka për ta thënë, mbi 450, dhe keni taksuar shumë më pak këto pjesët e tjera. Është shumë e vërtetë, por pjesa më e madhe e informalitetit, përkatësisht e përpjekjeve ose e paraqitjes jo të sinqertë, mos të them të mashtrimeve, të raportimeve financiare, është në atë pjesë. Shkoni, pyetni bizneset private në Kosovë, qofshin ato individuale, qofshin korporata, 90% prej tyre do të dalë rroga mesatare në Kosovë është shumë e ulët, sepse në raportimet financiare jepen shifra shumë të ulëta për t'i ikur 20%.

Ne konsiderojmë se me këtë do të luftohet goxha mirë informaliteti, sepse askush nuk do të rrezikojë që të mos e paraqet punëtorin të regjistruar për një taksë prej 6 -7% në mesatare, që i bie 5,2%. Unë e kam llogaritur diku për mesataren prej 200 e diçka eurove, për të paguar një punëtor i bie diku 5%, përkatësisht i paguan ai 10 euro më shumë nga rroga që ka, nga 250 euro eventualisht dhe për ato 10 euro nuk do të rrezikojë që nesër inspeksioni të shkojë dhe ta dënojë me shumë dënime të larta që janë paraparë edhe me ligjet që pasojnë.

Kështu që, këtë që e thashë më herët, Kosova me këtë... dhe në një konferencë që isha në Londër para nja 10 ditësh, kur i kam shpjeguar se mesatarisht, për rrogën mesatare në Kosovë ju do të paguani jo më shumë se diku 6,2 deri në 7,2% të pagës, përkatësisht të hyrjes individuale, reagimi ishte shumë i shpejtë: "lets go to business here"?! Në Angli, edhe pse TVSH-ja është zvogëluar, taksat mbi të ardhurat janë shumë të larta, në Danimarkë, Gjermani e tjera. Në regjion janë prapë shumë më të larta se sa këtu që i kemi ne në Kosovë.

Me këtë konsideroj që mundësohet, nën një, që të gjitha shtresat me këtë qasje do të kenë një përfitim, e thashë dhe e shpjegova, nuk dua ta përsëris ..., nëse mund të them, ata që marrin para pak më shumë, janë, por ajo është për ta luftuar informalitetin, ndërsa në aspektin e sjelljes së Kosovës në pasqyrën, në hartën e vendeve në regjion, Kosova me këtë vendim vjen në vendin me ngarkesë ose me barrë fiskale më të ulët në regjion. Andaj, besoj që ju do t'i kuptoni këto shumë seriozisht dhe besoj se do ta

përkrahni. Unë, do t'ua jap disa nga të dhënat teknike, thjeshtë, për hir të opinionit dhe për hir të shënimmbajtjes.

Ndryshimet në norma tatimore janë bërë në nenin 5, në nenin 18, në nenin 19, në nenin 20 të Rregullores 2004/52, të cilat besoj që me përkrahjen e juaj do të hyjnë në fuqi më 1 janar. Ju ftoj që ta përkrahni këtë, është në kuadër të një pakete dhe si mozaik mund të ketë efektet e veta të balancuara. Në qoftë se ndryshe veprohet, sigurisht që do të ketë edhe deformime ose asimetri jo të rregullta. Ju faleminderit shumë dhe jam i gatshëm për të debatuar. Ju faleminderit!

KRYESUSI: Ju faleminderit, zoti Shala!

Tani e hapim debatin për diskutim, në parim. Sipas renditjes, kryetarët e komisioneve, në fillim kryetari i Komisionit për Buxhet ose në emër të Komisionit për Buxhet, kush do të flasë? Zoti Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ajo që fola për ligjin paraprak, vlen edhe për këtë ligj dhe për dy ligjet e tjera. Po flas në emër të Komisionit për Buxhet dhe, po ashtu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Në emër të komisioneve të përhershme, e ka kërkuar dikush fjalën? Jo! Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit parlamentar të PDK-së, deputetja Selviqe Halimi e ka fjalën.

SELVIQE HALIMI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin në të ardhura individuale dhe e përkrah në parim këtë projektligj, kurse plotësimet dhe korrigjimet eventuale do t'i japë në procesin e amendamentimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, foli zoti Shatri.

Në emër të Grupit parlamentar të AKR-së, zoti Gashi.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje të nderuar,

Zoti zëvendëskryeministër, ministra, kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i AKR-së në njëfarë mënyre e ka edhe të paqartë kur thuhet se këto 4 ligje kanë një koherencë, janë një pako dhe në njëfarë mënyre e komplementojnë njëri - tjetrin. Ndonjëherë nuk po mundemi ta kuptojmë këtë logjikë dhe nuk po na funksionon sa duhet. Mendojmë që, Ligji të cilin tash po e diskutojmë, mbi tatimin në të ardhurat individuale ose personale, na duket se ka një inkoherencë me ligjet e tjera dhe, mbi të gjitha, ka një implikim në atë që quhet mbushje e arkës ose e buxhetit të Kosovës.

Mendojmë se dëmtohet pikërisht këtu, do me thënë të hyrat buxhetore dëmtohen nga kategoria që duhet të jetë e tatuar në një shkallë më të lartë, mendohet te pagat më të larta personale, ku Qeveria ka shkuar në zbritjen e tyre dhe arsyetimin nuk e ka shumë të qëndrueshëm kur thotë se me këtë iket, do me thënë i iket shmangies nga pagimi i këtyre, nëse janë të larta. Unë mendoj se duhet të rritet eficienca me mekanizmat tjerë

për mbledhjen e taksës dhe jo duke ulur taksën të stimulojmë ata që të mos e shmangin pagimin e kësaj takse. Pajtohem me ulje që është, që është bërë për pagat më të ulëta, po ajo ulja është shumë pak e ndjeshme dhe aty janë në fakt tatimpaguesit më të shumtë në numër në të ardhura, është 90% i tatimpaguesve, do me thënë në të ardhura nga të punësuarit në Kosovë dhe tash fitohet përshtypja se favorizohet kategoria, favorizohet 10 përqindëshi, ku indirekt në opinion do të interpretohet se jemi edhe ne aty dhe në njëfarë mënyre nuk tingëllon mirë kjo, e para. Dhe, mbi të gjitha, ne si subjekt politik në programin, në pjesën e programit tonë ekonomik në njëfarë mënyre nuk korrespondon me planifikimet tona programore, pikërisht ulja e tatimeve në të ardhurat e kategorive që kanë paga më të larta, të cilët kishin për të qenë në njëfarë mënyre kontribuuesit më të mëdhenj të buxhetit dhe unë nuk mendoj se kjo kategori është shumë që do të krijojë destimulim për investitorët, sepse në njëfarë mënyre ata që investojnë në biznes të vogël ose të mesëm, sigurisht se nuk do të shkojnë menjëherë për të paguar ose do të kenë numër të vogël të të punësuarve që do të kenë paga të larta personale. Kjo më shumë iu referohet kategorive që janë aktualisht të punësuar në Kosovë dhe që paguhet nga buxheti i Kosovës. Prandaj, në parim, nuk mund ta mbështesim kështu si është, pikërisht për këto arsye që sapo i thashë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendësministra, ministra dhe kolegë deputetë,
Tatimi mbi të ardhurat individuale deri me tani ka qenë i rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2004/52 dhe ministri mjaft qartë e sqaroi se janë bërë disa ndryshime, kryesisht në uljen e normës dhe diçka tjetër nuk ka në nenin 5, 18, 19 dhe 20 dhe me këtë politikë fiskale, me të gjitha këto tentohet që të sigurohet procesi i formulimit të tatimeve dhe të shpenzimeve publike dhe qëllimi i kësaj politike është të mënjanojnë ngritjet dhe rëniet e cikleve të biznesit si pako. Mirëpo, Qeveria i ka politikat e veta dhe shpresojmë se do të jenë të suksesshme

Prandaj, ne si grup e përkrahim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional dhe në komisionet kryesore ku do të kalojë ky Projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, zoti Berim Ramosaj ose deputetja Synavere Rysha. Regjia, deputetja Rysha e ka fjalën.

SYNAVERE RYSHA. Ju faleminderit, zoti kryesues!

Nga Projektligji të cilin na e ka ofruar Qeveria, apo edhe në përgjithësi edhe pakojat fiskale, të cilën na e ka ofruar Qeveria, shihet qartë se Qeveria ka bërë dy ndarje apo ka bërë një ndarje të qytetarëve apo të shtresave, një në shtresën e lartë dhe shtresën e ulët.

Nëse i analizojmë dhe i shohim qartë tendencat e Qeverisë, shihet se këtu hapur është përkrahur shtresa më e lartë apo të pasurit. Janë kategoria që më së shumti janë favorizuar në taksa. Duke filluar nga tatimi i mbi vlerën e shtuar, e cila iu destinohet apo është pjesë të cilën e paguajnë vetëm qytetarët dhe nuk ndikon fare në biznese, nuk ndikon fare në politikën e shtetit apo në tërheqjen e investimeve, mirëpo është një taksë e drejtpërdrejtë që e paguan qytetari dhe Qeveria nuk ka menduar fare për atë shtresë, mirëpo i ka interesuar ndoshta vetëm të bëjë një harmonizim të ligjeve me ligjet e Bashkësisë Evropiane pa e vlerësuar mirë standardin e qytetarëve të Kosovës.

Thuhet se rritet TVSH-ja nga 15 në 16%. Vërtet është një përqindje shumë e ulët, mirëpo si do të reflektohet kjo në buxhetin e qytetarëve të cilët jetojnë me 75 euro apo edhe të cilët kanë të ardhura të ulëta. Prandaj, këtu shihet se në këtë aspekt janë dëmtuar qytetarët e Kosovës me tatime, me rritjen e taksës në tatimin mbi vlerën e shtuar.

Sa i përket Ligjit për të ardhurat individuale, prapëseprapë edhe këtu shihet që ka një favorizim të shtresës së lartë, do me thënë të atyre që marrin të ardhura të larta, sepse aty është shkuar diku me një ulje të normës së tatimit diku në 50%, ndërsa të paguesit e të ardhurave apo përfituesit e të ardhurave më të ulëta minimale, aty është shkuar me një taksë, me një zbritje të taksës diku 10%. Ne shohim një përpjekje të Qeverisë për të bërë diçka, por në fakt i ka favorizuar, edhe njëherë po e them, e ka favorizuar shtresën e lartë, mirëpo e ka nënçmuar apo diskriminuar shtresën e ulët apo pjesën më të madhe të qytetarëve të Kosovës.

Duke i parë kështu në këtë rrafsh, Lidhja Demokratike e Dardanisë nuk mund t'i mbështetë këto taksa, mirëpo duke e pasur parasysh se është leximi i parë, mendojmë se do të kemi mundësi ta japim kontributin tonë në komisionet funksionale dhe do të ketë një ndryshim, gjithëherë duke i pasur parasysh qytetarët e Republikës së Kosovës apo shtresën më të ulët. Prandaj, ky do të jetë afërsisht orientimi ynë. Kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ju kisha lutur që të diskutoni për ligjet që po e miratojmë sot, e jo për ato që i kemi miratuar dje.

Në emër të Grupit parlamentar “7+!, Myfera Shinik.

MYFERA SHINIK Teşekkür ederim!

Sayın başkan vekili, bakanlar ve milletvekilleri,

Kişisel gelirler vergisi Yasa Tasarısı, Bütçe ve Finansi Komisyonunda görüşülmüştür. Birinci okunuşunu 7+ Parlamenter Grubu olarak kabul ediyoruz, eklenmesi gerekenleri de funksional komisyona sunarak katkımızı sunacağız.

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, fjalën e ka deputetja Nikoliq.

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući,

Pozdrav Vladinom kabinetu i svim kolegama poslanicima,

Poslanička grupa SLS je razmatrala Nacrt zakona o porezu na lični dohodak i konstatovala da možda ima nekih malih tehničkih izmena u prevodjenju reči koje sasvim drugo imaju značenje na srpskom jeziku, tako da čemo svoj doprinos dati na Kojisiji za budžet i financije. U načelu podržavamo.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Tani sipas renditjes, deputetët e paraqitur, në fillim është Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë, publikisht po kërkoj falje që u futa në debat me ministrin, se nuk ia vlen, sinqerisht nuk ia vlen me këtë çka tha tash. Unë, veç nuk po e shoh ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë për t'i treguar se çfarë njerëzish ligjërojnë në Universitet.

Singerisht, duhet shumica prej aty të pushohen, në mënyrë që mos t'i marrin në qafë fëmijët tanë...

KRYESUESI: Ju lutem, të futeni në temë ose t'i ndërpritni ofendimet, zoti deputet!

DRITON TALI:... politika fiskale..., po unë e kam parasysh, jo unë e kam parasysh se shumicës këtu nuk i lë përshtypje ajo që u tha këtu, por për njerëzit e profesionit është shumë me rëndësi, andaj edhe nuk po ua marrë për të madhe juve të tjerëve që po ankoheni, por sidoqoftë po kthehem te Ligji.

Shikoni, çka ka ofruar Qeveria? Ka ofruar uljen e tatimit në të ardhura. Po nisemi nga ajo që të ardhurat tatimore mesatare në Kosovë janë 150 euro, ndonëse është 120 euro. Për 150 euro, sipas kësaj pakete, qytetari i Kosovës, i punësuar, është më mirë apo do t'i kursej 70 centë, kurse sipas djeshit, edhe pse u ngatërrua këtu, por nuk desha të futem me ata të cilët nuk janë ekonomistë, për efektin e tatimeve indirekte në buxhet, nga se në buxhetin e njerëzve e ka efektin e shumëzuesit, të multiplikatorit, e jo të drejtpërdrejtë. Por, sidoqoftë, po e marrin edhe drejtpërdrejtë, pra lirohet nga TVSH-ja, do me thënë, i ngarkohet nga TVSH-ja në të ardhurat e 150 eurove 1.50 centë, do me thënë, qytetari me të ardhura të ulëta është më keq për 80 centë. Po e marr gjithmonë duke pasur parasysh efektin direkt, ndonëse efekti nuk është direkt, por është me atë efektin e shumëzuesit që nuk kam këtu kujt t'ia shpjegoj, se u pa me performancë se çka tha, por sidoqoftë, edhe për deputetët e nderuar ta shpjegoj një send, se tatimi për ekonomistët, politika fiskale është vegël, është instrument me anë të së cilës Qeveria merr atje ku ka, për të financuar atje ku nuk ka, do me thënë bën redistribuimin e pasurisë.

Me këtë politikë fiskale të ofruar, ju e keni deformuar kuptimin filozofik. Ju jeni duke marrë atje ku s'ka, për t'ju dhënë atyre që kanë.

Personat me të hyra që kanë mbi 700 euro, po e marr këtë pragun që shumica të punësuarve me të ardhura të larta e kanë, do të kursejnë 40% me këtë tatim. Unë e kam parasysh se, nëse Zoti nuk kujdeset për fukaranë, Qeveria ka edhe më pak faj aty, por megjithatë, me këtë politikë fiskale e keni dëmtuar seriozisht qytetarin, por në mënyrë indirekte edhe korporatave nuk jeni kah iu ndihmoni për shkak se jeni kah e dëmtoni fuqinë blerëse.

Në këto kushte, çfarë jemi ne, është dashur që të ulen, edhe ashtu 250 milionë nuk keni ditur t'i shfrytëzoni, këto 250 milionë t'i leni si fuqi blerëse, mos të merren nga qarkullimi i të ardhurave kombëtare. Ky është trend çdo kund në kriza ekonomike. Po them, këtë depresionin tonë që nuk e njeh ekonomia, unë po e përsëris, që në krizën e madhe ekonomike që kanë qenë në vitet e 30-ta, në SHBA si më e prekura, edhe Gjermania, nuk e ka kaluar papunësia normën më shumë se 30%. Në realitet, në Gjermani ka qenë 31%. Në Kosovë e kemi 45%, do me thënë, këso krize çfarë e kemi ne, këtë mjerim nuk e njeh historia dhe, Qeveria, në vend se ta stimulojë konsumuesin, i cili në mënyrë direkte pastaj do t'i stimulonte ndërmarrjet duke i konsumuar produktet e tyre, e bën të kundërtën i destimulon ndërmarrjet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Sipas radhës, deputetja Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala ljepa!

I ja smatram da treba danas isto da dam svoj doprinos kada je u pitanju Nacrt zakona o oporezivanju na ime ličnog dohotka. Čuli smo gospodina ministra, prezentaciju zakona, čuli smo kolege poslanike i grupe.

Hoću jedno da kažem. Sa ovim zakonom, saglasna sam kada se radi o Nacrtu zakona i podržavam Nacrt zakona ali sa jednom primedbom. Ovaj Nacrt zakona isto pogadja gradjanina, a oslobadja jednu dobru kategoriju koja za sada ima veća primanja od 450, neću da ponavljam skalu, pošto smo je čuli od gospodina ministra. Ja smatram da ova kategorija u kojoj pripadamo i mi sami, treba da ostane oporezivana i dalje sa 20%. Zašto? Zato što će neko, kao što smo čuli kolegu, da zaradi sa ovim pojevtinjenjem 70 centi, a mi ćemo da zaradimo 20% na naših 800 evra i to je 80 evra. Znači, deset, ne deset nego sto puta više. Ova fiskalna politika smatram da nije pozitivna, nije pozitivna iz jednog ugla zato što kada se radi fiskalna politika i reforma u poreskoj upravi..., čini mi se da nemam sada minutažu i ne treba da žurim. I kada se radi reformi u poreskoj upravi, treba da se vidi koja je kategorija ugrožena i koja kategorija treba da bude malo potpomognuta od poreskog sistema.

Hoću još jedno da napomenem. Nama je ministar ovde rekao doslovce da su se u Engleskoj čudili zašto mi imamo takvu poresku politiku, pa ja ću da kažem kada je u pitanju ovaj zakon, da Kosovo ima samo 1100 dolara bruto lični dohodak, a to vidimo iz svih evropskih istraživanja i statistike koju radi Evropska zajednica, i kada to podelimo na 12 meseci – 98 dolara, čak nije ni 98 evra – ima po glavi stanovnika, po glavi zaposlenog, molim vas! A, dok zemlje u regiji imaju bruto lični dohodak od 3.600 do 4.500 evra, što znači najmanje od 5 do 10 puta više od našeg bruto ličnog dohotka. A, mi nismo Englezi, mi znamo i ne možemo da gledamo šta Englezi primaju, i kada bi gledali šta Englezi – Evropska unija, koje bruto lične dohotke imaju, to je od 12.000 do 36.000 evra. Molim vas, mi moramo da vidimo ko i s kim smo u regiji, kako su oni postigli da zadrže taj nivo bruto ličnog dohotka, da se trudimo da mi barem trčimo za komšijama. Hvala ljepa!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Nuk e pata ndërmend fare të diskutoj, por ajo që dëgjova këtu në Parlament, m'u desh patjetër t'i ngrejë disa çështje.

Së pari, ka qenë mirë që këto projektligje po i kuptojmë, janë të pakos dhe ka qenë dashur ndoshta në pako. Të gjithë e kuptojmë se këto projektligje janë në fuqi nga viti 2004. Janë rregullore, nuk di a kanë pasur mundësi t'i shohin të tjerët, por janë rregullore të cilat i kemi aplikuar deri më tani dhe së paku duhet të respektojmë këto ndryshime që kanë ardhur në normë, të cilat, konsideroj se nuk e bëjnë jetën më të rëndë as të qytetarëve, as të punonjësve, por e lehtësojnë.

Në anën tjetër, konsideroj se nuk duhet të keqpërdoret vendi ku e kemi këtu. Dikujt po i duket se po flet dhe po e arsyeton ndoshta atë diturinë, por në të vërtetë, nuk është ashtu. Nëse për opinion dikush po flet se është duke i mbrojtur qytetarët Kosovës, nuk është në rregull, sepse nuk jemi duke folur për qytetarët e Kosovës. Nuk jemi duke folur për njerëzit e varfër. Këtu jemi duke folur në këtë projektligj për njerëzit të cilët janë të punësuar. Nuk jemi duke folur për asnjë kategori dhe për asnjë shtresë të njerëzve. Dhe, nëse dikush mendon që nëse është ulur tatimi në të ardhura për pagat, të cilat janë më të larta se 500 euro, po bën klasifikim, për mua nuk e njeh dhe nuk e di mirë situatën. Nuk

janë 100 mijë në Kosovë që kanë paga të larta. Duhet të kuptohet. Është një numër shumë i vogël. Nëse flitni për institucionet, janë diku 300 apo 400 veta, të mos them ndoshta edhe 500. Dhe, është një ndryshim i madh me numrin e përgjithshëm që janë mbi 100.000 apo 200.000 të tjerë që marrin paga në shumën tjetër që u fol deri në 250 euro. Prandaj, nuk është pak respekt nëse ulet 50% apo 1%, 2%, 3%. Duhet ta respektojmë.

Çështja tjetër, me interes. Po flitet këtu se ndoshta nuk po i ndihmojmë tash me këtë ulje varfërisë. Në varfërisë s'po i ndihmojmë fare. Dhe, për opinion është mirë të kuptojnë drejt, nuk jemi duke folur për njerëz të varfër, sepse njerëzit e varfër duhet t'i punësojmë, duhet të krijojmë vende të lira të punës dhe me këtë ligj nuk mund t'i punësojmë, as t'iu krijojmë vende të lira të punës dhe nuk mund t'ua rregullojmë pozicionin aktual që e kanë.

Ky projektligj po flet për një ulje të tatimit në të ardhura, që duhet respektuar. Nëse është ulur edhe për 5 euro për një punonjës të shërbimit civil, duhet respektuar dhe konsideroj se është bërë mirë.

Prandaj, ju kisha lutur, është mirë që ndoshta të mos e ofendojmë askënd, i dimë vlerat e gjithsecilit dhe është mirë të flasim së paku për ligjet. Nëse duhet atakuar ligjin, e keni mundësinë, sepse këto janë rregullore prej nenit të parë dhe deri në nenin e fundit të gjenden plotësime e ndryshime. Janë rregullore të cilat nuk na kanë penguar për 4 vite. I kemi mbajtur në supet tona, kurse sot, kur po dëshirojmë të bëjmë diçka në të mirë dhe në interes, po na pengojnë dhe po del se jemi tash duke punuar kundër qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe lidhur me këtë projektligj unë jam për atë që të miratohet në parim dhe të shkojë në diskutim të mëtjeshëm në kuadër të komisioneve.

Me siguri, Ministria e Financave, propozimet që i ka bërë lidhur me ndryshimet në politikat fiskale, nuk i ka bërë pa analiza dhe konsultime me institucionet relevante.

Mirëpo, gjatë leximit të parë të këtyre projektligjeve, mund të bëhen korrigjime dhe plotësime, të cilat do të mundësojnë që të kemi ligje që do t'i kontribuojnë zhvillimit dhe prosperitetit më të madh të vendit tonë.

Ndryshimet e propozuara në normat e tatimit në të ardhurat invididuale, mendoj se janë të arsyeshme nga dy aspekte. Në radhë të parë, për shkak të plotësimit të buxhetit, domethënë që parashihet për shkak të uljes së normave të tatimit në të ardhurat e korporatave dhe, në anën tjetër, edhe për shkak të kostos së lartë të jetës së qytetarëve apo të standardit të ulët jetësor të qytetarëve në vendin tonë.

Ulja e normave të tatimeve në të ardhurat personale të propozuara prej 5 në 4%, prej 10 në 8% dhe prej 20 në 10% mendoj se ka mundësi të korrigjohen. Arsyeja është se ulja më e vogël e normave të tatimit propozohet për shtresat e njerëzve të cilët kanë të ardhura më të ulëta, kurse ulja më e madhe propozohet për shtresat me të ardhura më të larta.

Edhe pse dëgjuam arsyetimin nga ministri, megjithatë unë e kam një propozim konkret. Propozimi im është që ulja e tatimit të bëhet për shtresat të cilat kanë të ardhura më të

ulëta dhe të korrigojohet me një pjesë të rritjes së normave tatimore për ata që kanë të ardhura më të larta. Konkretisht, propozoj që të bëhet ulja e tatimit për të ardhurat individuale prej 5 në 3%, prej 10 në 7% dhe prej 20 në 14% në mënyrë që të përfitojnë ata që kanë të ardhura më të ulëta.

Edhe ky projektligj, natyrisht, lidhet me Projektligjin për TVSH-në dhe me këtë rast dua të cek se humbjet që do t'iu shkaktohen shtresave të qytetarëve të cilët me rritjen e TVSH-ës për 1% do të kenë humbje, mendoj se ulja e normave tatimore në të ardhurat individuale do të kompensohet nëse atyre iu ulen tatimet prej 5 në 3%. Mirëpo, rritja e TVSH-së, megjithatë, do të godasë edhe shtresën tjetër, të ardhurat e të cilëve nuk tatimoren fare. Prandaj, mendoj se Qeveria duhet të gjejë mënyrën ose instrumentin që edhe kësaj shtrese t'ua kompensojë humbjen që u shkaktohet nga rritja e TVSH-së për 1%. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Smaka.

RIZA SMAKA: Respekt, zotëri kryesues!

Zotëri zëvendëskryeministër, ministra dhe deputetë të nderuar, Fillimisht do të isha angazhuar që titulli të meditohej tani, por në etapat e mëtejme të riformulohet dhe të jetë jo të “ardhurat individuale”, por “personale”, madje – madje të meditojmë edhe për termin “paga”. Është shprehje shumë e lezetshme dhe e përdorshme.

Gjuhësisht medoemos duhet të bëhet një harmonizim i të tri gjuhëve. Ka diskrepanca në terma që e ndryshojnë edhe kuptimin. Bie fjala, në serbisht-boshnjakisht në vend që të thuhet “radnik” thuhet “sluzhbenik”, kurse duhet “radnik”, sepse është atje “poslodavac”, e kështu me radhë.

Te neni 22, paragrafi 2. Parimisht do të isha angazhuar, në parim që të rishikohet politika e kuotës së qirasë 10%, aq më parë kur ne e dimë sot në Kosovë se ka shumë qiradhënës që marrin renta shumë të larta enorme. Në asnjë shtet të Evropës perëndimore nuk do të kishim mund t'i marrin ato të ardhura, aq më parë kur një numër i madh i objekteve janë ilegale, të ndërtuara në mënyrë informale, madje-madje ka ministri tona që janë të vendosura në objekte të tilla. Prandaj, këtu do të duhej të rishikohej kjo dispozitë ose të plotësohej me një dispozitë a paragraf tjetër që do t'u referohej, si të them, këtyre kategorive.

Duhet medoemos të riformulohet preambula, neni 28 dhe 29.

Dhe, më lejoni t'i them dy-tri fjalë për hir të korrektësisë së Kuvendit të Kosovës, të autoritetit që ka dhe konkretisht për ministrin Shala.

Unë ju them me kompetencë se jemi kolegë në një fakultet. Aty është edhe profesori Ramosaj, profesoresha Pantina dhe ministrja Pula. Unë jam i bindur se edhe opinionin e tyre e manifestoj me këtë rast. Mendimet dhe vlerësimet më të mira i kemi dhe madje unë them edhe në këtë rrethanë, kam qenë më parë prodekan për mësim dhe për shkencë, që e kam përcjellë angazhimin, punën dhe efektet e stafit pedagogjik, pastaj...

KRYESUESI: Ju lus, t'i përmbaheni temës. Nuk je avokat i askujt dhe përmbaju vetëm temës.

RIZA SMAKA: Ju lutem! E përfundova. Edhe anketimet e studentëve, vlerësimet më të larta ishin, janë dhe mendoj...

KRYESUESI: Ju lutem, nëse s'doni t'ua ndal fjalën, përmbajuni dhe futuni në temë. Të lutem, mos, mos se s'po duam ta bëjmë tash Pazar.

RIZA SMAKA: Të mos bëjmë ofendime. Jam kundër ofendimeve dhe jam për gjuhë parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,
Të nderuar ministra, zëvendëskryeministër,
Unë nuk do të flas për Projektligjin, do të flas për diçka tjetër që, besoj, i ka cenuar seriozisht të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës. Unë jam shumë i privilegjuar, kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që gjendem me shumë njerëz të mençur në Parlament, por nuk lejoj askush të më fyej dhe ta fyej Parlamentin e Kosovës. Andaj, të lus, kryesues dhe të gjithë kryesuesit e tjerë të seancave që, kur tejkalohet kodeksi elementar i Rregullores së Punës dhe kur fyhet deputeti, absolutisht t'i merret fjala! Unë, të paktën gjë që do ta bëj, është se kur ta marrë fjalën deputeti i caktuar, unë nuk do të jem në seancë. Por, ju lutem, ju lus singërisht në emër të të gjithë Grupit Parlamentar, por edhe më shumë, që unë nuk lejoj të fyhem, as të fyhet institucioni në të cilin gjendem unë. Unë po them, përsëri, kam privilegj që jam me njerëz të mençur këtu, por megjithatë, as prej njeriut më të mençur të mundshëm në botë nuk lejoj të fyhem!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk është punë e imja t'ia marr fjalën askujt. Ky është Parlament dhe dihen rregullat çka mund të flasë deputeti. Ju mund ta kundërshtoni fjalën e tij, cili të doni, dhe nuk kam nevojë unë të përlohem me askënd për shkak të fjalës..., nuk jam avokat i askujt, Ramë. Më fal! Fjalën e ka deputeti Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Përshëndetje për Qeverinë e vendit,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Unë edhe dje debatova lidhur me paketën e projektligjeve që nuk mund t'i ndajmë njërin prej tjetrit, edhe pse rendi i ditës i shqyrton një nga një, por po ritheksoj se unë përkrah iniciativën e ndryshimeve në politikën fiskale që ka ofruar Qeveria, sepse është vlerësim i drejtë dhe është politikë e drejtë mbi çështjet e tatimit që ndikojnë shumë në jetën ekonomike edhe të qytetarëve. Por, meqenëse jemi duke bërë debatin parlamentar, unë kujtoj se deri në leximin e dytë, nëse ka kuptim debati, e me siguri se ka, atëherë do të shtroj këtu për debat edhe çështjet që, në parim, ndoshta nuk pajtohemi lidhur me disa dallime, siç e thashë edhe dje, dhe rezervat që i kemi tek disa indeksa që kanë ndryshuar, a ka mundësi që ata tani të shqyrtohen deri në leximin e dytë përmes Komisionit për Buxhet, përmes Ministrisë, të cilat unë do t'i ndajë në këto grupe.

Mendoj se zbritja e tatimit prej 50% tek pjesa e të ardhurave mbi 450 euro është shumë. Prandaj, ngjashëm kisha thënë edhe për çështjen që e kaluam pak më herët, sepse ka mundësi ndoshta të shikohet mundësia që 10 deri 15% edhe te korporatat të ngrihet për mallrat luksoze te ligji që do të vijë në shqyrtim për akcizat dhe të mos ketë ndryshime atje ku edhe më herët u dhanë vërejtje të mëdha. Nëse ka mundësi të bëhet, të them, ky ribalans gjatë shqyrtimit dhe të shihet tamam në paket ai kompensim që duhet të kemi te të hyrat buxhetore, atëherë është një mund më i madh për Komisionin për Buxhet, për

Ministrinë, por unë personalisht vlerësoj se është më e mirë, më e dobishme dhe më e drejtë. Prandaj, thirrja ime, si deputet, është që të mundohemi në kuadër të këtyre varianteve të propozuara për ndryshime, që po them se ndryshime duhet të ketë dhe jam për ato, i kam votuar dhe do t'i votoj sërish, por mendoj se është mirë të mundohemi bashkërisht dhe të gjejmë modalitetin edhe më të përshtatshëm që do të jetë në pajtim me këto sugjerime, vërejtje dhe debate që po shtrohen nga ana e Parlamentit. Pra, të mos e cenojmë ose të mos ndikojmë shumë me këto tatime te ato shtresa të cilat, realisht, do të ndihet më tepër kjo, ndërsa të provojmë të pjesa tjetër ta analizojmë dhe ndryshojmë atë koeficient që është propozuar. Pra, siç thashë, tek korporatat, tek të hyrat ku janë më të mëdha dhe tek akcizat të kemi në shqyrtim dhe të ketë mundësi atje të rritjes ashtu që të mos kemi ngritjen e TVSH-së edhe tek këto pjesët e tjera. Prandaj, e përkrah në parim, por besoj se do të përpiqemi deri në leximin e dytë t'i korrigjojmë këto gjëra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën, i fundit, deputeti Buçinca.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes të gjithë të pranishmëve,

Nuk e pata ndërmend të flas, mirëpo sinqerisht u preka shumë nga një diskutim këtu që ndodhi në Parlament. Edhe unë ndihem i fyer dhe i bashkëngjitem kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, i cili bëri një vërejtje dhe sugjerim që të ruhet niveli intelektual i debatit politik në Kuvendin e Kosovës.

Unë nuk përjashtoj mundësinë që njerëzit të kenë komplekse të ndryshme dhe nuk përjashtoj mundësinë që të shfrytëzohet Parlamenti për fushatë elektorale. Ajo është krejt e logjikshme. Mirëpo, mendoj se edhe fushata edhe propaganda duhet të bëhet me një etikë të debatit intelektual dhe parlamentar, me një gjuhë të përshtatshme për këso rastesh.

Tani do t'i kthehem ligjit, të cilin po e diskutojmë. Këtu, ma merr mendja se nga të gjithë ata që diskutuan, po harrohet një fakt se ligji që po e diskutojmë, i zbrit taksat për të gjitha kategoritë sociale në Kosovë dhe më së paku ky ligj e vështirëson ose e përkeqëson gjendjen financiare të individit. Pse nuk thuhet këtu, kur është vendosur taksa 20% për pagat më të larta në Kosovë, ka qenë taksa e tepërt. Ky ligj i përfshin të gjitha kategoritë, të gjithë përfitojnë nga ky ligj dhe kështu duhet të thuhet dhe kështu duhet të interpretohet dhe të mos shfrytëzohet ligji për nevoja personale, për fushatë dhe për qëllime elektorale. Problemi i varfërisë, problemi i papunësisë nuk zgjidhet nëpërmes subvencioneve, donacioneve, duke shpërndarë para. Ne duhet të vetëdijesohemi të gjithë në këtë Parlament dhe të gjithë qytetarët e Kosovës se vetëm duke investuar në Kosovë, duke investuar në ekonomi, hapim vende të reja pune. Vetëm përmes punës njeriu mund të zbusë varfërinë e vet. Nuk ka ligje të tjera. Ligjet e vetme janë ato që njeriu duhet të punojë dhe të sigurojë të ardhura për vetveten. Papunësia në Kosovë nuk mund të zbutet pa investime, pa thithjen e investimeve serioze, pa ardhjen e kapitalit në Kosovë, pa stimulimin e investimeve edhe të atyre që fitojnë në Kosovë. Nëse ne e ulim taksën për ata që kanë më shumë fitime në Kosovë, sigurisht se do të stimulojmë konsumin dhe njëkohësisht do t'i ruajmë vendet e punës, sepse ka rrezik që edhe vendet e punës të mbyllën në Kosovë, edhe ato që ekzistojnë. Ne do të stimulojmë përmes këtyre politikave fiskale financimet, të hapim tregun e kapitalit në Kosovë dhe njëkohësisht të bëjmë përpjekje t'i ruajmë vendet e punës, të cilat janë këtu, dhe t'i shtojmë investimet nga ata të cilët në këto çaste për momentin fitojnë në shumë se ata që nuk fitojnë. Në këtë pikëpamje, dëshiroj që të përkrahet ligji dhe të mos shfrytëzohet çdo rast, çdo vend e pa

vend, të flitet dhe të bëhet propagandë elektorale në Parlamentin e Kosovës. Unë ju ftoj të përkrahim ligjin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, kryesues!

Prapë nuk do të lëshohem në debatet e nivelit që s'i takon as këtij podiumi, as etikës së komunikimit intelektual, as njerëzor. Unë, natyrisht, e falënderoj profesorin Riza Smaka për vlerësimet. I vlerësoj shumë lartë mbështetjet dhe komentimet, që konsideroj se janë shumica profesionale për këtë ligj. Ky ligj mundëson që të gjitha shtresat të kenë taksa prej 50% deri në 20% më pak. Këto kanë qenë taksat në fuqi që deri tani qytetarët e Kosovës, të punësuarit e Kosovës i kanë paguar. I tregova arsytet pse kemi shkruar me norma të ndryshme. Pra, në qoftë se zërat do të duhej të ngriheshin për ulje taksash është dashur edhe më herët, edhe kur janë vendosur ato, edhe para vendosjes. Pra, duhet t'ua shpjegoj të gjithë atyre që s'e kuptojnë se qytetarëve të Kosovës me këtë vendim, atyre që janë të punësuar, iu mundësohet që të zbritet për 50% taksa në të hyrat mbi 450 euro dhe 20% në taksat tjera që kanë paguar deri më tani. Përmes kësaj, e thashë, do të luftohet informaliteti, përmes kësaj do të mundësohet që qytetari i Kosovës, në fakt, nga 1 janar secili nga ju dhe secili që është i punësuar në sektorin privat apo shoqëror, do të marrë më shumë të ardhura, sepse do të paguajë më pak taksë. Për atë që sa zvogëlohet taksa, sigurisht dhe besoj se tregu nuk do të reagojë ndryshe, do të jetë taksa në muajin e parë më e ulët dhe ju do të merrni në zarfin për atë që sa zvogëlohet përqindja, do të merrni rrogë më të madhe. Kjo është një.

Dy, përmes kësaj do të mundësohet që Kosova të jetë në listën e fundit, faktikisht, ose nëse mund të them në aspektin progresiv, numër një në Ballkan, në regjion për barrën e taksave më të ulëta në të hyrat individuale dhe kjo do të mundësojë sigurisht kursim më të madh për korporatat për të paguar dhe për njerëzit për të marrë dhe hapjen më të madhe të vendeve të punës. Filozofia e ndihmës, pa zhvillim ekonomik, është filozofi e dështuar. Ne po mundohemi dhe e kemi promouguar edhe në programin tonë, edhe në Konferencën e Donatorëve, që bosht kryesor i luftës kundër varfërisë do të jetë zhvillimi ekonomik. Konsideroj se kjo paketë, sadopak do të mundësojë një lëvizje përpara dhe një lehtësim më shumë për taksapaguesit, nëse mund të them, në një anë, dhe atyre të rregullt, natyrisht se do ta ngrisin edhe pasqyrën më të mirë bilancore. Faleminderit për përkrahjen. Natyrisht, i kuptoj emocionet e njerëzve për kuptime të ndryshme. Tek e fundit, është mendim i lirë ai, por fyerja nuk është në etikën e askujt. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër Shala!

Në sallë janë 68 deputetë dhe është koha për votimin e ligjit, në parim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota "për" – 1 pa kartelë, 4 "kundër" dhe 6 "abstenime", miratohet Projektligji për tatim në të ardhurat individuale.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që në afatin më të shpejt të mundshëm, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Kam edhe një lutje, në emër të ministrit, meqenëse ka një obligim zyrtar, që pikën e shtatë të rendit të ditës ta shtyjme për fund të seancës për këtë arsye dhe mendoj për të mos e arsyetuar deri në fund, ne kemi konstatuar se arsyetimi është me vend, sepse ai domosdo duhet të shkojë, prandaj ju kisha lutur për mirëkuptim edhe juve dhe pikën e shtatë ta lëmë për fund të rendit të ditës. Besoj se nuk ka dikush kundër? Faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Të nderuar deputetë, vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për faljen

Konstatimet hyrëse: Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për faljen dhe Kuvendit i kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore.

Komisioni për Komunitete ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka vlerësuar se Projektligji e ka bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për faljen dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e komisionit funksional, nëse e sheh të nevojshme, të arsyetojë raportin me rekomandime. Fjalën e ka kryetari i Komisionit, Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje të nderuar të pranishëm,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke marrë parasysh edhe kërkesën e Qeverisë dhe rekomandimin e Kuvendit të Kosovës, që Projektligjin për faljen ta shpejtojmë sa është e mundur dhe në afatin sa më të shkurtër ka hartuar raportin përfundimtar për Kuvendin e Kosovës. Duke pasur për bazë rëndësinë që ka projektligji, meqë për herë të parë njerëzve të cilët janë të dënuar, po mbahen në entet ndëshkimore, po iu mundësohet të bëjnë kërkesë për falje individuale. Me rastin e shqyrtimit në komision, komisioni ka vendosur edhe amendamentet të cilat nuk e ndryshojnë shumë Projektligjin e ofruar nga Qeveria, mirëpo kemi bërë edhe amendamente të cilat edhe në përmbajtje e ndryshojnë. Ne kemi krijuar një amendament, të cilin kërkoj ta përkrahim, që njerëzit të cilët e vuajnë dënimin në ente ndëshkimore brenda Kosovës, kurse dënimi iu ka shqiptuar nga gjykatat jashtë territorit të Kosovës, iu kemi dhënë mundësinë që edhe këta të bëjnë kërkesë konform këtij ligji, konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës për falje individuale.

Ne kemi pasur edhe amendamente të propozuara edhe nga deputetët. Me gjithë respektin që kemi për deputetët për amendamentet e propozuara, komisioni funksional ka konsideruar se këto amendamente nuk mund të kalojnë. Nëse ka nevojë për qartësime të mëtutjeshme, do t'i bëjmë kur të flasim për amendamentet në fjalë.

Prandaj, edhe njëherë rekomandoj Kuvendit të Kosovës që ta aprovojë Projektligjin së bashku me amendamentet e propozuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet, njëherësh edhe kryetar i komisionit funksional.

Të nderuar deputetë, pasi që në sallë janë 54 deputetë, nuk kemi kuorum për votimin e amendamenteve. Unë i ftoj deputetët që janë në hapësira të Kuvendit, që të kthehen në sallë dhe të procedojmë me rendin e ditës, përndryshe duhet ta shtyjmë pastaj seancën për nesër. Do të mbajmë seancë edhe të dielën, nëse deputetë nuk janë serioz e nuk vijnë por rrinë nëpër bufe të Kuvendit. Unë i lus deputetët të kthehen, sepse nuk ka arsye të mos jenë në votimin e amendamenteve. Mund të votojnë “për” e “kundër” dhe kërkoj nga regjia që të ftohen deputetët të kthehen në sallë.

(Reagime)

Pauzën do ta kemi, por është kryer vetëm një pikë e rendit të ditës. Dje e kemi ndërprerë seancën dhe, ju e dini, për shkak të kuorumit, e këtë le ta dinë edhe mediat, sepse kjo është gjendja e Kuvendit tonë, a po kuptoni! Dje është ndërprerë seanca për shkak të kuorumit, sepse një numër i deputetëve nuk kanë qenë në sallë dhe, sot, pas pikës së parë të rendit të ditës për sot, ne jemi të detyruar ndoshta ta ndërpresim punën për shkak të mungesës së kuorumit. Xhavit Haliti e ka fjalën.

XHAVIT HALITI: Ne mund të bëjmë edhe pauzë, por kërkoj që të konstatohet kush nuk është në sallë dhe këtë ta kemi parasysh, jo në publik por në regjistër. Faleminderit! Unë mendoj se kjo është përgjegjësi e vet grupeve parlamentare.

KRYESUESI: Dua të paraqes atë që e shoh në monitor. Janë prezentë 81 deputetë, do të thotë i kanë lënë kartelat dhe sillen nëpër bufe të Kuvendit deputetët dhe nuk vijnë në sallë për të votuar. Unë po ju them se nuk kemi kuorum për vazhdimin e punës së seancës. Pauza e drekës është në ora 13,30 ose në 14,00 sikur që gjithmonë ka qenë. Nuk jemi të lodhur aq shumë, sepse vetëm një pikë e rendit të ditës është kryer sot, a po kuptoni! Unë propozoj që deri në orën 12,30 të bëjmë pauzë dhe në qoftë se nuk kthehen deputetët, atëherë jemi të detyruar ta vazhdojmë punën nesër. Faleminderit!

(Seanca ndërpret punën)

KRYETARI: Të nderuar deputet! A ka deputet që nuk e ka kartelën me veti? Një, do të thotë vetëm një. Kështu, i kemi 58 plus 1, pra 59 deputetë. Për të vazhduar seanca, duhet t'i kemi së paku 61 deputetë.

Dëgjoni, njëherë do të bisedojmë pak. Nuk kemi transmetim në televizion, seanca është e mbyllur për televizion.

Vërtet, duhet të shtohet disiplina e deputetëve, se nuk është në rregull, për të gjitha pikat që i kemi në rend dite, duhet të ketë kuorum të plotë. Kemi të bëjmë me votime. Debatin

mund ta zhvillojmë edhe kur janë pak deputetë këtu, por jo edhe të votojmë, një. Dy, kisha lutur në mënyrë të veçantë shefat e grupeve parlamentare edhe Komisionin që e ka hartuar Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Ju lutem, dëgjoni! Ethem, me gjithë respektin, të dëgjojmë, unë dua të them diçka. Pasi është në shqyrtim Rregullorja e Punës, në Rregullore të Punës duhet vërtet të hyjnë disa sanksione për deputetët.

Neve do të na detyroni që në fund të çdo seance, në të dy anët e Kuvendit ta vendosim fletën e nënshkrimit dhe mëditjet të jepen vetëm mbi bazën e prezencës së deputetëve në fund të seancës.

Kisha kërkuar që deputeti që nuk është në seancë, të mos e lë kartelën për t'u regjistruar, kinse ai është këtu, edhe për një arsye tjetër. Kemi disa raste që deputeti ka votuar dy herë, edhe për veti, edhe për kolegun që nuk e ka pasur aty.

Nuk ka qenë shumë e shfaqur kjo, por ka pasur raste. Do të thotë, pasi jemi me këtë nivel të përgjegjësisë, kjo duhet të sanksionohet me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Por, edhe disa rregulla të tjera mendoj që duhet të sanksionohen, sepse nuk është mirë që ne tash, disa, një pjesë e mirë, do të thotë, rreth 60 deputetëve tash jemi në sallë, plus Bajrami që nuk ka kartelë, 61, që mund ta vazhdojmë seancën, por nuk është mirë që të na vjen puna që mos të kemi deputetë. Po tua ndalim mëditjet, pastaj menjëherë bëjnë zhurmë, i bëjnë njëqind ankesa. Jo, vërtet disa çështje të futen në Rregullore dhe pastaj secili ta dijë! Jo, jo, e kemi seancën, ne po vazhdojmë, e kemi kuorumin prej 61 vetëve. Mund ta vazhdojmë, por edhe një çështje tjetër që po dua t'ua them juve dhe ju ta bisedoni edhe me kolegët e juaj, edhe me deputetët e pozitës edhe të opozitës. Ju e dini që duke pasur shumë detyra, është duke na u dëmtuar cilësia e punës të Kuvendit.

Unë ju them sinqerisht, kur është hartuar Kushtetuta, unë kam qenë këmbëngulës dhe kam kërkuar që deputeti ose të jetë deputet, ose të jetë ministër. Ju them sinqerisht, është e kundërligjshme që jo vetëm ministrat, në një mënyrë ministrat e kanë mandatin, por zëvendësministrat dhe punëtorët e tjerë që janë në administratën e lartë në Qeveri, thjeshtë është e kundërligjshme, këtë duhet ta dimë, ta dini ju, ta dinë edhe deputetët që i kanë nga dy pozita. Ata duhet të largojnë ose njërën ose tjetrën.

Unë jam i bindur që po të mos kishte ngarkesa të dyfishta, nuk do ta kishim këtë problem në Seancë. Prandaj, është mirë që ministrat zëvendësministrat dhe të gjithë të tjerët që i kanë nga dy pozita edhe në legjislativ, edhe në ekzekutiv, që në fakt është konflikt interesi, sepse nuk ka ndarje të pushteteve. Ndarjet e pushteteve nuk po bëhen së pari në Kosovë, janë bërë kudo tjetër.

Do të ishte me interes që vërtet edhe për punën e Kuvendit, edhe për punën e komisioneve, se në komisione ministrat nuk mund të jenë, për pasojë nuk mund t'i gjesh as zëvendësministrat, kështu që është mirë që njerëzit të zgjedhin ose legjislativin ose ekzekutivin, por jo edhe njërin edhe tjetrin.

Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve në Projektligjin për falje.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se amendamenti 1 është i deputetit Riza Smaka, pa mbështetjen e komisionit funksional.

Fjalën e ka kërkuar Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Nuk është fjala absolutisht për farë kaprici, por për përparim. Teksti që e kam hartuar dhe e kam propozuar, është korrekt dhe është në konformitet me standardet sa i përket preambulës. Unë u konsultova me kryetarin e Komisionit për Legjislacion edhe ai më tha, ndër të tjera, se paska pas menduar se është fjala për datën, por data nuk është këtu, janë vu tri pika. E marr, e lexoj tekstin e parë, tekstin e ligjit, thuhet: Në mbështetje të nenit 65 (1), ai paragraf duhet, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, presë, më pastaj germë e madhe.

Në pajtim me paragrafin 29, që nuk shkruhet askund ashtu, paragrafi jo, po neni 84, paragrafi 29 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pikë presje. Teksti që nuk e kam akceptuar, por e kam hartuar projekt-amendamentin, dhe zbrazësi, vakum, miraton. Kush miraton? Teksti që unë e propozoj, ju lutem: Në bazë të nenit 65, paragrafi 1 dhe neni 84, paragrafi 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur me..., këtë e kam lënë zbrazët, e qesim atëherë kur mbahet, 2008, miratoi Ligjin për falje. Ky është propozimi. Mendoj që ishte dashur të miratohet. Ju Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komisionit për Legjislacion, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e respektoj deputetin Riza Smaka për kontributin që ka dhënë për të propozuar amendamentet, mirëpo e njoftoj se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi nuk e ka aprovuar amendamentin duke e marrë parasysh që bëhet rasti i parë. Ne e kemi një standard unik për të gjitha ligjet të cilat i kemi aprovuar deri më tani dhe, nëse e aprovojmë këtë preambulë, këtë amendament, do të ndryshonim standardin që e kemi deri më tani.

Çështja pak më e komplikuar bëhet atje ku është paraparë që të vendoset data e aprovimit të Projektligjit në Kuvend. Kjo do të sjellë dilema për shkak të aprovimit të mëvonshëm, qoftë me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës, apo pas shpalljes publike në “Gazetën zyrtare”, prandaj si Komision, që të mos sjellë dilema dhe mos ta prish standardin të cilin jemi duke e aplikuar deri më tani, kemi konsideruar se nuk e ka përkrahjen e komisionit funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dëgjuat se nuk e ka përkrahjen e komisionit funksional, edhe për faktin se është kundër standardeve të deritashme. Megjithatë, ne procedojmë me votim dhe këtë duhet ta dini.

Pra, kush është për amendamentin 1 të deputetit Riza Smaka. Votojmë tash:

Me 17 vota “për”, 22 “kundër”, 13 abstenime, konstatoj se nuk miratohet amendamenti i deputetit Riza Smaka.

Po ashtu, edhe amendamenti 2 është i deputetit Riza Smaka, pa mbështetje të komisionit funksional.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Smaka.

RIZA SMAKA: Zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë, ministra,

Edhe ju pak më parë e përmendët, por në kontekstin tjetër. Intenca është që të përfillet parimi i ndarjes së pushteteve, e tri pushteteve themelore. Kryetari i shtetit nuk do të duhej të ishte i autorizuar për të caktuar kritere për falje, por do të duhej ta kishte dokumentin e miratuar dhe sipas diskrecionit të vendoste. Kjo është esenca dhe intenca e këtij amendamenti. Ndryshe, neni 5 do të ishte, do të thotë do t'i jepte pushtet kryetarit që nuk është legjislativ, por është në kuadrin e ekzekutivit për të caktuar kritere dhe më pastaj, do të thotë, bie aty që do të bëhej statusi i një personi që i kryen dy pushtete e nuk do të ishte në harmoni me parimin checks and balance. Kjo është. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputet! Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komisionit për Legjislacion, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Amendamentin në fjalë nuk e kemi aprovuar si Komision për arsye se amendamenti thotë: “ky ligj i përcakton autorizimet ligjore të Presidentit të Republikës së Kosovës”. Ne mendojmë që të mbetet amendamenti si ka qenë në Projektligj, sepse autorizimet ligjore të Presidentit të Republikës së Kosovës iu kanë dhënë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kurse ligji vetëm i rregullon rregullat, i përcakton rregullat për të marrë vendimin deri te falja. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në votim. Pra, amendamenti numër 2 i deputetit Riza Smaka. Lus regjinë të përgatitet për votim dhe votojmë tash:

Me 33 vota “për”, 15 “kundër” dhe 10 abstenime, miratohet amendamenti numër 2 i deputetit Riza Smaka.

Amendamenti numër 3.

Deputeti Riza Smaka pa mbështetje nga komisioni funksional.

Fjalën e ka kërkuar Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Meqë po e shoh se ndoshta edhe gabojmë me rastin e votimit, po tërheq vëmendjen se amendamenti 3 nuk duhet kurrësi të kalojë, sepse deputeti ka propozuar që Presidenti i Republikës së Kosovës t'i lirojë njerëzit edhe nga ndjekja penale. Lexoni me vëmendje amendamentin dhe çështja është se Presidenti nuk e ka këtë autoritet dhe nuk ia ka dhënë as Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Ai liron vetëm njerëzit të cilët janë duke vuajtur dënimin në ente ndëshkimore në Kosovë dhe kurrësi nga ndjekja penale. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë, ministra,

Këtë definicion nuk e kam shpikur, por e kam marrë nga Enciklopedia juridica se ç'është falja, në këtë rast është abolicioni. Ky është definicion që e njeh doktrina juridike dhe çdo praktikë e mirë e rendeve juridike të shteteve të përparuara. Ky është definicion që është i pranuar, i pa diskutuar kur është fjala për falje, përkatësisht abolicion. Prandaj, edhe e kam propozuar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar ministrja zonja Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Abolicioni është diçka krejtësisht e kundërt me faljen, sikur që është edhe falja diçka krejt e kundërt me amnistinë, prandaj presidenti me Kushtetutë nuk e ka mandatin për të dhënë abolicion, por për të dhënë falje.

KRYETARI: Faleminderit ministre! Unë kam vetëm një lutje. Nëse amendamentet janë në kundërshtim me Kushtetutën, ju e dini që mund të votoni, por duhet të ç’votohen pastaj. Unë nuk kisha pasur qejf t’i ç’votojmë pastaj. Do të thotë, nuk mund të vjen asnjë ligj në kundërshtim me Kushtetutën. Ky është parim dhe ju lus të keni parasysh kur votoni dhe gjithçka që është në kundërshtim me Kushtetutën duhet të jetë vota negative.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Është fjala për amendamentin 3 të deputetit Riza Smaka, pa mbështetje nga komisioni funksional. Votojmë tash:

Konstatohet se me 9 vota “për”, 41 “kundër” dhe 10 abstenime nuk miratohet amendamenti numër 3 i deputetit Riza Smaka.

Amendamenti 4 është i Komisionit funksional.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Komisioni, shpresojmë, e ka harmonizuar.

Konstatohet se me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti numër 4.

Amendamenti numër 5 i komisionit funksional.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti numër 5.

Në sallë janë 67 deputetë.

Amendamenti numër 6 është i deputetit Riza Smaka, pa përkrahje nga komisioni funksional.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 17 vota “për”, 30 “kundër” dhe 11 abstenime nuk miratohet amendamenti numër 6.

Në radhë është amendamenti numër 7 i komisionit funksional.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim miratohet amendamenti numër 7.

Në radhë është amendamenti numër 8 i komisionit funksional.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti numër 8.

Në radhë është amendamenti numër 9 i komisionit funksional. Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime miratohet amendamenti numër 9 dhe i fundit.

Tani përgatitemi për ta votuar në tërësi ligjin. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 51 votë “për”, 2 “kundër”, 2 “abstenime”, Kuvendi miratoi Ligjin për faljen.

Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

- Rishqyrtimi i Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për rrugët

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, datë 30 korrik 2008, dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin me ligjet e pashpallura, Komisioni përgjegjës raportues ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për rrugët dhe Kuvendit i ka parashtruar rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Energjetikë, zonjën Myzejene Selmani, apo raportuesin e Komisionit, që para deputetëve të prezantojë raportin, nëse e sheh të arsyeshme. Fjalën e ka deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuara ministre,

Ligji në fuqi për rrugët numër 2003/11 është ndër ligjet e para që është miratuar nga institucionet e Kosovës. Në atë kohë gjendja në infrastrukturën rrugore ishte tepër e rëndë dhe ky ligj ishte një bazë e mirë për të ndryshuar gjendjen, mirëpo në atë kohë thjeshtë ishte më tepër një punë emergjente sa i përket ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës rrugore. Tani Republika e Kosovës është në një fazë krejtësisht tjetër, është në fazën e ndërtimit dhe të zhvillimit të bazuar në programin e Qeverisë dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës. Me këtë projektligj synohet të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i ligjit në fuqi me qëllim që ligji të jetë sa më i aplikueshëm. Në atë kohë nuk kemi pasur edhe disa kategori të rrugëve të cilat tani i kemi, gjegjësisht rrugë të cilat janë të kategorisë apo të një niveli shumë më të lartë.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në bazë të Rregullës 41.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me datë 30. 7. 2008 rishqyrtoi Ligjin 2003/11 dhe me këto ndryshime dhe plotësime të Ligjit kërkon që këto 10 amendamente sot të miratohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës në mënyrë që ligji të jetë sa më shpejt i aplikueshëm dhe në këtë mënyrë të kemi një ligj të bazuar sipas standardeve evropiane. Faleminderit!

KRYETARI: Kalojmë në votim amendament për amendament.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për të votuar:

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 1 votë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 61 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

Amendamenti 3.

Të gjitha amendamentet janë të komisionit funksional.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miraton amendamentin 3.

Amendamenti 4.

Fjalën e ka kërkuar Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: përsëri që po më mendojnë mua, më duket këtu “auto-udhë” nuk qëndron, duhet të jetë “auto-rrugë” dhe duhet gjithkund ku është përdorë “nacionale”, të jetë “kombëtare” sepse më e kapshme është “kombëtare”. Për shembull, nuk mund të themi “in” edhe të huajën, për shembull, “internacionale”. “Ndërkombëtare” themi, “ndërnacionale” nuk mund të themi. Prandaj, është mirë të mbetet “auto-rrugë” dhe “kombëtare”, rrugë “kombëtare”, jo “nacionale”

KRYETARI: A pajtohet Komisioni me këtë.

Zef Morina, e ka fjalën.

ZEF MORINA: Ne, edhe në Ligjin për transportin rrugorë e kemi paraparë që të jetë “auto-udhë”, jo “auto-rrugë”, kështu që tash do të bie ndesh me ligjet paraprake. Përndryshe, nga fjala “autostradë”, e cila është internacionale, është përkthyer pak më bukalisht “auto-udhë”, përndryshe edhe “auto-rrugë” nuk prishë, por Komisioni kështu ka vendosur. Ndërsa, “rrugë kombëtare” dhe “rrugë nacionale”, ky është një term i përgjithshëm, nuk është mirë të jetë kombëtare, por le të jetë nacionale.

KRYETARI: Mirë, e votojmë propozimin e Komisionit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 3 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 4.

Amendamenti 5.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e respektoj punën që e ka bërë Komisioni dhe, natyrisht, nuk është faji i Komisionit, mirëpo është mirë ta lexojmë amendamentin 5, sepse është e pamundur që të aprovohet kështu. Shkruan kështu: “Neni 6 i Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për rrugët ndryshohet si në nenin 6”.

Neni 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit ndryshohet si vijon: 8.1. “Ministria është përgjegjëse për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtim të auto-udhës, të rrugëve nacionale dhe rajonale, ndërsa komuna është përgjegjëse për rrugët lokale dhe urbane”. 8.2. Fjala “duhet” të zëvendësohet me fjalën “mund”.

Dhe, nëse e shikoni, në rend të parë do ta kenë problem ata të cilët do ta zbatojnë edhe këtë që e harmonizojnë, sepse nuk po e kuptojmë nëse ka dashur të ndryshojë nenin 6, qysh po flet në fillim, e mandej thotë 8.2. Neni 8.2. ashtu është edhe në Projektligj, ashtu shkruan, nuk e di çka ka dashur të ndryshojë. Prandaj, ndoshta është mirë që administrata të ketë kujdes, sepse kështu nëse e aprovojmë si amendament, unë besoj që edhe kryetarja e Komisionit pajtohet, është komplet e paqartë dhe nuk ka mundësi as Presidenti ta dekretojë. Faleminderit!

KRYETARI: Komisioni!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Këtu me siguri është bërë lëshim teknik, përndryshe në Ligjin nuk ka “mund” por “duhet”. Do me thënë, Ligji është i zbatueshëm, ndërsa “mund” të lihet, mund të votohet ose mos të votohet. Unë mendoj që këtu është bërë gabim teknik. Duhet të jetë “duhet” e jo “mund”. Ka plotësisht të drejtë zotëria.

KRYETARI: Bahri Hyseni e ka kërkuar fjalën.

BAHRI HYSENI: Pa dashje të ngarkoj tash, unë mendoj që mund ta rregullojmë, mirëpo referimi në nenin 6 nuk duhet fare të ekzistojë, t’i referohemi menjëherë nenit 8.1. sepse vetëm neni 8.1 po ndryshon, 8.2 është në Projektligj dhe ndryshimet të vlejné vetëm për nenin 8.1. Të tjerat, të gjitha të fshihen, 8.2 është në Projektligj, nuk e di pse çka po ndryshon nga pjesa tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Me siguri, gjatë përshkrimit, është shumë e qartë që zotëri Bahri Hyseni thotë se është përsëritur kjo 8.2, se këtu mjaftë qartë është, paragrafi 8.2 nga Ligji bazë duhet të zëvendësohet me fjalën “mundet”, po më mirë kishte për të qenë ajo, se gjatë diskutimit, deputetët brenda Komisionit njëherë e japin këtë variant, votojnë, kur dalin në Kuvend tani thonë jo se kemi dhënë këtë variant. Edhe kështu mundësia është më e lehtë që të marrim një vendim të qartë, a “mundet”, a “duhet”. Ligji duhet të jetë “duhet”, jo “mundet” se në ligj nëse japim mundësinë “duhet”, “mundet” atëherë nuk e di pse ceket ai paragraf. Faleminderit!

KRYETARI: Mund të themi kështu: Neni 8, paragrafi 1 është krejt në rregull. Paragrafi 2, fjala “duhet” nuk mund të zëvendësohet me fjalën “mund”, po duhet të mbetet “duhet”. A jeni dakord me këtë? Pra, me këtë propozim që u dha ne votojmë amendamentin 5.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 1 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet me ndryshimet e cekura amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 7.

Amendamenti 8 i Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miraton amendamentin 9.

Dhe i fundit është Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Pra ky nen u votua, por duhet t’i shtohet “ky Ligj hynë në fuqi”.

Atëherë, konstatohet se me këtë ndryshim, për amendamentin kanë votuar 56 deputetë, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, pra miratohet amendamenti 10.

Dhe, tash votojmë për Ligjin në tërësi.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët. Ju faleminderit!

Nëse jeni dakord, e vazhdojmë seancën, nëse jo, mund të marrim pauzë. Pauza e drekës, do të thotë, në orën 15,00, a jeni dakord që të vazhdojmë në orën 15,00? Ju lutem, mos u vononi! Atëherë, në orën 15,00 të jemi këtu të gjithë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, po vazhdojmë debatin. Konsiderojmë që ndërkohë do ta kemi edhe kuorumin për votim, por derisa të vinë, vazhdojmë debatin.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2008, ka shqyrtuar Planin e veprimit të Kuvendit dhe të njëjtin ua ka dërguar grupeve parlamentare me kërkesë që ta shqyrtojnë dhe t’i paraqesin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre eventuale.

Plani i veprimit të Kuvendit u është shpërndarë deputetëve.

Të nderuar deputetë,

Nga Raporti i progresit të Komisionit Evropian del që Kuvendi duhet të përmirësojë punën në këto drejtime ndërveprimi me Qeverinë:

- Vlerësimi i draftligjeve për përputhshmërinë e tyre me të drejtat e njeriut,
- Vlerësimi i ndikimeve buxhetore të draftligjeve,
- Ekspertiza për të pasur shqyrtim efektiv në Kuvend,
- Sugjerimi i kapaciteteve për mbikëqyrjen efektive të implementimit të ligjeve,
- Kontaktet e deputetëve me zonat e tyre zgjedhore,
- Pjesëmarrja efektive e shoqërisë civile në procesin legjislativ,
- Plani vjetor i punës.
- Zgjedhja e Avokatit të Popullit,
- Sigurimi i stafit të kualifikuar në administratë dhe përfshirja e komuniteteve minoritare,
- Harmonizimi i projektligjeve me standardet e BE-së,
- Sistemi autonom i teknologjisë informative,
- Botimi i rezultateve të votimit,
- Mbështetja e Komisionit për Integritet Evropian.

Në Planin e veprimit në përgjithësi janë përfshirë këto rekomandime në objektivat afatmesme të Kuvendit.

Në këtë plan janë përcaktuar objektivat themelore, si:

1. Të sigurohet organizimi dhe funksionimi sa më efikas i Kuvendit të Kosovës,
2. Të zhvillohet më tej një proces ligjvënës efikas dhe gjithëpërfshirës,
3. Të fuqizohet roli mbikëqyrës i Kuvendit ndaj institucioneve që i zgjedh,
4. Të mbahen takime të rregullta të Kuvendit me zgjedhësit e tij,
5. Të zhvillohen kapacitetet adekuate të administratës së Kuvendit,
6. Të krijohen hapësira dhe kushte të nevojshme për punën e deputetëve dhe të organeve të Kuvendit,

Në plan përfshihen edhe objektivat tjera specifike, si:

- Funksioni legjislativ,
- Funksioni mbikëqyrës,
- Mbikëqyrja e buxhetit dhe kontrolli i financave publike,
- Mbikëqyrja parlamentare e Agjencisë për Inteligjencë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës,
- Bashkëpunimi me institucionet e tjera të pavarura,
- Funksioni përfaqësues,
- Kryetari dhe Kryesia,
- Grupet parlamentare,
- Komisionet parlamentare,
- Deputetët e Kuvendit,
- Administrata e Kuvendit.

Këto objektiva shpjegohen gjerësisht në plan dhe planin e keni marrë.

Në sallë kemi 61 deputetë. Fjala është e shefave të grupeve parlamentare.

Fjala është për shefin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zotin Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuari zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pak ministra që keni mbetur në sallë,
Respekt dhe përshëndetje,

Çështja e Planit strategjik të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës është marrë kaherë dhe është shqyrtuar nga deputetët dhe nga Grupi ynë Parlamentar dhe ne, natyrisht, e përkrahim si të tillë çfarë është, por kemi hallin që ata që kanë për obligim t'i trajtojnë çështjet e implikimeve buxhetore, që janë jo të pakta, siç e kemi parë ne në këtë plan, të shikohen mirë që të mos kenë defekte rreth kësaj çështje. Përndryshe, si plan strategjik ne në parim e mbështesim dhe do ta votojmë, pa dyshim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuar ministre, ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet Planin për veprim që është propozuar. Ne kemi pasur rastin që me sekretarin e Kuvendit ta diskutojmë në fazën e parë dhe, po ashtu, të involvohemi në takime edhe me partnerët e Kuvendit të Kosovës. Është dokument i mirë. Atë që ne e kemi vërejtur në këtë dokument, është implikimi buxhetor prej 100 mijë eurosh që, në këtë fazë para miratimit final të buxhetit për vitin e ardhshëm, mendoj që duhet të parashihet domosdoshmërisht që zbatimi i planit të lidhet ngushtë edhe me mundësitë buxhetore. Meqë ekzistojnë këto, besoj që do të arrijmë deri në javën e ardhshme, kur miratohet buxheti, të sigurojmë buxhet të mjaftueshëm në mënyrë që plani të jetë funksional. Ai i ndihmon shumë. Ky plan është bazë e mirë dhe qartëson edhe obligimet, edhe angazhimet tona të përbashkëta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë po e jap një sqarim, pasi jemi marrë më shumë në këtë drejtim. Plani ka qenë vërtet, ka kërkuar më shumë buxhet, por në formën që është, do të thotë, nuk ka pengesa buxhetore. Plani në formën që është tani, nuk ka implikime buxhetore të papërbalueshme për buxhetin e Kuvendit, do të thotë, kjo duhet të jetë e qartë. Prandaj, miratimi i këtij plani sot ndihmon shumë edhe në rishikim, se disa çështje duhet të hynë edhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah këtë plan të veprimit, sepse deri tash Kuvendi nuk ka pasur ndonjë plan gjatë veprimit të vet dhe, natyrisht, janë shkaktuar një mori problemesh edhe në funksionimin e tij si tërësi, por në veçanti të komisioneve.

Besoj shumë që pas miratimit të këtij plani, një pjesë mjaft e mirë e të cilit do të shndërrohet edhe në Rregulloren e Punës, ky Kuvend do të jetë më efikas dhe në pajtim me pritjet tona dhe të qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë deputetë!

Në emër të AAK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i AAK-së e ka shqyrtuar Planin e veprimit afatmesëm të Kuvendit të Kosovës që po e shqyrtojmë tani. Ne kemi rezerva të implikimet buxhetore se a janë parashikuar saktë dhe mund të ndodhë që gjatë implementimit të këtij plani të punës, do të thotë, do të ketë tejkalime të parashikimeve buxhetore. E kam fjalën për 2 komisione të reja që do të themelohen në kuadër të Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, si komision i veçantë i Kuvendit të Kosovës, dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Inteligjencës dhe një nënkomision brenda Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, që do të jetë Nënkomisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, apo të Ministrisë së Forcës së Sigurisë. Por, këto janë 2 – 3 angazhime shtesë, pra të dy komisioneve dhe të një nënkomisioni, që do të kenë me siguri implikime buxhetore si me stafin, ashtu edhe..., të nderuar deputetë, për ngritjen e një komisioni që ka për të marrë përsipër mbikëqyrjen e Agjencionit të Inteligjencës, duhet së paku 6 muaj përgatitje të atij komisioni, trajnime dhe do të ketë implikime shtesë.

Me bisedimet me DIKAFIN, do të ndihmojnë financiarisht në punësimin e 2 punëtorëve në staf, pra do t'i bartin ata, do t'i mbështesin financiarisht, por një koordinator duhet, qoftë nga këta të vjetrit, ose të pranohet i ri. Njësoj do të ketë nevojë për staf edhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Grupi Parlamentar i AAK-së mbështet këtë Plan të punës, me këto vërejtje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Naser Rugova e ka kërkuar fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Më lejoni që edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë t'i themi disa fjalë për Planin e veprimit të Kuvendit. Ne në parim do ta përkrahim, do ta përkrahim këtë plan dhe kërkojmë që funksionaliteti i trupave të Kuvendit dhe efikasiteti i tyre, si në vëllim, si në cilësi, po shihet dita-ditës që është nevojë imediate të rritet.

Unë jam anëtar i Komisionit për Integritet Evropian dhe ne e kemi shqyrtuar me seriozitet edhe si Komision, por edhe si Grup Parlamentar çështjen e vërejtjeve që i bëhen organit më të lartë legjislativ të Republikës së Kosovës dhe më erdhi mirë që edhe ju i cituat, zoti Kryetar. Është koha e fundit që ato vërejtje që ka mundësi të evitohen dhe që në raportin e ardhshëm të atij komisioni mos të jenë si kritika të adresuara institucioneve të Kosovës. Një pjesë e tyre, po besoj, janë marrë parasysh edhe në këtë plan veprimi. Mjaft komisione, edhe të reja që duhet të krijohen, po në këtë rast Komisioni për Integritet Evropian ballafaqohet me pengesa në kryerjen e aktivitetit të vet, si Komisioni më i ri, që po shihet që ka shumë punë dhe do të jetë shumë i rëndësishëm në kohët që vinë.

Andaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, ne do ta mbështesim Planin e veprimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar “7+”.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “7+” edhe pse jam vetëm, veç po flas “7+”, këtë plan do ta pranojmë, sikur të gjithë që e pranuam. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë, deputet Merxha!

Radha është e Grupit Parlamentar SLS, Slobodan a e do dikush prej Grupit të juaj fjalën?

SLOBODAN PETROVIĆ: U ime Samosltalne liberalne stranke, odnosno Poslaničkog kluba, u načelu podržavamo ovaj plan.

KRYETARI: Faleminderit!

Për debat është lajmëruar deputetja Edita Tahiri,

EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe unë, po ashtu, e mbështes këtë plan, i cili mendoj se në përgjithësi është mjaft i mirë, por desha të jap edhe disa mendime edhe propozime lidhur me, ndoshta, begatimin e tij dhe rrjedhimisht edhe të punës së Kuvendit të Kosovës.

Së pari, është fjala për diplomacinë parlamentare, e cila është duke u zhvilluar nga ana e Kuvendit, mirëpo unë nuk po shoh një mekanizëm analitik i cili do të kishte marrë rekomandimet që vinë nga këto vizita dhe do t'i kishte analizuar, në mënyrë që të shohim në bazë të rekomandimeve si do të zhvillojmë ne strategjinë e ardhshme të diplomacisë parlamentare. Për të qenë më konkrete, mendoj se, së paku nga përvoja ime personale mendoj se askush nuk i lexon raportet e aktiviteteve dhe nuk ka një analizë, pra po sugjeroj krijimin e një mekanizmi analitik për rezultatet e diplomacisë parlamentare dhe të ndërtimit të strategjive në këtë drejtim.

E dyta, mendoj se te çështja e fuqizimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit për punën e Qeverisë dhe të organizatave publike, ne kemi nevojë që në Parlament të kemi më shumë debat. Janë çështjet e sigurisë, veçmas një kohë ka qenë dhe vazhdon të jetë pra çështja e veriut, strukturat paralele, pastaj janë problemet në fushën e politikës së jashtme, të ekonomisë, çështjet sociale që mendoj se duhet të krijohet hapësirë në Parlament përmes debateve, dhe unë kam përshtypjen sikur këto interpelancat kanë tendencë ta zëvendësojnë këtë çështje. Për shembull, dje, interpelanca për Raportin e progresit sikur vuri në shënjestër vetëm Qeverinë përgjegjëse për këtë punë. Ndërkohë që për këtë raport përgjegjës janë tri shtyllat e shtetit: edhe ekzekutivi, edhe legjislativi edhe gjyqësori, dhe rekomandimet që dolën pastaj, dolën për Parlamentin. Prandaj, mendoj se është mirë të inkorporojmë debatin, në mënyrë që të jemi më të fuqishëm në mbikëqyrjen e proceseve qeverisëse në Kosovë.

E treta, ka të bëjë me deputetët. Plani parashikon aftësimin e mëtejshëm të deputetëve, që është shumë në rregull. Mirëpo, ky plan nuk parasheh një minimum të kushteve për deputetët. Ne nuk i kemi zyrat ende dhe, madje, mendoj se deputeti minimum duhet ta ketë një asistent për të qenë më efikas. Këto nuk janë, është vetëm çështja e aftësimit më tejshëm të deputetëve, pas 7 – 8 vjetëve, unë e di se ju si lider i këtij institucioni i keni trashëguar këto probleme, u desh të thirret, mendojnë më shumë për hapësirat, por pas 7 – 8 vjetëve të punës të mos ketë zyre për deputetë, me të vërtetë është shumë vështirë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Realisht, debati është dashur të zhvillohet sot vetëm me shefat e grupeve parlamentare, të merremi vesh, ky material ka kohë që është dorëzuar dhe vërejtjet kanë mundur të vinë. Megjithatë, mendoj që është një dokument që Kuvendi duhet ta miratojë, por paraparakisht

debati është dashur të zhvillohet në grupet parlamentare. Megjithatë, unë po ua japë fjalën.

Fjalën e ka kërkuar ministri Mahir Yagcilar.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, atëherë unë ju kërkoj falje, mund të tërheqem. Unë vetëm mendova ta përkrah, sepse vërtet ka nevojë për plan të tillë dhe besoj që do të krijohet një mundësi për një bashkëveprim edhe bashkëkoordinim të kalendarik edhe përmes Qeverisë dhe strukturave tjera të shtetit. Unë plotësisht e përkrah.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në këto objektiva që janë reale dhe janë të nevojshme e të domosdoshme dhe, natyrisht, të arsyeshme për të sendërtuar, do të duhej të bëheshin disa modifikime, kështu që kanë domethënie në përmbarim. Po e zëmë, konkretisht, flas deputeti – qytetari, të krijohet lidhja e të kërkohej, së paku na po e dimë, po parakushte teknike modeste, së paku. Ndryshe, deputetët, hiq anëtarët e Kryesisë, do të duhej të udhëtonin me bus, do me thënë është gjendje e këtillë, apo jo. Më pastaj, të krijohet lidhja e interkomunikimit deputet - zona e tij. Një zonë është krejt Kosova, një zonë zgjedhore është, nuk ka askush zonë të veten, zona e secilit është krejt Kosova.

Ose te objektivi, të rritet shkalla e koordinimit ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë. Mendoj që duhet e kundërta, se Qeveria i jep llogari e përgjegjësi, e raporte Kuvendit, por gjithsesi së paku jo të rritet po të sendërtohet. Të sendërtohet, kjo mund të bëhet edhe duhet të bëhet, se rritja do me thënë e ka një kuptim relativ. Mund të thuhet gjithmonë, është rritur më mirë se sa përpara, e kështu.

Edhe kur thuhet, bie fjala, të fuqizohet mbikëqyrja e Kuvendit mbi organet e veta. Të realizohet medoemos, këtë duhet ta bëjë Kuvendi, sepse është funksion themelor dhe, tek e fundit, këto ligje që po i miratojmë, në qoftë se nuk do ta kishin sendërtuar mbikëqyrjen efektive, po thuaj se nuk do ta kishim justifikuar legjislativin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputetja, do të thotë diskutuesja e fundit, Njomza Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, i nderuari Kryetar!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Si dhe deputetë,

Kuptohet që deri tani, Parlamenti i Kosovës, Kuvendi më saktësisht, nuk ka qenë edhe aq sa duhet, flas për administratën, aq sa duhet në nivel. Duke pasur parasysh përvojën prej fillimit që kam ardhur dhe nuk ka qenë edhe shumë efikase, mua më në fund po më duket i arsyeshëm Plani strategjik i veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe mendoj që me këto pika që i keni bërë strategjitë, të fillohet të përmirësohen edhe kushtet e ne deputetëve dhe, po ashtu, në Komisionin ku jam unë, për Integritet Evropian, të ketë më shumë mbështetje në zbatimin dhe të kërkesave që ne i kemi aty për aty.

Një çka pashë edhe në strategji të planit, është edhe dita e hapur e Kuvendit, që i ka munguar Kuvendit të Republikës së Kosovës, të jetë dita e hapur për qytetarët që të vijnë e të vizitojnë, nuk ka qenë një ditë ..., që tash e keni paraparë këtu të jetë, por në

përgjithësi unë desha të jap një kontribut timin personal që kjo është e mirëseardhur për ne deputetët, po ashtu është edhe për Parlamentin e Kosovës që të jetë më efikas në detyrat dhe këto çka i keni prapa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Unë shumë shkurt, zotëri Kryetar, por po e shoh të domosdoshme t'i them dy fjalë, ku është arsyeja. Arsyeja është që tipi i të folurit, tash çka po bëjmë, s'është bërë kurrë, është qesharake. Unë dhe ju, zotëri Kryetar, që jemi tri legjislacione këtu dhe e bëjmë atë që quhet memorie institucioni, e që përcillet, e dimë që ky Kuvend plane të tilla shumë të detajuara ka pasur dhe ka zbatuar edhe në legjislatura të tjera. Tjetër është që ky vit i yni ka qenë viti i vendimeve të mëdha, të cilat nuk kanë lejuar që të krijohen orare të tipave qysh i kemi pasur më parë. Po, për hir të së vërtetës, për hir të kulturës së këtij Kuvendi, për hir traditës, në të cilën marrim pjesë, ju lutem, mos e merrni që është hera e parë. Përkundrazi, pak jemi vonuar kësaj radhe ta bëjmë këtë program, por ky Parlament program të tillë të detajuar ka pasur edhe në legjislaturat e tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk kemi kërkesa për diskutim.

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota "për", 2 "kundër" dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Planin e veprimtari të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e radhës. E kemi një pikë të radhës, për të cilën duhet të jetë kryetari i një komisioni, e kryetari i atij komisioni nuk është këtu. Nuk di a ka zëvendës. Po! Atëherë, në radhë është:

- Shqyrtimi i parë i Projektregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Komisioni për Rregulloren e Punës ka hartuar Projektregulloren e Punës së Kuvendit dhe e ka proceduar për shqyrtim dhe miratim, në parim.

Kryetar është Ahmet Isufi. Ahmeti nuk është këtu, a ka zëvendës? Zëvendës është Kolë Berisha. Zëvendësi i parë është Kolë Berisha. E ke fjalën deputet.

KOLË BERISHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në literaturën juridike, rishikimi i kohëpaskohshëm i dispozitave në fuqi dhe ndryshimet e plotësimet e tyre të shpeshta dhe në vazhdimësi shpjegohen në dy mënyra.

E para, si barometër, i cili dëshmon për dinamikën e zhvillimeve të shpejta të shoqërisë dhe demokratizimit e zhvillimeve dhe të institucioneve të saj të vendit në tërësi, në këtë kontest edhe nevojën imediate për përshtatjen e strukturës ligjore të këtyre zhvillimeve.

Dhe e dyta, si reflektim i mungesës së profesionalizmit për ndërtimin e një legjislacioni më të qëndrueshëm në legjislacionin që u paraprinë evoluimeve të natyrshme në shoqëri.

Meqë jam njëri nga hartuesit e kësaj Rregullore dhe të Rregullores së përparshme, dëshiroj që të jetë varianti i parë për neve. Si deputet i tri legjislaturave të pas luftës në

Kosovë, si njëri nga hartuesit e Rregullores në fuqi, si anëtar i Grupit punues në kuadër të Komisionit aktual për Hartimin e Rregullores dhe, më në fund, si jurist, dua të them se nevoja për hartimin e rregullave të reja të punës së Kuvendit të Kosovës ka shumë kohë që është bërë imperativ, është bërë prioritet, është bërë domosdo nga se rregullat të cilat aktualisht janë ende në fuqi, ka kohë që kanë filluar të jenë në disproporcion me dinamikën rreth rrjedhave në përgjithësi.

Për më tepër, janë bërë edhe pengesë dhe po e vështirësojnë funksionimin normal të punës së Kuvendit dhe të trupave të tij.

Prandaj, është mirë që sot, ndonëse me pakë vonesë, e kemi në duar një tekst të tillë juridik. Dhe, mund të them se tekstin që e kemi në shqyrtim, në radhë të parë është inkorporuar zgjidhja e Kushtetutës së Republikës së Kosovës që ka të bëjë me punën e Kuvendit dhe të mekanizmave të tij. Për herë të parë, janë dhënë shpjegime profesionale për një gamë të gjerë të terminologjisë që përdoret në tekst. Janë përcaktuar dhe janë detajizuar procedurat për verifikimin e mandatit të deputetëve, për konstituimin e Kuvendit të Kosovës dhe zgjedhjen e organeve të tij, siç janë: kryetari dhe anëtarët e Kryesisë, përkatësisht nënkryetarët. Janë specifikuar saktësisht mandati, kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit dhe të organeve të tij, si kryetari, Kryesia, përkatësisht nënkryetarët, pastaj grupet parlamentare, komisionet e përhershme dhe ato ad-hoc.

Për të mos u zgjatur shumë, dua t'ju them se, duke u mbështetur në përkushtimin dhe seriozitetin e punës së grupit punues dhe të Komisionit në përgjithësi, pastaj në përvojën e vendeve me një demokraci më të avancuar, qoftë përmes kontakteve të drejtpërdrejta, qoftë përmes rregulloreve të tyre, si për shembull ajo e Sllovenisë, Francës, Gjermanisë, Shqipërisë e të tjera, si dhe në mendimin e organizatave që mbështesin punën e Kuvendit, jam i sigurt se ia kemi dalë që sot ta kemi në dorë një tekst të natyrshëm, natyrisht jo të përkryer, por gjithsesi shumë praktik, gjithëpërfshirës dhe të qartë që ofron zgjidhje për shumë çështje, gjë që i ka munguar aktit të mëparshëm.

Për herë të parë kemi në duar një akt, i cili, edhe në aspektin teknik ka fizionomi të plotë juridike, në kuptimin e plotë të fjalës.

Grupi Parlamentar i LDK-së e miraton, në parim, këtë Rregullore.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Radha është e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Që në fillim, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe, natyrisht, ne e mbështesim në parim Rregulloren, mirëpo megjithatë konsideroj se Rregullorja ka nevojë për modifikim dhe plotësim.

Shqetësimet i ngrehim në shumë çështje. Në disa raste, dispozitat kushtetuese të cilat janë në fuqi në Draft-rregulloren, janë modifikuar nga Komisioni dhe kanë dalë të pakuptimta. Dispozitat e Rregullores aktuale, të cilat janë në fuqi, janë modifikuar dhe mandej e kanë humbur kuptimin. Prandaj, sugjeroj që komisioni funksional duhet ta ketë parasysh që atje ku janë dispozitat në rregull, qoftë në Rregulloren aktuale, qoftë në

Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të shkruhen ashtu si janë, sepse përndryshe e humbin kuptimin.

Në nenin 3 të Draftregullores flitet për përkufizimet dhe termat dhe nuk vazhdon me asnjë përkufizim, mirëpo vetëm thotë, shprehjet dhe termat e përdorura në këtë rregullore kuptohen e interpretohen në përputhje me kuptim e me përdorimin e tyre në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Përkufizimet bëhen me qëllim që deputetët dhe të tjerët ta kuptojnë një nocion apo një term që është përdorë në Rregullore. Dhe, tash, ky nen thotë, duhet të jenë në përputhshmëri me Kushtetutën, por nuk jep fare interpretim dhe si të kuptohet, askush nuk ka mundësi që në një kohë të ketë në dorë edhe Rregulloren edhe Kushtetutën.

Konstituimi i Kuvendit. Këtu e kuptoj që kanë dashur të modifikojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, mirëpo e kanë lënë të mangët. Është gjithsesi mirë që të merret neni 66.1 i Kushtetutës, sepse ajo e tregon edhe afatin kur duhet të mbledhet, që është i domosdoshëm, dhe mënyrën. Prandaj, nuk duhet të lihet anash. E kanë filluar kah mesi dhe ka mbetur çështja përmbajtësore. Vetë fjala “konstituimi i Kuvendit” duhet që në fillim të tregojë datën dhe mënyrën.

Mandej, te neni 7, zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit. Edhe këtu është modifikuar, është dashur të modifikohen dispozitat kushtetuese dhe ia kanë humbur kuptimin. Është mirë që të merren komplet dispozitat kushtetuese që janë në nenin 67 pika 1, 2, 3, 4, sepse janë komplet të qartë dhe s’ka pasur nevojë të modifikohen, sepse kanë shtuar vetëm fjalë të tepërta dhe ia kanë humbur kuptimin. Kurse, pika 4 mandej të bëhet pika 5 dhe të vazhdohet.

Kryesia e Kuvendit, mandati i Kryesisë. Shkarkimi i kryetarit të Kuvendit dhe i nënkryetarëve është i përcaktuar mirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Këtu, në pikën 4, në Draftregullore e kanë shkruar kështu në Projektregullore: “Shkarkimi i kryetarit të Kuvendit ose i një anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, me propozim të një partie politike ose të grupit që e ka propozua, bëhet me votën e 2/3”. Kjo është në kundërshtim me Kushtetutën, sepse partitë politike nuk mund të propozojnë shkarkimin, as të kryetarit, as të nënkryetarit të Kuvendit, por mund të propozojnë grupet parlamentare dhe kjo çështje është e rregulluar shumë mirë në nenin 67.5 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Është shumë e qartë si shkarkohet kryetari dhe nënkryetarët e Kryesisë.

Mandej, neni 10, mbledhja e Kryesisë. Është shumë interesant çka është modifikuar nga Rregullorja aktuale, por me plotë të drejtë mund të thuhet se Rregullorja aktuale që e kemi, është shumë më e qartë se propozimi që ka dalë tash në nenin 10. Ka filluar të modifikohet dhe është harruar se kush i pari e thërret mbledhjen dhe si duhet të thirret, është modifikuar dhe është bërë mandej e paqartë. Mandej, propozoj që në këtë nen të merret komplet neni apo Rregulla 7 e Rregullores aktuale, se është shumë e qartë, është shumë e punuar mirë dhe nuk ka pasur nevojë të modifikohet, se gjatë modifikimit ia kanë humbur kuptimin. Po thuaj se është e njëjtë, po kanë harruar, e kanë lënë dispozitën e parë që e bënë të pakuptimtë.

Gjithashtu, te neni 11 janë kompetencat e Kryetarit të Kuvendit. Kompetencat e Kryetarit të Kuvendit janë të përcaktuara shumë mirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Edhe këtu përafërsisht i kanë bërë ashtu, pa një ndryshim, por e kanë humbur atë kuptimin si janë të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe kjo vlen, vetëm përshkruhen ashtu siç janë, sepse janë shumë të qarta dhe nuk ka asnjë problem.

Te neni 16, flitet për imunitetin e deputetëve të Kuvendit, flet me nja 4 – 5 paragrafe, që unë konsideroj që janë të tepërta. Mund të preket ndoshta vetëm një nen për imunitetin, sepse imuniteti i deputetëve do të përcaktohet me ligj të veçantë, me Ligjin për përgjegjësitë dhe imunitetin e deputetëve.

Mandej, flet neni 17 për procedurën e heqjes së imunitetit, komplet janë edhe nja 7 paragrafë, mandej neni 18 për procedurat kur deputeti është ndaluar ose arrestuar. Janë nja 2 – 3 faqe për imunitetin e deputetit që bien ndesh njëra me tjetrin. Këtu duhet të kemi të qartë, kemi 2 – 3 paragrafe, një për procedurën, gjithsesi të rregullohet, sepse ajo është, është Rregullorja e Punës së Kuvendit, por për imunitetin vetëm shkruhet ajo që është në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mos ta ngarkojmë Rregulloren me gjithë këto propozime.

Te çështja e interpelancës, mendoj që këtu duhet të kemi një propozim të çështja e interpelancës. Unë e kuptoj që aktualisht është ai 10 minutëshi që iu ka dhënë mundësi Kryeministrit apo ministrave, kur thirren në interpelancë, mirëpo konsideroj që po iu bëhet e padrejtë deputetëve, qoftë të opozitës, në këtë rast, kur po thirren në interpelancë Kryeministri apo ministrat, sepse koha e deputetëve në dispozicion po merret nga njerëzit e Qeverisë. Këtu është më mirë që në Rregullore të parashohim një kohë më të gjatë për interpelancë, për njerëzit të cilët thirren dhe kurrësi të mos lejohet që koha e deputetëve të merret, qoftë nga Kryeministri apo ministrat për interpelancë. Dhe, këto i propozojmë si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike, të kemi parasysh dhe këtu gjithsesi ta shtojmë kohën e njerëzve apo të anëtarëve të Qeverisë që thirren në interpelancë, pa e kufizuar kohën e deputetëve të pozitës.

Neni 34 i Rregullores flet për deklaratën e deputetëve për çështjet që... janë në rend dite. T'ju them të vërtetën, kjo është pak për ne e paqartë, për çka ka nevojë neni 34. Çështja e interpelancës është e rregulluar, çështja e rendit të ditës është e rregulluar, çështja e...

KRYETARI: Ju lutem, veç keni parasysh që është në parim. Ju lutem, ju jeni komision, do ta merrni për detyrë, mirëpo të keni parasysh që kjo është në parim dhe, në parim, mendoj që është një diskutim tjetër. Unë, po ju them juve, që ta kuptojnë edhe të tjerët. Diskutimi sot është në parim, urdhëroni çdo grup, çdo komision le t'i bëjë amendamentet e veta dhe pastaj votojmë.

BAHRI HYSENI: E vetmja mundësi sot është për t'i dhënë vërejtjet. Kurrë kjo Rregullore s'do të na vijë ne më në komisione. Kjo do t'i shkojë komisionit funksional dhe në çështjen e amendamentimit do të vije këtu e gatshme. E vetmja mundësi është sot për t'i bërë vërejtjet dhe komisioni funksional t'i marrë parasysh dhe t'i bëjë amendamentet. Nëse doni, mund ta ndërpresim por, ne në leximin e dytë nuk kemi mundësi asgjë të bëjmë dhe kjo nuk do të vijë as në komisionin tim, as në komisione të tjera.

KRYETARI: Ju lutem, për këtë Rregullore, përveç atyre që e kanë hartuar, ju si Komision për Gjyqësi dhe Legjislacion duhet ta keni edhe ju të drejtën që të raportoni për këtë çështje. Ju e dini shumë mirë, edhe të bëni amendamente keni të drejtë, siç e kanë edhe grupet parlamentare, jo vetëm një komision, por edhe një deputet ka të drejtë të bëjë amendamente. Prandaj, shfrytëzoni periudhën e amendamentimit, kurse sot miratimi është në parim. Unë po e kërkoj, mos ta harxhojmë kohën kot.

BAHRI HYSENI: Në rregull, zoti Kryetar. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet, në parim, Rregulloren. Do të mundohemi që të paraqesim amendamente, mirëpo kjo nuk do të thotë që do ta përmirësojë Rregulloren komisioni aktual funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Është radha e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike. Fjalën e ka kërkuar Fatmir Rexhepi. Qenka kryer. Atëherë, vazhdojmë, fjalën e ka Ibrahim Makolli!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zotëri Kryetar! Ka qenë kërkesë e kahershme e Grupit Parlamentar të AKR-së që ky Kuvend të nxjerrë Rregulloren e Punës dhe, për fat të mirë, sot ne po e shqyrtojmë këtë rregullore.

Unë, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, natyrisht, e përkrah këtë Rregullore, në parim, por më lejoni që pavarësisht asaj se është vetëm pajtimi në parim, të jap disa nga vërejtjet, të cilat besoj se do të përmirësohen gjatë përpunimit të mëturshëm, sepse kjo Rregullore gjendet në mes të tri çështjeve: është pjesërisht e mbështetur në Kornizën Kushtetuese, është pjesërisht e mbështetur në Kushtetutën e Republikës dhe është pjesërisht e mbështetur në dëshirat individuale.

Më lejoni vetëm të përmend, ta zëmë, e keni - zgjedhja e sekretarit të Kuvendit, që sipas meje, është absolutisht e padrejtë, sepse Kryesia e Kuvendit nuk mund të zgjedh sekretarin e Kuvendit, Kryesia e Kuvendit mund të zgjedh sekretar për Kryesinë e Kuvendit, por një trup më i vogël nuk mund të zgjedh sekretar për Kuvendin, prandaj sekretarin e Kuvendit do të duhej ta propozojë Kryesia dhe ta zgjedh Kuvendi, sepse është sekretar i Kuvendit.

Së dyti, po ashtu, as Projektbuxhetin e Kuvendit nuk do të duhej, sipas kësaj Rregulloreje, që ta miratojë Kryesia, por duhet Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe ta miratojë Kuvendi. Kryesia, po ashtu, nuk mund të vendosë për mjete financiare të deputetëve, as të grupeve parlamentare, sepse është organ administrativ.

Këtu diku thuhet që rendin e ditës, në Kushtetutë e keni, e përcakton kryetari, në Rregullore thuhet diku e përcakton Kryesia, diku thuhet Kryesia me shifat e grupeve parlamentare, ka dualizma. Po ashtu, do të duhej që në interpelancë opozitës t'i jepej më shumë hapësirë se sa që ka qenë deri tash. Është shumë e padrejtë që opozita të ketë hapësirë, sepse është e vetmja mundësi për opozitën që të paraqesë qëndrimet e veta në interpelancë dhe do të duhej në këtë rast, që opozitës t'i kushtohej hapësirë më e madhe.

Propozoj, po ashtu, që shqyrtimi nga leximi i parë i draftligjeve, në leximin e dytë, të jetë në kohëzgjatje më të madhe se sa 2 muaj, sepse nuk po ka mundësi as fizike, as të tjera, që këto draftligje të analizohen edhe me grupet e tjera të interesit, të keni parasysh se kemi një numër mjaft të madh të ligjeve që nuk i kanë respektuar këto afate të draftligjeve, sepse kemi draftligj që tash e 5 – 6 muaj është shqyrtuar në shqyrtim të parë, ndërkaq edhe më tutje nuk ka ardhur këtu.

Po ashtu, komisionet kryesore do të duhej të udhëhiqeshin nga opozita, sepse ashtu kemi koncentrim të të gjitha të drejtave vetëm te pozita. Do të duhej, po ashtu, që edhe deputetët e pavarur të jenë nëpër komisione me drejta të barabarta sikurse të tjerët, sikurse që, nëse e shikoni mirë, në një vend të Komisioni për Marrëdhënie me Jashtë, thotë: Ratifikimi në bllok ose ndaras të traktateve, të cilat Kosova dëshiron t'i nënshkruaj, është në kundërshtim flagrant me Kushtetutën, sepse ratifikimin e traktateve,

të marrëveshjeve e bën vetëm Kuvendi, e jo komisionet e tij. Ka mjaft dualizma brenda saj. Ne do të japim kontributin tonë në komisione, por në parim e mbështesim, sepse është një dokument shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm për mbarëvajtjen e punës së këtij Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Po, edhe njëherë po ju lus të na kurseni, është në parim. Të gjitha komisionet dhe grupet parlamentare, edhe njëherë po them, edhe deputetët e kanë të drejtën të amendamentojnë. Keni parasysh kur diskutoni, se janë disa norma standarde që i kanë vendosur të tjerët dhe ne nuk mund t'i ndryshojmë, se gjithnjë po thirremi në standarde. Disa çështje që i kundërshtoi shefi i Grupit Parlamentar i AKR-së, vërtet janë standarde dhe janë edhe në rregullore të parlamenteve të tjera. Kështu që, të kemi mirëkuptim në këtë drejtim!

Fjalën ia kisha dhënë Ahmet Isufit edhe në emër të Grupit të AAK-së, edhe si kryetar i Komisionit.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Rregullorja është punuar që nga 5 maji 2008 dhe në hartimin e saj kanë marrë pjesë të gjithë përfaqësuesit edhe nga partitë e tjera politike, po ashtu të përkrahur nga ekspertët e NDI-së, të ICO-s dhe të OSBE-së. Po ashtu, është mbajtur edhe një, 3 ditë kemi pasur një punëtor, në të cilën janë angazhuar të gjithë dhe kanë dhënë kontributin e tyre, duke marrë parasysh të gjitha specifikat që i ka Parlamenti ynë dhe duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Sllovenisë, të Shqipërisë, të Bundestagut Gjerman dhe janë marrë përvoja edhe nga vendet e tjera. Do të thotë, sidomos në këto jemi bazuar.

Duke pasur parasysh se është leximi i parë, konsideroj se duhet në parim të aprovohet edhe amendamentohen pastaj me të gjitha angazhimet që i kanë edhe grupet parlamentare dhe përfaqësuesit në komisione, që janë. Prandaj, konsideroj se për këtë rast nuk dua të zgjas më shumë, por ta amendamentojmë edhe shkojmë më tutje në leximin e dytë, pastaj.

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Në emër të Grupit të LDD-së, fjalën e ka kërkuar Adem Salihaj. Urdhëro!

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe unë mendoj që kjo Rregullore është dukshëm më e mirë se ajo aktuale që e kemi. Në fakt, ky projekt i rregullores i definon më mirë disa çështje dhe mundëson një punë shumë më efektive të Kuvendit të Kosovës. Megjithatë, ka vërejtje dhe mendoj që shumë vërejtje që u thanë janë me vend, në procesin e mëtejshëm duhet t'i marrim parasysh.

Në mënyrë të veçantë mendoj që duhet saktësuar disa çështje në rregullat 22, 23 dhe 24, veçanërisht te rregulla 39, që ka të bëjë me interpelancën. Mendoj se duhet ndryshuar diçka, meqë është rregull që interpelancën gati gjithmonë e kërkon opozita dhe me Rregulloren e tashme, po edhe me këtë projektregullore opozitës nuk i mundësohet që të thotë atë që realisht do të duhej ta thoshte. Kështu që, mendoj se në rregulloren që do ta aprovojmë dhe që duhet të amendamentohet, është mirë që të parashihet së paku një kohë e barabartë për pozitën dhe opozitën, në mënyrë që opozita ta ketë mundësinë ta thotë gjithë atë që dëshiron. Përndryshe, interpelanca në mënyrën si është bërë deri më tash, por edhe me këtë projektregullore nuk ka domethënie dhe s'ka kuptim. Edhe aty është

një gabim. Mendoj që duhet të përmirësohet në procedurën e mëtutjeshme të minutazhi, sepse është paraparë që interpelanca të jetë 3 orë, në fakt propozohet që çdo deputetë të ketë nga 2 minuta, që bëjnë 4 orë. Këtu është një shpërputhje dhe mendoj se do të përmirësohet në procesin e mëtutjeshëm. Në parim, ne e përkrahim dhe do ta japim kontributin tonë më tutje.

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” fjalën e ka kërkuar ministri dhe deputeti Mahir Yagcilar.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, faleminderit, zotëri Kryetar!

I nderuari Kryetar i Parlamentit,
Të nderuar deputetë dhe ministra,

Grupi “7+” në parim e përkrah Projektregulloren e Kuvendit të Kosovës. Edhe ne në grupin punues kemi qenë pjesë aktive. Mendojmë se aprovimi i Rregullores së Kuvendit të Kosovës është një çështje e rëndësishme për funksionimin normal dhe efikas të Kuvendit, sidomos pas aprovimit dhe fuqizimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kështu që në parim, thashë, e përkrahim Projektregulloren dhe besojmë që do të aprovohet me një shpejtësi, sepse nevojitet për funksionimin më të mirë.

Rregullorja, sigurisht, duhet të jetë e qartë dhe pa dilema ose dykuptimësi dhe duhet të jetë në përputhje të plotë me Kushtetutën.

Në parim, si vërejtje e paraqes që shumë çështje të përmendura në Kushtetutë nuk duhet të përsëriten edhe në Rregullore. Ndërsa, vërejtje konkrete kam të rregulla 15.5, ku mendoj i njëjti duhet të harmonizohet me nenin 69 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ose me titullin - Seanca dhe kuorumi, ku parashihet të jenë sesionet plenare.

Gjithashtu, në Rregullën 52.4 mendoj se në vend të “komisionit funksional”, duhet të thuhet “komisionet e përhershme”.

Rregulla 55, gjithashtu, shqyrtimi i tretë i projektligjit duhet të rishqyrtohet, sepse ky nocion është prej Kornizës Kushtetuese, kjo duhet të konsultohet me Kushtetutën, a kemi drejtë për leximin e tretë të një ligji.

Të mendohet edhe për votimin dhe kuorumin në komisionet parlamentare, që të mos krijohen konfuzione gjatë punimeve të komisioneve. Gjithashtu, duhet menduar edhe për komisionet, në të vërtetë ekziston ad-hoc Komisioni ose grupet e miqësisë, të qartësohet roli edhe misioni të këtyre komisioneve. Me këto vërejtje, unë dëshiroj t’ju përshëndes edhe prapë ritheksoj se në parim e përkrahim Projektregulloren. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, fjalën e ka kërkuar Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovane kolege poslanici,

Poslanički klub Samostalne liberalne stranke naravno u načelu podržava ulazak skupštinsku proceduru ovakvog Nacrta poslovnika i smatramo da on, u ovoj formi u kojoj je dat Skupštini, predstavlja jednu jako dobru osnovu da se eventualno uz neke male korekcije unapredi i da pospešimo bolji rad Skupštine. Naravno, imamo neke sugestije

koje ćemo na komisijama izneti, jer se ovo i onako ne piše, ne može da stiže transkript u pisanom formi na Komisiji pa da se uzme kao predlog. Želeo bih samo da kažem da će mnogo bitnije biti ono kada ga budemo doneli i ne sumnjam da ćemo napraviti jednu dobru formu, kako ćemo poštovati taj poslovnik i koliko ćemo implemantirati to u Parlamentu. Hvala vam puno!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Ndihem i obliguar që çmoj dhe të vlerësoj punën e dobishme të hartuesve të Projektregullores. I çmoj, sepse janë projektuesit e nismëtarit të hapit të tretë madhor pas shpalljes së pavarësisë dhe hartimit dhe vënies në funksion të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Vlerësoj veçanërisht punën e hartuesve të këtij projekti jo, thjeshtë, nga përshfaqja e aftësive të tyre profesionale për harmonizimin e kësaj rregulloreje me Kornizën Kushtetuese, me të cilën kanë vepruar dy legjislaturat para nesh, por për përgjegjësinë e kompetencën e hartimit të strukturës dhe përmbajtjen e kësaj rregulloreje që na paraqitet sot, për shqyrtim e miratim, në përputhje e në funksion të zbatimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Miratimi i strukturës dhe i përmbajtjes së Projektregullores së Kuvendit dhe shndërrimi i saj në ligj, pas miratimit nga Kuvendi, shënon një ngjarje historike jo vetëm për institucionet politiko - shtetërore të Kosovës, si shtet i pavarur, por edhe për të gjithë qytetarët tanë. E them këtë, nisur nga dy fakte: nga shpallja e pavarësisë dhe nga hartimi dhe vënia në funksion e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miratimi në parim, prej nesh sot, i Projektregullores së parashtruar mendoj se do t'i shërbejë konsolidimit të pavarësisë shtetërore, demokratizimit, aktivizimit e fuqisë vepruese të shtetit në Kosovë dhe përshpejtimit e prosperitetit për mbarë qytetarët e shtetit tonë.

Duke vlerësuar këtë Projektregullore, që është ligji i funksionimit të pushtetit ligjvënës, që është zemra dhe treguesi kryesor i përfaqësimit e karakterit të Republikës sonë demokratike, me predispozitën dhe dëshirën për t'i kontribuar përmirësimit dhe përsosjes së këtij projekti, do të sugjeroja në parim:

Që ky projekt, pas miratimit në parim dhe miratimit në leximin e dytë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, do të marrë fuqi ligjore për organizimin, kompetencat, funksionimin e strukturave dhe buxhetin e organit më të lartë legjislativ - Kuvendit. Dhe, duke qenë ligj, Rregullorja e Kuvendit duhet të shfaqë dhe të bartë edhe termat përkatëse të parashtrimit të përmbajtjes së tij. Ligji përshfaqet në nene e paragrafe nenesh dhe jo përmes termit rregullore ose rregulla.

Prandaj, sugjeroj që veçimi i ideve të çdo kreu të Rregullores, të mos bëhet me termin -rregulla x, por me termin -neni numër x. Projektregullorja të shmangë sa të jetë e mundur, jo vetëm transplantet, por edhe përjasjet e dukshme me nenet e caktuara të Kornizës Kushtetuese dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Mendoj që është e panevojshme që Rregullorja të përmbajë rregulla, nene të bartura në projekt për statusin dhe të drejtat e detyrat kushtetuese për kryetarin e Kuvendit, zgjedhjen e kompetencat e presidentit, të Qeverisë dhe të organeve të tjera kushtetuese, sepse janë sanksionuar me Kushtetutë.

Tre, Projektregullorja të jetë më koncize dhe më shumë në shërbim, zbërthim, interpretim e zbatim të Kreut IV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 83, 82 të kësaj Kushtetute. Në këtë mënyrë, Rregullorja do t'i shërbejë më mirë e më drejtpërdrejt organizimit, funksionimit dhe kontrollit institucional e publik mbi veprimtarinë e Kuvendit të Republikës.

Njëherësh, me këtë ajo do të jetë më optimale në të përdorur nga deputetët në zbatim të kompetencave të tyre ligjore në seancat plenare, në mbledhjet e komisioneve plenare, por edhe në takimet e tyre me zgjedhësit.

Na duhet një rregullore që mund të mbahet kurdo herë me vete, me të cilën mund të konsultohesh në çdo kohë. Mendoj që rregullorja duhet të jetë një dokument i pandashëm dhe i përhershëm konsultimi, në nxitjet e veprimtarisë produktive, por edhe në parandalimin e gabimeve të mundshme gjatë punës.

Propozimet konkrete në ndihmë të realizimit të sugjerimeve që i dhashë, do t'ua parashtroj me shkrim komisioneve përkatëse, me mendimin se mund t'i vlejnjë Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore për të përsosur strukturën e përmbajtjes së Rregullores së Kuvendit para parashtrimit në këtë sallë, në lexim të dytë. Ju falënderoj!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Tash, unë po përsëris edhe njëherë çka thashë më parë, s'po mbarojmë kurrfarë rregulloreje për herë të parë, por po përpiqemi ta përmirësojmë një që e kemi të botuar tri-katër herë dhe do ta shihni, në fund, që nuk ka edhe aq ndryshime të mëdha në këto propozime.

Sido që të jetë, unë kam parë insistimin që duken disa propozime themelore. Unë sa shoh, në punën e legjislacionit është që komisioni funksional ta shohë ligjin shumë më herët dhe më fuqishëm, para se të shkojë në lexim të parë, që unë e konsideroj që është punë e mirë. Në pjesën e asaj që quhet debat foljor, kemi tri mundësi të të folurit, ta quajmë ne jashtë temave të përcaktuara me rend dite: deklaratat e deputetëve, deklaratat e ministrave, deklaratat e grupeve parlamentare, që do të marrin mjaft kohë, kur të shtohen bashkë edhe me pyetjet parlamentare, nëse ruajmë ende këtë strukturë të punës në Kuvend. Po, ajo që për mua është me rëndësi që të studiohet në këtë ndërkohë, që kemi deri në aprovimin përfundimtar, është të kihet kujdes. Edhe në këtë rregullore kemi, zoti Makolli pak e përmendi problemin, kemi hyrje të ndryshme të shikimit të problemit, sepse kjo po na ndodhë edhe me problemin rreth mandateve të deputetëve. Kreu themelor i Kushtetutës sonë thotë decidivisht, që nuk guxojnë të përsëriten mandatet në pjesën ekzekutive legjislative, po kreu kalimtar i të njëjtës kushtetutë lejon që deputetët të jenë edhe në legjislativ, edhe në ekzekutiv. Pra, kemi një projektim të bazës kushtetuese dhe një situatë reale që e kemi. Kjo ka të bëjë edhe me komisionet, keni kujdes, nëse i shihni edhe me vetë Kryesinë e Kuvendit, se kemi një Kryesi, e cila në bazë të Kushtetutës, në këtë legjislacion vazhdon me të njëjtat detyra dhe me të njëjtën përbërje, ndërsa në anën tjetër, kemi një kushtetutë që e parasheh një kryesi me tjera funksione dhe me përbërje tjetër. Keni kujdes, ne mund të bëjmë rregullore për këtë legjislacion, por rregullore për legjislacionin e ardhshëm ne nuk mund të bëjmë, se ai legjislacion s'do ta pranojë dhe është problem i saj. Në këtë që kam unë përpara, unë veç po ju them që kam objeksionin, nenin 27.33, 42.43, 44.58, 63, unë do t'i jap, si edhe kolegu Haliti, ato që i kam thënë, të

konkretizuara në mënyrë që mos t'ju marrë kohë tash. Normalisht, jam që kjo rregullore të kalojë në princip, në lexim të parë sot, por se më duket që ka punë shumë ende. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë do të paraqes një çështje që mendoj se është lënë pas dore dhe dëshiroj që të marrë edhe konfirmimin prej kësaj seance. Fjala është për një nen ose artikull lidhur me Buxhetin e Kuvendit të Kosovës. Mendoj që kjo mungon dhe mendoj që procedurat e buxhetimit të Kuvendit të Kosovës të rregullohen në atë mënyrë që të jenë analoge me mënyrën e buxhetimit të agjencioneve të pavarura. Është një procedurë e veçantë dhe mendoj që duhet ta gjejë vendin në këtë rregullore, e cila po pretendojmë që të bëhet edhe ndoshta edhe ligj. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka kërkuar ministrja Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë u paraqita për dy arsye. Arsyeja e parë është se po thuaj se çdo legjislaturë po e nxjerr rregulloren e vet dhe kjo është rregullorja e tretë. Këtu ka çështje që rregullohen edhe për legjislaturën e ardhshme, që për mendimin tim nuk do të duhej të gjenin vend në këtë rregullore, ose së paku ato të gjejnë vend në dispozitat kalimtare dhe të fundit. Kjo është e para.

Arsyeja e dytë e paraqitjes time është për të dhënë një kontribut apo për të dhënë një material për komisionin funksional si vërejtje që nëse do t'i marrë, t'i bëjë në formë të amendamenteve, e këto vërejtjet e mia kanë të bëjnë me nenin 5, ku mendoj se përkufizimet nuk duhet të jenë si shtojcë e rregullores, por duhet ta gjejnë vendin e vetë në fillim të kësaj rregulloreje.

Nga ana tjetër, në nenin 10, pas pikës 2 do të duhet të shtojë apo të rregullohet me rregullore, çka nëse në seancën e radhës, deputeti nuk e jep betimin, pra të rregullohet këtu në këtë nen, sepse këtu thotë: "Deputeti që mungon në mbledhje konstituive kur bëhet betimi, betimin e bën në mbledhjen e parë të radhës", e çka nëse nuk vjen edhe në mbledhjen e parë të radhës? A duhet të kuptohet kjo se heq dorë nga posti i deputetit, apo çka. Apo gjithnjë të përdoret e radhës, e radhës.

Pastaj, rregulla 13, këtë e thashë veç. Te neni 17 është përvjedhur një gabim teknik, ndoshta: "propozon rendin e ditës, nënshkruan aktet e miratuara nga Kuvendi, mbikëqyrë rendin gjatë seancës", ishte dashur të shtohet, e për të vazhduar teksti: "dhe ushtron edhe funksione të tjera". Fjala është për Kryetarin e Kuvendit.

Pastaj, në nenin 24, pika 3, thuhet këtu në Rregullore "Komisioni brenda 2 ditëve pas njoftimit nga kryetari i Kuvendit, shqyrton rastin e deputetit të ndaluar ose të arrestuar, duke dëgjuar organin kompetent të ndjekjes dhe deputetin e ndaluar ose të arrestuar". Unë kisha për ta shkurtuar këtë afat dhe do të thosha "ditën e ardhshme menjëherë ta dëgjojë komisioni" sepse është çështje urgjente, nuk është një çështje shumë e këndshme

që një deputet të mbahet në arrest përkatësisht të ndalohet brenda dy ditëve, sepse aq zgjatë edhe ndalimi me Kodin e procedurës penale, 2 ditë – do të thotë 48 orë e pastaj i dorëzohet gjyqtarit apo prokurorit të çështjes dhe mund t'i caktohet edhe paraburgimi prej 30 ditësh, nëse brenda këtyre 2 ditëve nuk vendoset lidhur me deputetin e arrestuar nga ana e komisionit.

Humbja e statusit të deputetit. Kjo ndërlidhet me nenin 10, kur thashë, çka nëse nuk e bën betimin në seancën e radhës, sepse këtu flitet për humbjen e mandatit nëse nuk e bën betimin. A konsiderohet ajo mosbërje e betimit.

Pastaj, po kështu, në nenin 25, paragrafi 2 “për një vit” është paraparë, e unë kisha thënë për “më shumë se 6 muaj”, sepse edhe ashtu deputetit i pushon mandati, nëse pa arsye mungon 6 muaj.

Dhe, në nenin 37, paragrafi 2, thuhet: “në fillim të seancës kryesore bëhet propozimi për rendin e ditës me shkrim” e tjera, e tjera. Duhet të qartësohet kur dhe ku dorëzohet propozimi me shkrim, aty për aty në seancë, apo më përpara, nëse bëhet me shkrim. Unë mendoj se duhet të rregullohet dhe të thuhet “më përpara”, sepse ne e marrim thirrjen për seancë më përpara, para se të vijmë në seancë.

Vetëm edhe një vërejtje e kam. Çështja e përdorimit të gjuhës, mendoj se nuk është dashtë të lihet këtu bash për fund, por duhet ta gjejë një vend më përpara në tekstin e Rregullores. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Përshëndetje, zotëri Kryetar!

Ministra dhe deputetë,

Disa rekomandime parimore. Nuk bën, nuk duhet dhe nuk ka nevojë që në këtë rregullore apo në cilëndo rregullore të përfshihen edhe dispozita, qoftë nga ligji, se mos të flasim nga kushtetuta, e kështu është vepruar me nenin 9, 8, 21, 27, po e zëmë, kryetari, detajisht në Kushtetutë është përshkruar copy-paste, edhe te kryeministri, neni 29, kështu që rregullorja sa më e shkurtër, më koncize që është, më e aplikueshme, më e përdorshme është dhe e kundërta, sa më vëllimore është, është më nebuloze.

Duhet “nene”, jo “rregulla”. Cenohet me nenin 40, sikur të miratohej, do të cenohej e drejta kushtetutare e deputetit, ku thuhet “mund t'i parashtrojë deri në dy pyetje kuvendore. Deputeti mund të parashtrojë pyetje aq sa vlerëson. Tjetër është kapaciteti, ka mundësi për t'u përgjigjur apo s'ka mundësi. Prandaj, kjo do të ishte në kolizion me Kushtetutën, prandaj nuk mund të jetë e tillë.

Edhe tash, me rregulloren që është në aplikim, edhe këtu çështja urgjente duhet të definohet qartë, sepse nuk është e definuar qartë dhe nga aty dalin edhe, si të them kështu, diskrepanca. Unë personalisht e kam pasur një rast që iu kam përmbajtur kësaj, por ka dalë ndryshe se çështja e interpretimit dhe fajtor nuk është kush tjetër, pos hartuesit që e ka lënë të paqartë.

Këtu u përmend mirënjohje. Komisioni e ka bërë një punë të mirë dhe për atë ne po e miratojmë, në parim. Mirëpo, megjithatë, meqenëse u përmendën disa dokumente të këtilla të disa shteteve demokrate të përparuara, e në ato dokumente përpos termeve “komisione”, ka edhe “komitete”, ka edhe “pleqësi”, ka edhe “këshilla”, kështu që nuk

janë rastësisht të dhëna ato, sepse për këshillin ekziston një definicion, për pleqësinë një definicion e një kuptim dhe nuk duhet të jenë të gjitha këto komisione të ne vetëm komisione.

Më pastaj, termi, bie fjala, prapë është bartë, që ishte, që është në aplikim. Komision kryesor, raportues, përgjegjës. Nuk ka komision kryesor. Komisioni raportues për atë temë është kryesor dhe është përgjegjës, prandaj ne duhet t'i përshtatim termat, t'i gdhendim.

Do të ishte krejtësisht korrekte që, nëse do ta limitonim kohën për pyetjen e deputetit në dy minuta, që edhe përgjigja të ishte dy minuta, se më lehtë është për t'u përgjigjur se për të pyetur. Edhe me atë do ta kishim obliguar ministrin që të përgatitet, se kur përgatitet ministri mund të përgjigjet për një minutë, kur nuk përgatitet, s'mundet për 10 minuta.

Duhet medoemos, në parim, çka, çfarë, në qoftë se ministri nuk përgjigjet fare, e neglizhon pyetjen e deputetit. Çfarë? Domethënë, ta obligojmë që ta japë në seancën tjetër. Përpos publikimit, edhe të japë arsyetimin se përgjigja në pyetjen e deputetit është relevante. Për deputetin, për kryetarin e Kuvendit, për vetë ministrin është nder, edhe aq më tepër për votuesin. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Ju njoftoj se edhe pesë pika të rendit të ditës i kemi. Radha është e deputetit Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, Kryetar!

Po ma bën nga pak me hile, po ne jse!

Debati, në parim, e ka rëndësinë e vet, mendoj për këtë projektregullore, për shkak të rëndësisë që e ka ajo, për organizimin e punës së Kuvendit dhe krejt ajo çka e përfshinë vetë rregullorja, për përgjegjësitë dhe kompetencat e Kryesisë, të grupit parlamentar, të komisioneve parlamentare dhe të deputetëve, kushtet dhe detyrimet e tjera që dalin. Ne në mes veti kemi biseduar shpeshherë, ndoshta kemi dhënë vërejtje, por sot kujtoj që është mirë këtu në Parlament t'i debatojmë dhe të shohim më tutje se si mund ta ndërtojmë më mirë këtë rregullore për punën tonë më të mirë.

Nga 19 kapituj, sa janë këtu, unë do të jap vërejtje në parim tek 4 kapituj dhe atë sa më shkurt.

Te kreu VI, kemi rregullën 20 ku flitet atje për të drejtat e deputetëve, mandatet, e tjera. Unë mendoj se është mirë, ndoshta, të marrim iniciativën në këtë debat dhe të shohim arsyeshmërinë dhe kodifikimin e një sjelljeje të deputetëve, të pamundësohet ndoshta që deputeti i zgjedhur nga një parti ta lëshojë grupin parlamentar të vetin dhe të dalë te një parti tjetër. Pra, të provohet mundësia e kodifikimit të kësaj, në mënyrë që të ruhet vota e atij elektorati. Një deputet, ndoshta, mundet nga partia ta lëshojë grupin e vet parlamentar, por jo të kalojë në parti tjetër, ose në grup tjetër parlamentar. Le të bëhet i pavarur, ndoshta e ka një logjikë, por nga një parti në partinë tjetër, nuk ma merr mendja. Kjo është për ta ruajt, do të thotë atë, të mos bëhet tregti me votën e elektoratit që e ka zgjedhur, të shkojë në parti tjera. I pavarur mund të dalë. Që, për shembull, nesër dikush prej PDK-së ndonjë deputet do të dalë në LDK, nuk duhet t'i mundësohet kjo. Po, nuk duhet!

Te kreu VII, rregulla 21, i kemi të drejtat dhe detyrat e deputetit. Unë mendoj që deputetëve që 7 vite a më tepër, sa po bëhen këtu, iu kemi mbetur borxh shumë, sidomos

te krijimi i kushteve për punë. Kemi folur nganjëherë shumë, nganjëherë është tepruar, bile-bile e shfrytëzoj të drejtën, sot po reagoj ndaj të gjithë atij, po them, spekulimi të madh që u bë me imazhin e deputetëve para pak kohe me një iniciativë që shumë mirë u mor për të menduar diçka për kushtet më të mira të deputetëve. E dini se si ka përfunduar krejt ai debat, absolutisht në kurriz të imazhit dhe, si të them, të këtij mandati të deputetit, pa të drejtë, sepse asnjë deputet, përjashtuar dy-tre vetë, askush tjetër nuk e ka ditur se çka po zhvillohet dhe çka po bëhet. Po them, edhe pse është menduar mirë, krejt ajo është keqpërdorur më vonë prej të gjitha informatave që janë përcjellë. Kështu që, kujtoj se duhet në këtë rregullore të parashihet që zyra për deputetë të jetë një detyrim për Kuvendin më. Është tepër, tepër luksoze të lejohet kjo dhe të mos bëhet për deputetin. Ku ka për të punuar deputeti? Ku jemi duke punuar ne? Në një formë apo tjetër, ajo duhet të zgjidhet dhe jo vetëm të mbetet një dëshirë, sepse s'ka mundësi të punohet, nëse dëshirojmë të punojmë. Dhe, disa kushte të tjera elementare të cilat i duhen deputetit, e nuk i ka, realisht nuk i ka. Nëse nuk i ndërtojmë brenda rregullores, unë s'e di kush mendon për ne.

Te kreu XI. Unë pajtohem me atë që është futur deklarata lidhur me rendin e ditës. Mendoj se ka për t'iu dhënë një mundësi deputetëve që me deklaratat e tyre për çështjet që dëshirojnë t'i bëjnë publike, por duhet të shihet se a ka kaluar kohën apo a e dhanë provimin çështjet e pyetjeve parlamentare. Mendoj se kanë filluar të demodohen. Ky është një mendim i imi dhe kjo e dyta mund të jetë, ndoshta, një provë më e mirë për të parë se çka po del si nevojë dhe si temë e rendit të ditës.

Dhe, te kreu i fundit, gjegjësisht kreu XIII, kur është çështja e komisioneve të Kuvendit. Vërejtja ime parimore është që t'i shtohet, aty kur është për anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, t'i shtohet edhe për shefat e grupeve parlamentare që të mos jenë kryetarë të komisioneve, për shumë arsye. Ata kanë për të udhëhequr grupin parlamentar, për t'i ndarë detyrat, për t'i ndarë do të thotë ato mandate për të cilat u fol edhe këtu. Pra, mendoj se është mirë kjo të kihet parasysh.

Dhe, një çështje tjetër parimore, kujtoj është te çështja e veprimtarive, te komisionet parlamentare. Nuk duhet të lejohet asnjë subordinim në mes të komisioneve, por duhet të ketë vetëm koordinim. Pra ka tentime dhe prova të tilla të cilat më japin të drejtë ta shtroj edhe këtë çështje si vërejtje parimore.

Dhe, krejt në fund, unë e përqafova me shumë respekt propozimin e Kryetarit të Parlamentit për mandatet e dyfishta, që i tha, ose interpretimi i Kushtetutës, që të shikohet tash ky debat politik deri në leximin e dytë kur kemi të bëjmë, do të thotë, me Parlamentin – legjislativin dhe Qeverinë dhe vërtet kjo të merret me shumë seriozitet, gjatë këtij debati deri në leximin e dytë. Unë kujtoj se kjo ka për të dhënë një fuqi të mirë, një punë shumë më e mirë ka për t'u bërë këtu në Parlament dhe një punë shumë më efektshme dhe shumë më serioze ka për t'u bërë në Qeverinë e Kosovës. Prandaj, ta provojmë, ta ndajmë këtë mandat dhe unë e përkrah dhe e përqafoj dhe kërkoj që kjo të futet, do të thotë, në kuadër të kësaj rregulloreje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po për këtë të fundit, vërtet na pengojnë dispozitat përfundimtare të Kushtetutës. Për sa i përket mandatit të deputetit, neni 70 i Kushtetutës, paragrafi 1, thotë: “deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues”. Do të thotë, këtë e thotë Kushtetuta. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje, kolegë deputetë!

Është vërtet për ta përshëndetur këtu në mënyrë qysh po bisedohet dhe qysh po shqyrtohet rregullorja që ka fuqinë e ligjit dhe është ligj në të vërtetë për Kuvendin, por duhet pasur parasysh se është fjala për një rregullore të tranzicionit, e cila domosdo edhe do të kishte, do të ketë vulën e këtij tranzicioni. Rregullorja është punuar me kufizimet që u theksuan dhe thuaja janë mirë të njohura. Një, Kushtetuta e Kosovës që vendos tamam kornizën, siç është thënë, po me shumë mangësi brenda saj edhe në formulime, e tjera, që pastaj e ka bërë ndonjëherë edhe të zorshme ndërtimin e relacionit adekuat me të. Për më tepër, janë pastaj edhe këto - pakoja e tjera, që po ashtu aty-këtu kufizojnë dhe sidomos fakti që Kushtetuta ka paraparë procedura të ndryshme dhe struktura të ndryshme për këtë legjislaturë dhe për legjislaturën tjetër. E ka bërë edhe të zorshme koherencën e kësaj rregulloreje, por edhe e ka bërë të domosdoshme atë që u kontestua me të drejtë dhe ka qenë kontestuar edhe në grupin punues që rregullorja megjithatë të ketë njëfarë mënyre dy rrafsh, një rrafsh që është për këtë legjislaturë dhe rrafshin tjetër për legjislaturën e ardhshme. U tha këtu se s'ka pas nevojë të thuhet, të bëhet fjalë për atë se do ta bëjë legjislatura e ardhshme. Po, kjo rregullore ka pasur parasysh një nevojë që do të jetë shumë shpejt aktuale, sepse me të përfunduar kjo legjislaturë, krijohet vakumi dhe është nevoja e konstituimit dhe e ndërtimit të strukturave. Nëse s'do të kishim një bazë ligjore, ne do të ishim detyruar të vazhdonim me këtë strukturë, kurse kjo do të ishte antikushtetuese dhe do të bëhej një ramasis i tërë. Prandaj, ju lutem që duhet edhe të kihet mirëkuptim për këtë.

Mendoj që përsosja e Kushtetutës, si pasojë do të jetë një konstantë që mendoj se nuk mund të kontestohet edhe në punën që është bërë. Aty-këtu vërehen edhe ngatërime nga fakti se kanë qenë në qarkullim tekste të ndryshme dhe ndonjëherë edhe mund të citohen gabimisht.

U theksua, pse shtojca të përkufizimet, ose pse përkufizimet fare. Ka qenë kjo dilemë në grupin punues dhe duke pas parasysh nevojën që deputetët të kenë një fjalor të terminologjisë parlamentare, edhe pse në asnjë rregullore nuk ka terminologji, si të thuhet, fjalor të terminologjisë parlamentare në rregullore, jemi përcaktuar që kjo të bëhet, por meqë fjalori që e kishim ne nuk ishte i saktë, mendoj se është i drejtë përcaktimi që kjo të bëhet në një aneks që dot ë jetë shtojcë dhe ajo pastaj nuk e rëndon rregulloren, por mund të jetë e përdorshme për ata që kanë nevojë për të.

Lidhur me çështjen e deklaratës, po përpiqem të mos i konkretizoj, por vetëm të flasim në parim, ka një ngatërrim deklarata për rendin e ditës aty-këtu dhe deklarata e deputetit. Në rregulloren e deritashme kjo po ashtu ka qenë e mundshme, por nuk është shfrytëzuar. Por, është edhe instrumenti tjetër, deklarata e ministrit. Nëse ministri mund të bëjë një deklaratë të çastit, pse të mos e bëjë edhe deputeti, jashtë në të gjitha parlamentet. Edhe çështja e imunitetit dhe e procedurës për marrjen e imunitetit është në rregullore të vendeve, të cilat ne i kemi marrë si bazë - të Sllovenisë, Kroacisë, Shqipërisë, Gjermanisë dhe të vendeve të tjera dhe ne s'mund të jemi përjashtim.

Unë përshëndes edhe praktikën që ka vendosur Kryesia për ta shqyrtuar si ligj, do të thotë që të kemi sot shqyrtimin në parim, të punohet më vonë, të vihet me amendamente dhe bashkërisht ta përsosim përmbajtjen e saj. Ju faleminderit, Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Dhe, diskutuesi i fundit, deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e kam një propozim konkret, por nëse më lejohet një sqarim paraprakisht për të kaluarën, që ishte sot në këtë seancë. Unë mendoj se atë që iu drejtova Parlamentit, disa kuptova që ishin ofenduar, e unë thashë për joekonomistët. Domethënë, atyre ua shpjegova dhe opinionit se disa gjëra që u thanë nuk ishin të qëndrueshme nga aspekti profesional. Domethënë, nuk thash për ekonomistët, kështu që çdo ekonomist këtu që është, s'ka nevojë të ofendohet, sepse ato i di, domethënë paraprakisht i ka ditur. Dhe, edhe ata që janë edhe ekonomistë edhe, bie fjala, juristë dhe i kanë shumë profesione, domethënë e kuptojnë edhe ekonominë, që ka edhe të tillë, edhe ata s'kanë pasur nevojë të ofendohen se edhe ata, domethënë, pasi i dinë shumë profesione, e dinë atë çka u tha, që nuk ishte në rregull. Por e thashë për ata edhe për opinionin që e kanë vetëm një profesion qeshtu si une, por që atë profesion nuk e kanë ekonomine, pra atyre ua shpjegova. Dhe, unë mendoj se debati im ishte në kufij të demokracisë, të demokracisë parlamentare. Këtu përfaqësojmë disa votues, siç e dini, nuk jam pjesëtar i Qeverisë, por nuk kam as parti politike, kështu që s'keni çka të frikoheni prej meje. Por, edhe një kujtesë të vogël, se e di unë, kur hipin në pushtet njerëzit harrojnë. Veç një kujtesë të vogël, le të kujtohen sidomos kolegët e mi të nderuar nga PDK-ja, çfarë kritikash iu keni dhënë ministrave të qeverisë së kaluar, pikërisht për profesionalizmin e tyre, kompetencën e tyre, e tjera e tjera.

Mendoj se edhe kjo është pjesë e demokracisë dhe në këtë notë të pjesës së demokracisë unë e kam një propozim shumë konkret, zoti kryetar, e kjo është për kohën e pyetjeve parlamentare. Mendoj se koha e pyetjeve parlamentare që është 60 minuta, tash veç është rritur edhe koha për pyetje në 2 minuta, dhe nëse i llogarisim të gjitha këto, po them, pyetja 2 minuta, pyetja shtesë 1 minutë, përgjigja 3 minuta, përgjigja shtesë 2 minuta, del që në seancat parlamentare të mos bëhen më shumë se 7.5 pyetje, po i lëmë 8 pyetje apo 9 pyetje. E dimë se kemi shumë pyetje të cilat po na vjetrohen për shkak të hapësirës, andaj unë kisha për të propozuar që një herë në javë, po them, për ata deputetët që paguhën, si unë, që marrin rrogë prej Parlamentit, një herë në javë ta mbajmë një kohë parlamentare, më falni, një seancë parlamentare dhe ta quajmë koha e pyetjeve. Kështu e praktikojnë edhe parlamentet e tjera. Domethënë, ato pyetje të cilat deputetët i kanë si, po them gjithmonë si përfaqësues të qytetarëve, domethënë t'i shprehin brengat qytetarëve, t'ia adresojnë Qeverisë. Mendoj se në dy seanca të rregullta nuk po mund që t'i debatojmë çështjet shumë me rëndësi dhe këtu sot u pa. Ne, edhe në të kaluarën nuk kemi mund të debatojmë për strukturat paralele, për këtë çështje, për atë çështje, tash edhe për politikën fiskale s'po mund të debatojmë. Mendoj se jemi përfaqësues të qytetarëve, domethënë pos atij rolit legjislativ veç për t'i votuar ligjet, e kemi edhe për t'i qarë hallet e qytetarëve, andaj këto 60-minuta nuk po na dalin, të paktën deri më tash. Jemi dëshmitarë që shumë pyetje po na vjetrohen, po e humbin kohën, po skadojnë, e edhe ashtu Parlamenti ka filluar në opinion të quhet si vend ku deputetët veç i përdorin gishtat, e jo trurin. Mendoj se do të ishte e rrugës që ta kemi një herë në javë një seancë parlamentare, po them, ne për këtë edhe paguhemi. Me ne po mendoj ne ata deputet që paguhën qeshtu si une, e jo për ata që nuk paguhën nese ka të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë! Vërtet duhet të mendojmë, por një gjë duhet ta kemi parasysh. Është mirë që kjo çështje që u shtrua e pyetjeve dhe e deklaratave, le të mendohet në të gjitha grupet parlamentare, le të futet si një seancë mujore nëse dëshirojnë deputetët, por jo seancë obligative, por për ata që donë të bëjnë pyetje dhe për ata që donë të bëjnë deklaratat. Por, qytetarët nuk ka nevojë t'i qajnë, ata i qajnë nënat e tyre. Ne jemi këtu për t'i zgjidhur hallet e tyre.

Tani do të votojmë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 “abstenim”, Kuvendi miratoi Projektregulloren e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në parim.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon Komisionin për Rregulloren e Punës, si komision përgjegjës dhe raportues, për të shqyrtuar Projektregulloren dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime.

Komisionet dhe grupet parlamentare mund të shqyrtojnë Projektregulloren nga aspekti i fushëveprimit të tyre dhe amendamentet eventuale ia paraqesin Komisionit për Rregulloren e Punës.

Kjo vlen edhe për deputetët, si individë, do të thotë edhe për Driton Talin, që është deputet i pavarur, mund të bëjë amendamente për të ndryshuar Rregulloren. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

- Projektligji për normën e akcizës në Kosovë

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 e Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij Projektligji.

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Përshëndetje të gjithëve!

Ne i diskutuam sot edhe tri ligje përpara. Ligji mbi normën e akcizës ka të bëjë vetëm me një pjesë të akcizës dhe ka të bëjë vetëm me ngritjen e akcizës së duhanit, përkatësisht shkruhet klauzula për ngritjen e cigareve që përmbajnë duhan me kod të caktuar, pra këto cigare që i pimë ne sot.

Kosova, deri më tani në bazë të Rregullores ka aplikuar akcizë 17 euro për njësi konvencionale, përkatësisht 17 euro për kilogram të cigareve, që ka qenë niveli më i ulët në regjion dhe ka mund të përdoret si pjesë e një, nëse mund të them, vendi ku ka mund edhe të ketë transite të cigareve për vende të tjera dhe shpeshherë është paraqitur vëllimi i importeve shumë më i madh sesa vetë konsumi real.

Përmes kësaj norme, ne konsiderojmë se mbushim mungesën, përkatësisht humbjet eventuale buxhetore për shkak të ngritjes, përkatësisht uljes së taksave dhe prapë jemi në nivelin më të ulët në regjion. Nominalisht dhe realisht do jemi prapë më të ulët në regjion.

Vendet e regjionit, siç është Shqipëria, e ka 19%, plus kanë doganën më të lartë në cigare. Maqedonia e ka më të lartë. Mali i Zi, Kroacia 35 euro e tjera, e tjera, dhe me këtë ende nuk rrezikohet, a po më dëgjoni, nuk rrezikohet eventualisht ndonjë mundësi e keqpërdorimit ose e rritjes së kontrabandës, përkatësisht konsideroj se administrata tatimore në bashkëpunim me doganën dhe posaçërisht pas zbatimit të ligjeve dhe të arkave fiskale që i kemi në plan t'i zbatojmë në vitin e ardhshëm, ne do të sforcojmë edhe

institucionet e tjera përcjellëse, gjithnjë me qëllim të ruajtjes ose të bllokimit apo të parandalimit eventual të keqpërdorimeve në këtë lëmi.

Me këtë ngritje, ne ngrisim një akumulim përafërsisht 12 milionë euro më shumë në vit, e cila na mundëson që faktikisht t'i kompensojmë ato nevoja buxhetore të cilat na nevojiten për ngritjen e rrogave, ngritjen e pensioneve dhe nevojat tjera të zhvillimit të shtetit të Kosovës.

Kërkoj nga deputetët që ta mbështetni edhe këtë projektligj, ndërsa Ligji mbi akcizën, i veçantë do të vijë në fillim të pranverës së vitit të ardhshëm për t'u shqyrtuar bashkërisht, me të cilin pretendojmë që t'i zgjidhim edhe segmentet e tjera të llojeve të ndryshme të duhanit, jo vetëm cigaret. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Në emër të Komisionit, fjalën e ka deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit!

Unë, në emër të Komisionit jam deklaruar edhe për këtë ligj dhe e përkrahim në emër të Komisionit rekomandimin që është dhënë. Po ashtu, edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, rekomandojmë që të mbështetet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Ramadan Avdiu e ka fjalën.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, sikurse edhe ligjet tjera të pakos fiskale, e ka shqyrtuar edhe Ligjin për tatimin e normës së akcizës në Kosovë dhe në parim e mbështet këtë ligj, duke u zotuar se do të japë kontributin gjatë shqyrtimit të tij në komisionet funksionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Duke parë se ministri kësaj radhe ishte shumë i qartë në lidhje me Projektligjin dhe në rast se ngritet akciza vetëm për duhanin, ashtu si e përshkroi ai, atëherë Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziri e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe ne, fillimisht, si grup e përkrahim në parim ligjin. Ngritja e akcizës do të mbushë buxhetin e Kosovës, mirëpo jemi skeptik për arsye se do të shtohet edhe kontrabanda, për arsye se ky artikull do të shtrenjtohet dhe do të funksionojë, por presim që fjalët e ministrit që i tha, do të organizohen sektorët e caktuar, si policia dhe dogana, dhe mos të lejohet kjo kontrabandë. Edhe pse ne e dimë se me doganat në veri se si i kemi punët, mund të ndodhë që ky artikull të kontrabandohet. Shpeshherë ndodhë që këta që e pinë duhanin, të pinë edhe erë të benzinës për arsye se kontrabandohet me këto dy produkte.

Shpresojmë se organet do ta kryejnë këtë detyrë më në nivel. Parimisht, e përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Berim Ramosaj e ka fjalën.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti Kryetar! Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së në parim e mbështet, por iu lë të drejtë individuale deputetëve kur vjen momenti i votimit, duke marrë parasysh rrethanat e caktuara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe nga ju! Në emër të Grupit Parlamentar “7+” deputeti Enis Kervan, e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti Kryetar!
Edhe Grupi Parlamentar “7+” është i mendimit se duhet të miratohet në parim ky projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović e ka fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, predsjedniče!
Parlamentarna grupa Samostalne Liberalne Stranke takode podržava u načelu u potpunosti ovaj zakon i glasamo naravno “za”. Nemamo nekih suštinskih primedbi tako da i u drugo čitanje verovatno ćemo podržati. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Për diskutim janë lajmëruar edhe dy deputetë. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Nga ekspozoja e ministrit, u tha se akciza do të rritet vetëm për duhanin. Unë mendoj personalisht se vërejtjen time do ta adresoj dhe ritheksoj edhe një herë se duhet të rritet akciza edhe te mallra të tjera luksoze. Pra, edhe te mallrat luksoze dhe për të mos e zgjatur, mendoj se propozimi duhet të shkojë në shqyrtim të mëtutjeshëm në mënyrë që në kuadër të paketës që e kemi propozuar gjatë modelimit, nëse bëhet ndonjë ndryshim, pra kjo të ndryshohet, e të mos ndryshohet TVSH-ja. Faleminderit!

KRYETARI: Prapë u bën dy deputetë! Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!
Meqenëse jemi duke diskutuar vetëm për një dispozitë lidhur me rritjen e akcizës së duhanit, patëm rastin edhe më herët, në projektligjet e tjera në shqyrtim për dispozitat e veçanta që aty u diskutuan, siç ishin ato për tatimin në paga personale apo individuale. Në këtë rast kisha menduar që të bëhet ndryshim komplet i ligjeve, të vinë ligjet me tekstin për ndryshimet dhe kjo mundësi t’i lejohet Qeverisë në të ardhmen që të bëhet në kuadër të ndonjë rregulloreje, e të mos merremi me çështje të caktuara sepse për politikën financiare edhe për mundësitë buxhetore duhet t’i mundësohet qeverisë vetë, e jo të ketë ndryshim tekstual në dispozita ligjore vazhdimisht, atëherë kur një qeverie i intereson ta bëjë një gjë të tillë. Kaq kisha për të shtuar. Ndërkaq, e tha në emër të Grupit parlamentar deputetja, zonja Selmani, se ne do ta mbështesim këtë dhe unë, besoj, se do të kem një vullnet timin të lirë të votoj. Faleminderit!

KRYETARI: Driton, u tërhiqe, a? Faleminderit! Atëherë, shkojmë në votim. Lus regjinë të përgatitet për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim”, Kuvendi miratoi Projektligjin për normën e akcizës në Kosovë.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues;
- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi;
- Komisioni për Komunitete, dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që, në afatin më të shpejt të mundshëm, Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime.

Është mirë që rekomandimet të jenë për seancën e datës 18 dhjetor. Pra, kjo vlen për Haki Shatrin. Faleminderit!

A vazhdojmë ose doni të bëjmë një pauzë sa për të pirë nga një kafe?

Atëherë, Vazhdojmë! Faleminderit!

Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës për fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe të furnizimit të KEK-ut**

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Telekomunikacion ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë për fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe të furnizimit të KEK-ut dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandimet.

Rekomandimi i Komisionit së bashku me propozim-vendimin e Qeverisë iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetaren e Komisionit, zonjën Muzejene Selmani, që para deputetëve të Kuvendit t’i arsyetojë rekomandimet.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Në bazë të Rregullave 36 dhe 46 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion më 17.11 dhe 24.11. 2008 shqyrtoi Vendimin e Qeverisë për fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe të furnizimit të KEK-ut Numër 03/38 të datës 02.10.2008. Komisioni miratoi rekomandimet të cilat ia procedon Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim, si vijon:

Mbështet në parim nismën e privatizimit të distribuimit dhe të furnizimit të KEK-ut, duke përcaktuar prioritetet në kuadër të procesit të privatizimit, si vijon:

- së pari duhet të realizohet dhe të përfundohet transformimi i plotë organizativ i korporatizimit të KEK-ut duke e përcaktuar statusin formal juridik të secilës njësi në kuadër të ndërmarrjes publike të KEK-ut;
- Gjatë vitit 2009 të përcillet dhe të merren parasysh rezultatet e afarizmit ekonomik për secilën njësi veç e veç;
- Të merret parasysh ndikimi i krizës globale në çmimin ofertues në procesin e privatizimit;
- Procedurat e privatizimit të fillojnë varësisht nga rezultati i fizibilitetit dhe konkluzioneve analitike në aspektin e afarizmit ekonomik, me kusht që privatizimi i njësisë së caktuar të jetë prioritet dhe përparësi ekonomike për vendin.

Njëkohësisht, kryetar, kërkoj që të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, nëse më jepet mundësia. Faleminderit!

Grupi Parlamentar i AKR-së, dy vendimet të cilat janë këtu në këtë dokument të Komisionit, shihet shumë qartë se Qeveria e Kosovës me një vendim kërkon shthurjen e KEK-ut, pastaj me një vendim tjetër nisë procedurat e privatizimit të KEK-ut. Pasi prezent sonte është këtu edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, i cili lidhur me Ligjin mbi ndërmarrjet publike është njeriu i parë i cili duhet të merret me privatizimin e ndërmarrjeve publike, kisha kërkuar prej ministrit të na japë sqarime a është krijuar një kornizë ligjore rregullative, e cila na mundëson privatizimin e ndërmarrjeve publike dhe sa është bërë ndarja e KEK-ut nga njësia e cila është dashur të formohet brenda KEK-ut për shthurjen e KEK-ut. Pra, në mungesë të ministres së Energjisë dhe të Minierave, ndoshta ministri do të na japë një përgjigje, kur dihet se kompanitë publike kanë një rëndësi të veçantë edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse neni 160 e potencon mjaft mirë që kompanitë publike, me miratimin e Kushtetutës, kalojnë në pronësi të Qeverisë, mirëpo Qeveria punon për të mirën e qytetarëve të vet dhe këtu e shoh mundësinë që ministri ta bëjë shumë të qartë çështjen e privatizimit të ndërmarrjes publike të KEK-ut. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A doni në fund, pasi të marrin fjalën grupet parlamentare të jetë sqarimi i ministrit apo tash të sqarojë këtë ministri. Në fund, doni. Në rregull. Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet kabinet qeveritar,

Përsëritet të nderuar deputetë,

Kjo çështje që po e diskutojmë këtë pikë të rendit të ditës ka ngjallë debate dhe ka nxitur reagime pro e kontra. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe të furnizimit të KEK-ut është shqyrtuar edhe në Komisionin parlamentar përkatës, i cili është përcjellë me debate, siç e thashë, pro e kontra.

Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë si dhe rekomandimet e Komisionit në fjalë i ka shqyrtuar në mënyrën analitike edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

Ne, si Grup Parlamentar, i mbështesim edhe vendimet e Qeverisë, edhe rekomandimet e Komisionit.

Të nderuar deputetë,

Do të përpiqem që në fjalën time të jam shumë e shkurtër nga se e kam parasysh edhe lodhjen që e kemi me punën gjatë tërë ditës, por si do qoftë do t'i them disa fjalë.

Ne kemi pasur informatën e Qeverisë lidhur me këtë çështje. Krahës kësaj, jemi dëshmitarë të gjendjes nëpër ndërmarrjet publike, përkatësisht në Korporatën elektroenergjetike të KEK-ut. Përndryshe, fjala KEK për qytetarët e Kosovës ka kuptimin e prodhimit të territorit, fjala KEK ka kuptimin e korrupsionit, fjala KEK ka kuptimin e keqmenaxhimit, keqpërdorimit e tjera. KEK-un e përcjellin mangësi dhe dobësi të ndryshme në të gjitha njësitë e saj përbërëse, e në këtë rast edhe në Njësinë e furnizimit dhe distribuimit. KEK-u, me fjalë tjera, është bërë një barrë e kushtueshme për buxhetin e konsoliduar të Kosovës, duke shpenzuar kështu më tepër se 70 milionë euro në vit. Nga ana tjetër, performancat jashtëzakonisht të dobëta të KEK-ut si, dhe mungesa e sigurisë në furnizim me energji elektrike, janë një pengesë e madhe edhe për tërheqjen e investitorëve të huaj, të cilët ngurrojnë të investojnë në Kosovë në këtë gjendje të furnizimit me rrymë.

Energjia elektrike është një domosdoshmëri absolute për progresin e vazhdueshëm të zhvillimit të Kosovës dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Të gjitha këto që thuhet në informatën e Qeverisë dhe të gjitha ato që shihen, kanë shtyrë Qeverinë në një vendim të tillë dhe ky vendim është edhe konform strategjisë së Qeverisë dhe përcaktimit të saj sa iu përket ndërmarrjeve publike. Me këtë rast, desha ta shfrytëzoj rastin t'ia përkujtoj edhe kryetares së Komisionit, se në një vendim të Qeverisë, në pikën 2, në mes tjerash thuhet se grupi punues ndërqeveritar, i formuar për privatizimin e distribuimit dhe të furnizimit të KEK-ut do t'i rekomandojë Qeverisë se cilat divizione në kuadër të KEK-ut do të privatizohen. Për mua, kjo ka një domethënie shumë të madhe, e ne na mbetet si Parlament t'i përcjellim hapat e mëtutjeshëm të Qeverisë dhe kërkojmë nga Qeveria që të jetë transparente në këta hapa.

Ftoj të gjithë deputetët që t'i mbështesin rekomandimet e komisionit parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ësë, fjalën e ka kërkuar deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar këtë dokument që është ofruar sot për shqyrtim dhe miratim. Grupi Parlamentar i LDK-së, në parim është për privatizimin e një pjese të ndërmarrjeve publike ose të tërësisë së ndërmarrjeve në bazë të rregullave dhe të Ligjit në fuqi.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike i përkrah rekomandimet e Komisionit për Tregti, Industri, sepse vlerësojmë se ky rekomandim nuk e pengon Qeverinë të realizojë vendimet që i ka marrë lidhur me fillimin e privatizimit të pjesëve të KEK-ut, por

nënkupton që ky proces të bëhet me kujdes dhe pas punëve paraprakisht përgatitore për të filluar realisht procesi i shitjes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Muzejene urdhëro, se po më duket replikë ke.

MUZEJENE SELMANI: Vetëm për sqarim. Mjaft mirë në dokumentin e Qeverisë thuhet se fillon procesi i privatizimit të rrjetit të distribucionit dhe të furnizimit. Në rast se ministri kishte për të thënë, unë një herë po e bëj vlerësimin e të gjitha divizioneve dhe të gjitha aseteve, e pastaj do t'i qes në privatizim, atëherë do të vliente metodë krejt tjetër. Këtë e pata për sqarim. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AKR-së, a dëshiron të marrë ndokush fjalën. Jo. Në rregull! Fjalën e ka Shkumbin Demaliaj. Po, ai e tha njëherë fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, Kryetar!

I kemi edhe nja 2-3 minuta në media dhe po e shfrytëzojmë se kundër këtyre politikave ka qenë vetë qeverisja në hije, qeverisja e mirë e PDK-së, e tash po na vjen mirë që ka filluar t'i pranojë ato politikat e përparshme, të shohim, duam t'ju përkrah, sepse jeni zbutur, jeni reformuar. Kryeministri ka thënë dje se jemi të djathtë, nuk po di, hala dyshoj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka, në emër të AAK-së, deputeti që ka kaluar nga historiani në energjetikë – Ethem Çeku. Regjia, ia mundësoni të marrë fjalën deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, Kryetar!

Jemi kolegë! Më vjen mirë bile që jemi shumë kolegë në profesion. Edhe Grupi ynë parlamentar edhe në Komision, edhe më herët e kemi diskutuar çështjen e privatizimit të distribucionit. Mendoj se në parim edhe Grupi ynë e mbështet, edhe pse kemi sugjerimet tona. Qeveria është duke gabuar në hapa në këtë drejtim. Mendoj se ministri që i njej procedurat shumë mirë të privatizimit ka të bëjë se Qeveria ka hedhur në debat strategjinë e energjisë dhe është duke diskutuar strategjinë dhe po të njëjtën anë ka filluar procesin që ka të bëjë me privatizimin e KEK-ut, por në të njëjtën anë Komisioni ka kërkuar dhe ka mbështetur unanimisht që të kryhet ajo, siç themi ne, shthurja e plotë e KEK-ut në baza financiare. Do të thotë, kemi një mospërputhje të hapave në këtë drejtim.

Prandaj, unë e ftoj Qeverinë që në radhë të parë në qoftë se e vazhdon strategjinë që ka qenë më herët, le ta vazhdojë, mirëpo në të njëjtën kohë të shoh çfarë procedurash është duke ndjekur në procesin që ka të bëjë me privatizimin e distribucionit.

Po them, Grupi ynë Parlamentar e mbështet në parim dhe sugjerimet tona do t'i japim më tutje rreth procesit. Besoj se Qeveria më në fund do të pranojë rekomandimet që i ka dhënë komisioni parlamentar dhe do të marrë për bazë që në punën e saj të vazhdojë me këto rekomandime që i ka dhënë Komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeti Berim Ramosaj e ka fjalën.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mua po më vjen shumë çudi që disa kolegë të mi veç paskan transformuar mendimet, të cilat i kemi pasur në Komisionin funksional për këtë çështje, respektivisht për Tregti, Industri, Energjetikë. Përafërsisht ato rekomandime i kemi bërë bashkë në Komision dhe

pranë atyre rekomandimeve qëndrojmë, edhe unë personalisht, dhe LDD-ja. Mirëpo, për shkak të njohurive, respektivisht për shkak të informimit më të qartë edhe të opinionit, edhe të juve si deputetë, ne në fakt në parim jemi për privatizimin e ndërmarrjeve publike si koncept, por duke marrë parasysh shumë vërejtje që janë edhe të distribucionit, edhe të KEK-u - kemi shumë arsye të mendojmë se në këtë proces, po na duket, se kjo Qeveri po do të hyjë shumë herët.

Duke marrë parasysh se njësi e shpërndarjes në KEK është në procesin e thithjes së donacioneve, për këtë gjë është i obliguar edhe ministri të thotë, sepse rrjeti i shpërndarjes është në proces të thithjes së donacioneve, andaj hyrja tani në procesin e privatizimit është nënçmim i donatorëve, respektivisht kjo përkthehet se na po i shesim donacionet që po i marrim. Kjo është një arsye.

E dyta, nuk ka përfunduar fare procesi i korporatizimit të KEK-ut. Në daç thirrni ju divizion, në daç thirrni njësi organizative - unë sa kam informata, nuk është përfunduar procesi i korporatizimit të KEK-ut. Ndërsa, sipas ligjeve në fuqi, pa u korporatizuar dhe pa u ditur saktë se a është korporatë kjo apo çka është, nuk mund të hyjmë në procesin e privatizimit, qoftë në partnerizëm, qoftë në privatizim të thjeshtë të një njësie organizative.

Së treti, keni hyrë në procesin e privatizimit pa bërë fizibilitetin e kësaj njësie organizative, sepse performanca e saj ende nuk na ka dhënë të kuptojmë se është njësi organizative që mund të shitet, çfarë çmimi mund të ketë dhe a mund të jetë si njësi autonome.

Së katërti, faza e tanishme, që në fakt është si fazë e një krize apo momenti i tanishëm i një krize globale financiare, nuk na jep ne shumë arsye që do të na vjen ndonjë investitor, respektivisht ndonjë blerës potencial i fuqishëm, duke marrë parasysh krizën globale financiare në botë. Edhe kjo është një arsye plus që ne po hyjmë herët në këtë proces.

Së pesti, rekomandimet e FMN-së dhe të Bankës Botërore tregojnë se njësi apo divizioni, si të doni e thirrni, e KEK-ut që është fjala për distribucionin, është ende në fazën më të dobët të inkasimit të mundshëm. Ka elemente pozitive, por është ende në fazën e dobët. Andaj, hyrja në proces të privatizimit në këtë fazë, ku performanca e distribucionit është shumë e ulët, dyshoj se do të shitet sipas çmimit që realisht duhet ta ketë.

Andaj ne, edhe Qeveria, edhe ne si Kosovë, e dimë se është një pasuri kombëtare, prandaj ne duhet të gjejmë momentin më të mirë kur çmimi i saj vërtet të jetë çmim real dhe ai që e blenë, e blenë si distribucion dhe faktikisht që ka vlerën reale në treg, e jo në këtë fazë, ku performanca e saj është kaq e ulët. Kjo do të thotë, edhe nga prezantimi që e ka bërë ministri për arsyen e hyrjes në privatizim tregon se performanca e distribucionit është në nivelin shumë të ulët, respektivisht KEK-u është në pozitë jashtë çdo rregulli të performancës së rentabilitetit. Andaj, në këtë fazë KEK-u apo kjo njësi do të shitet me çmim nën realen.

Së fundi, edhe pas procesit të korporatizimit të plotë, duhet të jepet hapësirë kohore së paku 1 vit, të shihet se performanca a organizohet si njësi organizative, si divizion, të shihet se si performancë e veçantë a është efektive, sa ka për të dhënë rezultate dhe kjo na

jap një arsye plotësuese të matim fizibilitetin e saj. Atëherë ne do të dimë se çka jemi kah shesim, e jo në këtë fazë.

Duke u mbështetur në të gjitha këto argumente që i përmendëm, unë mendoj por dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë mendon se procesi i privatizimit të ndërmarrjeve publike duhet të bëhet, mirëpo kur është fjala te distribuoni duke marrë parasysh donatorët dhe performancën e dobët, duhet të fillojë diku nga viti 2010. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të Grupit parlamentar “7+” a do dikush fjalën? Jo! Faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të SLS-së nuk është lajmëruar askush. Atëherë, kalojmë në radhën e deputetëve. Fjalën e ka kërkuar deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Para se të futemi qorras në procesin e privatizimit, do të duhej shikuar për mundësitë e privatizimit si vetëm një prej mundësive të politikave reformuese dhe si një gjë që ka çmim.

Ne sot po shqyrtojmë një rekomandim të Qeverisë për një privatizim, që sukseset e mundshme të këtij procesi nuk janë të analizuara dhe argumentuara. Edhe pas privatizimit të distribuimit dhe furnizimit, Qeverisë i mbesin përgjegjësitë për ofrimin cilësor me energji elektrike, për çmim për tarifa dhe për implikime sociale që realisht mund të ndodhin, sepse ka ndodhur në vende të tjera.

Privatizimi në këtë moment është portretizuar si mjet që rritë eficiencën dhe sjell investime. Studimet e privatizimit nga vendet e ndryshme tregojnë se duhet kaluar kohë shumë e gjatë që të ndodhë një gjë e tillë dhe implikimet afatgjata të këtij procesi nuk janë shumë të qarta.

Të nderuar,

Para se të fillohet me procesin e privatizimit të distribuimit dhe të furnizimit, duhet filluar me fazën e para privatizimit, e cila do të kishte siguruar përgjigjen në tri pyetje themelore: pse të privatizohet; çka të privatizohet se nuk është e thënë e tëra të privatizohet dhe, si të privatizohet.

Edhe në strategjinë 2005-2015 në procesin e ristrukturimit të KEK-ut, më saktësisht në fazën e tretë të kësaj strategjie ka qenë e paraparë që të ketë pilot-projekt për procesin e privatizimit. Me fjalë të tjera, pilot-projekt. Ngritja e pilot-projekteve ka pasur të vetmin objektiv, që të arsyetojë fillimin e procesit të privatizimit në tërësi. Një gjë e tillë deri më sot nuk ka ndodhur edhe pse është paraparë që të përfundojë pilotimi i këtyre projekteve në vitin 2006.

Tash unë po ju them se pa u dhënë përgjigje mirë të argumentuara në tri pyetjet e mësipërme, është qasje shumë joprofesionale. Nuk do të thotë se privatizimi është gjithmonë zgjidhja e problemit.

Ju kujtohet mirë se çka ndodhi me rastin e Feronikelit. Me rastin e privatizimit të Feronikelit ne kemi ardhur në situatë në të cilën Kosova nuk ka përfituar asnjë cent të

vetëm, nga gjoja shitja e pasurisë të cilën ia ka dhuruar zoti, nuk e ka ndërtuar dora e njeriut, dora e njeriut veç e ka falë. Pa strategji të mirëfilltë një herë e shet dhe më s'mund ta shtie kurrë në dorë. Nuk kthehet.

Ne të gjithë qytetarët e Kosovës sot paguajmë për diçka që mendojmë se e kemi shitur. Ne sot paguajmë për një kontratë të lidhur, e cila për çdo ditë i dëmton qytetarët fukara të Kosovës - duke blerë rrymë dhe dhënë kompanisë prej së cilës është pritur të fitohet, e jo të dëmtohem financiarisht. Për dikë kjo s'është asgjë, se kanë ndoshta mjaft pasuri. Por, është çështje etike, është çështje nderi. Qeveria e Kosovës i kritikon, por nuk merr asnjë veprim konkret, ose nuk do ose, s'e di çka. Nuk e di pse nuk inicion procedurë hetimore lidhur me kontratën e dëmshme, që së paku ta shohin se drejtësia i ka duart e gjata, se i prek të gjithë pa marrë parasysh statusin social, partiak dhe të pozitës.

Pra, të nderuar, kërkoj nga ju të jemi të ndërgjegjshëm dhe të vetëdijshëm për atë se çka po bëjmë.

Demokracia kërkon transparencë kur kemi të bëjmë me sektorë të ndjeshëm dhe monopolistë. Kur kemi të bëjmë me këta sektorë, atëherë duhet hapur debat. Së paku, të dëgjohet zëri i atyre që e kanë përsipër privatizimin, a e dinë se çka po bëjnë, apo veç i kanë në përdorim nja dy-tre slogane monotone dhe bajate që kërkojnë ndryshim sa për hatër të ndryshimit. Fjalori i përdorur nuk sjell asnjë argument, pos slogane. Ka kaluar koha e ekonomisë së planifikuar, rritet efikasiteti, slogane shkollore - gjëja për të treguar se janë në përkrahje të demokracisë, se nuk i takojnë klasës udhëheqëse komuniste. Ndryshimi, të nderuar, është në një mendje. Nuk luftohet mentaliteti komunist me mjete komuniste. Dhe, është e njëjta gjë, vetëm në komunizëm merren vendime pa afruar argumente. Dihet, ai që sjell vendime paraprakisht e ka mirë.

Të nderuar deputetë,

Mësime duhet marrë nga eksperiencia e vendeve të tjera, nga vende që ndajnë eksperiencia të ngjashme apo të njëjta me Kosovën. Për shembull, në shtetet si Maqedonia dhe Gjeorgjia, privatizimi i distribucionit nuk ka treguar sukses, sepse është shtrenjtuar energjia elektrike dhe kualiteti i shërbimit me energji ka shënuar rënie. Apo, në Ukrainë, Moldavi dhe Armeni, pas privatizimit dukshëm ka rënë kualiteti i shërbimit. Janë vetëm disa raste suksesi – Rumania dhe Bullgaria, raste në të cilat procesi i privatizimit është udhëhequr prej njerëzve shumë profesionistë, kurse Kroacia nuk do të fillojë me procesin e privatizimit të Elektroekonomisë së Kroacisë para se të pranohet në BE, sepse nuk i nënshtrohen direktivave evropiane përderisa nuk pranohet në BE. Mund t'i vendosin vetëm bazat për BE.

Disa nga këto mësimë fillestare janë:

E para, para privatizimit duhet krijuar kushte për një treg konkurrues. Nuk privatizohet monopoli. Nga monopoli shtetëror mund të kalojmë në një monopol privat që është më i egër dhe me shumë implikime sociale, ku qytetarët e Kosovës nuk kanë asnjë dobi të vetme. Mund të ketë fitime individuale dhe mbushje xhepush të ndonjë biznesmeni kazakistanez, si me rastin e Feronikelit.

E dyta, para se të privatizohet, duhet pasur një treg që funksionon mirë, treg të rregulluar me infrastrukturë ligjore adekuate.

E treta, e fundit dhe jo më pak e rëndësishme, duhet ta dimë saktë se çfarë vlere mund të sjellë investitori i ri, cila është vlere që e sjell investitori. Me fjalë të tjera, çka fiton me privatizim të distribucionit dhe furnizimit populli i varfër i Kosovës. Arsyeshmëria e lënë shumë pezull se rritet efikasiteti, pa ta dhënë asnjë analizë, është hiq gjë, është kot fare. Kjo qasje jo vetëm që drejtpërdrejt po ndikon në zhvillim ekonomik, por edhe po prek në vlerat themelore demokratike, për shembull, siç është integriteti dhe e vërteta. Ata që e pranojnë pa pyetur, kanë problem integritetin.

Fjalën më të shpeshtë e kanë “po” dhe vetëm kështu e mbulojnë injorancën e vet profesionale. Kjo po na prekë edhe në kulturë dhe kështu nuk mund të zhvillohet jeta demokratike. Model suksesi po bëjnë njerëzit që përlënë pa integritet. Kjo po bëhet shumë keq, po bëhet pjesë integrale e kulturës sonë.

Të nderuar deputetë,

Ne mund të bëhemi gjoja se këtë propozim e kanë bërë ekspertët, por që të tregojnë gjithë botës se Kosova mund të bëhet funksionale, duhet heqë nga fjalori fjalët dhe slogane që janë pezull, por të gjykojmë në bazë të argumenteve të sjella, që fatkeqësisht ky rekomandim i ofruar është hiq gjë përpos një gjykim që u ofrohet atyre që nuk i respekton dhe i trajton si të pa informuar, vetëm sa për të plotësuar anën ligjore, Ligjshmëria e këtij propozimi, rekomandimi nuk është i qartë, mund të diskutohet si e tillë, është Ligji për ndërmarrjet publike, neni 7 -shitja e aksioneve.

Kujt po i ngutet? Le të bëhet shthurja ligjore, le të bëhet shoqëri aksionare me më shumë aksione, jo vetëm me një aksion, dhe pastaj mund të vendosim se a do të shesim aksionet, apo mos t'i shesim dhe nëse vendosim t'i shesim, sa t'i shesim, nga pikëpamja se aksionet i shesim.

Të nderuar, vetëm një rast që janë shitur 100% i aksioneve. Është rasti i Maqedonisë, që është rast dështimi. Shumë saktë, nuk mund të bëhet fjalë për privatizim, si koncept klasik i ofruar. Në fund, ju lutem që këto çështje të mos trajtohen nga prizmi i marrëdhënieve pozitive - opozitive, sepse nuk ka të bëjë me të, strategjia është shkruar në vitin 2005.

Edhe në këtë dokument ka qenë e paraparë të pilotohet dhe, të nderuar, pilotohet kur nuk je i sigurt për konsekuenca. Një gjë e tillë nuk ka arritur të bëhet. Pra, kemi dy argumente shumë të qëndrueshme. E para, miratimi në parim i këtij dokumenti do të ishte jo ligjor para se të kryet shthurja ligjore nga shoqëria aksionare dhe, e dyta, procesi i shitjes së pasurisë së Kosovës kërkon përgjigje në tri pyetje, pse, çka dhe si të privatizohet.

Privatizimi i distribucionit dhe furnizimit ka të bëjë me zhvillim strategjik të Kosovës, ka të bëjë me të ardhmen e popullit tonë. Sot ne kemi nevojë që të shohim, dëgjojmë alternativa dhe të zgjedhim më të mirën nga ato, gjë e cila nuk është prezantuar në këtë rekomandim. Pra, mendimi im personal, u rekomandoj edhe të tjerëve, që të gjykojmë para se të marrim vendim a të shkohet me privatizim apo jo. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet, por nuk e di, dëgjove në emër të Grupit Parlamentar ka diçka tjetër. Unë e kuptoj demokracinë, por demokracia nuk duhet të thuhet veç para televizionit, por duhet të thuhet edhe diku tjetër. Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala, gospodine predsedniče!

Znam da smo svi jako umorni. Ja sam očekivala da će ova tačka dnevnog reda biti možda druga ili treća, kako ste je smetili na 12-to mesto, uopšte mi nije jasno. Ovo se dešava više puta kada imamo oko rešavanja vitalnih problema i oko vitalnih pitanja na Kosovu, stalno nam srstavate ove tačke da budu zadnje kad smo premoreni i jednostavno da glasamo mehanički i da odemo kući.

Ovo je moja primedba. Pošto sam dugovodišnja radnica KEK-a, radim punih 35 godina u Distribuziji Prizren, sa ponosom kažem da je ovo jedno nacionalno bogatstvo ove države, sa svojom proizvodnjom, prenosom i distribuiranom mrežom. Ovde imamo danas predlog Komisije, na predlog Vlade o inicijativi za privatizaciju. Ja ću jedno da kažem, kao radnica KEK-a, kažem da se mnogo ne žuri nama za privatizaciju, jer sada smo praktično svrstani u tri grupe a, b, c, a kada budemo privatizovali distribucije onda ćemo biti večito u mraku, jer mi ćemo morati da kupimo struju da bi naši građani imali.

Da li je ovo težnja svih nas, molim na pažnju, molim na pažnju! Prvo, ja se obračam gospodinu ministru, mi imamo Zakon o javnim prduzećima. Da bi se pristupilo privatizaciji javnih prduzeća, prvo treba da postoji Zakon o privatizaciji javnih preduzeća, u kome će se definisati zakonska prava na ime transformacije javnog preduzeća.

Prvi oblik, svi znamo iz Zakona za javna preduzeća, daje mogućnost da postanu akcionarska društva kao što je ovo komentarisao kolega pre mene. Drugi oblik je davanje javnog preduzeća na korišćenje. Treći oblik je saniranje javnog preduzeća od strane Vlade koja ima nadležnost nad kapitalom i osobljem javnog preduzeća pošto su do sada bili IV Stub UNMIK-a, i zadnji oblik je privatizacija.

Pre procesa privatizacije mora se uraditi savezna revizija javnih prduzeća putem koje se utvrđuju kapitalne vrednosti preduzeća, ukupan ljudski resurs i ukupan dug javnog preduzeća, kao i potraživanja javnih prduzeća. Sve ove elemente mora da preuzme investor i Vlada u procesu privatizacije.

Mi znamo da je to kapitalna investicija naša koju imamo, koja vredi danas na tržištu četiri ipo milijarde eura. Da li smo mi danas spremni da obezvrđimo ovakvu vrednost i da je prodamo za nepunu milijardu koja je znak pitanja da li će nam biti ponudjena na tržištu ponude i tražnje. Znači, kao drugo moramo da uradimo Zakon o dekapitulizaciji javnih prduzeća, gde ne smemo oštetiti ljudski faktor koji je zapošljen u tom preduzeću, gde moramo obezbediti ekonomski i socijalni program, gde ljudi imaju prava na deonice i akcije kao zapošljeni, gde nije privatizacija kao i pitanje društvene imovine i društvenih preduzeća koja je Agencija za privatizaciju faktički poklonila i uzurpirala i na jedan nezakonit način prodala.

Moramo da znamo da je u tom preduzeću, ja sam čula više puta, danas imam priliku da kažem, da ima 12 hiljada zapošljenih radnika, ne 7 hiljada. Imamo matične brojeve zapošljenih, kao lične karte, brojevi su od 11 do 12 hiljada. Moramo da definišemo zatečene i zapošljene radnike po godini staža, znači da investitoru predstavimo sve ovo, a najviše zapošljenih ima u distribucijama.

Jedno od jako vitalnih pitanja, moram da dam do znanja ovde u Skupštini, da je 1700 radnika, 1700 radnika imaju status raseljenog lica, a bili su radnici ovog prduzeća.

Znači, imaćemo pojave da se ljudi kod međunarodnih organa pojavljuju za ostvarivanje svojih prava iz radnog odnosa.

Da li smo danas spremni da odgovorimo na sva ova pitanja, ili treba da se domaćinski malo pozabavimo, da napravimo reviziju javnog prduzeća koje se u zadnje vreme ponaša jako monopolistički, da ova vlada sa posebnom revizijom i sa posebnim metodama učini jedan korak oko definisanja da li to da urdi za godinu, dve ili tri, bez žurbe.

Ja sam u tom javnom prduzešću i stojim na raspolaganju ovoj vladi, da mogu biti mnogo od pomoći, bez obzira da li je pozicija ili opozicija u pitanju, u pitanju je 12.000 radnika. Dali ćemo te radnike pod hitno da isteramo na ulicu i da prepolovimo ili ćemo da uradimo jedan pametan korak oko analize, oko pristupanja. Ja sama ovde kažem da možemo sve tehničke službe reviziono da definišemo za privatizaciju. Sve tehničke uslove ispunjavaju, zato što su verujte mi i ja smatram to službe u okviru samih javnih prduzeća i distribucija i privatizovane, koje ne donose nijedan dinar distribucijama a troše. Znači, moramo da smanjimo javnu nabavku, moramo da vodimo računa oko menadžmenta, moramo da vodimo računa oko ljudskog faktora, ako saniramo ova prduzeća ko su sve menadžeri i koje sve zapošljene kadrove ima. Šta je to što je javna prduzeća dovelo da danas potražuju 268 miliona na ime energije neplaćene sa 30% jedva naplate, sa 60% gubitaka, znači kradje struje, kradje struje gde, verujte mi, veliki potrošači krade, ne domaćinstva. To su hoteli, moteli, razni pogoni proizvodni. Mi moramo sve ove stvari da definišemo sa malo većom revizijom, sa malo većim moralnim raspoloženjem za rad kako bi bili korisni i kako ne bi nam bilo sutra kasno, ako se nadjemo u potpunom mraku, ne da imamo grupu nego da nemamo energiju, a najveći sloj domaćinstva će biti većito kažnjen, onaj sloj domaćinstva koji neće moći da izmiri energiju koja je i tako, znamo, najskuplja u regionu, ako je 5 do 6 centi u regiji, naš kilovat je 14 do 15 euro centi.

Ja sam videla da ste jako umorni, da vam ovo nije puno značilo, sve ovo što sam rekla, ali ipak se zahvaljujem na pažnji. Hvala!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, le përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi,.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

T nderuar kolegë deputetë,

Për mendimin tim, privatizimi i një pjese të KEK-ut është i nevojshëm dhe mendoj se në mënyrë të kujdesshme kjo në një të ardhme duhet të bëhet. Mirëpo, sot për të dhënë vizën për fillimin e procedurave të privatizimit, duhet të dihet në fillim se për çka është fjala, për këtë para së gjithash, duhet një rregullativë ligjore. Pra, ne nuk e kemi një ligj për privatizimin e ndërmarrjeve publike, të cilin duhet ta bëjmë sa më shpejt që të jetë e mundur. Andaj, ky ligj do të mundësonte një privatizim transparent, pra mos të harrojmë edhe procedura transparente. Këtu po flitet për fillimin e disa procedurave të cilat duhet të përshkruhen në një ligj të caktuar se si do të jenë ato procedura, por nuk ekziston ai ligj.

Gjithashtu, gjatë privatizimit duhet të jenë të qarta disa detaje të cilat nuk është mirë më vonë të na shfaqen si pengesa ose si çrregullime sociale. Ta zëmë, në këto detaje duhet të hyjnë, duhet të jetë e qartë se cili do të jetë fati i të punësuarve, të cilët momentalisht punojnë në njësinë e cila po mendohet të privatizohet.

Këtu u përmend dhe pajtohem me atë se duhet pasur kujdes që shembujt e keqprivatizimit të disa ndërmarrjeve, të na jenë si mësim. Ndërkaq, kisha thënë ta marrim më seriozisht këtë punë, kjo është çështje mbi grupet parlamentare, sepse kemi të bëjmë me një pasuri të përbashkët kombëtare të Kosovës, por besa edhe mbi gjeneratën e sotshme, nuk po flasim edhe për një gjeneratë të ardhshme të Kosovës, jo vetëm për gjeneratën tonë të sotme. Po bëhet fjalë për një pasuri që e kemi sot dhe do ta kemi edhe në të ardhmen, se na e dimë që KEK-u nuk e ka vetëm një njësi, e ka edhe njësinë e prodhimit dhe të minierave, të shpërndarjes, dhe duhet shumë më me kujdes të flitet për këto çështje dhe sidomos shumë më me seriozitet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le përgatitet deputeti Naser Rugova.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Unë përkrah në parim rekomandimet e komisionit parlamentar pas një debati që nuk ka qenë edhe i lehtë. Unë mendoj që në ato dy-tri seanca të komisionit kemi pasur rastin dhe mundësinë që së bashku me njerëzit përgjegjës, kompetent të Ministrisë, të nxjerrim edhe përfundimet, të cilat konsideroj që një pjesë e tyre janë brenda këtyre rekomandimeve, prandaj edhe e përkrah në parim. Po, kujtoj që tash do të dallojmë me arsye se ndryshe është veprimi i Qeverisë, nuk është në pajtim me këto rekomandime. Prandaj, ajo që më motivoi ta marrë fjalën, është kjo pjesë e moskoordinimit të mirë në mes Parlamentit dhe Qeverisë lidhur me politikat dhe strategjinë, si dhe kohën e privatizimit të ndërmarrjeve publike që janë të rëndësishme të veçantë, në këtë rast siç është KEK-u, nesër PTK-ja dhe në procedurë e sipër, siç është edhe Aeroporti.

Unë mendoj se është me shumë rëndësi debati parlamentar derisa të vjen deri te faza e privatizimit të këtyre ndërmarrjeve dhe të kësaj pasurie publike. Ne po na mungon kjo, nuk e di pse, qoftë si partnerë të koalicionit, nuk po flas për opozitën, ju e dini vet, prandaj thirrja ime është që mos të ngutemi, por realisht të harmonizojmë një politikë dhe strategjinë që është shumë me rëndësi, po flas për koalicionin parlamentar në kuadër të programit politik që e kemi, sepse nuk bëhet vonë. Nëse ngutemi, mendojmë se do të gabojmë, dëmi dhe zarari do të jetë shumë i madh për vendin tonë. Nuk jemi ne aq të pasur sa kaq shumë të ngutemi dhe nesër ta lëmë shtetin thatë.

Në kuadër të kësaj, unë po i kthehem temës për të cilin e kemi fjalën lidhur me Qeverinë dhe strategjinë rreth KEK-ut. Disa herë është debatuar, jo vetëm në Parlament më së paku, po e them, në komisione dhe në workshope të tjera dhe unë kujtoj se hapi i parë që duhet Qeveria ta respektojë, është në kuadër të strategjisë ekzistuese që organizmi i ri ose ristrukturimi i KEK-ut, që të gjithë deputetët e kanë përmendur, edhe më herët, edhe sot, të fillojë të implementohet, në radhë të parë, dhe të shohim, do të thotë, se si do të jetë afarizmi i këtyre ndërmarrjeve të ndara, i këtyre korporatave, i këtyre shtëpive. Realisht, të shohim performancën dhe bilancin e tyre afarist në minimum një deri në dy vjet, ndoshta dy janë, mund të jenë tepër për ndonjë ndërmarrje, për ndonjë nuk janë, por të shohim pra realisht në fund dhe të dalë një vlerësim i saktë, se sa duhet nesër të shiten këto ndërmarrje. Prandaj, hapi paraprak që po e ndërmerr Qeveria me vendimin e vet, nuk është në përputhje me rekomandimet e komisionit parlamentar. Kush do t'i këqyrë nesër se këto do të koordinohen. Mendoj se ato do të mbeten të tilla dhe do të ecin rrugës në të cilën do të kemi dallime dhe ndryshime për të cilat unë kërkoj që ato të harmonizohen. Në këtë pikëpamje e ftoj edhe Grupin Parlamentar të LDK-së, edhe unë jam deputet i këtij grupi, që më mirë të shqyrton këto punë, t'i diskutojë shumë më me

seriozisht se sa që e ka bërë deri tash, se nuk e ka bërë si duhet, ky është mendim i imi, bile as që i ka humbur nja 10 minuta për këtë punë, e ngjashëm po më duket janë edhe të tjerët, hiq më mirë. Prandaj, unë kujtoj që duhet të rikthehemi dhe ta shohim se është tema më e rëndësishme, më e rëndësishme, unë nuk kujtoj që do të kemi ditëve të ardhshme temë më të rëndësishme se kjo.

Na jemi një trup, si Qeveria, si Parlamenti, nuk kemi nevojë të dallojmë shumë në pikëpamje, as nuk kemi nevojë të ikim nga debatet, por kemi nevojë t'i harmonizojmë, se po flitet për pasurinë nacionale të vendit tonë. Me këtë rast, do të shkoj te e katërta, tek më vonë vjen çështja e modalitetit ose e variantit më të përshtatshëm për privatizim. Nëse ka praktika të mira, ato i marrim siç u thanë, nuk kemi pse të ikim prej tyre, nuk kemi kurrëgjë çka të zbulojmë. Tash i kemi përvojat e të tjerëve, e shohim se cilat, në çfarë variante kanë bërë privatizimin.

Në këtë frymë, unë kujtoj që i takon Qeverisë që ta shohë dhe të zgjedhë në të ardhmen variantin më të përshtatshëm. Prandaj, nuk jam për atë për t'u ngutur. Këtu duhet ta shohim nesër, cila do të jetë hisja e shtetit tonë, sepse në fund të fundit, do të ndodhë më vonë. Unë do të pyes, çka do të qeverisim na, me cilën pasuri publike. Çfarë Qeverie do të jemi pa pasuri. Këtu është pra edhe poenta, kështu është edhe ajo, si të them, shqetësimi im. Pse po ngutemi në hapa, jo pse po përgatitemi lidhur me privatizimin. Unë pajtohem me atë që të përgatitemi edhe si Qeveri në procesin e mëtutjeshëm të privatizimit të këtyre ndërmarrjeve, por mos të ngutemi me hapa, se po vijmë pastaj në konfrontime dhe nuk po del mirë kjo punë. Pra, edhe njëherë ju ftoj, edhe koalicionin, që të mendojë mirë lidhur me fazat, dinamikën dhe strategjinë e privatizimit dhe të jenë në pajtim me këto rekomandime dhe të mos ngutemi, por ta bëjmë ashtu siç duhet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri deputet!

Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le përgatitet deputeti Ethem Çeku.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zotëri Kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zotëri ministra të Kabinetit qeveritar,

Vërtet është një temë shumë e rëndësishme, e një rëndësie të veçantë nacionale, sepse po flasim për shitjen e mundshme apo edhe privatizimin e aseteve të një nga burimet nacionale energjetike që, tek e fundit, është edhe shpresë e fazës së parë të zhvillimit ekonomik dhe të krijimit të një ambienti të favorshëm për investitorët e mundshëm në vendin tonë.

Unë i kam lexuar me vëmendje rekomandimet e komisionit funksional dhe ne, si Grup Parlamentar, e kemi analizuar në aspekt shumë analitik se hapat e Qeverisë, nismat e Qeverisë, nismat e ngutshme, thjeshtë të nxituara të Qeverisë në këtë drejtim, ku e shpijnë KEK-un dhe çka do të ndodhë, do të thotë, me burimet energjetike në të ardhmen dhe a i bëjmë shërbim qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe çka fiton shteti i Kosovës nga hapat e tillë të nxitueshëm?

Procedurat e ngutshme të privatizimit pa fazën analitike dhe të fizibilitetit, qoftë të aspektit të afarizmit apo të aspektit ekonomik, asnjë qeveri serioze besoj nuk do të kishte bërë, sepse po bëhet fjalë që njëherë e për gjithmonë të shitet një aset, në këtë rast distribuimi dhe furnizimi i KEK-ut. Nga konsultimet që i kemi pasur edhe me ekspertë, tek pas dy vite e gjysmë apo tri mund të shihet efienca e rezultateve të

përmirësimit, të ngritjes së cilësisë së shërbimit me energji elektrike për qytetarët e Kosovës.

Vallë, kujt po i ngutet ky privatizim pa faza paraprake, pa fazë përgatitore para privatizimit, pa fazën më se të nevojshme të analizave dhe të fizibilitetit. A mos ju ka premtuar dikujt ky projekt e të shitet shkel e shko një pasuri nacionale, a i merr për bazë Qeveria e Kosovës eksperiencat e vendeve të rajonit, rasti konkret i dështimit total të shitjeve të aseteve të ngjashme në vendet fqinjë, siç janë Maqedonia dhe Bosnja.

Fondi Momentar dhe Banka Botërore, zotëri ministër, në mënyrë decitive rekomandojnë që ky proces të fillojë në vitin 2010. Por, nëse i marrim edhe vërejtjet që i jepen Qeverisë, vendit dhe institucioneve të vendit nga ana e Raportit të progresit vjetor të Komisionit Evropian, kur një nga kriteret ekonomike të kriterëve të Kopenhagës, është funksionalizimi dhe korporatizimi i ndërmarrjeve publike në Kosovë. A është bërë korporatizimi i KEK-ut, në rastin konkret? Jo! Atëherë, kujt po i nxitohet dhe pse pa i kaluar këto procedura të nevojshme

Duhet të jemi të kujdesshëm, sepse kur është bërë shitja e këtij aseti të rëndësishëm në Bosnje, pas një viti e ka vu në sprovë serioze ekonomike, sociale dhe strategjike në lëmin e energjetikës shtetin fqinj. Edhe disa kolegë deputetë, thjeshtë këtu nuk po diskutoj si deputet opozitar. Te aspektet e burimeve energjike dhe të pasurive nacionale nuk ka pozitë dhe opozitë. Duke i marrë shembujt e regjionit, duke i ditur dhe disa storie të këqija të privatizimit në Kosovë, unë kërkoj që Qeveria të mendojë dhe të respektohen rekomandimet e komisionit funksional, do të thotë korporatizimi, ristrukturimi, faza e fizibilitetit dhe pastaj të merren hapa të tjerë, dua të besoj, të logjikshëm dhe racional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ethem Çeku, le përgatitet deputeti Riza Smaka.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë tani dua të flas si deputet, por e mora në emër të Grupit, nuk ndryshoj nga qëndrimet në mes asaj që fola në emër të grupit, se janë të harmonizuara politikat, mirëpo duhet të shtojmë vetëm diçka.

Ne sot po e diskutojmë rekomandimet e komisionit dhe rekomandimet e komisionit flasin shumë mirë për procesin kah duhet të kalojë çështja e kyçjes së sektorit privat në sektorin e distribucionit. Do të thotë, këtu nuk kemi të bëjmë menjëherë me hyrjen e procesit të privatizimit. Unë tani po kaloj në pjesën e pozitës, për arsye se po e shoh se pozita nuk është kah mundet të shpjegojë drejt rekomandimet që ne sot i kemi.

Pika e dytë, është kërkuar shthurja e plotë e KEK-ut, apo amballdingu i KEK-ut në baza financiare, e cila nuk e precizon kohën a do të jetë deri në 2009 apo 2010. Do të thotë, për të ardhur deri te ana e privatizimit të distribucionit, duhet të bëhet ndarja e plotë në sektorë të caktuar dhe në baza financiare, ku secila njësi e ka xhirollogarinë e vet dhe jep përgjegjësi për funksionimin dhe mosfunksionimin e saj. Pastaj, të kryhet analiza dhe, pastaj në radhën e tretë të hymë në analiza a duhet të bëjmë. Këto janë rekomandimet, prandaj unë e mbështesë plotësisht Naserin në diskutimin e fundit që e bëri.

Ne kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që të respektojë rekomandimet që e ka bërë komisioni dhe të mbikëqyrët a është Qeveria në rrugë për të përkrahur dhe për të implementuar vendimet të cilat i ka sjellë komisioni dhe unë besoj që i aprovon Parlamenti i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le përgatitet deputeti Gani Geci.

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zotëri Kryesues!

Respekt për ministra, për deputetët,

Parafolësit ishin aq përmbajtësor edhe aq kuptimplotë sa që të flitet më tutje, mendoj që mund të flitet, por nuk ka nevojë.

Unë do t'i kisha theksuar disa parametra. Çështja pronësore, kolegë të nderuar, në Kosovë, është çështja më e ndërlikuar që shumë vështirë do të zgjidhet, nëse do të zgjidhet brenda një dekade! Këtu do të ndalem në këto forma, që janë edhe definicione janë, si të them, të interferuara.

Prona shtetërore, prona publike, prona shoqërore, problematike janë këto, por në rastin konkret, ne flasim për pronën publike. Për t'u bërë privatizimi i pronës publike, është kusht pa të cilin nuk bën, kondikcio sine kvanon. Ligji, unë preferoj që Qeveria le ta sponzorojë ligjin, ta diskutojmë ligjin, sepse ligji do të shërbente, përpos tjerave, për bazament të raporteve reciproke, të obligimeve dhe të autorizimeve për kontratë. Kontrata do të ishte e mbështetur, se kjo është çështje madhore, prandaj do të duhej me ligj fillimisht edhe me kontratë, më pastaj të bëhet precizomi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Gani Geci, le të përgatitet deputeti Haki Shatri

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues! Ne, si parti e djathtë, në fakt, përkrahim privatizimin, por ne nuk mund të përkrahim hapjen e rrugës për uljen e çmimit të pasurisë sonë kombëtare. E them këtë, sepse unë dyshoj që është përgatitje e terrenit apo hapje e rrugës për uljen e çmimit apo për marrjen e një provizioni nga ata që donë të vijnë dhe të privatizojnë një korporatë siç është KEK-u apo asetet e KEK-ut dhe, përqindja apo provizioni që e marrin ata për hapjen e rrugës është marramendëse dhe, siç duket, dikush qëndron në këtë lojë dhe ne nuk jemi për të. Prandaj, unë pyes ministrin, kur mendon ministri se duhet të fillojë privatizimi i aseteve të KEK-ut, për shembull, ose i distribucionit të KEK-ut.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar, si parti e djathtë, Lidhja Demokratike e Dardanisë përkrah privatizimin në përgjithësi, por jo uljen e çmimit të pasurisë kombëtare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Haki Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë dëshiroj të tërheq vëmendjen vetëm te një çështje. Në Ligjin për buxhetin, në pjesën tekstuale të cilën e kemi në dorë, Komisioni për Buxhet, për përgatitje për lexim të dytë, neni 16 i këtij Ligji na bën të vijnë në një kundërshtim me këtë vendim që po pritet të merret sot.

Decidivisht aty shkruan, në nenin 16, që do të bëhet kontrata me një investitor për Kosovën e re, njëra pjesë e nenit, dhe pjesa e dytë thotë që gjatë vitit 2009 do të privatizohen këto dy pjesë të KEK-ut dhe mjetet do të derdhen në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Unë, e mora fjalën që ta tërheqë vëmendjen që ky rekomandim me propozim Ligji, nenin 16, janë në kundërshtim dhe ne duhet ta kemi vëmendjen. E mora fjalën që ta dëgjojë edhe ministrin i Financave, që ta përgatit një version për nenin 16 të Ligjit për buxhetin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Sala Berisha Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA SHALA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë veç desha ta përshëndes zotin Çeku nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës për zbërthimin që ua bëri deputetëve në lidhje me rekomandimet, se tha që pozita nuk ishte në gjendje t'ua mbush mendjen deputetëve se këto rekomandime duhet mbështetur. Unë e kam një përgjigje se të gjithë deputetët e kemi pasur materialin në dorë dhe rekomandimet, e perceptimi individual është i secilit veç e veç, e jo paaftësi e dikujt për t'ia mbushur mendjen dikujt tjetër. Kaq!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Unë, plotësisht pajtohem me rekomandimet që janë dhënë dhe janë përgatitur nga ana e Komisionit për Tregti dhe Industri dhe mendoj se me të vërtetë i parashohin të gjitha ata hapa që janë të nevojshëm të merren para se të shkohet në procesin e privatizimit të KEK-ut.

Mirëpo, rekomandimet janë rekomandime, rekomandimet nuk e kanë fuqinë e ligjit. Prandaj, me qenë se kemi të bëjmë me një çështje shumë madhore për vendin tonë, mendoj se më parë Ministria e Financave është dashur të dalë para nesh me një ligj të përgatitur për privatizimin e ndërmarrjeve publike, e pastaj t'i hyhet procesit të privatizimit të ndërmarrjeve publike. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Hydajet Hyseni

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe mua më bën përshtypje përcaktimi për privatizimin, por më bën përshtypje veçanërisht entuziazmi me të cilin shprehet kjo. Në rastin më të mirë, duket njëfarë iluzioni pak i tejkaluar djaloshtar, sipas të cilit me privatizim e kemi gjetur çelësin magjibërës që rregullon gjithçka. Tash nuk jemi krejt të pa përvojë, kemi njëfarë përvojë dhe do të ishte mirë t'i kemi edhe ato parasysht.

Megjithatë, unë nuk mund të mos e mbështesë përcaktimin e komisionit, rekomandimet e komisionit dhe përcaktimin për të parë se cilat janë metodat më të mira që do të siguronin efikasitetin në distribucion. Po, mendoj se do të duhej pasur parasysht edhe specifikat me të cilat ballafaqohet realiteti kosovar dhe sistemi i distribucionit.

Në analizën që na është bashkëngjitur, e cila është e mangët, thuhet që 60% e rrymës elektrike nuk paguhet. Dilema ime tash është, si e rregullon këtë privatizimi? Ne të gjithë e dimë që shkaqet janë politike, lidhen me Ahtisarin, me Kushtetutën e tjera. Përveç tjerash, dua ta saktësoj, a i rregullon këto privatizimi dhe a rregullon gjithçka nëse ne themi: - mirë, po e heqim prej dore. Ma kujton kjo atë iluzionin e djemkave se thonë: - nuk kanë ditur prindërit tanë të bëjnë vetura të shtrenjta, paska qenë lehtë, e shesim tokën e babës!

Në të vërtetë, do të duhej parë të cilat janë shkaqet e mosfunksionimit të sistemit të distribuimit dhe të pagesave në Kosovë sa duhet, dhe tek atëherë, pastaj, sipas shkaqeve të gjendjen edhe recetat e duhura.

Më bën përshtypje në rekomandimet e Komisionit theksimi që duhet pasur parasysh ndikimin e krizës ekonomike. Është shumë i drejtë dhe nuk mund të mos e mbështes por, ju lutem, a mund të shkojmë edhe përtej kësaj pak, sepse përvoja me krizën e re financiare ekonomike ka nxjerrë në pah edhe një fenomen tjetër. Edhe qeveritë më të djathta tani po e fusin në funksion fuqinë e shtetit dhe nuk po shkojnë tash me entuziazëm në privatizimin.

Ne ishim, për shembull, në Zvicër frik tash dhe atje thuhej se elektricitetin, ujin, nuk lejojmë të privatizohet. Ne, është e kuptueshme që jemi të gjithë të djathtë, por mos po dalim pak, siç thotë populli, në stërnishtë pak, edhe përtej të djathtës në këtë mënyrë atje. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit! Edhe unë dua t'i them nja dy –tri fjalë pasi veç e zgjatëm shumë. Unë po flas jo si kryetar i Kuvendit si deputet, prandaj dola këtu.

Të nderuar deputetë,

Unë, në një masë jam dakord me shumë çka që u tha këtu, por jam i obliguar që t'ju përkujtoj diçka.

Në legjislaturën e kaluar disa herë kam pas kërkuar që Qeveria të sjellë në Kuvend, cila është strategjia e interesit kombëtar, dikush po thotë nacional? Absolutisht, nuk ka pasur kurrfarë dëshire dhe vullneti për të sjellë një strategji të interesit nacional.

Kam qenë njëri nga ata që e kam kundërshtuar në kontinuitet privatizimin e Feronikelit. Kam qenë dhe jam i bindur që edhe Qeveria, edhe populli i Kosovës, e ndoshta më së shumti qytetarët e Drenicës kanë humbur me atë privatizim. Po, jo vetëm që është dëmtuar, janë dëmtuar asetet e Feronikelit, kur është shitur Feronikeli, por është dëmtuar edhe kontrata e lidhur për shfrytëzimin e energjisë elektrike dhe, natyrisht, kurrë institucionet e Kosovës, as Parlamenti, po as Qeveria nuk kanë pasur mundësi ta dinë cila ka qenë kontrata e shitjes së Feroniklit dhe cilat asete janë shitur, cilat kanë mbetur pa u shitur dhe, vërtet, shumë asete që nuk kanë qenë në kontratë e nuk kanë qenë të shitura, ai që e ka blerë Feroniklin i ka shfrytëzuar dhe, bile, aty e ka pasur fitimin e tij.

Qeveria, në fillim ka pas premtuar që do ta bëjë një auditim të procedurave të privatizimit të KEK-ut, por megjithatë dikush ndërhyri dhe një ndërhyrje politike e pengoi një procedurë të tillë.

Mendoj që tash e kemi një vendim dhe i kemi rekomandimet. Mendoj që është mirë secili nga ne ta dijë se a munden rekomandimet ta ndalin vendimin e Qeverisë? Nëse

po, është çështje tjetër, por vërtet në këtë proces, në disa procese po hyjmë me vonesë, po hyjmë nganjëherë pa bazë ligjore të mjaftueshme dhe pastaj shpejt e shpejt po na imponohen disa çështje që vërtet kanë një rëndësi të veçantë.

Nuk është çështja a jemi të djathtë apo të majtë, se çdo popull përbëhet edhe prej të majtëve, edhe prej të djathtëve. Në fund të fundit, edhe vetë trupi i njeriut e ka anën e majtë dhe të djathtë dhe nuk mund të jetë funksional. Prandaj, është mirë që vërtet këtyre qasjeve t'u qasemi me seriozitetin, jo e majtë dhe e djathtë, por vërtet a është interesi i vendit, a është interesi i qytetarëve të Kosovës dhe vërtet a po fitojnë qytetarët e Kosovës. Nëse fitojnë qytetarët e Kosovës, le të privatizohet edhe KEK-u, jo vetëm distribuimi, por edhe pjesët e tjera të tija. Por, realisht, disa gjëra nuk kanë filluar në këtë vit, këtë duhet ta kemi parasysh. Nuk ka pasur, për mua, edhe sot jam i bindur, nuk ka pasur interes më nacional, më kombëtar se sa Feronikli dhe pasuria me xehen e Feronikelit, dhe ju e dini se si ka shkuar!

Ndoshta është mirë që të ndërpritet çdo formë e privatizimit të pamenduar mirë, por e vërteta është mirë që të marrim vendime, ta shikojmë të cilat kanë qenë procedurat dhe vërtet çka i është shitur blerësit të Feronikelit dhe çka nuk i është shtirë atij?

Unë po ju them këtu, me përgjegjësi të plotë, që pronari që e ka blerë Feroniklin, ka fituar asete që nuk i ka në kontratat e tij që është nënshkruar atëherë me Qeverinë e Kosovës. Andaj, është mirë që për disa gjëra vërtet të vendosim një kontroll.

Vërejtja ime është edhe te disa deputetë, edhe te deputetët e pozitës. Deputetët e pozitës i kanë grupet parlamentare dhe disa vendime merren në grupe parlamentare. Në grupe parlamentare nganjëherë flitet diçka tjetër, në seanca parlamentare diçka tjetër! Mendoj se edhe kjo logjikë duhet të ndërpritet.

Grupet parlamentare duhet ta bëjnë politikën e grupit të tyre dhe vendimet duhet të jenë të grupeve parlamentare dhe jo t'i kemi dy qëndrime, një qëndrim në grupin parlamentar dhe qëndrim tjetër në seancë parlamentare. Kjo vërtet krijon konfuzion edhe brendapërbrenda grupit, por edhe në Kuvend dhe dëmi më i madh po i sillet Kuvendit.

Deputetët duhet të mësohen. Në Parlament vendosin grupet parlamentare, pasi ta kenë marrë vendimin e grupit parlamentar, në mënyrë që të na e lehtësojnë punën, se ne nuk mund t'i zgjasim me javë të tëra seancat e Parlamentit. Prandaj, janë të organizuara komisionet, grupet parlamentare dhe në këtë mënyrë na e lehtësojnë punën për ta shkurtuar kohën dhe për ta bërë më racionale punën e Kuvendit. Nuk mund të bëhet puna e Kuvendit racionale, nëse secili deputet e ka një mendim të vetin. Për atë arsye, edhe ne në vota kemi dalë para qytetarëve si subjekte politike, me një politikë të caktuar dhe ne tash po i mashtrojmë edhe qytetarët. A na kanë dhënë ata neve votën si individë, apo na kanë dhënë votën si parti politike të organizuara.

Prandaj, megjithatë, vendimet a janë individuale? Por, bash krejt individualisht në këtë sallë nuk kemi ardhur ne deputetët e partive politike. Prandaj, mendoj se duhet ta kemi parasysh edhe këtë. Ju faleminderit!

Ju faleminderit! Ju e keni harxhuar kohën, por megjithatë unë edhe dy deputetëve të lajmëruar po ua jap fjalën, edhe pse e kanë kryer. Deputeti Berim Ramosaj dhe pas tij deputeti Ethem Qeku.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Në fakt, më herët kam folë në emër të Grupit Parlamentar, tani po flas në emrin tim personal.

Mua po më vjen mirë logjika e mendimit origjinal, kur është në pyetje interesi nacional. Kur është interesi i Kosovës, në fakt, mos të them atë krejtësisht nacional. Tek e fundit, nuk jemi, sa e pashë unë edhe këtu, nuk jemi askush kundër procesit të privatizimit, mos të keqkuptohemi, por mbas 2010 ka mundësi t'i rregullohet performanca KEK-ut dhe vërtet të shitet me çmimin real të tregut, mos t'i ngutet ministrit, mos t'i ngutet Qeverisë. Mos më keqkuptoni. Këtë po e them edhe në aspektin profesional. Është interesi i Kosovës që të shitet sa më shtrëngtë, në qoftë se shitet. Sot nuk shitet mirë, shitet aq keq, sepse ia keni dhënë, e keni identifikuar me një performancë se është më mirë me t'i falet dikujt sesa ta mbajmë. E, nuk është e vërtetë ajo! Performancën që e ke dhënë, zotëri ministër, sa i përket KEK-ut, është aq e dobët, aq e ulët, sa që thua se ne po u dashka të ikim prej KEK-ut, lëre më ta shesim.

Ju lutem, me këtë logjikë, ne nuk jemi ofertues atëherë. Me këtë logjikë mua po ma zgjon kureshtjen, thua se ju jeni kërkesa, jo oferta. Mos më keqkuptoni, në kuptimin logjik të fjalës. Andaj, mos më keqkuptoni, në aspektin personal nuk e kam. Si ministër, po të them. Andaj, është detyrë e jotja t'ia sqarosh Qeverisë se momenti i privatizimit të KEK-ut nuk është adekuat për Qeverinë, më së pari, sepse do të vjen një gjeneratë pas nesh që ka për t'ju akuzuar shumë. Sot po e shoh edhe kryetarin e Kuvendit, që vërtet tha fjalë logjike sa i përket Feronikelit.

A e dini çka ka fituar Feronikeli? Ka fituar ndotjen e Drenicës, që po depërton ajo ndotje aq thellë, deri në Dukagjin. Kemi fituar, asgjë s'kemi fituar, humbje të mëdha kemi fituar, në fakt. Mos të na ndodhë nesër që ta vijmë situata të tilla. Ne deri tash kemi akuzuar shumë se po e bën KPA-ja, ky Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, po na e bëjnë të huajt. Sot e kemi në duart tona procesin, e në qoftë se është në duart tona, hajde të bëjmë diçka bashkërisht mirë. Më falni. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Përkundrazi, respekti për opinionin e juaj shumë të madh që e kam, më bëri shumë përshtypje. Ju folët, thatë që ka pasur ndërhyrje politike dhe dua të pyes se si mund të ketë ndërhyrje politike në një Qeveri për proceset që ka të bëjë me zhvillime ekonomike.

Folët për Feronikelin, thatë që ka edhe kontrata apo asete të cilat Feronikli është duke i shfrytëzuar jashtë kontratave të cilat janë bërë. Ja ku janë prezentë njerëzit të cilët e kanë mbajtur procesin e privatizimit të Feroniklit dhe pse nuk i denoncojmë ato kontrata? Po flasim para opinionit, para një institucioni më të rëndësishëm, Kryetar! Ju e dini që keni deklaruar se procesi i privatizimit të Feronikelit është storie më e mirë e mundshme e privatizimit në një sektor të caktuar.

Në qoftë se flasim për kontratat e energjisë elektrike që janë bërë me Feroniklin, ju duhet ta dini se ato kontrata dikush nuk i ka votuar dhe nuk i ka mbështetur. Prandaj, kur të komunikojmë me opinionin, të jemi shumë korrekt. Në fund, duhet të them se rekomandimet të cilat i kemi bërë si komision, përkundër debateve të mëdha që kanë qenë, pro dhe kundër, ato të cilat sot Berimi dhe kolegët e tjerë që po e shtrojnë se a

është koha, a është momenti, janë futur në një pikë të veçantë. Mendoj se rekomandimi i ka përmbledhur të gjitha shqetësimet që sot ju deputetët me të drejtë po i hidhni. Do të thotë, rekomandimet janë dhënë dhe a është Qeveria e gatshme dhe a janë këto në përputhshmëri me Qeverinë, unë mendoj se ky Kuvend duhet ta japë fjalën e fundit. Edhe njëherë faleminderit, që ma dhatë fjalën tri herë.

KRYETARI: Ju faleminderit! Po, edhe një herë po e them, opinionimi im për Feroniklin ka qenë prej fillimit dhe kur nuk e kam ndryshuar. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Edhe unë po kërkoj falje se sot fola pak shumë, kryetar, por... Unë mendoj se të njëjtin mendim po e ndaj me atë çka ju e thatë në fund. Ajo më shtyri ta marr fjalën sërish.

Sa i përket, në përfundim që thatë lidhur me ruajtjen e atij interesi nacional mbi këto pasuri gjatë procesit të privatizimit dhe qëndron kjo, por në qoftë se në mandatet e kaluara na ka penguar dikush tjetër të mos e vëmë debatin në Parlament, a kemi ndonjë arsye sot ne si koalicion qeveritar, PDK dhe LDK, që të mos e vëmë këtë debat në Parlamentin e Kosovës. Mbi këtë politikë dhe strategji lidhur me privatizimin, jo! E kujt do të mbetet përgjegjësia? E jona! Këtu ishte edhe thirrja ime pak më herët, në fjalimin e kaluar kur nuk ishit, do thotë, ftesa është që ta shohim këtë politikë, ta harmonizojmë këtë politikë dhe mos të vijmë në kundërshtime.

Rekomandimet janë në kundërshtim me politikën që e ka aprovuar Qeveria. Na po hymë, si të them, po e shesim, e kemi parashikuar ta shesim, gjegjësisht vitin e ardhshëm në buxhet. Unë e kam pyetur ministrin atë ditë, a është ky buxhet i qëndrueshëm, por nuk kemi marrë përgjigje, që ku është ministri këtu, se nuk pati kohë, ashtu na erdhën rrethanat. Pra, planifikimi i të hyrave, a do të garantojë që të jetë buxheti i qëndrueshëm? Unë mendoj se jo! Nuk mundemi ne, siç thuhet: “Peshku në deti, fërtelja në zjarr”. Kjo është, nuk mundet! Prandaj, edhe një replikë me ju, zoti Kryetar. Nëse ke menduar te deputetët e opozitës, ku bie edhe unë, lidhur me atë se i kanë dy lloje të qëndrime, për Fatmir Rexhepin e ke gabim. Nëse ke menduar, nëse jo, kërkujt kurgjë!

Prandaj, po të them, e ke gabim sa u përket dy qëndrimeve, që thatë se ka disa deputetë të pozitës këtu, për këtë e morra fjalën sërish, se nuk i kam dy qëndrime, atë çka e kam në Grupin Parlamentar, asnjëherë nuk e ndërroj as këtu. Aty si pëlqen as Lutës, as këtyre, po s’është dert ajo punë. Prandaj, këtë po të them që sa i përket kësaj pune, kur mos u mërzit për fjalinë time, për tjerët nuk e di.

KRYETARI: Unë nuk të kam dëgjuar kur ke folë, kështu që e ke marrë kështu. Sabri Hamiti e ka kërkuar fjalën.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar! Unë nuk jam ekspert i lëmisë, por e kam një kujtesë të mirë dhe mua më pëlqeve kur dole dhe u deklarove, sepse duke dëgjuar zotëri Rrustemin, unë i thashë, unë e pash që ka një diskordancë me ekipin çka po flet. Unë i thashë, ti po e lexon fjalimin e Jakup Krsniqit para dy vitesh dhe po me vjen shumë mirë që ju dolët dhe e thatë qëndrimin tuaj, që nuk keni ndërruar për Feroniklin. Por, qëndrimi i juaj parimor ka qenë edhe një hap më tutje, të mos privatizohen pa menduar pasuritë nacionale ose të Kosovës. Ju i gjeni, sepse fjala e thënë këtu është vepër gjithkund.

Çka desha të them? Desha të them që është një preokupim i jashtëzakonshëm i deputetëve rreth këtij problemi dhe unë mendoj që me peshë të madhe po bisedohet, sidomos njerëzit që janë edhe shumë më të zanatit, se ne disa të tjerë. Pyetja ime tash është: A do të votojmë ne rekomandimet e Komisionit, të cilat përpiqen të derivojnë procedura rreth privatizimit dhe asgjë më shumë, dhe cila është fuqia e këtyre rekomandimeve, që ne i kemi në rend dite? Dhe, pyetja e dytë është: Politikat e privatizimit të Qeverisë, në bazë të cilave kritere bëhen dhe a votohen këtu? Kjo është pyetja ime. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Më vjen keq që e morra fjalën për arsye se e di se jeni të gjithë të lodhur. Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Procesi i privatizimit, askush mos të mendojë se është një proces i lehtë dhe është proces i lehtë në kuptimin e vendimmarrjes. Procesi i privatizimit gjithkund në Evropën Lindore ka qenë një proces shumë i dhimbshëm për të gjithë qytetarët e vendeve të cila et kanë kaluar tranzicionin.

Për fat të keq, këto procese i kanë përcjellë edhe shumë dukuri negative, më mirë të themi se pak ka vende në rajon e kanë pasur një proces të privatizimit të suksesshëm, e kanë pasur transparent dhe e kanë pasur për momentin e privatizimit dobiprurës për qytetarët e vendeve respektive.

Ky proces nuk do të jetë i lehtë as për ne, do të jetë proces shumë i dhimbshëm dhe, për fat të keq, nuk do t'i ketë efektet zhvillimore e as financiare shumë të shpejta në Kosovë. Mirëpo, nga përvoja e të tjerëve, mua ma merr mendja se ne duhet të hyjmë në këtë proces. Në logjikën ekonomike ekziston një shprehje, që thotë, rreziku krijon kapital. Edhe politika nuk dallon shumë prej ekonomisë. Edhe në politikë, rreziku krijon kapital. Ne duhet të jemi shumë të vetëdijshëm se procesi do të jetë i vështirë, por duhet të hymë me një guxim të madh në këtë proces, t'i marrim disa rrezeqe, qoftë sociale, qoftë ekonomike, qoftë të natyrës personale, se do të ketë këtu, edhe vende të punës do të humbin. Nuk do të sjellin vende të reja, privatizimi nuk sjell vende të reja të punës për momentin kur privatizohet, po sjell më vonë.

Mirëpo, një gjë po ua përkujtoj se KEK-u, si një gjigant energjetik, i cili ka qenë promotor i Zhvillimit të Kosovës në të kaluarën, sot është bërë një korporatë e cila e gllabëron të ardhmen e Kosovës, edhe ekonominë e Kosovës. Nuk duhet pasur shumë dilema se ky gjigant ekonomik duhet të privatizohet. Unë pajtohem me të gjithë ata të cilët e shtrojnë si dilemë, si të privatizohet, sa do të jetë çmimi, a duhet të privatizohet me një çmim që do të jetë i leverdishëm për Kosovën? Mua ma merr mendja që ne rekomandimet e Komisionit duhet t'i aprovojnë, se janë rekomandime shumë gjithëpërfshirëse dhe e kapin esencën e problemit, procesin e privatizimit, por duhet edhe Qeveria t'i ketë parasysh dhe t'i respektojë këto rekomandime dhe në kuadër të një procesi të përsheptuar, të nxjerrë legjislacionin adekuat, që ky proces të jetë transparent, të jetë i besueshëm, të jetë me një kosto pozitive ekonomike dhe sociale për qytetarët e Kosovës. Për një kosto të mundshme, aq sa mund të shpëtohet, aq sa mund të jetë ajo kosto në këtë situatë.

Mos harroni se ai që shet, të shumtën e rasteve gjithnjë humbë, por ne jemi në atë situatë, mundet tërë buxheti i Kosovës të orientohet në rivitalizimin e KEK-ut. Buxheti

i Kosovës nuk mund ta përballojë rivitalizimin dhe të mbajë gjallë një gjigant ekonomik i cili nuk po sjellë asnjë dobi për buxhetin e Kosovës, as për taksapaguesit e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti Kryetar!

Me të vërtetë, e bëri pyetjen profesori, edhe unë do të doja ta di se mes vendimit dhe rekomandimeve ka dallim. Unë ju lus ta dijë ky Kuvend, edhe unë si deputet, edhe të gjithë të tjerët, do të jenë të karakterit obligativ këto rekomandime, apo ne veç po marrim rekomandime? Nëse janë vetëm sa për t'u dhënë rekomandimet, e nesër nuk implementohen nga Qeveria, kjo rrugë zgjidhje e këtij procesi, mendoj kjo është një çështje që na qet para dilemës, sepse edhe një herë po e përsëris, rekomandimet në terminologjinë juridike janë rekomandime, që sikur nuk të obligojnë. Prandaj, janë shumë të mira, posaçërisht e keni rekomandimin e pestë, të gjitha janë të mira në kuptimin pozitiv, krijojnë parakushte të mirëfillta për atë proces të cilin e dëshirojmë ne të jetë i suksesshëm, por vërtetë rekomandimet nëse janë të karakterit obligativ, ne të gjithë me dëshirë do t'i aprovojmë. Në të kundërtën, kjo hapur dilema sepse atëherë për çfarë ne, jo shpenzojmë kohë kot, se nuk shpenzohet koha kot, por vërtet na vë para dilemës se a duhet apo nuk duhet t'i miratojmë. Unë mendoj se do të duhej t'i miratojmë, por cila është fuqia e tyre obligative? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Atëherë, ne po e marrim një pauzë, pastaj i kemi edhe tre diskutues. Po pushojmë pak, e kam një kërkesë për të pushuar nga shefat e grupeve parlamentare. Një sqarim, Ismet. Këto janë rekomandime të komisionit, por kur votohen, nuk janë më rekomandime, janë vendime.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Ju lutem, po vazhdojmë me debatin. Kemi edhe tre diskutues. Kisha kërkuar nga 2 minuta kohë, më shumë kohë të mos na merrni!

Fjalën e ka deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, Kryetar!

Unë, thjeshtë, nuk e mora fjalën rreth çështjes së privatizimit të KEK-ut, sepse edhe nëpër debate, edhe nëpër diskutime jashtë me kolegët deputetë, sikur kemi opinion që vërtet është herët të hyjmë në fazën e privatizimit të KEK-ut, prandaj dhe mendova se do ta kalojmë pak më shpejt. Po, sido që të jetë, rrodhën debatet, rrodhën diskutimet që, në parim, po ta vlerësojmë atë që është diskutuar, ne shohim qartë që ky Kuvend nuk i jep vizën, do me thënë, nuk e përkrah privatizimin e KEK-ut, sepse u dhanë arsyet pse nuk duhet të privatizohet KEK-u. Mirëpo, unë do të ndalem tash te pjesa e fundit apo te faza e fundit, sikur u ngatërrua.

Ne e kemi një rast të freskët kur, ky Kuvend, një vendim e ka marrë për moslejimin apo mos futjen e investimeve në "Rilindje", mirëpo përkundër kësaj, Qeveria me vendimet e veta ka vendosur dhe ka filluar renovimin e objektit të "Rilindjes". Prandaj, nuk është çudi që edhe në këtë proces të futet në lojë ky Kuvend apo edhe ndoshta edhe vendimi i këtij Kuvendi të mos përfillet, por Qeveria të jetë shumë, vetë e arsyeshme dhe të vendos ndoshta krye në vete. Por, për të mos ardhur deri te këto çasje, apo për të mos lënë lojë brenda këtu në Kuvend, unë do të doja të sqaroja rreth rekomandimeve të

komisionit, që i ka prurë për Kuvendin. Prandaj, të sqarohemi drejt, sepse rekomandimet kanë qenë vetëm për Kuvendin dhe duhet të përfillen në Kuvend.

Në bazë të asaj që u diskutua, del se rekomandimet e Kuvendit duhet të shkojnë dhe privatizimi i KEK-ut duhet të bëhet diku në vitin 2010. Do me thënë, gjatë vitit 2009 të shkojë fizibiliteti i KEK-ut, mandej në vitin 2010 të shohim sa do të jetë i përgatitur për privatizim, tek kah fundi i vitit 2010, por sido që të jetë, të kuptohemi qartë, rekomandimi...

KRYETARI: Regjia, vazhdojeni edhe një minutë!

SYNAVERE RYSHA:... një minutë. Ne sot duhet të votojmë, t'i japim vizën, do me thënë, duhet të privatizohet KEK-u apo jo? Kjo duhet të jetë votimi për ne. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Myzejene Selmani e ka kërkuar fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, Kryetar! Kërkoj falje se m'u desh të flas shumë herë, por njëkohësisht kërkoj nga ky Kuvend që rekomandimet e komisionit të votohen. Në rast se është puna e komisioneve me të gjitha grupet parlamentare dhe është marrë një vendim shumë i mirë, atëherë kisha kërkuar prej jush, si kryetar i Kuvendit, të miratohen këto rekomandime të komisionit funksional të Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, Kryetar!

Unë e morra fjalën pikërisht pasi jam edhe anëtar i komisionit. Këtu po fitohet përshtypja që rekomandimet e Komisionit janë në kundërshtim me vendimin e Qeverisë. Nuk është ashtu. Edhe në Komision, kur kemi biseduar, disa takime që i kemi pasur, ne jemi pajtuar që privatizimi i këtyre dy sektorëve të bëhet. Natyrisht, duke pasur parasysh të gjitha procedurat e rregullta ligjore se si të veprohet. Këtu fitohet përshtypja që Qeveria ka vendosur t'i privatizojë me formën që ne, faktikisht, nuk e dimë dhe mënyra e privatizimit do të jetë vetëm dëm. Kjo nuk është e vërtetë.

Nëse i analizojmë 5 pikat, një nga një, të gjitha pikat i japin mbështetje Qeverisë, por natyrisht duke dashur që privatizimi të bëhet vërtet në mënyrë procedurale, në mënyrë ligjore, ashtu si duhet. Edhe në komision e kemi marrë të njëjtin vendim. Kështu që, unë nuk mendoj dhe nuk e dëshiroj që dikush këtë çështje ta trajtojë ndryshe, sepse privatizimi i këtyre dy sektorëve është shumë i domosdoshëm, duke pasur parasysh situatën në të cilën jemi.

U tha se mbi 60% ka humbje. Nuk ka humbje, vetëm vjedhje. Pikërisht ka humbje në teknologjinë shumë të vjetër të transmisionit, të mënyrës së përçarjes së energjisë deri te konsumatori. Andaj, mendoj që deputetët ta analizojnë mirë profesionalisht kërkesën e Qeverisë, sepse kërkesa është shumë e drejtë dhe kjo çështje duhet të kalojë. Faktikisht, rekomandimet japin mbështetje vendimit të Qeverisë për privatizimin e këtyre dy sektorëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Zoti ministër, fjala përfundimtare është e juaja.

MINISTRI AHMET SHALA: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Në fakt, duket Zefi e shpjegoi shumë mirë. Rekomandimet e Komisionit janë në përputhje me atë që Qeveria ka për qëllim të bëjë. Është vetëm faza ose hapi i parë drejt privatizimit të një pjese të KEK-ut.

Për ne që jemi pak më të shtyrë në moshë, para '89-ës, Elektroekonomia e Kosovës ka qenë e organizuar në pothuaj se dy njësi: Elektroekonomia e Kosovës, që ka përfshirë minierat, gjenerimin dhe distribuimin. Distribuimi, përkatësisht distribuimi dhe furnizimi, që po e quajmë, ka qenë Elektrokosova, për ata që i mbajnë në mend ato. Pra, fjala është për fillimin e procesit të privatizimit, vetëm hapi fare i parë i privatizimit të ish Elektrokosovës.

Termocentrali “Kosova C” ose Termocentrali “Kosova e Re” është një tjetër çështje, e cila do t'i përfshijë minierat dhe pjesën e regjenerimit të pasurisë nacionale, që po e quajmë. Si do të merret ai vendim, do të varet nga komisioni që udhëhiqet dhe kryesohet nga Ministria e Energjisë dhe e Minierave. Këtë sqarim desha ta bëj.

Tjetrin sqarim, çfarë duhet ta bëj, është që Ministria e Energjisë dhe e Minierave është Ministria e cila e udhëheq me politikat në sferën e minierave dhe të energjetikës.

Me Ligjin mbi ndërmarrjet publike është shumë e qartë që një komision ndërmnistror për privatizim do të themelohet, ai është me Ligj i përcaktuar, që ministri i Ekonomisë dhe i Financave kryeson, ndërsa përfaqësues permanent është ministri i Tregtisë dhe i Industrisë, përfaqësues tjetër është ministri i Linjës, në këtë rast i Energjetikës, dhe pastaj Qeveria ka vendosur që t'i futë dy ministrat tjerë, që me ligj është e përcaktuar që njëri prej tyre të jetë ministër i Minoriteteve, dhe atë është Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale dhe Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, për hir të vetë efektit që ka. Pra, ky grup ndërmnistror udhëheq procesin e privatizimit në bazë të ligjit. Plus kësaj, Qeveria, për shkak të specifikës dhe rëndësisë që ka, ka vendosur që dy zëvendëskryeministrat në mënyrë permanente të mbikëqyrin, të përcjellin secilin privatizim. Pra, zëvendëskryeministri Manaj dhe zëvendëskryeministri Kuçi.

Tjetrin sqarim, çfarë desha të bëj, mbase që u shtrua këtu me shumë të drejtë nga shumë deputetë. Kam marrë pjesë në një konferencë ndërkombëtare para nja dy-tri viteve sa i përket privatizimit të aseteve nacionale. Një profesor, me shumë renome ndërkombëtare, doli para nesh dhe e shpjegoi faktikisht. Ka qenë një pjesë, një pjesëtar i një familjeje mbretërore, këtu të regjionit, dhe ka hedhë në aukcion, në shitje pasuritë mbretërore që i ka pasur shteti. E pyeti, tha: A është turp të shitet pasuria kombëtare? Kjo është pasuri kombëtare. Tha, i pyeta fëmijën, çfarë do të bënit ju, nëse ua lë unë pas vdekjes? Ata më thanë, mami do ta shesim në qoftë se kemi nevojë. Pra, në fund ishte se do ta shesin.

Shtrohet pyetja tash, a është momenti për ta shitur? Ishte pyetje shumë e drejtë, a është momenti për ta shitur sot? Konsideroj që momenti më i keq është çfarë është sot. 1 miliardë e 200 milionë euro janë dhënë për KEK-un deri më sot, 600 e diçka milionë euro nga buxheti i Kosovës, pra nga taksapaguesit e Kosovës. Ajo zonja, më vjen keq që nuk ia di emrin, deputetja, tha para privatizimit është “sanacija”. Ne, faktikisht, që 9 vjet jemi duke e bërë sanimin, se për çdo vjet kemi “pam - pau”, që thonë, kemi hedhur

para për KEK-un. 200 milionë euro i nevojiten elektro-distribucionit, përkatësisht distribucionit në tri vitet e ardhshme për të rregulluar këtë.

A do t'i kemi t'i japim, shtrohet pyetja. Dhe, t'i përgjigjemi punës fundamentale. Dje ka përfunduar tenderi për një kompani konsultative, ku kanë marrë pjesë fatmirësisht 7 kompani ndërkombëtare, të cilat do të na ndihmojnë neve edhe juve për mënyrën e privatizimit të kësaj pjese të KEK-ut. Sa do të privatizojmë, qysh do ta privatizojmë, ne do ta dimë në mars. Pra, a bën nëse ka mundësi dhe po e përfundoj, vetëm edhe një minutë. Pra, kjo kompani që do të përzgjidhet ndërkohë, do të ndihmojë Qeverinë e Kosovës së bashku me donatorët e tjerë, harrova të them se në kuadër të këtij komisioni ndërministrorë i kemi ftuar si monitorues edhe të gjitha institucionet ndërkombëtare, Bankën Botërore, USAID-in, i cili është duke përkrah Ministrinë e Energjisë dhe Komisionin Evropian, të cilët kanë shprehur gatishmëri që ta përcjellin këtë proces me shumë vëmendje. Pra, diku e keni lexua edhe në materiale, besoj, deri më 31 dhjetor të këtij viti, ajo që u shtrua, ne besojmë se do jemi në gjendje të bëjmë “disbendëllin” që thonë pra, shthurjen që Berimi nuk e do, ndarjen ose në atë kuptim pavarësimin financiar të secilës njësi. Pastaj, deri më 31 mars do të bëhet shthurja ose ndarja juridike edhe e aseteve, deri më 31 mars, dhe pasi që të bëhet kjo, vetëm atëherë do të jetë e mundur të privatizohet KEK-u, të privatizohet pjesa e KEK-ut. Pra, unë besoj që i kemi harmonizuar shumë mirë, vetëm për hir të sqarimit e dhashë, i kemi harmonizuar mjaftë mirë me Komisionin parlamentar për Energji, Tregti e Ekonomi dhe ne besojmë që këto 5 pika janë në frymën çfarë ne p duam të bëjmë dhe, natyrisht, që do të kemi plotë debate edhe me komisione, do të kemi plotë debate edhe tryeza të rrumbullakëta, edhe paraqitje prapë para jush, për të shpjeguar në çdo hap cili do të jetë procesi i privatizimit. Besoj që qëllim i Qeverisë së Kosovës nuk është vetëm sa para do të marrim, qëllimi fundamental është që KEK-un ta sjellim në një ndërmarrje të vetëqëndrueshme dhe në një ndërmarrje që do të jetë në gjendje, nën një, të furnizojë energji të mjaftueshme, të furnizojë permanent energji të mjaftueshme, të jetë në gjendje të bëjë mbledhjen dhe ajo nuk do të varet prapë vetëm prej KEK-ut. Unë pajtohem me disa nga diskutimet kritike që ishin. KEK-u, as privat, as shoqëror, nuk do të jetë në gjendje t'i mbledh faturat e veta në qoftë se krejt shoqëria nuk i ndihmon, pra edhe policia, edhe qytetarët, edhe Ministria e Punëve të Brendshme, edhe gjyqësia edhe të gjitha këto. Është një proces. Për mënyrën se sa për qind do ta privatizojmë, prapë do vijmë dhe do të flasim te ju këtu. Këtë desha t'ju them, faleminderit shumë dhe uroj që të na përkrahni edhe në proceset e ardhshme. do të jemi shumë koshient për të marrë parasysh çdo sugjerim pozitiv që merret për të përsheptuar këtë proces. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Ju lutem, debati ka përfunduar. Keni marrë fjalën më shumë se sa që keni të drejtë me rregullore: Keni mirëkuptim, ta mbyllim këtë çështje me votim, se këto punë i ndanë vetëm votimi. Fjalët nuk ndalen kurë.

Prandaj, lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votimin e rekomandimeve të komisionit. Votojmë tash:

Prezentë janë 69 deputetë.

Konstatoj se me 47 vota “për”, 10 “kundër” dhe 8 abstenime, votohen rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion. Do të thotë, tani bëhen vendim i Parlamentit dhe bëhen obliguese për Qeverinë e Kosovës.

Urdhëro, Ramë Buja.

RAMË BUJA: Zoti Kryetar, unë u dakordova me disa shefa të grupeve parlamentare që këto tri pika të fundit, që janë kryesisht, që kërkojnë votimin, t'i shtyjme për të hënë ose të martën, meqë kemi seanca për ligjet e pakos së Ahtisarit. Ato nuk na marrin shumë kohë, ne e dimë. Kështu që mund t'i fusim këto tri pika, meqë i kemi zgjedhore në këto 2 ditë, të hënë ose të martën.

KRYETARI: Të hënë, atëherë, të hënë duhet të jetë vazhdimi, pastaj seanca tjetër, se ajo është seancë e re, kurse kjo duhet të jetë vazhdim. Jeni dakord? Të hënë po e vazhdojmë, në orën 14,00. jeni dakord.

* * *

Vazhdimi i seancës, më 15.12.2008, në orën 14:00

KRYETARI I KUVENDIT JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
Po e vazhdojmë seancën e ditës së premte. Në sallë janë të pranishëm 78 deputetë.
I nderuar Kryeministër, zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 11 dhjetor 2008.
Ju njoftoj se nga agjenda e kësaj seance kanë mbetur për shqyrtim pika 13, 14 dhe 15.

Konstatoj se në sallë janë 79 deputetë, janë plotësuar kushtet për filluar me punë. Fillojmë me pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës.

- **Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me emërimin e 2 anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë**

Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë për emërimin e 2 anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit, së bashku me dokumentacionin, u është shpërndarë deputetëve. Ftoj kryetaren e Komisionit zonjën, Myzejene Selmani, që para deputetëve të Kuvendit të arsyetojë raportin me rekomandime.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!
Përshëndetje për Kryeministrin, zëvendëskryeministrat dhe ministrat, dhe të gjithë deputetë që janë sot në sallë!

Komisioni, më datën 24.12. 2008 përfundoi me vlerësimin se kandidatët e propozuar me vendimin e Qeverisë numër 09/31 të datës 27.08.2008 për emërimin në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë i plotësojnë kushtet formale, andaj Komisioni rekomandon që Kuvendi i Republikës së Kosovës të emëroj kandidatët:

- Përparim Kabashi, inxhinier i diplomuar i elektroteknikës, dhe
- Blerim Koci, inxhinier i diplomuar i makinerisë,

anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e shëfave të grupeve parlamentare. Nuk janë të paraqitur. Atëherë, shkojmë në procedurën e votimit.

Lus regjinë, le të përgatitet për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 61 vota “për”, 9 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi emëroi Përparim Kabashin dhe Blerim Kocin, anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, me mandat për 5 vjet.

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad-hoc për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur për Media

Komisioni Parlamentar ad-hoc ka shqyrtuar listën e kandidatëve të propozuar nga Komisioni i Pavarur për Media për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur për Media dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit, së bashku me dokumentacionin, u është shpërndarë deputetëve. Ftoj kryetarin e Komisionit ad – hoc, zotin Berat Luzha, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë raportin me rekomandime.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni ad-hoc i Kuvendit për Media, i përbërë nga 14 anëtarë, është formuar në mbledhjen e Kuvendit, të mbajtur më 25 shtator të këtij viti.

Komisioni ad-hoc, duke u mbështetur në Rregulloren e Punës së Kuvendit, në rregullat 46 dhe 50.2 dhe në Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, nenin 44f, në 2 mbledhjet e mbajtura më 21 dhe 26 nëntor, ka shqyrtuar listën prej 8 kandidatëve të propozuar nga Komisioni i Pavarur për Media.

Komisioni ad-hoc, pas një procedure ligjore demokratike dhe transparente, vlerësoi dhe përzgjedhi 4 kandidatë, të cilët ia rekomandon Kuvendit për emërim si anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media. Ata janë:

- Filloreta Bytyçi, juriste,
- Sadija Nikshiq, inxhinierë,
- Agim Sopi, regjisor, dhe
- Ramë Bajraktari, jurist.

Komisioni ju ka përmbajtur plotësisht procedurave që rrjedhin nga Ligji për Komisionin e Pavarur për Media, e veçmas që kandidatët e përzgjedhur të reflektojnë përfaqësimin gjinor dhe atë të komuniteteve. Faleminderit!

KRYETARI: Shëfat e grupeve nuk janë lajmëruar për diskutim.

Shkojmë në votim.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 49 vota “për”, 25 “kundër” dhe 9 abstenime, Kuvendi emëroi Filloreta Bytyqin, Sadije Nikshiqin, Agim Sopin dhe Ramë Bajraktarin, anëtarë të Këshillit të Pavarur për Media, me mandat 2 vjeçar.

Kalojmë në pikën e pesëmbëdhjetë dhe të fundit:

- **Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad-hoc për emërimin e 4 anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.**

Komisioni Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në pajtim me Rregulloren nr. 2008/2 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil, ka intervistuar kandidatët për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit, së bashku me dokumentacionin, u është shpërndarë deputetëve. Ftoj kryetarin e Komisionit ad-hoc, zotin Hydajet Hyseni, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë raportin me rekomandime.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Zonja e zotërinj deputetë, ministra, zoti Kryeministër,

Me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të konkursit të publikuar për emërimin e 4 anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, njëri prej tyre pjesëtar i komunitetit jo shqiptar dhe jo serb, është formuar Komisioni Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, pas procedurës së selektimit mbi baza të kushteve formale në pajtim me Rregulloren 2008/12 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të kriterëve unike për të gjithë kandidatët, të hartuara nga Komisioni në mbështetjen e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë, të angazhuar sipas përfundimit Kryesisë së Kuvendit, në prani të vëzhguesve nga OSBE-ja intervistoi veç e veç kandidatët që u paraqitën në intervistë për pozitën - anëtar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Do theksuar faktin se kishte shumë kandidatë dhe në përgjithësi ishte një cilësi që meritonte shumë respekt dhe krijonte vështirësi për përzgjedhje.

Të gjithë kandidatëve të intervistuar iu janë shtruar pyetje të njëjta dhe të përshtatshme. Çdo njërit iu është dhënë mundësia e përgjigjes lidhur me pyetjet e shtruar, duke respektuar të drejtën e secilit kandidat për t'u përgjigjur në gjuhën e preferuar nga kandidati.

Në bazë të vlerësimit pas përfundimit të intervistës, e cila ishte transparente dhe e bazuar në rregullat dhe kriteret e përcaktuara, Komisioni Parlamentar ad-hoc, në pajtim me Rregulloren 2008/12 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores numër 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, Kuvendit të Republikës së Kosovës i paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

Komisioni Parlamentar ad-hoc i rekomandon Kuvendit këta kandidat për pozitën e anëtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës:

Bajram Zogjani, Medi Geci, Mursel Ahmeti, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, dhe Heset Mazrekaj, nga grupi i parë. Zgjidhen 3, janë 6 kandidatë.

Dhe nga grupi i kandidatëve nga komuniteti minoritar joserbë, janë kandidatet Bisera Spahi dhe Resmije Mumxhi.

Njoftoj Kuvendin se, sipas Rregullores, janë shumë kandidatë dhe votimi duhet të ketë parasysh këtë fakt. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Ju njoftoj se votimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës është i fshehtë.

Komisioni ad-hoc, në grupin e parë i ka propozuar 6 kandidatë, për 3 pozita dhe në grupin e dytë ka propozuar 2 kandidat, për një pozitë.

Fletëvotimi është ndarë në dy grupe. Në grupin e parë, deputeti voton tre kandidatë dhe në grupin e dytë voton një kandidat të propozuar nga Komisioni ad-hoc.

Për zbatim të procedurës së votimit është krijuar Komisioni prej 3 zyrtarëve, ndërsa punën e tyre do ta monitorojë përfaqësuesi i secilit grup parlamentar.

Kërkoj nga grupet parlamentare që të caktojnë nga një deputet, i cili do të monitorojë procesin e votimit.

Nga PDK-ja, caktoni një kandidat!

RAMË BUJA: Propozoj Nait Hasanin.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Lutfi Haziri!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Propozojmë Ismet Beqirin.

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Propozojmë deputeten Suzan Novobrdali.

KRYETARI: Faleminderit! AAK-ja, Ardian!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, Kryetar!
Propozojmë deputeten Donika Kadaj Bujupi.

KRYETARI: Faleminderit, LDD-ja!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Propozoj deputetin Naser Rugova.

KRYETARI: Faleminderit, edhe prej teje!
Grupi “7+”.

MYFERA SHINIK: “7+” Parlamentar grubundan Shpresa Murati.

KRYETARI: Faleminderit!
SLS-ja,

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!
Mi predlažemo gospodina Murselj Haljilji.

KRYETARI: Faleminderit!
Adem Grabovci,
Adem Hajdaraj,

Adem Salihaj,
Agim Veliu,

Ahmet Isufi,
Ali Lajçi,

Alush Gashi,
Anita Morina,

Ardian Gjini,
Armend Zemaj,

Arsim Bajrami,
Arsim Rexhepi,

Bahri Hyseni,
Bajram Kosumi,

Behgjet Pacolli,
Berat Luzha,

Berim Ramosaj,
Besa Gaxherri,

Bojan Stojanoviq, nuk është,
Branislav Grbiq,

Bojan Stojnoviq,
Bujar Bukoshi,

Donika Kadaj,
Dragisha Miriq,

Drita Kadriu,
Drita Maliqi,

Driton Tali,
Xhezair Murati,

Edita Tahiri,

Elhame Etemi,

Berim Ramosaj,
Emrush Xhemajli,

Enis Kervan,
Enver Hoxhaj,

Eqrem Kryeziu,
Esat Brajshori,

Etem Arifi,
Ethem Çeku,

Fatmir Limaj,
Fatmir Rexhepi,

Fatmire Berisha,
Fehmi Mujota,

Flora Brovina,
Gani Buçinca,

Gani Geci,
Gani Koci,

Gjylnaze Sylja, nuk është,
Hafize Hajdini,

Adem Grabovci,
Hajdin Abazi,

Hajredin Hyseni
Hajredin Kuçi,

Haki Shatri
Hashim Thaçi,

Heset Cakolli
Hydajet Hyseni-Kaloshi,

Ibrahim Gashi
Ibrahim Makolli,

Ibrahim Selmanaj
Ismet Beqiri,

Jakup Krasniqi
Kaqusha Jashari,

KRYESUESI NAIM MALOKU:

Kolë Berisha
Kosara Nikoliq,

Dragan Dimiq
Luljeta Shehu,

Lulzim Zeneli
Lutfi Haziri,

KRYETARI I KUVENDIT:

Mahir Yagcilar
Mark Krasniqi,
Melihate Tërmkolli
Memli Krasniqi,

Mihajllo Shqepanoviq
Mimoza Ahmetaj,
Myfera Shinik,

Mursel Halili
Myrvete Pantina,

Muzejene Selmani
Naim Maloku,

Naim Rustemi
Nait Hasani,

Naser Osmani
Naser Rugova,

Nekibe Kelmendi
Nerxhivane Dauti,

Nexhat Daci
Njomza Emini,

Numan Baliq
Nurishahe Hulaj,

Qamile Morina,

Radmilla Vujoviq
Ramadan Avdiu,

Ramadan Gashi
Ramë Buja,

Ramë Manaj

Rasim Selmanaj,

Rita Hajzeraj
Riza Smaka,

Rrustem Mustafa
Sabri Hamiti,

Sadik Idriz
Safete Hadërgjonaj,

Sala Berisha-Shala
Sanije Aliaj,

Selvije Halimi
Shkumbin Demaliaj,

Skender Hyseni,

Sllavisha Petković
Sllobodan Petrović,

Shpresa Murati,

Suzan Novobërdaliu
Synavere Rysha,

Teuta Hadri
Vezira Emrush,

Vlladimir Todorović
Vlora Çitaku,

Xhavit Haliti
Xhevdet Neziraj,

Zafir Berisha
Zef Morina,

Zylfi Merxha
Zylfije Hundozi,

Nëse ka deputet që nuk është thirrur, le të paraqitet. Nuk ka. Kërkoj që monitoruesit t'i zënë vendet e veta.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Dragisha Miriq.

Procedura e votimit është mbyllur. Ju, monitorues, mund ta vazhdoni punën tuaj. Regjia, le të kyçet mikrofonin qendror!

NAIM MALOKU: Tash komisioni i votimit fillon numërimin e votave.

ISMET BEQIRI: Fletëvotimi i parë për grupin e parë është i pavlefshëm, sepse janë votuar 4, domethënë Bajram Zogiani, Murseli dhe ky është i pavlefshëm. I pari, është i pavlefshëm.

E shënoni: Bajram Zogiani, Nysret Ahmeti, Heset Mazrekaj, grupi i parë.

Ishte, Bajram Zogiani, Nysret Ahmeti, Heset Mazrekaj.

Grupi i dytë: Resmije Mumxhi, edhe ky është një fletëvotim i rrumbullakësuar dhe nuk është as me iks, do të thotë edhe ky është i pavlefshëm. Nuk e ka bërë iksin, por është i rrumbullakuar.

Fletëvotimi tjetër i radhës është në rregull: Bajram Zogiani, Bajram Ajeti, Heset Mazrekaj.

Në grupin e dytë: Bisera Spahi, Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Heset Mazrekaj dhe Resmije Mumxhi. Ky nuk ka votuar, veç Bisera Spahi, tjetër s'ka votuar. Domethënë është në rregull: Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Nysret Ahmeti dhe Bisera Spahi.

Fletëvotimi i radhës: Bajram Ajeti, Nysret Ahmeti, Heset Mazrekaj dhe Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nysret Ahmeti dhe Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Bisera Spahi.

Kjo e ka vetëm Bajram Zogiani.
Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Bisera Spahi, Heset Mazrekaj. Më falni! Edhe Heseti është në këtë fletëvotim.

Bajram Zogiani, Mursel Ahmeti, Bajram Ajeti, të tjerë nuk ka.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nysret Ahmeti dhe Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mursel Ahmeti, Heset Mazrekaj, Resmije Mumxhi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nysret Ahmeti dhe Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Bajram Ajeti, Heset Mazrekaj dhe Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Bajram Ajeti dhe Resmije Mumxhi.

Mursel Ahmeti, Bajram Ajeti, Heset Mazrekaj, Resmije Mumxhi.

Ky fletëvotim është i pavlefshëm sepse janë votuar 4 vetë, është fjala për grupin e parë.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Haset Mazrekaj dhe Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Haset Mazrekaj dhe Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Haset Mazrekaj dhe Resmije Mumxhi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nysret Ahmeti dhe Bisera Spahi.

Ky fletëvotim ka vetëm Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Haset Mazrekaj, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Bisera Spahi.

Mursel Ahmeti, Nysret Ahmeti, Haset Mazrekaj dhe Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Nysret Ahmeti dhe tjetër s'është votuar.

Bajram Ajeti, Nysret Ahmeti, Haset Mazrekaj, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Bisera Spahi.

Në këtë fletëvotim është vetëm Bisera Spahi, domethënë në grupin e dytë.

(Ndërprerje e shkurtër)

Regjia, mikrofonin e aktivizoni. Okej. Edhe një herë po e përsëris të njëjtën, por mos i përsëritni votat.

Ishte: Mursel Ahmeti, Nysret Ahmeti, Haset Mazrekaj, Bisera Spahi.

Bajram Ajeti, Nysret Ahmeti dhe Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Haset Mazrekaj, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mursel Ahmeti, Haset Mazrekaj, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci

Nysret Ahmeti, Bisera Spahi, Bajram Zogiani.

Bajram Ajeti, Bisera Spahi, Bajram Ajeti.

Haset Mazrekaj dhe Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Haset Mazrekaj dhe Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Nusret Ahmeti dhe Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mursel Ahmeti, Bajram Ajeti, Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti,

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Resmije Mumxhi.

Bisera Spahi, ok, për të besuar që është tri herë, e paska rumbullakuar.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Resmije Mumxhi.

Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Eset Mazrekaj, Resmije Mumxhi.

Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Eset Mazrekaj, Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Nusret Ahmeti, Eset Mazrekaj, Resmije Mumxhi.

Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Nusret Ahmeti, Resmije Mumxhi.

Mursel Ahmeti, a e shenuat, Bajram Ajeti, Eset Mazrekaj, Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Resmije Mumxhi.

Musel Ahmeti, Nusret Ahmeti, Eset Mazrekaj, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Bajram Ajeti, Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Bajram Ajeti, Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Resmije Mumxhi.

Mehdi Geci, Nusret Ahmeti, Eset Mazrekaj, Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Nusret Ahmeti, Eset Mazrekaj, Resmije Mumxhi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Eset Mazrekaj.

Te unë është e pavlefshme, sepse i ka ra vi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti dhe Bisera Spahi.

Këtu e keni vetëm Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Nusret Ahmeti, Eset Mazrekaj, ska tjetër.

Mehdi Geci, Nusret Ahmeti, Eset Mazrekaj, Resmije Mumxhi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Bajram Ajeti dhe Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti dhe Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Eset Mazrekaj.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti dhe Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti dhe Resmije Mumxhi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Eset Mazrekaj, Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mursel Ahmeti, Bajram Ajeti, Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Eset Mazrekaj, Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Resmije Mumxhi.

Mehdi Geci, Nusret Ahmeti, Eset Mazrekaj dhe Resmije Mumxhi,

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Eset Mazrekaj dhe Bisera Spahi.

Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Eset Mazrekaj, Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mursel Ahmeti, Eset Mazrekaj, Resmije Mumxhi.

Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Eset Mazrekaj, Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Eset Mazrekaj, Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Resmije Mumxhi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Nusret Ahmeti, Resmije Mumxhi.

Mehdi Geci, Nusret Ahmeti Eset Mazrekaj, Resmije Mumxhi.

Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Bajram Ajeti dhe Bisera Spahi.

Mehdi Geci, Bajram Ajeti, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, Mehdi Geci, Mursel Ahmeti, Bisera Spahi.

Bajram Zogiani, do me thënë, fletëvotimi i fundit është Mehdi Geci, Mursel Ahmeti dhe Resmije Mumxhi.

Ju faleminderit, tash do t'i numërojmë dhe do t'ju raportojmë.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Lus regjinë që t'i ftojë deputetët të kthehen në sallë!

ISMET BEQIRI: I nderuari kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni të lexoj raportin mbi rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Në mbështetje të nenit 65, pika 1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe të nenit 1 të Rregullores nr. 2008/12, për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, Komisioni votues, në përbërje nga përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare, në seancën plenare të mbajtur më 15 dhjetor 2008, pas numërimit të votave konstaton, si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 107 deputetë. Pjesa e parë e fletëvotimit, do të thotë nga komuniteti shumicë, janë këto vota:

- Për Bajram Zogianin, kanë votuar 48 deputetë,
- Për Mehdi Gecin, 70 deputetë,
- Për Mursel Ahmetin, 36 deputetë,
- Për Bajram Ajetin, 49 deputetë,
- Për Nusret Ahmetin 40, deputetë dhe për
- Eset Mazrekaj, 39 deputetë.

Të pavlefshme kanë qenë 4 fletëvotime.

Për Grupin e dytë të kandidatëve për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës është votuar kështu:

- Për zonjën Bisera Spahi, kanë votuar 55 deputetë,
- Për zonjën Resmije Mumxhi, 37 deputetë.

Njësoj kanë qenë të pavlefshme 4 fletëvotime.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me Rregulloren, gjegjësisht Rregullën 31.3 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, konstatohet se këta anëtarë janë zgjedhur anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës me mandate 5 vjeçar, si vijon:

- Mehdi Geci, me 70 vota,
- Bajram Ajeti, me 49 vota,
- Bajram Zogiani, me 48 dhe
- Bisera Spahi, me 55 vota

Ne të gjithë e kemi nënshkruar, normalisht, këtë Raport.

Sukses këtyre që janë zgjedhur në një punë sigurisht të përgjegjshme.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë, me kaq konstatoj përfundimin e punimeve të kësaj seance plenare.

Tani kemi 15 minuta pauzë, e pastaj vazhdojmë me seancën e radhës, që është seancë e veçantë plenare. Ju faleminderit!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve